KRISTO FLOQI

KATËR DRAMA

Historike kombëtare

*Fè e Kombësi
*Piro Neoptolemi
*Karllo Topia
*Triumfi i Lirisë

Tiranë 2024

FÉ E KOMBËSI

DRAMË KOMBËTARE

ME KATËR AKTE DHE KATËR TABLLO

Prej

Kristo V. Floqit

SOFJE

Shtypur ndë shtypëshkronjët “Mbrothësija” Kristo P. Luarasi
Ulitsa Tsar Simeon 60
1914

FE E KOMBËSI

RAMË KOMBËTARE

RË AKTE DHE KATRË TABLLO

Prej

Krist. V. Floqit

BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË
555
1
123

SOFJE
Shtypur ndë shtypëshkronjët „Mbrothësija" Kristo P. Luarasi
Ulitsa Tsar Simeon 60.
1914

Parëthënje.

Ç' do komp hapi sytë; veç ne Shqipëtarët mbetëmë pas; shkakun e dimë dhe ësht' e tepër t'a përsëritim. Një nga vegëlat më të çmuara të diturisë është pa fjalë edhe **Dramatologjia** *e cila e zgjon popullin në pun' e në detyrë, në përparim e në vepra. I rrënjoset në mëndje si vijat e fella të vijavitura në mermer a në granit a si ngjyr' e fortë në një fytyrë klasike. I japin një përshtypje ta pashojtur për jetë e i tregojnë rrugën e Vepërimit e të Qytetërisë.*

Kësisoj, dyke qenë çështja e **Dramatologjisë** *është mëkat të lihet prapa nga ne Shqipëtarët. Gjuha jonë është mjaft e plottë për të tilla gjëra dhe vjershërimi e stihurgjia[1] mjaft të gjëra e pëllore në pikpamjen dramatike.Nga ana tjetër në historinë t'onë kombëtare kemi mjaft lëndë dramatologjie, jo vetëm të kohërave të para, po edhe të ditëve të sotme, sa na tepërojnë edhe të huajmë akoma. Përandaj është mëkat, dhe e pa-arësyeshme të huhemi[2]neve nga të huajtë dyke pasur t'onat.* **Besa** *edhe* **Mëmëdheu,** *të përkthyera të dyja nga turqishtja s' munt të quhen të dramatologjisë t'onë, me tërë që përkthim' i tyre ka qëllim kombëtar, sepse u shkruan pik-së-pari në gjuhë të huaj.* **Pirrua***, a* **Vdekj' e Pirros** *e Z. Mihal Gramenos, mikut t'im, është me të vërtet e para dramë kombëtare e shkruar më gjuhë shqip prej Shqipëtari.* **Israilitë e Filistinj** *të mikut të dashur të përndershmit At Fan Noli është edhe kjo dramë prej Shqipëtari edhe në gjuhën shqip, po për fat s'munt të vihet në sërën e dramave shqip kombëtare, me që lënda është jehudishte. Fundi,* **Tregtar' i Vlorës** *e përkthyer nga frëngjishtja edhe e botuar nër shtyllat e* **Diellit** *prej mikut t'im të çkëlqyer Z. Faik Konitzës vërtet është një komedi kombëtare, po* **Fe e Kombësia** *që sheh sot dritën është e para dramë më lëndën fjesht kombëtare, e ngjarë pothuajse në ditët t'ona, e shkruar shqip me qëllim edhe me shkak të*

[1] Stichos = vargje të një vjershe. Stihurgjia = doktrina e vjerrshtorisë

[2] huhemi = marrim uhâ

gatitur për kombin t'onë. Kësisoj edhe në këto mënyra e qëllime kemi edhe të tjera vepra, gati për të dalë në dritë.

Shkaku që u ndërtua në vjersha është më fort lehtësir' e popullit e të ç'do njeriut me të cilin munt t'a kupëtonjë e t'a marë vesh më mirë e të mos e harronjë kurrë, se sa po të ish ngrehur në gjuhë kombase.

Tani,në goditmë a jo qëllimin t'onë me të cilin vruluam të qitim këtë veprë në shesh, këtë të tjerë le t'a kritikojnë e t'a gjykojnë. Unë u lutem lëçitësve të dashur të m'a falin ç' do mëkat a gabim dhe do të jem i lumtur po të shoh në kohën e pritme të dalin të tjerë më të stërvitur se mua për nderin dhe përparimin e Kombit e të Mëmëdheut.[1]

Kr. V. Floqi

---

[1] Sipas Kristo Floqit ai e ka shkruar këtë dramë në Vlorë në vitet 1908-1909

Lënda e dramës

Zylyftar Poda, nja nga krerët e kryengritjes të vitit 1831, si mundi ushtërin' e Mehmet Pashës edhe shpëtoj kalat' e Melesinit edhe Podën, kthehet me kordhëtarët e ushtërin' e tij në fshat të tij Podë edhe qëllon mi këtë gas mundësie të martonjë edhe të bir' e tij Ganinë me të bijën e kryeushtarit tij Rakip beut, me të cilën i kanë vluar që vogëlie. Po Ganiu nuk e dô Latifenë, po shërbëtoren e saj Marron, që ish keq e bukur. Kur çpall Ganiu mendimin e tij që dô Marron e jo Latifenë, i ati i tij Zylyftari egërsohet e qit koburen të vrasë të birë po e mpron Marua me krahëror' e saj, dyke dashur kjo të bëhet theror për Ganinë, të cilin e dô me shpirtin. Nga ky shkak Latifeja e dëshpëruar bie në lëngim edhe dergjet gjer sa vdes.

I at' i saj Rakip Beu, i cili e donte keq Latifenë, kërkon të vrasë Ganinë të marrë gjakun e së bijës, po kur hasen të dy çveshur jataganët, Ganiu e thyen vetë të tinë e heth në këmbë të Rakip Beut,dyke lypur ati t'i bjerë, po Rakip Beu, i cili e ka rritur Ganinë që në foshnjëri, shastiset ahere dhe vret vet-vehten e rrëzohet përmi Latifenë,të cilët i varrosin më një varr. Më së fundi si bindet Zylyftari me të shoqen që s' kanë ndryshim Shqipëtarët midis tyre, Myslimanë janë a të Krishterë edhe që s' lipset vërejtur oxhak e sërë përpara njeriut, bëhet dasm' e Ganiut me Marron zyrtarisht. Po Bidua, një shërbëtor i vjetër i Rakip Beut që s' ka ngushëllim për humbjen e të zotërve të tij, dyke qenë fshehur, kërkon të hyjë atje ku dëfrejnë, t'u prishë dasmën e të vrasë Ganinë dhe Marron, sa i harron të gjitha edhe e quan Marron bijë, në vent të bijës së tij që i vdiq që moti. Kështu bashkohet dhe Bidua me tá e dëfrejnë tok keq të enthusiasur për kombësinë, së cilës ja njohin vleftën e lartër.

Rollësit e Dramës

ZYLYFTAR PODA.	. . .	50 vjeç
MANUSHJA	- e shoq' e tij. . .	40 "
GANIU	- I bir i tyre. . .	22 "
RAKIP BEU	- kryeushtar i Zylfo Podës	45 "
LATIFEJA	- e bij' e tij. . .	19 "
BIDUA	- shërbëtor i vjetër i Rakip Beut	70 "
NGJELINUA	- shërbëtore e Rakip Beut. . . .	48 "
MARRUA	- çup e bukur, e bij' e saj. . . .	18 "
MERSINI	- trim, kordhëtar[1]' i Zylyftarit. .	25 "
AHMET BEU ZABOVA	- trim, kordhëtar' i Zylftarit. . .	70 "
ALIKO PRODANI	- kordhëtar' i Zylyftarit.	40 "
ELMAZI	- trim . . .	35 "
NJË KALORËS	- mandatar i ushtërisë Podës. . .	25 "

(Popull burrash, grash, kalorës e ushtarë)
Sqena në Podë, afër Leskovikut, më 1831 Pas Kr.

Mburimet e dramës

Auguste Dozon, consul de la France. Manuel de la langue Albanaise. Deuxième partie *chansons*.

Bletta Shqiptare (1878) e t'im gjyshi Efthim Mitkos.

Këngëra popullore që dëgjova në Kolonjë dhe në Leskovik.

Copra istorirash, të mbledhura andej këtej.

[1] kordhë = një lloj shpate pak e kthyer në majë dhe që pret vetëm nga njëra anë.

Pamj' e parë.

(Theatrua represanton konakun e Zylyftar Podës në Podë, shtruar mir'e bukur. Zylyftar Poda me çibuk në gojë po heq tym dyke mentuar. Është natë)

Sqen' e I

ZYLYFTAR PODA
(*Vetëm*)

ZYLYFTARI
(*dyke u ngritur*)

Prolog

O kalat' e Melesinit, o fortesa të dëgjuar
Ju, o gërxhe, o moçale, o shkëmbënj keq të tmerruar,
Ti moj Podë, Poda plakë, moj folè e trimërisë,
Fshat i lart' e i bekuar, q'i dhè famë Shqipërisë !
Zot' i math u falt' uratë, e u dhëntë dit' e shpresë,
Ju çkëlqeftë gjithë jetën, për nderimn' e mëmëdhesë.
Ju, o fusha, ju bregore, o përenj që gjithë rithni
Ju lumënj kaq të kulluar që valoni edhe brithni,
Mbani pak ushtimnë t'uaj, mbani rugën e qëndroni,
Ejani pushoni pak, Zylyftarë të dëgjoni,
Që ka dit' e net pa gjumë, i këputur e i vrarë,
I munduar nga mejtimi, i rronitur[1] e i tharë !
Qysh do marrë tragën[2] vallë, këjo luftë e pa-prerë
Që na xhvat lëkur' e eshtra, dhe na le kaqë të mjerë !

[1] ronitur = i dërmuar, pafuqi
[2] traga = drejtimi që do marrë një punë ose një ngjarje

S’ na qe mjaft sa pam’ e hoqmë, s’ na ish mjaft poter’ e shkretë
Që na rroku djelmurinë, burrat që përpinë retë.
Që i qan Atdheu i gjorë, i vajton gjith’ Shqipëria
Nëna, motra, nuse, vajza, që po vdesin nga uria !
Nuk harinin hidhërimet që na pikëlluan fare
Po na vjen dhe Mahmut Pasha me ordhitë gjakatare,
Të na bjerë, të na rrokë, të na kapë posi zoga,
Se kështu urdhron Dovleti, q’i paguan kaqë roga !
Më qafë na past’ armiku, që kallzon e çpif pa qënë,
Ishte *taksirat* reziku, ky rezik na ish thënë !
Mahmut pashë kumandani me ushtri si mizëria,
Këtë radhë vjen me topa, me gargi[1] e me boria
Vjen të na zaptonjë Podën, t’ ja falë prapë Sulltanit,
Pa përmendur edhe Zylfon, që i falet jataganit.
Edhe pushkës e pisqollës, dhe pallaskave[2] të lara,
Që me grusht e ha barutin e fishekëtë me bara !
O Mahmut, o qime bardhë, q’e ke gjoksin plot *nishanë*
Ç’ i pandehe Shqiptarët ? S’ ju a njohe jataganë ?
S’ janë berra, s’ janë kafshë, që t’i lithç t’i heqsh zvarë
Ik lark nga Poda plakë, s’e ke njohur Zylyftarë !
O Mahmut, o mjekër thinjur, të paska gënjyer mëndja,
Mërgohu nga këto rripa, se as kurrë s’ bëhet t’ëndja.
Poda pâ si ty pa masë, e ka embrin Poda plakë,
I ka trima të rallë, burra me zjar e me flakë !
Shëko majatë dhe brigjet, pyeti se ç’ kanë parë,
Ka rijedhur gjaku lumë, janë mbushur me të vrarë,
Poda, Shalësi, Barmashi kanë burra luftëtarë,
Ik o Mahmut Pashë, ikë, se s’ ke parë Kolonjarë !
(*dyke mentuar pak*)

[1] gargë = gëzhojë fisheku
[2] pallaska = rrip lëkure për të mbajtur fishekët kraha-qafë

Ç’ na u bë Rakipi vallë, dhe Mersini kapedani
Edhe ky Ahmet Zabova me Alikon nga Prodani ?
Zot’ i math e Perëndia qofshin mpronjës e mburesë !
Se n’ ata mvaret pothua ç’ do pandem edhe ç’ do shpresë !
Ç’ bënet vallë kull’ e Qarit ? ah, o Rakip bej o burrë,
Më të lumtë ajo shpatë, ti për mua mos vdekç kurrë !
Djemt’ e mij, o bijt’ e dashur, q’u do shumë Zylfo plaku
Që për nder’ e Mëmëdhesë çurk e çurk ju vajti gjaku;
Ku më jini, o luanë, o petritë kaq të rallë,
T’ ju dëgjonj edhe nj’ herë zëthin !....
Do t’ju shoh edhe nj’ herë vallë ?
Zot’ i math ju qoftë pranë, ju shpëtoftë Perëndia,
Se me trinërinë t’uaj, mburret gjithë Shqipëria.
Shkodër, më të faltë Zoti, a e kujton Zylyftarë,
Që kullon posi qiriri pshtjellë qark me ushëtarë.
Shkuan ditët e po shkojnë, kalon moti me të shpejtë,
Dhe Shkodranëtë na lanë në rezik e në të metë !
Si do bënj me një grusht trima kundr’ armikut si mizëria ?
Do shuhemi të gjithë ! Na shpëtoftë Perëndia !
(*vjen pranë derës*)

Edhe po më s’ ka të gdhihet, që të marrim nonjë fjalë,
Është mvrërët, errësirë, Yll’ i Mëngjezit s’ ka dalë.
(*me një psherëtimë*)

Si duron kjo zembra ime e s’ pëlcet s’ bëhet thrime,
Vallë si do qëndrojmë ? Qaj e qaj o zembra ime !
(*dyke marrë shpresë*)

Po jo, jo se s’bëhet kurrë, s’ qajë burra me besë,
E qara ka hie gruas, burri duhet të vdesë !

Është turp për Zylyftarë të merret me psherëtime,
Këtë mos e dhënt' as Zoti, sa të rronjë shpata ime !
Jemi burra Shqipëtarë e me famë të dëgjuar,
Ti, o Zot, forcona krahun, mos na nxir të turpëruar.
(*Dëgjohet një ushëtim kuajsh.*
Zylyftari mban veshin e dëgjon)

Pa dal, pa dal se po dëgjoj ca këmbë kuajsh që po vinë,
Qysh më lëfton kjo zembra, sot për trimat t'an e për Ganinë !
Ja tek përndanj atje përtej një hie q' ikën si shigjetë
Si shpesh po prihetë këtej po breth si plumbi me të shpejtë.

Sqen' e II
ZYLYFTAR PODA edhe KALORËSI

KALORËSI

T' ngjatë jeta, Zylfo bej !

ZYLYFTARI

O mir se vjen, o bir i dashur.

KALORËSI

Lajme të keqe po të sjell, më mirë të kisha plasur !

ZYLYFTARI

Bir, mos hump shpresën, mos u tremp, ç' do gjë që ke eja, rëfeje
Mba frymënë e çlodhu pak, eja afrohu afër meje.

KALORËSI

Jemi të humbur e pa shpirt, armiku t'onë s' na la shpresë
Na ka rethuar reth e qark! Po burratë me besa besë,
Kanë dy ditë edhe dy net që po lëftojnë si të marë.
Gjaku ka vatur gjer më gju, s' ësht' as e gjegjur as e parë.
Topi po rreh e po dërmon majat e thata të Melesinit,
E kumbaraja copëton ushtrin' e gjorë të Mersinit
Kalat' e vjetra si vollkan kan' hapur zjarë an' e mb' anë,
Dhe ushtëria si rufe po përhap vdekjen e zapanë
Pushkat kërcasin me buçim, plumbat si breshër rëkëllehen
Sfungjit' e pàllat me vrëngllim po çpojn' e presin; prapë s'kthehen
(*enthusiaset dyke rëfyer*)

Ago Mersini, sy shkëmdi, gjithë dëgjohet dyke britur,
Burrat e djemvet po u thret me zë të fortë e të mahnitur.
Së qysh u derth ca ushtëri prej ushëtarët e Mahmutit,
Që të zaptojnë n' Allonaq kalat' e vjetra të Barutit,
Po kur u derth Mersin agaj, bashkë me Mete kapedanë,
Me një grusht trima plot me shpirt kapnë dyfek e jataganë,
Edhe u sulë me vërtik buçitnë kodrat e përënjtë,
Edhe sa kaq' armiku u cbyth, e humbi shpresën edhe mëntë
E s' mbeti këmbë syresh më, e humpnë fare terezinë,
E më s'i lanë gjallë dot që të zaptojnë Melesinë !
Po ushtëria pas atë shumë më tepër u forcua,
Zembrim, mërî, i shtoj më keq, sa u mahnit e u marua !
Kështu fortesa e kala e ushtëria gjithë ç' janë,
U piskëllua reth e qark, u rotullua an' e mbanë !
Ndodhemi gjithë në rezik e si të bëjm' as neve s' dimë,
Lipset të biem gjer më një, të çveshim kordhat a të rimë ?
Tani dërguar jam te ti, nga burrat t' anë kordhëtarë,
Qysh të punojmë paskëtaj pyesin ju si kryetar.

ZYLYFTARI
(*burrërisht*)

Ishte nevojë sot ata, burra të zgjedhur luftëtarë,
Të prisnin udhën t'u tregonj, a ç' farë rugë duhet marë ?
S' janë të sotmit, as të rinj, që rokin shpatënë në dorë
Si të lëftojnë burrërisht, a si të bien dëshmorë !
Eja u thua, që me vrap të çveshin fora jataganë,
Edhe të derdhen si dragonj, t'u kllasin dërmën edhe danë.
Si Shqiptarë, si fisnik, si burra trima e me besë,
Le të ftojnë Melesin' a ndryshe këmbë le mos mbesë.
Mërgohu, biro, hiq me vrap, bëmu të fala ushtërisë,
Frikë mos ket' ay që do të ket' uratën e Shqipërisë.
(*Kalorsi u falet nderës e del jashtë*)

Sqen' e III

ZYLYFTAR PODA vetëm,
pastaj MANUSHJA

ZYLYFTARI
(*prapë i mejtuar*)

Eh, o moj Podë, o vëndi im, që të kam mprojtur me pallë
E ti shtëpi e dashur fort si do t'ju vejë filli vallë !
(*hyn Manushja*)

MANUSHJA

Mirdita, burrë, qysh më je, qysh m'a ke shkuar këtë natë,
Kam orë që po të dëgjonj që po fjalon o jetë-gjatë.
Qysh nuk fjete po qëndron natën e tërë i mejtuar

Ç’ munt të të bije, o im zot, që të të shoh të lehtësuar ?
Të shoh të trëmbur e më vjen sikur gjësendi na ka gjetur
Se ndryshe gjer në zbardhëllim s’ muntnje të rinje pa fjetur.

ZYLYFTARI
(*ia pret fjalën*)

Manushe ler’m’ e mos më nga se s’është gjë, po ri e qetë,
Po të kish ngjarë nonjë gjë nuk do ta thosha vetë ?
Po hiq të lutem e na shtro, bëna gati konakn’ e parë,
Se ja u gdhi e mase vjen nonjë nga burrat luftëtarë.
(*Si shkon Manushja ngreh duart përpjetë*)

O bir’ i vetëm, o Gani, q’u rrite kaq me përkëdhele,
Je vallë gjall, o bir im ? apo të çvatnë posi dele!
Ti s’pate parë *batare,* s’e dinje luftënë të reptë,
Se je i mitur e djalosh, po s’ të la zembra të rrish qetë.
As mëm’ as babë s’vure re porsa dëgjove topn’e parë,
As Latifenë, që të pret të rroni bashkë të pa ndarë.
O Rakip bej, o vllathi im, qysh s’ t’ ardhi keq për Latifenë
T’ a lesh e t’ ikësh me vrap që të lëftosh për Mëmëdhenë !
Po mbahe shpresën, shoku im, se Zot’ i math na ka mëshirë,
Besonj me hirën e Ati të ndodhemi një ditë të lirë,
Që të dëfrejmë edhe ne të zbavitemi një herë,
Dykë martuar djemt’ e rinj si kemi fjalënë, në Verë.
Janë zambakë që të dy, një bozilok, një trëndafile,
Posi burbuqetë në Prill, si manushaq, si karafile.
Gjer sa t’ i jepetë një funt, gjer sa të mbyllet luft’ e pshtirë,
Do të durojm’ o Rakip bej, në mos me pahir me të pahirë.

Sqen' e IV

ZYLYFTARI, MANUSHJA, pastaj BIDUA

(*Hyn Manushja në sqenë*)

MANUSHJA

Të gjitha ndodhenë gati, si pas urdhratës Zotris s' ate
Urdhro në daç, të prehësh pak, të harosh hidhërimet që patte.

ZYLYFTARI

Më rrofsh, Manushe, e më qofsh që m' a ke kaqë dashurinë,
Mos u helmo të lutem fort, të përgjëroj Perëndinë
Mendonj Ganinë kur t' a shoh, kur t'i përzjenj me Latifenë
T'i shoh bashkuar që të dy, një shpirt, një trup të dy të kenë
Se mir' e di, Manushe ti, se qysh e bëmë vlimn' aherë,
Që kur Ganiu ish *çilimi* e vluam djalthin në Prinverë.
M' atë q' e shoq' e Rakip beut, e ndyera Zeinep Kadënë
Do linte, vajzë po të ish, e me fytyrë posi Hënë,
Si Latifen e Rakip beut, që ndrin si ar, si moll' e kuqe,
Muntnim të gjenim për t' im bir, Manushe, çupë si burbuqe ?
Ç' thua Manushe?

MANUSHJA

Po, im Zot, ësht' i goditur shumë bukur,
Ky vlim i vyer si për tá nga Perëndia ësht' i dukur.
Veç të na rrojn', i lënçim pas, bekime paçin e uratë,
Qofshin të lumtur e me fat, qofshin për herë jetë-gjatë.

BIDUA

(*porsa hyn në sqenë; vjen të marrë nonjë lajme për Rakip benë*)

ZYLYFTARI

Po ti, o Bido, qysh e sheh, vlimn[1]' e bashkimn' e sat' zonje ?

BIDUA

Të qofsha fal' o kryetar... Atë dhe unë' i ziu mentonje.

ZYLYFTARI

Ç' bën Latifeja ?

BIDUA

Po qendis, po merret pak me avlimëntnë,
Po bën gati ç' do q' i mungon e po loth krahët edhe mëntë
Po bën ca shtresa me mjeshtri, s' përton e s' lodhet dit' e natë,
Si të të thom, o kryetar, çupë si tê s' ka m'e begatë.

ZYLYFTARI

Na rrofshin, Bido, Zot' i math të dyve neve na i faltë,

BIDUA

Të lumtë goja, o im Zot, me fjalët t' ëmbla posi mjaltë.

[1] vlim = fejesë

ZYLYFTARI

Bido, i besës shërbëtor, ri pak këtu, se ne do shkojmë,
Do ngjitemi pak në konak t' ormisim dhomën e të shtrojmë
Se mase vjen nonjë njerî prej burrat t' anë luftëtarë,
A nonjë tjatër, kush e di, ushtarë, kalorës, mandatarë.
Andaj të ndodhemi atje, të presim miqt' e t'i përcjellim
Edhe ti, Bido, biri im, porsit ç' të duash të të sjellin
Eh ! lamtumirë, Bidua im.

MANUSHJA

Bido besnik të le shëndenë,

BIDUA

Urdhroni bashkë me shëndet.

ZYLYFTARI

Drejt në konak ja mbajmë penë.
(*Zylyftari me Manushen për krahu*
dalin jashtë)

Sqen' e V

BIDUA
(*vetëm*)

O sa të mirë që të dy, sa u ka duk fjala e shije,
O sa të ëmbël zotrinj, e sjell' e tyre sa ka hie !
O Zot i math, o Perëndi, ti qofsh me tá, i mprofsh për jetë,
Bekoji që të dy, o Zot, o Zot i math e i vërtetë.
(*vete shëkon ne dera se mos duket njeri*)

Të gjitha mirë....Po mungon edhe një lajme luftëtare,
S' dime qysh vate filli yn, s' muarrm një lajme ushëtare !
Burrat me besë e fisnik që mprojnë malet' e Melsinit
S' dimë se qysh janë, edhe qysh u suall trimat e Mersinit !
Pastaj më fort për t'im zot, për kordhëtarë Rakip bejnë
S' dimë se ç' bëhet për mbi Qar, s' dimë ç' tregojnë e ç' rëfejnë!
(*dyke marrë kujdes më tepër,*
e dyke unjur pak zënë)

Pa le këto, po qysh të bënj, unë vobeku për Latifenë,
Ah, o im zot, o Zylyftar, si do të bënj për Rakip bejnë,
Ku dini juve ç' ngjet këtu, që kur u nis kjo luft' e shkretë
Ah, qysh të bënj, qysh t' a tregonj, ah msomë ti, o Zoti vetë !
Më thresin "Bido Besnik" po ç' besë kam, haj un' i mjeri
Kur zembra ime s' tregon dot, kur ment pëlcas i ziu së zjeri !
Një shërbëtore, mituri, bijë kopileje[1] nga Kolonja,
Që në konake të shërben që kur ish gjall' e mjera Zonja,
Çupë të varfër e vobek që rron dhe sot me thrimet t'onë
Marron, fatkeqen, që s' shoh dot, që shërben bejnë gjithëmonë
Na do Ganiu !...Ah, po ç' të thom, se s' ësht' e par' e gjegjur kurrë
Oxhak prej beu, **oxhak** i math, krushqi të bënjë me **kaurë** !!
T'a dij' e gjora Latife, që vritet fare për Ganinë
Se Gani beu me gjithë mënt i hodhi Marros dashurinë !
Si do durosh, moj Latife, moj vajz' e bukur që s' ke shoqe,
Të shohç Ganinë q'e dô keq të ketë Marronë për shoqe !
Ah, Perëndi, mos e pranofsh, ti që je Zot i vërtetë,
Oh, mos u bëfsh kurrë **kail**[2] të lesh Latifenë si të shkretë !
(*S'i mbahen lottët edhe ze qan me zë të shembur*)

[1] kopile – shërbëtore e caktuar për të bërë punë të rënda
[2]kail = jam gati të bëj diçka

E ç' i pëlqeu Marros Ganiu, fisin e saja të begatë ?
A mase **nazetë** që ka, që vjen e sheh për dit, për natë !
Po veç këtyre ka një gjê, që kur kutonj më bije pika
Edhe më erret syri keq e në mëlçi më shkojnë thika !
Bës'[1] e kaurit me të Beut a mundin kurrë të bashkohen !
Mëndja s'm'a merr që kësisoj këta të dy të trashëgohen!

Sqen' e VI

(*Latifeja hyn me vrap në dhomë*)

LATIFEJA

Ç' u bëre, Bido, gjer tani ! Shum' u mënove[2] që kur dolle,
Kam kaqe kohë që të pres dhe ti një lajme nuk më solle !

BIDUA

Më ndje o zonja Latife, unë jam fare për të vrarë,
Po kishim fjalë gjer tani me Zylo bejnë kryetar.

LATIFEJA

E ! ç' të ra kemi ?

BIDUA

Jo, as gjë, o zonja ime jetë-gjatë,
Po kemi shpresë se s' mënon të vinjë mase sot yt atë.

[1] bës = mbesë
[2] mënove = vonove

LATIFEJA

Po Ganinë ?

BIDUA

(*S' i mbahen të qarat; vërtitet*
më nj' anë, fshin sytë me shami
edhe kthehet prapë)

...Po, shpresonj si mundëtar që do të kthehet
E do t'a shohç, o Latife të vinjë prapë të dëfrehet
(*më nj' anëzaj edhe me nga dalë*)

Ah, mbamë zembrën, ti o Zot !

LATIFEJA

Ç' pate o Bido, që s' flet dot ?

BIDUA

O Latife, t' u ngjatë jeta, të lutem falja plakut sot !
Jam i drobitur un' i ziu e s' e kam mëndjenë më kokë,
Ah, pleqëria këto ka, kur zbardhen qimet bëhen flokë !

LATIFEJA

Më vjen se qan, sikur diç ke, mua së gjorës të më thuaç,
A di gjësendi ? Folë shpejt ! Pse të m' a pshesh[1] edhe, të vuaç ?
Babaj, Ganiu a janë gjall ? Tregomë, Bido, mos u druaj,

[1] pshesh = fsheh

Çpalle sa kaqë, mos e mba, ç' më gjet të mjerën pa më thuaj !

BIDUA

Jo, Zonjë, fare gjë prej to, po.

LATIFEJA
(*i pret fjalën*)

Folë, Bido, pse m' a psheh ?

BIDUA
(*veçan*)

Ah, mbamë zëmbrën ti, o Zot, o Perëndi, ti që më sheh !
(*Dyke u kthyer nga Latifeja*)

Ah, si të thom, qysh t' a tregonj !... jo s' kam gjësendi Latife !

LATIFEJA
(*dyke dyshuar*)

Të të mbesonj që fole drejt, thua për Qiell edhe për Dhè ?

BIDUA

Të më besoç!...të më besoç, Bidua s' gënjen me këto qime !
(*veçan*)

Ah, moj e gjora Latife, ah pse më bëhet zëmbra thrime !

Pamj' e dytë.

Theatrua tregon konakët e Rakip beut në Podë. Nëpër muret janë llojesh fytyra të varura. Rrotull plot të ndënjura. Konaku shtruar mir' e bukur.Në funt një pasqyr' e madhe. Posa ka zënë të zbardhëllohet.

Sqen' e I

(*Latifeja duket në funt të dhomës.*
Vjen përpara pasqyrës edhe
ndreq kokën e stoliset)

LATIFEJA
(*e brengosur*)

Shkuan kaq dit edhe më kot po ri e gjora dyke pritur,
S' di si të bënj e qysh të them,jeta më duket e mërzitur !
S' muarm një lajme nga babaj, as nga Ganiu, e mjera unë,
Se pse s' u duk asnjë njerî, sidô që shkuan ditë shumë !
(*ngreh duart përpjetë*)

O Perëndi, të qofsha fal, mburomë babën e Ganinë,
Mburo ç' do burrë ushëtar, mburona gjithë ushtërinë
Tek ti shpresojmë na te zest, eja ngjat dorën e bekona,
Fuqi e shpirt, o Perëndî, fali ushtrisë e shpëtona !
(*dyke vajtur pranë pasqyrës e dyke u parë*)

Sikur të vij tanî Ganiu e të më shij kaqë të bukur !
Si një zambak kur hap në Prill, si trëndafil gallat të kuqur !
Ah, ç' do të thoshe, o Gani, për Latifen' e besës t' ënde?
Eja tani se s' duronj dot, nga luft' e shkretë nuk' u rënde ?
(*dyke kënduar*)

Ah, o Gani, kur të kujtonj,
Të dish e mjera si duronj
Gjer të të shoh ty pranë,
Se malli s'më ka anë !
Eja, Gani, se po të pres,
Ah, të të shoh pa le të vdes !
Ah, o Gani, Gani !

Të shohç ç' e bukura që jam,
Sa dashuri për ty që kam,
Sa s' fle as dit as natë,
Për ty, o jetë-gjatë,
Eja, Gani se po të pres,
Ah, të të shoh, pa le të vdes,
Eja, Gani, Gani !

Mban mënt ç' fjalonim të dy
Kur piqëshimë sy më sy ?
Ah Latife, më thoshe,
T' u bëfsha, o bukuroshe.
Për ty Latife dua të vdes,
Vdekjen me gas për ty e pres,
Ah, o Latfe, Latfe !

Si kapërole kur më del
Për ty ç' do lule hap e çel,
Ze ligjëron bilbili
Hap palët trëndafili,
Ah, o e dashura Latfe
Ç' e bukura, ç' e ëmb'la je,
Ah, o Latfe, Latfe !

(*Pushon së kënduari edhe vjen*
përpara sqenës.Si mentohet pak)

LATIFEJA

Po-ëndërsë që pashë sot, vallë si, qysh i bëhet *halli*
A mase shoh se s' duronj dot, se m' keq i shtuar malli !!
Një djal' i bukur si flori, një Engjëll rënë si prej Qielli
Një kalë hipur si petrit, që shkrepëtinte posi Dielli,
Njatë me shkoj edhe me gas më përshëndoshi "mirdita",
Më tha: "o vajz, o Latife ç' po ndrtke kaq si Afërdita !
"Eja në vithet të të marr, të fluturojmë në Parajsë,
"Atje të rrojmë, o Latife, e virgjineshë, o moj vajzë!"
U sula fët edhe rëmbenj frenat e kalit në dorë,
Zura t' i hidhem në pëqi Engjëllit bardhë posi dborë,
Po kur një herjesh një akrep më kafshon keq me të vështirë,
Sa tërë trupnë m' a helmoj ! Kaq m' idhëroj akrep' i pshtirë !
Po s' më qe mjaft ky helm' i zi, po na dhe ky akrep i shkretë,
Një vajzë bëhet, si çudi, i hipën kalit me të shpejtë !
Pra Engjëlli e merr në gji, i ranë kalit edhe shkuan,
E s' mërguan shumë lark, iknë më lan' e më harruan.
...Jam shumë e trëmbur për këtë, zëmbra më dridhet si purtekë,
Po ngushëllohem se s' ish gjë, përveç një ëndërë e shkretë.

Sqen' e II

LATIFEJA edhe NGJELINUA

LATIFEJA
(*porsa e sheh Ngjelinon që hyn*)

Ngjelino ç' ardhe që tani ?A të dërgoj Marrua tek mejë ?
Mos pret gjësendi porosi ? A se po doj gjëkund të vejë ?

NGJELINUA

Jo, Zonja ime Latife, të puthça ty këmb' edhe dorë,
Që ndrin si yll, si një shkëndi, që je e bardhë posi dborë,
Ardha të shoh mos më dô gjë, a mos të lipsemë për punë,
Të më urdhëronjç atje ku dô, për ç' jam e zonja të bënj unë
Marrua punon me mjeshtëri sa mënt i bie vilanija,
Që t' a mbaronjë sa më shpejt qilimn' e bukurë me vija.
Mezi e presim këtë gas, o Latife, o bija ime,
Sa të na vinjë dhe Ganiu, të mbushen zembrat me gëzime.
Të hapim derënë një mënt, se mjaft na korri vdekje' e shkretë,
S'na qeshi buza që kur vdiq, që kur Zenepi na ndroj jetë!

LATIFEJA
(*me ngashërim; kopsit duart*)

Ah, moj im'ê, ah, ku të kam, që më le të varfër e të mitur,
Ah, un' e mjera që s' të di, që më le foshnjë të pa ritur !
Leri, Ngjelino, mos zbulo, plagë që s' mbyllen dot kurrë,
Ndro fjalënë, mos m' i kujto, mjaft jam fatkeqe, zhur e urë !

NGJELINUA

Bijë, ah, mos u dëshpëro, është i math Zot' i vërtetë,
Ay na sheh e na dëgjon e s' na le kurrtë në të metë.
Tani ti s' lipset të kujtosh të parat q' iknë e kaluan,
Po të dëfresh edhe të qeshç; ato po shkuan, u harruan.

LATIFEJA

Ngjelino, hiq bëni gati gjellra të mira me Marrushen,
Se kam gosti atënë t' im, Zylyftar Podën me Manushen.
Dhe hapni sytë.

NGJELINUA

Mos ki keq, o Zonjë, fare për të pritur,
Se për atë s' na del njeri, se jemi tepër të stërvitur.
(*Ngjelinua shkon nga njëra anë, nga tjatra Latifeja.*
Bije napa edhe ndrohet sqena)

TABLO E PARË

(Ngrihet napa. Theatrua represanton kasollen e varfër të Ngjelinos. Më të djathtë një avliment[1]. Marrua ka ndënjur mi tê për të punuar. Ësht' e lodhur e e kapitur nga puna sa e ka zënë gjumi mi avlimentin. Është nat' akoma).

Sqen' e I
GANIU, MARRUA

GANIU

(*Dëgjohet fellë edhe së largu një këngë*
dashurie e Ganiut)

U treta dit e net pa gjumë,
Ah, unë i mjeri si do bënj,
Kjo luft' e shkretë na vrau shumë
As di ku jam, as prehje s' gjenj.

Marro për ty
Vuanj e heq

[1] avlëment = tezgjah

Ah, ato sy
Më vrasin keq
Më ke plagosur mushkërinë,
Marro s' m' a njohe dashurinë.

———

Që kur të njoha, ah i mjeri,
U bëra tjetër lojta mënç
M' a dogji zëmbrën ky nishteri,
Marro do vdes, do mos më gjenç.
Ah, më s' duronj
Më s'qëndronj dot
S' dua të rronj
Do qanj me lot.
Marro që ndrin posi shkëndija
Ah ti m' i more mënt' e mija.

MARRUA

(*Zgjohet nga stihat e fundit, ngreh kokën, fërkon sytë për njëherësh e mban veshin*)

Mos pashë ëndër ? a vërtet m' u duk një zë sikur dëgjova,
Kush që pa gdhirë po këndon ? a unë vallë ëndërova ?
(*mban veshin prapë*)

GANIU

(*dyke përsëritur stihet e fundit*)

Marro që ndrin posi shkëndija
Ah ti m'i more mënt' e mija !

MARRUA

Oh, qënk' ay që po këndon !

GANIU
(*dyke hyrë*)

Marro je ti këtu që shoh,
Je, ti, o Engjëll i sërmanjtë[1] !

MARRUA
(*me nga dale edhe me frikë*)

Gani, t' u bëfsha, hesht, pushoh,
Se kemi rrotull njerëzi e mos pikasin nga konaku.

GANIU

Oh, Marro, eja se s' duronj, se m' u err syri, m' u prish gjaku !
(*zijen dorë për dore dhe pushtohen*)

Nga lufta ika me rëmbim, u mvodha pshehur nga kalatë
I lashë gjithë në qetsim dhe ruajtësit i shkova njatë;
S' më kupëtoj asnjë njeri, sido që shkova mes ushtrisë,
Për ty, oMarro, ç' do rrezik, theror ja bëra dashurisë.
Ardha edhe nj' herë të të shoh, të çlodhem pakë e të prehem,
Se kush e di si ngjet më tej, ardha të piqem, të dëfrehem.
Shëkomë nj' herë m' ato sy, o Marro ti, o Yll, o dritë,
Ah, o thëllëzë, o bilbil, Yll i Mëngjezit, Afërditë.

MARRUA

Të keqen unë, o Gani, po qysh kështu nuk pate frikë

[1] sërmá = Fill i argjëntë (serm) ose i artë për të qendisur, sërmanjtë = i qendisur me âr (Flori)

Qysh ti kuxove gjer këtu ! ah, o Gani, të lutem, ikë.
Dridhem si zogu në fole, si ljepuri, si fletë druri,
Ah, si të bënj as unë s' di, ah, këjo gjë në dhê më vuri.

GANIU

Marro, mos trembu, se s' besonj asnjë njeri që më ka parë;
Kjo dashuria që të kam më prishi mënç, jam si i marë.
(*dëgjohet një zê së jashtmi*)

MARRUA

Oh, kush të jet' o Perëndi !

GANIU

O mos u tremp, o Yll, o Hënë,
Fletët e drurit era fryn, shelgjet të tunden kanë zënë.

MARRUA

Oi ! sa dridhem, o Gani, ah si të bënj, ah un' e mjera.
Hiqu të lutem, o Gani bej, fjalët më çpojnë si nishtera[1] !
Unë jam çupë e vobekt, s' të ujdis fare zotris' ate,
Për Latifenë që të do, Gani, mëshirë nuku pate ?

GANIU

Marro, me fjalëtë që flet zembrën e varfër m' a plagose,
Ah, mos, o Marro, fol' ashtu, më vrave fare e më sose !

[1] Nishter = një farë vegle mjeksore (K. Floqi)

Keq më vjen shumë dhe për të, se bashk' u rritmë që voglije,
Po për ty, Marro, prëhje s' gjenj, s' di se ç' t' i bënj ksaj dashurije !
Dua me ty jetën t' a shkonj, motër t' a kemi Latifenë,
Në mos po nj' orë do mos rronj, Marro, kështu t' a dhashë benë.

MARRUA

Ah, mos të lutem, Gani bej, se mi këto një trap i gjërë
Na ndan të dy e na largon, si një rrukullim, një mal i tërë
Përveç që sërë s' kam për ty, se jam një vajzë varfanjake,
Po s' kam dhe fenë, o Gani.

GANIU

Marro, s' je fare detyrake,
Të kesh një fe me mua ti, pastaj të rrojmë burr' e grua,
Jo, kjo gjë s' ka shëmbëllim, po lere, Marro mos m' a thua
Feja a besa s' mbajnë dot, s' ndalojn' as fare dashurinë
Marro, kur duhemi kaq fort, Fê kemi patur kombësinë !
Feja dhe Besa cilado të shëntëruara të dyja
Janë të shenjta gjithënjë në kishra qoft' a në xhamija,
Cilido ka një zakon, një palë ndjenja, një vetijë,
Njërit një udhë i pëlqen, tjetrit një rrugë, a një vijë.
Mentohet njëri kësisoj, tratri pëlqen një mëndje tjetër,
Fetë kështu janë gjer sot, njëra m' e re, njëra m' e vjetër.
Mundet të keshnjë besë sot, cilën nga prindrit trashëgove,
Po nesër zgjeth kë të pëlqesh, atë që njohe a provove.
Po gjak e eshtra, zê e shpirt, fuqi e frymë edhe ndjenja,
A ësht' e mundur t'i ndrosh dot e t' i shkelmosh gjith këto shenja ?
Feja dhe besa jan' ato që munt të ndrohen pas zakonë,
Po Kombësia ësht' ajo që s' ndrohet dot as gjithëmonë.
Kemi një gjuhë, një zakon, kemi një palë vetëdija,

Një gjak, një shpirt, një far' e fis kur na ka lindur Shqipërija.
Përpara se të marrim fên' o Mysliman' o të Krishterë
Shqiptarë ishim gjithënjë edhe vëllezër kurdoherë.
Kemi një nënë që të dy **atë Atdhenë Shqipërinë**,
Mase ndryshuam fetë sot, po kurrë, Marro, Kombësinë !
Është m' e lartër nga ç' do gjë, m' e shentëruar kombësia
Nga mëmë, at' e bes' e fe, kshu ka urdhruar Perëndia !
....Po eja duamë me shpirt, siç po të dua un' i mjeri,
S' na ndan gjësendi ne të dy, po kto pralla Marro leri.
(*e pushton Marron, po këtë çast dëgjohen kërcëllime pushkash jashtë; edhe trompeta. Ganiu përnjëherësh e lëshon Marron. Jashtë po thërresin: "Ndihmë ! ndihmë ! o burrani!"*)

GANIU
(*kërcen një herjesh*)

Të le shëndenë !

MARRUA

Ku do vesh ?

GANIU

Marro, më thret kalorësia,
Lipset të ikinj, të vraponj, ndryshe na shuhetë shtëpia !

MARRUA

Po Marron tënde ku e le ?

GANIU

Të le penk më Perëndinë
Lipset të ndodhem shpejt atje, të piqem bashkë me Mersinë.

MARRUA

Ah un' e mjera.

GANIU

Mos ki keq, po bëj durim edhe ki shpresë
Falu të kthehem mundëtar, ndryshe "kush lindi do të vdesë!"
(*Dëgjohen prapë zëra, "o burrani !". Këmbë kuajsh edhe kërcëllim pushkash*)

GANIU

Ri me shëndet, Marro, se shkonj, zëri më thret i Shqipërisë,
Lipset të vete tok me tá t' i vimë ndihmë ushtërisë.
Ri me shendet e lamtumir.

MARRUA
(*me kurajo*)

Udhën e mbar', o shpirti im,
Zoti pas teje kurdoherë, dalç faqe-bardhë edhe trim
(*Ganiu del, Marrua zë qan e bie përmbys*)

Sqen' e II

MARRUA – LATIFEJA

LATIFEJA
(*porsa hyn*)

Mirdita, Marro, si kështu ? të shoh të trembur si të vrarë,
Ç' pate ? Ç' pësove ? Ç' je kështu ? më duket sikur paske qarë !

MARRUA

Të qofsha fal', o Latife, o zonja ime. t' u ngjat jeta,
S' di edhe unë ç' jam kështu, ndofta nga gjumi që nuk fjeta.

LATIFEJA

Marro, pse s' do të më tregosh se ç' farë pune të ka ngjarë,
Unë të shoh, mirë të njoh, që je e ënjtur dyke qarë !

MARRUA

Jo, t' u ngjat' jeta, s' kam asgjë, po jam e lodhurë me punë,
M' u qepnë sytë mi gjergjef, mi avliment, e ku di unë.

LATIFEJA
(*me dyshim*)

Sikur dëgjova që andej nga rëz' e pshatitë ca zëra.
Mos gjësendi ? Mos ish gjë? thuaj.

MARRUA
(*veçan)*

Ah, dridhem e tëra !

LATIFEJA

Nga mua druhesh ? Nuk e di sa dashuri që të kam patur ?
Të kam si motër, ti e di, thuam ç' ka ngjarë e ç' ka vatur.

MARRUA

Jo, zonjë jo, nuku di asgjë, theror t' u bëfsha, mos më pyet,
Jam e sëmurë, s' jam nër mënt, të përgjërohem në daç kryet !
(*Dëgjohet Zylyftar Poda nga jashtë,*
Latifeja vete ne porta të shohë ç' është)

Sqen' e III

ZYLYFTAR PODA, dhe të sipërmit

ZYLYFTARI
(*hyn në skenë*)

Këtu më qënke, Latife ? Po të kërkonja, o bija ime,
Më paç uratën e më qofsh e lumtur shumë, plot gëzime.
Vinj të të shoh e të të puth se jam gati për të kaluar,
Ashtu ra puna,Latife, shokët më thrasin të harbuar.
Se i rethoj armiku keq, topi po korr burratë t' anë,
Luftojnë gjithë me dëshprim, jemi shtërnguar an' e mb'anë.
Vete me shokët të luftonj, vete t' u ap kuraj' e shpresë,
Ja të shpëtojmë burrërisht, ja po të vdesimë me besë
Të le shënden', o Latife, falu te Zoti nat' e ditë,
Të dalim të gjithë faqe-bardhë, e t' ju gëzojm' o yll, o dritë.
Të piqemi të gjithë tok, t' ju shoh bashkuar me Ganinë,
Pa le të vdes që atë çast ! Do kem fituar lumturinë !

LATIFEJA

Ah, i vyer ata im, qysh do duronj, ah, un e gjora,
Të rronj lark jush në dëshpërim !...ah, më s' më bën as këmb' as dora.
Jam si e humbur pa njeri, jam si e marë, si e shkretë
Si do të rronj, ah, o im zot, m' u zvertit keq e zeza jetë ! (*zë qan*).

ZYLYFTARI

Pusho, mos qaj, o Latife, mos blegëri, o bija ime,
Me këto lotte që po derth Zylfos ja bëre zëmrën thrime !
Po mos ki keq, po ki durim se po shpresonj te Perëndia,
Të vimë shpejt, o Latife, e të na hapetë shtëpia.

LATIFEJA

Zoti me ju !

ZYLYFTARI

Eja këtu, moj Latife, të t' ap uratën
Më qofsh e lumtur gjithënjë (*Latifeja unjet më gjunjët e saj, edhe Zylyftari i ve duart mi krye të saj*)

LATIFEJA

Zoti ju forcoftë krah' e shpatën.
(*Zylyftari del jashtë. Latifeja e përcjell dyke fshirë sytë*)

Sqen' e IV

LATIFEJA, MARRUA, pastaj BIDUA

LATIFEJA

Ah, fat i lik, përse na ndjek, pse na këpute mushkërinë,
Pse na le varfër e vobek, ah, pse na prure mjerësinë !

MARRUA

Hesht ! Zonja ime e mos qaj, është detyr' e burrërisë
Të mprojmë vëndin me theror për nder' e math të Shqipërisë !
Ne le të falemi për tá ne Zot' i math e i vërtetë,
T' i shohim prapë gjithë tok plot me fuqi, pa gjë të metë.

LATIFEJA

Ah sa kam frikë se s' duronj gjer sa të shoh këtu Ganinë !

MARRUA

O, Zonja ime mos kështu, ki shpresë ti më Perëndinë.

(*Hyn Bidua me rëmbim.*
Marrua shtrohet të punojë mi avlimentin)

BIDUA

U raskapita un' i ziu !

LATIFEJA

Ti Bido je ?

BIDUA

Mos qofsha i gjalli !

LATIFEJA

Ç’ pate Bido ?

BIDUA

Ah, ç’ të kem që mënt më hapet, Zonjë balli !

LATIFEJA

Mos je i lodhur ?

BIDUA

O, jam keq, dirsët më venë posi lumë,
Më ranë këmbët posht’ e lart, si plak që jam u lodha shumë
I pregatitmë gjer tani kalorsin’ e ushëtarët
E i përcuallm gjithë tok, vanë të gjithë në të mbarët.
(*dyke u enthusiasur*)

Zylyftar Poda përmi tá ndritte si ar, sikur shkrep Dielli,
E gjithë burrat hipur pas, tërë çkëlqenin posi Qielli,
Ish bukuri e madhe fort të shifnje trimat luftëtarë
Pushkat në supt, armët gati, gjithë të ndruar e të larë.
Pallaskat ndrinin si flori, gjithë pas mezit dyke ngjeshur,
Shpatat e ahura si brisk fora i kishin gjithë çveshur!
Shërbim u prura sa m’ u dha, e flaka tutje pleqërinë,
Zëmbr’ e pa plakur po më rij ah ! kur kujtonja djalërinë !
I nxora gjithë gjer ne kroj dhe ikn’ e zun’ udhën e gjatë,

Duart i ngrita lart në qiell e i përcolla në uratë !

LATIFEJA

Ah zembra qysh po më lufton, ah ti, o Zot, që më sheh mua
Falu forcatë gjithë-kujt, si dëshëronj, sikundër dua !

BIDUA

Shpresë të madhe kam tani që vate Zylyftari vetë,
Që cilido do marrë shpirt, fuqi e zembër edhe jetë.
(*dyke hedhur një sy të zëmbëruar mi Marron*)
Po këjo ç' dashkërka këtu ?

LATIFEJA

Në avliment më ndih e gjora,
Është e zgjuar për ç' do gjë, ç' t' i shohë syri já bën dora.

BIDUA
(*veçan*)

Ah, më s' duronj, e kam kalli[1], më vjen t' a çanj ta ha me dhëmbë,
Gjarpër më duket, s' e shoh dot, më vjen t' a shtyp t' a shkel me këmbë.

LATIFEJA
(*pa pikasur gjë*)

Punon vobekja pa përtim, s' lodhet për mu' as dit' as natë
Gjithë nevojat m' i mbaron, Zoti e bëftë të begatë.

[1] e kam kalli = dua ta dërmoj, ta çkatërroj, ta bëj pluhur e hi

BIDUA
(*veçan*)

Ah, moj e gjora Latife, e merr pas zëmbrësë të qetë
Pa ditur ti se ç' gjarpër ke, që do t' ja shtypnjë kokën vetë

MARRUA
(*po e dëgjon veçan*)

Shpëtom' o Zot, o Perëndi, ah sa kam frikë e llahtarë,
Ment vdes si zogu në kuvli, ç' është kjo vdekje, kjo tromarë !

LATIFEJA
(*që s' kupëton dot gjë prej këto*)

As munt gjësendi të marr vesh nga sa po ngasin midis t' onë,
S' kupëtonj asgjê, njerî s' të flet, as ky as Marrua gjê s' të thonë !

TË TRE BASHKË
(*Trio*)

BIDUA

Gjëmo, o Zot, hith një rrufe,
Goditte gjarprin që kam pranë,
Në mos për *din* edhe për *fe*
Vet e godit i nxir *imanë*
Unë s' duronj
As që pranonj
Këtë bashkim kaq të vështirë
Më mirë vdes,
Se sa të pres

Latifn' e dashur t' a shoh shtrirë !

LATIFEJA

Është çudi, është myster,
Ç' të përmendonj, ah un' e mjera,
Zëmbrën m' a çpojnë si nishter
Këto hidhrime, k' to potera,
Ah, o Gani
Ah, gjithë ti
Je shkak që vuanj un' e gjora !
Zëmbra më ré,
Thuam përsé
Gani, u treta posi bora ?

MARRUA

- Ah sa s' duronj
Sa s' mbahem dot,
Ç' ê ky *gazep* i math i shkreti !
Më vjen të thres, të qaj me lot
Ah më kulloj, më vrau, më treti !
S' dua të rronj
As të ndalonj
Këtë bashkim të vlerë shumë,
Mos, Gani, mos
E vra e sos,
Mos Latifen' e bëj për lumë !
(*si mbarojnë së kënduari*)

LATIFEJA

Bido, të lutem, folë drejt, thuaj ç' menton, në di gjësendi,
Ti kundra Marros diç do kesh, folë...s' i ndahem k'ti kuvendi.

BIDUA

Ah, zonja ime Latife, të thashë mos verë re plakun,
Që s' di se ç' bën, s' është nër mënt, që ka të prishur fare gjakun !

LATIFEJA.

Jo, do më thuaç, të betonj për shpirtnë të s' atë zonje,
Q' e adhuroj kaqe fort, që po si vet-henë e donje

BIDUA
(*veçan*)

Ah, mbamë zëmbrën ti, o Zot !

(*dyke parë me zëmbrim Marron*)

Ah, ti kopile Kolonjare.

LATIFEJA

Bido ç' të bëri ? Ç' ke me të ?

BIDUA

Lermë, o zonjë, t' a vras fare !

LATIFEJA
(*dyke u habitur*)

Këtu diç bëhetë në mes, po s' marr vesh gjë nga kto fjalë;
Marro, ti thuam në di gjë, ç' ê kjo mëri, ç' ê kjo valë !

MARRUA

Latfe, t' u bëfsha, urdhro që këtu brënda të largohem,
T' ju le të qetë që të dy, të ikinj fare, të mërgohem.
Mase fajtore unë jam, unë fatzeza e vobekja,
Mê mirë fare të mos jem, për mua mirë do ish vdekja.

LATIFEJA

Fajtore tinë ? po përse ? Çpalle, o Marro, ç' ke në zembër,
E mos më lerë në dyshim, në erësirë, si të verbër !
(*dyke kthyer nga Bidua*)

Bido, tregohe tërë ç' ke, se mjaft kam kohë dyke pritur,
Lipset të di se ç' ngjet në mes, duhet t' a njoh t' a kem të ditur.

BIDUA

(*me rëmbim dyke hedhur sytë prapë*
përmi Marron, nxjer pisqollën nga
silahja[1] *dyke drejtuar mi Marron*
e dyke bërtitur)

Çporru q' aty !

MARRUA

(*dyke u trëmbur*)

Ah, un' e mjera !!

LATIFEJA

(*sulet i ze dorën Bidos*)
Bido, mos lojte sot nga mëntë?

[1] silah = brez i gjerë lëkure që shërben për të mbajtur armët e brezit dhe paimet e tyre.

BIDUA
(*dyke mos vërejtur Latifenë*)

Dua t' a vras, të mos e le, t' a heth tá hanë copra qëntë !!

MARRUA

Ah, ç' mëkatare jam, o Zot ! (*ze qan*)

LATIFEJA
(*Bidos*)

Ç' faj ka Marrua,as më thua,
Vere pisqollën në vënt, eja fjalo këtu me mua.

BIDUA
(*Latifesë dyke rëfyer Marron me mëri*)

Edhe m' a mba ? mërgohe shpejt se na ka prurë babëzinë,
Kjo është shkaku që po heq, kjo na ka kallur mjerësinë.

LATIFEJA

Nuk të mar vesh ! Folë se ç' ke tregohe faqeza, së liri

BIDUA
(*veçan*)

Ah, mbamë zembrën, ti o Zot ! Vdiqa, u treta si qiriri !

(*dyke u kthyer nga Latifeja*)

Ah, si të thom....ah, o Gani !

LATIFEJA

(*e trëmbur, i pret fjalën*
dyke u hedhur përpjetë)

Bido, ç' ke prapë me Ganinë ?
Ah, un' e zeza ç' po më pret !...
(*dyke lebetitur*)
Bido, ç' kërkon të thuash tinë !

BIDUA

(*egërsohet sa më s' mbahet dot.*
Si ri pak, e dyke ndryshuar zënë)

Ah, qysh të flas, moj Latife, qysh të hap gojën un' i mjeri

LATIFEJA

(*dyke hequr pas fustanit Bidon*)

Folë, mbarohe, mos e mba, eja se vdiqa nga *zeheri* !

MARRUA

Bido, të lutem, prit të dal, a vramë ti me atë dorë !

BIDUA

(*i zgurdulluar*)

Jo, moj kopile, ri, mos loj, qëndro, se vdiqe, moj e gjorë !

LATIFEJA

Oh, un' e mjera, ç' është kjo !

BIDUA

(*i dëshpëruar*)

Ah, ç' të jet' o Latife

(*dyke dredhur zënë e duke shëmbur*)

Ganiu, q' e do, q'e adhuron....

LATIFEJA

(*i pret fjalën me llahtarë*)

Ganiu !....Pse ç' bëri ?...Pa rëfe !...

BIDUA

Ganiu, që kaq e adhuron, që vdes për tê, o Zonja ime,

LATIFEJA

(*pa shpresë*)

Eh !... Pastaj si ?...Ah, mê s' duronj, m' u këput zembra m' u bë thrime !

BIDUA

(*dyke prerë fjalën*)

Ganiu s' ka besë, lojti mënç, se është keq i përvëluar

(*rrëfen Marron*)

Për këtë dosë, këtë rop, këtë kopilen e mallëkuar !!

(*Latifeja më s' duron po bërtet me tërë sillën*)

Ah !!!

(*E pikon vilania; më s' mbahet dot, edhe bie*
nër duart' e Bidos e të Marros,të cilët e përmbajnë.
Bidua e shtyn Marron dhe e mban vetë Latifenë)

BIJE NAPA
Funt i Pamjes II
Pamj' e tretë.

Theatrua represanton një shesh në pshat të Podës. Rotull duken brigje dhe maja. M' anë të djathtë pshati Poda, m' anë tjatër një krua. Ushtëri, kalorësi, popull burrash e grash kanë zaptuar sqenën. Nër mest të tyre çkëlqen Zylyftar Poda me kordhëtarët[1] e çquar. Porsa ngrihet napa dëgjohet ky marsh

Marsh triomfan luftëtar
(*Të gjithë tok në valle*)

Ja tek u kthyemë si mundëtarë
Krye përpjetë me fuqi plot
Armikn' e thyemë si luftëtarë,
Podën e lartër s' e shkeli dot.
Ne s' jemi berra,
Ne s' jemi bisha
As nëpër ferra
S' fshihemi dot,
Fam' e stërgjyshet
E besa besë
As vdes, as prishet,
S' vdisetë kot

[1] kordhëtar = luftëtar që lufton me shpatë.

Na rrofshin pushkatë e shpata jonë
Rroftë Shoqnia që na nderon
Qofshin bekuarë për gjithë monë
Dhe Zot' i jetës që na ndihmon.
Ne s' jemi berra,
Ne s' jemi bisha, etj, etj.

Gëzim m' i ëmbëlë se mundësia,
As do të bëhet as sot as mot,
S' ka gjë m' e vlefshime se atdhesia,
Kshu ka urdhruar i madhi Zot.
Ne s' jemi berra,
Ne s'jemi bisha,
As nëpër ferra
S' fshihemi dot, etj. etj.

Sqen' e I

ZYLYFTAR PODA, MERSINI dhe AHMET BEU ZABOVA

ZYLYFTARI

O vëllezër, ju o burra luftëtar të dëgjuar
Kordhëtarë e kalorës, ushëtarë të uruar !
Brithni, loni e këceni, se kështu urdhroj Zoti
Edhe trimëria jonë që ka qënë gjithë moti.
Ësht' e barthë e bekuar, ësht' e lumur këjo ditë,
Eja bashkë të dëfrejmë, o Shkabonja, o Petritë.
Na e fali Zot' i jetës mundësin' e vleftën t'onë
Po dhe krahu e kuximi, që i patmë gjithë monë.
Gjith kush prej këti redhi tërë burrat mundëtarë

Lipset çgjeshur të më thoni ç' ndjeni ju si luftëtar.

MERSINI

Kryetar të qofsha falë, më qofsh zot për gjithë monë
Jam i lumur i kënaqur prej këta ushtarët t' onë,
Se luftuan posi trima me kuxim edhe me shpresë,
Pa përtuar e pa lodhur, lidhurë me besa besë.
Në rethimin e rezikshëm që na pat armiku bërë,
Lipsej gjithë t' ishim shuar, t' ishim xhvatur të tërë !
Po kta qëndruan trima, si dragonj e si luanë
Sado q' ishin piskëlluar e që s' kishin gjë të hanë.
Dy dit e dy net pa bukë, u përpoqmë si të marë
Ishim keq të dëshpëruar, po qëndronim Shqipëtarë.
Po që kur zotria jote u tfaq ndihmë n' ushtërinë
Zembrat gjith' u përtrinë edhe shtuan fuqinë.
Kështu Melesin' i thatë, mbet pa vdekur për jetë,
Të tjerat ç' t' i thomë, ç' t ' i çquanj, po i di zotrote vetë.

ZYLYFTARI

Më të lumt' o Mersin aga, eja të të puth në ballë,
Më të rroftë Nezireja, i ke shokëtë të rallë.
Ndofta edhe un' u ndiva punënë në vij që vumë,
Trim i mir' o Mersin aga s' bëhetë pa shokë shumë.
Po më rrofshi e u paça, qofshi gjithë të bekuar
Si nga Zoti, si nga Kombi, si nga mua të uruar;
Dal të shohim edhe Elmazë, si mejtohet e qysh thotë,
Pasandaj dhe Ahmet Bejnë q' e ka kokënë të plottë.

ELMAZI

Pasha Zon' o Zylfo Poda, po ç' të thom a un' i mjeri,
Me kuximn' e zotris s' ate thom që na shpëtovi nderi !

Sikur pak të mbese vonë, ishim shuar teje mb' anë
Me ushtrin' e Mahmut Pashës q' e kish bërë qark kalanë.

ZYLYFTARI
(*Ahmet Zabovës*)

Po ti Mete bajraktari që u thinje nëpër male
Së luftuari si burrë, q' e ze lepurin nga dale
Që je trim e i kuxuar, po dhe diplomat i fshehtë,
Qysh pandeh se këjo luftë mori funt me të vërtetë.

AHMET ZABOVA

Kryetar, t' u ngjatë jeta me që pyet edhe mua,
Si e qysh u bë kjo luftë e si puna u mbarua.
Do më ndjesh se do flas çgjeshur, m' a ka ënda drejtësinë
Më pëlqen të flas pa anë, ndjehe plakun fatzinë.

ZYLYFTARI
(*i pret fjalën*)

Ashtu më pëlqen dhe mua folj' e çgjeshur e e lirë
Kush më flet, më tregon udhën, un' atë e çmonj më mirë
Po të lutem me plot zembër , mos u druaj meje fare
Folë çgjeshur e çpenguar, çpall mejtimet Shqipëtare.

AHMET ZABOVA

Ushtëria lëftoj mirë, është keq për të lëvduar,
Për sa hoqi e sa vojti dyke lodhur e munduar.
Të mos ish ushtria trime edhe ky Ago Mersini
Mase thom se s' ishte punë të shpëtonte Melesini
Rapo Gruda me Salinë edhe Mekja e Orani

Edhe Lamja me Alinë, si edhe Nurja e Shabani,
Muslim Beu me të vëllanë, edhe Reme Kolonjari,
Tukja, Alua e Rexhepi edhe Demo kordhëtari
Edhe gjithëburrat t' anë, kush e kush me sa i ipej
Gjithë burrërisht lëftuan, na nderuanë si lipsej
Edhe zotëria jote i dha shpresë ushtërisë,
E forcoj, e vu përpara, dha kurajo burrërisë;
Nofta thom se dhe pa juve do na copëtonin fare,
Do na vrisnin, do na çkenin ushtërit' armikëtare.
Po spaloren më të reptë që e xbythi tej ushtërinë
Ja qëlluanë Shkodranët, që si ndihmë shpejt harrinë.
Po dhe Rakip Beu te Qari ja theu mjaft sulmin e parë,
Dhe Alikua nga Prodani s' e la frymë që të marrë.
Funtn'e luftës mundëtare më së pari k' ta e dhanë,
Pastaj dhe zotria jote edhe ne e gjithë ç' janë.
Kështu mase mua plakut më përngjet pas mëndjes s' ime
Ja se ku t' i thashë tërë, ndjeja plakut k'to mejtime.

ZYLYFTARI

Bravo Mete kapedani, bravo plak e mëndje fellë,
Më të lumtë ajo gojë, më kënaqi kjo e sjellë !
Ashtu dua, trimat t' anë që më duan me të drejtë,
Të më flasin liruar, të më thonë ç' do të metë.
Kurrë mos më fshehin fjalën, si pikasin le të thonë,
Uratën ashtu më paçin e të Zotit gjithë monë.
Ty, o Mete bajraktari, me kënaqësi të tepër,
"Këshillonjës" do t' të quaj, do t' të pyes për ç' do vepër.
Më kënaqe shumë zëmbrën me k' to fjalë kaq të dlira,
Të qëruara, të drejta, t' ëmbla shumë, keq të mira.

AHMET ZABOVA

Kryetar, të falem nderit, më latë shumë në barë,
Po ushtëria ka si mua shumë burra më të parë.
S' meritonj, ah, un' i mjeri, mëndja ime të kërkohet
S' jam i zoti unë plaku, s' lipset plaku të dëgjohet.

ZYLYFTARI

Met' Zabova, Mete trimi që ç' do fjalë të ka shije
Masat tënde mëndarake më pëlqejnë, kanë hije.

AHMET ZABOVA

Zylyftar, më rrofsh sa malet, s' t' i çpërblehem mirësisë,
Si ty burra kurdoherë janë nder' i Shqipërisë.

(*Dëgjohet ushëtim jashtazi. Të gjithë presin fjalën edhe dalin të shohin.Hyn Ganiu në sqenë, pastaj edhe Ali Prodani. Të gjithë i presin me gas)*.

Sqen e II

TË PARËT edhe GANIU,
pastaj ALI PRODANI

GANIU
(*plot gas*)

Mir' se ju gjejmë zotërinj !

TË GJITHË

O mir' se vjen !

GANIU

Jam i gëzuar,
Kur ju shoh mbledhur gjithë tok, posi vëllezër të bashkuar,
Vonova pak gjer sa të shoh, burrënë trim Ali Prodanë,
Mezi u poqmë të dy tok edhe u hothmë më këtˈ anë.

ZYLYFTARI

(i ze të dy për dore,Ganinë dhe Alikon)

Bij si shpëtuat juve dot, qysh sˈ u dërmuat e sˈ u vratë ?
Qënki të lumur e me fat, qënki pa fjalë jetë gjatë!
(*i puth që të dy në ballë*)

Jam keq i mburur me ju sot, Zoti ju faltë ditˈ e jetë
Jini të dy si një e një, jini dragonj me të vërtetë !
Po pa më thuaj ti Gani, qysh u çkëputtë nga Mersini
E vajte ndihmë vetëm ti, qysh dolle tej te Melesini ?
Sˈ të trempnë topat bot e bot, sˈ të trempnë gjylet, bataretë,
A mos nga dheu i ngritte lart e fluturove nëpër retë ?

GANIU

O atˈ i dashur, ata im, kisha detyrë siç do burrë
Tˈ i vete ndihmë çˈ do njeriut e mos kursehem për të kurrë.
Posa na ardhi nˈ ushtëri lajma qˈ Alinë e rethuan,
Ago Mersini ve një zê,sa gjithˈ u ngritnë e vrapuan
“Shpejtoni burra” thotˈ Agaj, “kush është trim kush ësht’ i gjallë,
“Ali Prodanˈ e kan rethu, cili prej jush sulet në ballë.
“Të harrinjë shpejt e shpejt se puna sˈ pret, që tˈ a shpëtojmë,
“Ndryshe e humpmë ! këtë gjë lipsetë mirë tˈ a mentojmë !”
Me të dëgjuar kështu mˈ u ngritnë leshrat përpjetë
Zembra mˈ u droth, më fluturoj dhe brodha shpejt në tatëpjetë.

Çkul jataganë e me vrap kthehem nga ana e Mersinit,
"Të le shëndenë", i thom se shonj, do t'i lëshohem Melesinit;
Kështu vrapova ata im, s' më shtiri në dor' armiku
Edhe Alikua kësisoj shpëtoj me burrat nga rreziku !

ZYLYFTARI
(*e përqafon i mallëngjyer*)

O bir'i vetëm, o Gani, të dish sa gas që ndjen yt atë
Kur të dëgjon me të vërtetë që të lëvdojn' o jetë gjatë !
Qasu, Aliko edhe ti, qasu këtej të të shoh synë
E më trego qysh, si u bë, pa më rëfe, o vëllathi ynë.

ALI PRODANI

Zoti t' a faltë të të bir, o kryetar, na bëri punë,
Vërtet me të ardhurë Ganiu shpëtoj ushtria dhe unë!
Plumbat na kornin që këtej, binin si breshëri në Verë,
Dhe topat rihnin pa pushim fortesat t' ona kurdoherë !
Burrat e flaktë bot e bot[1]u shtrin' u piknë[2] dyke vrarë
Po s' kishim ç' bënim, se për fat ishim të pakë të përçarë.
U dëshpërua gjithë kush edhe s' na mbet gjëkundi shpresë,
Dukej që faqeza asnjë këmbë prej nesh po do mos mbesë.
"Djema, o burra përmi ta" u thres një herjesh me sa munda,
Sa gjith' u ngrehnë funt e krej, i lojta vendit e i tunda.
"Sulmën e fundit kush e bën"!"Çkulni nga myllet jataganë"
"Bini si shkaba, si dragonj, zjar e skëterë an' e mb' anë"!
Atje ku mateshin kështu të derthnim gjakun të harbuar,

[1] bot e bot = me shumë mundime, pas shumë përpjekjesh
[2]pikem = bie perdhe si i këputur, këputem i vdekur përdhe

Javo[1] Ganiu si një petrit këtej po vij dyke vrapuar;
"Qëndroni", thotë, "se këtu puna e do të vepërojmë
"Ti bjer andej, unë këtej, ashtu të dy t' a copëtojmë".
Plani u kthye asisoj, sa kapmë pushkat me të shpejtë,
Ramë të dy më një vërtik[2], më një veprim, me gjak të nxehtë.
Kur pa armiku kësisoj fuqi të plott' e të pa prerë,
E humpi shpresënë që kish e zu të thyej me një herë.
Një buj'[3] e madhe midis ta, një zihj' e ashpër e ushtërisë,
I turbullon, i bën ujem[4], të math ngatrim i sjell ordhisë[5] !
Ahere rasti vjen për ne "o burra", thresim me Ganinë,
Çveshimë shpatat gjith-kush edhe përçajmë ushtërinë,
S' tregohet ç' ngjau në atë ças, qeni s' e njihte dot të zonë,
Dërmën u kallmë gjer më një, luftoj trimrisht ushtria jonë.
Kështu kjo luftë mori funt, Ganiut më fort i detyrohet,
Zoti i jetës na ndihmoj po dhe Ganiu do mos harohet.

ZYLYFTARI

(*i mallëngjyer ngreh duartë përpjetë*)

Zoti me ne ! Ti gjithënjë ! Armëtë t' ona ti bekona !
Vëllazëri e trimëri Ti, Zot i Math, falna, dhurona !!...
Ejani shokë, mblidhi tok të lusim ditën e shënuar,
Kjo ditë qoftë gjithënjë një dit' e vlyer e uruar !
Vemi atje te kroj' i math, vemi t' i'a shtrojmë në lëndinë,
Se po na presin gjithë tok, vemi të hamë e të pimë.
Rroftë ushtria edhe ju që na nderuat Mëmëdhenë,

[1] Javo = atë çast, menjëherë, pa pritë e pa kujtue (K. Floqi)
[2] vërtik = vrull, hov
[3] buis = ushton nga zhurma,buçet
[4] i bën ujem = i turbullon mëndjen, i prish mëndjen
[5] hordhi = ushtri e madhe e mizore e pushtuesit, bandë e egër gjakatare

Rrofshin dhe armët gjithënjë, që jan mbures për Atdhenë!
(*Të gjithë dyke dalë këndojnë në valle*)

Rrofshin e qofshin sa gjithë Dhêu,
Armëtë t' ona *nami* e *shani*[1],
Rroftë dhe pushka e jatagani
Rroftë e qoftë dhe Mëmëdheu !
Ne s' jemi berra,
Ne s' jemi bisha,
As nëpër ferra
S' fshihemi dot,
Fam' e stërgjyshet,
E besa-besë,
As vdes, as prishet,
S' shuhetë kot !
(*Mbarojnë marshin dyke dalë nga sqena*)

BIJE NAPA

[1]me nam e nishan

TABLO E DYTË

Ngrihet prapë napa

Theatrua represanton një pyll të vogël. Një burim po buron pranë një shkëmbi. Përpara shkon ujë prua. Latifeja ri pranë burimit dyke mentuar.

Sqen' e I

LATIFEJA pastaj GANIU

LATIFEJA

Burrat u kthyen gjithë gas, gjithë po ndritin e çkëlqejnë,
Lufta e ashpër mori funt e mundëtarët po dëfrejnë,
Edhe Ganiu mê fort se tá po ndrin si ëngjëll, si pasqyrë,
Si madhështor, si mundëtar, si faqe bardh' e pa mynxyrë.
Gjithë po lozin, burra, gra, gjithë po thresin e kërcejnë,
Kanë të drejtë gjithë-kush, këtë gëzim kurrë s' e gjejnë !
...Veç un' e mjera po derth lot, s' di sepse jam kaq' e helmuar,
Fjala e Bidos më pikëlloj, jam në vrahthim, e hidhëruar !
Ah ! s' e besonj zembr' e Ganiut të ketë dashur tjatër grua,
Ganiu i kthiellët, s' e pandeh të dojë tjatër e jo mua !!
Mase kush e di mori vesh, qysh u gabua Bido plaku,
Të zerë ngojesh këtë gjë ! Po them se mase iu prish gjaku
Ah ! Gani ! gjer sa me vesh të të dëgjoj t' a thuash vetë
Me syt' e mij, të të shikonj, prapë s' më duket e vërtetë !
(*pas ca shëkon së largu edhe kërcen një herjesh*)

Oh, si më vjen ! më s' duronj dot !... Më vjen se shëmbëllenj Ganinë
....Ah ! ësht' ajy !!..., ja tek e njoh ! Ah, Ylli im ! Gani je tinë ?

GANIU

(*dyke hyrë në sqenë*)

Jam un' i tëri, Latife, vinj të të shoh, të të çmallem,

Kam kaqë kohë në *sefer*[1]!

LATIFEJA
(*me gas*)

Ah, sa s' duronj, sa ment marrohem !
(*i sulet Ganiut*)

GANIU

Të zuri malli Latife ?

LATIFEJA

Pyet akoma si qëndrova ?
Pa fjalë ka, o Ylli im, si pritta unë, si durova ?
Munt të dyshosh për Dhê e Qiell, munt të dyshosh për botën tërë,
Po jo për mua, o Gani, për dashurinë aq të gjërë!
Të dua fort, të dua keq, s' ka të treguar dashuria,
Je ti im Zot, je shpirti im, je ti për mua Perëndia,
Ah të tregohej lehtësisht kjo dashuri që nuk ka anë,
Mase dhe Dielli q' është një do t' ishte i shuar an' e mb' anë !
Nxir zëmbrën t' ime e shiko, shiko si hapet e si mbyllet ,
Vere re mirë e dëgjo, si zëmbra ime tjatër s' pillet !
Shikomë synë e fello në Oqeanë të pa sosur,
Sa dashuri që të tregon ! Sa është vrarë e plagosur !

GANIU

Më këput shpirtin, Latife, me këto fjalë kaq të mprehta
Zembrën e varfër bm' a plagos, më vrasin keq plumbat e nxehta.

[1] Sefer = ekspeditë

Po le t' i lemë hê për hê këto fjalime prap' i gjejmë,
Sot duhet gjithë mbledhur tok t' ham e të dëfrejmë.
Të lusim ditën që bekoj armëtë t' ona Perëndia
E t' a adhurojmë gjithë tok të tërë ne dhe ushtria.

LATIFEJA
(*më vehte*)

Ah, vallë pse kaq ftohtësi ! Ah! s' e pandehnja asnjë herë,
Habitem fort, s' di qysh të them, s' është Ganiu ky q' ish aherë.

GANIU
(*dyke mos vënë re*)

Eja, na presin pa durim, mishrat po piqen, sofrat shtruar,
Eja, Latife, e mos mëno, se jemi mjaft të urëtuar[1]

LATIFEJA
(*veçan*)

Fjalët e tija si nisher njëra pas tjatrës po më çpojnë,
Zëmbrën, mëlçitë sa po vjen, m' i djegin keq, m' i përvëlojnë !

GANIU

Pse ri mentohesh, Latife ?

LATIFEJA
(*me një dëshpërim*)

Mentohem unë ?...Përse vallë !

[1] urëtuar = uritur

(*më vehte*)
Pse s' më pikon, o Perëndi ! Ah, si duronj, si jam e gjallë!
(*vjen Marrua*)

Sqen' e II

TË PARËT edhe MARRUA

LATIFEJA

Ju po u presim, Zotërinj, me sa ju mundet mos mënoni,
Të gjithë janë mbledhur tok, vraponi pakë, mos vononi.

GANIU

Ja tek po vimë edhe ne, po s' di pse sillet Latifeja,
Ti Marro mere me pahir, mere sa kaqe edhe eja.
(*ikën Ganiu*)

Sqen' e III

MARRUA, LATIFEJA.

MARRUA

Jakë, o Zonjë, ç' ri kështu ? Theror t' u bëftë Marrua jote
Pse ri mentuar ? Eja shpejt, lipset të dukesh dhe zotrote

LATIFEJA

Hiq, Marro, motër, iq me ta, çap e përzjehi e dëfrehi,
Dhe mua lermëni këtu, ju qeshni, loni e kërceni !
Do të ri vetëm, do të qanj, atën e dashur Rakip benë,
Se gjithë u kthyen, po ay s' dihet se ku e mbajti penë !

MARRUA

Ah, pse të hipi ky mentim, pse m' hidhërohesh, Zonja ime,
Të përgjërohem mos kështu, hidhi përtej këto mentime !

LATIFEJA

E shoh, o Marro, që më dô e të vjen keq me të vërtetë,
Po mua tepër m' u mërzit e m' u xvertit e shkreta jetë !

MARRUA
(*Dyke lypur*)

Zonjë, të lutem !...

LATIFEJA

S' ke përse !....është e tepër të mendohesh,
Marro, mos vuaj, po shko drejt, hiq të zbavitesh, të gëzohesh !!
(*Marrua ikën me kryet unjur. Latifeja ri e mentuar*).

Sqen' e IV

LATIFEJA
(*vetëm*)

Pse t' isha lerë ? Ah, përse ? Pse të të njoh, ah un' e mjera !
Ç' ish ajo orë që na poq ! që më ka hedhur në potera !
Gani, s' je ti, që m' ato sy, më shihnje dëndur m' adhuronje !
S' je ti që vdisnje q' atë çast, që kurrë tjatër gjë s' mejtonje !
S' je ti që vriteshe Gani ?...Po tani pse u dëshpërove?
Pse, o Gani, thuam përse u ftohe kaq' u ashpërove !
(*zë qan*)

Qani, o qani syt' e mij, qani me zê e mos pushoni !
Dhe ju, o brigje, o shkëmbinj, ahet e mija mos harroni !
E donja keq me gjithë shpirt, e lahtarisnja un' e gjora,
Po tani mbeta në dëshpërim edhe po tretem po si dbora !
Po si një lundrë, një anij', q' e rahin valët nat' e ditë,
E më s' afrohet në liman, as që sheh dot gjëkundi dritë,
Si peshk pa ujë, si një zok që kthehet e më s' gjen folenë,
Ah, n' atë shkallë, o Gani, dhe ti e prure Latifenë!
Të qanjë me lott, të mos pushonjë, e madh' e keqe që më gjeti,
S' rëfehet dot, më s' bëhet më, tani për mua lumi, deti !
Ah, Ahhh, Gani !!

(*zaliset edhe bie përmbyset. Porsa dëgjojnë*
që jashtë sulen të shohin ç' bëhet)

(*Zylyftar Poda me të tjerët të tryezës hyjnë në sqenë*)

Sqen' e V

LATIFEJA, ZYLYFTARI, ELMAZI,
MERSINI, AHMET ZABOVA, ALIKO PRODANI

ZYLYFTARI

(*dyke hyrë*)

Latfeja briti kësisoj ?!

ELMAZI

Pse vallë, ç' pati vajz' e gjorë ?

(*e ze për dore*)

Qënka e ngrirë porsi gur, i paskan ngrirë këmb' e dorë !

ZYLYFTARI

(*ze ta ngrerë*)

O bija ime Latife !

AHMET ZABOVA

I paska rënë vilania !

MERSINI

Pse u ndoth vetëm kjo këtu ?

ELMAZI

As q' e marr vesh me mënt' e mia.

ZYLYFTARI

Latfe, po fle Ç' pate kështu ? Pse s' më përgjigjesh bija ime ?
Sot që po lusim këtë ditë, Zylfos i' a bëre zëmbrën thrime !
(*dëgjohet një hingëllim kali së largu.*
Një kalorës po vjen me nxitim. Është Rakip beu)

Sqen' e VI

TË PARËT edhe RAKIP BEU

TË GJITHË
(*porsa e shohën*)

O ! Rakip beu !

RAKIP BEU

Mirë se u gjenj !

TË GJITHË
(*e zenë përdorë*)

Të lumtë këmbëza q' urdhrove !

ZYLYFTARI

Si pa pandehur po na vjen ! shumë na çele, na gëzove !

RAKIP BEU

Jam pak i lodhur, se po vinj dyke vrapuar që nga Qari
Është çudi si jam këtu e qysh shpëtova që nga zjari !

ZYLYFTARI
(*i ep dorën e zien për qafe*)

Të përqafonj, kryeushtar, mir se ardhe vllath i dashur
Na mori malli keq për ty, qemë pa-qet' e buzë plasur !

MERSINI

Jemi të lumtur, gjith gas.

AHMET ZABOVA

Më vjen se prap' u përsëritta,

ALI PRODANI

S' tregonj gëzimin që po ndjenj për këtë ditë që haritta !

RAKIP BEU
(*i ze gjithë për dore*)

Më rrofshi vllezër, Zot' i Math na qoftë gjithëve mburesë
Na faltë armët gjithënjë për nder' e math të Mëmëdhesë.
(*dyke vënë re rrotull*)

Po ç' qënki mbledhurë këtu ? Ç' është kjo vajzë q' është shtrirë ?

ZYLYFTARI

Jot bijë është, nuk e njeh ? S' di se ç' na pat me qenë mirë.

RAKIP BEU
(*me një ngashërim*)

Latfeja ime ! Si kështu ! Ç' pate moj bija ime e dashur,
(*e pushton dhe ze ta ngrerë*)

Ngreh-mu ! Yt atë po të thret ! hap sytë, shihmë, të jam qasur !

LATIFEJA
(*porsa vjen nër mënt*)

Âtë, o âtë, qënke ti ? A mos shoh ëndër un' e gjora !
(*i sulet për qafe*)

Theror jot bijë, âta im; është i math ky gas që mora !

RAKIP BEU

Po ç' jeshe shtrirë ? Ç' më të ngjau ? o Latife, o bija ime,
Pa i trego atësë t' ënt, pse sikur je në psherëtime ?

LATIFEJA

Nga malli t' ënt, o âta im, që kisha kohë të të shihnja,
Isha e marrë e pa mënt, e qysh të bënj' as unë s' dinja
U kthyen gjithë e veç ty s' të shihnja dot, as dukeshe fare
Më kishe tretur me gjithsej, ti më një pe zëmbrën m' a mvare

RAKIP BEU
(*e rëmben nër krahërorë*)

Më hape zëmbrën, Latife, ah o thesar, o bija ime,
Eja të preheshë këtu, hidhi përtej këto mentime

LATIFEJA

Sa jam e lumtur !

RAKIP BEU

Je vërtet, o bija ime, o moj lule,
Yt' atë ty të adhuron, të ka në lajka, në pekule[1] !

ZYLYFTARI

Vemi të gjithë atje tej, sofrat na presin, janë shtruar,
Vemi të qeshim gjithë tok, sot lipset lojtur e kënduar.
(*Zënë dalin nga sqena ca nga ca gjer sa dalin të tërë*)

BIJE NAPA

[1] pekule= përkëdhelje, përkujdesje

TABLO E TRETË

Me të ngriturit e napës, theatrua tfaqëson sheshin e math të pshatit, tek janë shtruar tryezat gjithë tok. Rotull kanë ndënjur gjithë tok. Zylyftari me Rakip bejnë rinë në krye. Bidua, Ngjelinua edhe Marrua po shërbejnë.

Sqen' e I

ZYLYFTARI, RAKIP BEU,
edhe gjithë të tjerët bashkë.

ZYLYFTARI

Mir se u mblodhme gjithë tok, gjithë të lumur, të gëzuar

RAKIP BEU

Na poqi fati ! Zot' i Math të gjithë bashkë na ka ftuar.

AHMET ZABOVA

Nisni, u lutem e pa turp, të gjithë si në shtëpi t' uaj,
Mos kini drojtje, se gjithkush është i brëndshim, jo i huaj,
Të hamë nj' herë, se s' duronj, plasa, më mori keq uria,
Pastaj fjalojmë cilido, si na mson vera e rakia.

MERSINI

U mplake, Mete, po s' i le shakat' e shkreta kurdoherë,

AHMET ZABOVA

Unë n' i shtofsha djalthi im, pa t' i paksonj mos prit as nj' herë

ALI PRODANI

Të gjith' uria na ka rrok, dirsët na venë posi lumë;

AHMET ZABOVA

Mase ju haet edhe ju, po plakut gjorë ca më shumë.

TË GJITHË

Ha, Ha !....

AHMET ZABOVA

Pse qeshni ?...Si përse ? Qeshni me plakun fatzinë,
Ah, po m' u mplakçi edhe ju, pastaj fjalojmë për urinë

ZYLYFTARI
(*dyke qeshur*)

Mirë flet Metja.

MERSINI

Aq flet paq !

RAKIP BEU
(*duke qeshur*)

Kanë të drejtë pleqt' e gjorë.

AHMET ZABOVA

Po! Si urdhëron, ashtu vërtet ! ky bark do mbushur e kjo zorë
(*Qeshin të gjithë edhe zënë hanë*)

ZYLYFTARI
(*mer qelqin me verë e ngrihet*)

Për shëndet t' uaj, zotërinj, qoft' e bekuar këjo ditë
Rroftë Shqipëria, dh' ajy Zot i dhëntë gjithë mirësitë.
Hani e pini gjithë tokse nja gas tjetër po mentojmë,
Ganin' e vetëm, birë t' im me Latifenë t' i martojmë,
Shokë, po dini gjithë ju sipas zakonit Shqipërisë
Q' i kemi vluar që të dy që n' atë mosh të vogëlisë,
Sot ardhi dita q' edhe ne të hapim dyert të dëfrejmë,
Dasmë të bëjmë këtu tok, këtë gas kurrë nuk e gjejmë

RAKIP BEU
(*Zylyftarit*)

Dëshira jote, Zylfo bej, le të mbarohet që taninë,
Rasje m' e mirë se këtë s' ka për Latifenë' e për Ganinë

AHMET ZABOVA

Ju lumtë goja ! Që të dy ç' më qënki fare mu në zembër
U trashëgofshin ! dhe ky gas qoftë për mashkull e për femër.

TË GJITHË

U trashëgofshin ! Për hair !
(*Ganiu këcen vëndit. Latifeja q' e sheh hidhërohet keq.*
Marros i bien misuret duarsh)

ZYLYFTARI

Më rrofshi, ju' a paça hua;

RAKIP BEU

Gas paçi gjithë;

GANIU
(*me vet-he*)

O rrufe ! Pse s' më pikove vallë mua !

ZYLYFTARI
(*Ganiut edhe Latifesë*)

Ejani tok, o bijt' e mij, uratën t' a apë Zylyftari,

MARRUA
(*Me vet-he*)

Ah, si s' pëlcas, si s' shuhem dot, si s' hapet të më pijë varri.

LATIFEJA
(*me vet-he*)

Puna u duk s' është mbë roth[1], vdekja më mirë më pikoftë

BIDUA
(*veçan dyke parë Marron*)

Ah, un' i ziu, që mbahem dot ! fara kopile më t' u shoftë.

MANUSHJA

M' u trashëgofshi që të dy Zoti u faltë dit' e jetë
Rrofshi të lumtur gjithënjë, pa gjë të keq, pa gjë të metë

ZYLYFTARI
(*pa durim, se sheh që s' vijnë*)

Ç' prisni ? dhe nj' herë t' u a thon ?

[1] Mbë roth = në terezi

AHMET ZABOVA

I kanë naze kto të rinjtë
S’ mentohen që do bëhen pleq siç jemi sot, a ne të zinjtë.

RAKIP BEU

Jakni të dy, mos kini turp, këto i shkuam dhe ne nj’ herë.

AHMET ZABOVA

S’ vinë, se presin, që të dy t’ a përsëritni nj’a tri herë.

ZYLYFTARI

Turpi më nj’ anë ! s’ ka *lezet* !

GANIU
(*veçan*)

Ah’, si të bënj ! si duhet sjellë !
Qysh të tregohem, un’i ziu ! Sa mirë që mos isha pjellë !

MANUSHJA
(*vete e zë Ganinë për dorë dyke hequr*)

Jakë tani, lini këto !

GANIU
(*dyke shkuar nga duart’ e s’ëmës*)

Lermë ! s’ vinj dot !

MANUSHJA
(*me habitje*)

Qysh ?... Pa më thua!...

LATIFEJA
(*veçan*)

Ah, ç' është kjo ! Popo s' qëndronj ! ah seç më gjet të zezën mua.

MANUSHJA

Gani, asfare s' më pëlqen e sjella jote këtu brenda,
Ja se po turpesh edhe s' vjen, ja se Latifenë s' t' a ka ënda !

ZYLYFTARI

Ç' thotë, Manushe, ky Ganiu ?

MANUSHJA

S' thotë gjësendi, t' u ngjat' jeta,
Po s' di sepse u bë kështu, s'vjen po s'e muarr dy tre veta.
(*Elmazi edhe Mersini ven' e heqin që të dy*)

ELMAZI

Aj, mjaft na lodhe, o Gani,

MERSINI

Kemi që kuri që durojmë;

GANIU
(*me një çfaqje kuximtare*)

Shokë mos lodhi fare kot !

ELMAZI

Pse ? nuku do të të martojmë ?

GANIU

Jo, se nuk bëhet ajo sot, do vinjë puna pas volije,

ZYLYFTARI
(*pak i zëmbëruar*)

Qysh ? Ç' jan' ato që po dëgjonj ? Nukë të vlova që vogjlije ?

GANIU

Âtë, të lutem, mos kërko të më shtërngosh me të pa hirë
Që të martohem fët për fët, këjo s' më duket gjë e mirë !

RAKIP BEU
(*dyke habitur veçan*)

Ç' dëgjova ? Mundet t'a besonj ?

ZYLYFTARI
(*Ganiut*)

Ç' fjalon ashtu, në daç Perëndinë
Kuxon përpara të më dalç, të më ktheç fjalë edhe tinë ?
Jam ata yt e të urdhëronj, do bësh kështu siç të thom unë
Do marrç Latfenë që tani, ndryshe po s' bëhet tjatër punë !

GANIU
Më vure ngulmin me pahir

ZYLYFTARI

Në shtëpi t' ime bënj si dua,
Latfen' e merr grua tani ? Përgjigju, folë... apo ç' thua ?

RAKIP BEU
(*me vet-he*)

O bot' e shkretë ç' je kështu !

LATIFEJA
(*me vet-he*)

Oh, m' u err syri, m' u nxi jeta !

BIDUA
(*gjith' ashtu*)

More u prishnë fare mënç !

MARRUA
(*me vet-he*)

Plumbat më shkojnë si shigjeta !

MANUSHJA
(*gjith' ashtu*)

Kërcurja unë !

AHMET ZABOVA
(*hyn në mes*)

Dale pak, o Zylfo bej, mos u shpejtoni,
Majë më majë kshu si ju, punrat më duket i malconi.

Pa dal t' a marrim me nga dal, me një qetsi me gjak të ftohtë
Pastaj të shohim kush ka hak e kush zëmbërohet më kotë.

MERSINI

Vërtet, pa fjalë, prisni pak.

ALI PRODANI

Mos zëmbrohi, mos u shani
Me qetësi ç' farë do gjë, dhe "urt e but' e plot tigani"

ZYLYFTARI
(*dyke çfryrë*)

Zgjidheni juve, unë s' munt, më prishet gjaku kur zëmbrohem,
Më vjen që, s' qënkërkam asgjë kur nga im bir mohohem !

AHMET ZABOVA

Me lejen t' ënde, Zylfo bej, mundem t' i them Ganiut dy fjalë ?

ZYLYFTARI

Me pash nga unë lejen ke.

AHMET ZABOVA
(*Ganiut*)

O Gani bej, o bir, o djalë,
Pa thuaj plakut me liri, qysh s' do martesin kaq të vlyer,
Që edhe ne që jemi pleq e gjejmë të pëlqyer ?

Sikur të ndodheshe njeri e të më thosh me të vërtetë
"A mer një nuse ore shtrik ?" Be të bënj për Zonë vetë
Që do mos thosha fare jo, as do t' e shihnja në ka dhëmbë,
Po do t' i bëhesha theror, t' i puthnja dorë e oëllëmbë !
Jo ty që t' apin një pullump, një sy mëshqerë, vetull zezë,
Ri e bën naze sikur s' do, sikur s' sheh syn' a s' i sheh mezë.

GANIU

Të falem nderit s' kam ç' të thom, fjalët e tua mendarake,
Më piknë xëmbrën si ballsam, zëmbrën e shkretë varfanjake !
Po në je plak, në e menton, në të kujtohet djalëria,
Gjyko se s' blihet në trek si ç' farëdo dhe dashuria

AHMET ZABOVA

Këtu s' ka fjalë që ke hak, se edhe unë isha nj' herë,
Djalë si ty no njëzet vjeç kur desh im' atë të më vlerë,
Më vinin vajza nja pas një; me donati, me pajë shumë
E deshnin áta e im' më që të më vininë në gjumë.
Të më martoninë me një që kishte ara e selishta[1],
Krushqi të bënim kësisoj me një të pasur nga Zelishta.
Po kur dëgjova pa pandem qe një lesh kuqe, zënë lia,
As prita fjalë të dëgjonj, po vete shpejt e marr dy shokë
E të rëmbenj një siselvi, pa soj, pa gjë, të varfër trokë.
Po un' e donj' atë me shpirt !Ashtu e shkova jetën t' ime,
Fatbardh', i lumtur gjer një vit që më la fill e në lëngime.

GANIU

Të lumtë goja, flet si plak, si një i vojtur e i ditur,
Si me triměri, me dituri, më ke pa masë keq habitur.

[1] selishtë = kopësht apo arë e vogël pranë shtëpisë

Andaj të lutem hë për hë të mos e prishimë gostinë,
Pa kemi kohë për këtë, ç' do gjë me radhë do të vinjë.

ZYLYFTARI
(*i zëmëruar*)

Mete, më ndje, s' qërove gjë ! unë s' po mora vesh gjësendi,
(*Ganiut*)

Gani, pa folë burrërisht, jepi një funt këti kuvendi !
Atë që zgjodha si për ty e me të cilënë të vlova
Dua t' a marrësh grua sot, se gjer tani s' u turpërova !

GANIU

Pse po nxitohesh âta im ? Nuk munt të preç një herë tjetër,

ZYLYFTARI
(*me zëmbërim*)

Jo, s' pres më tutje dua sot të marrë funt ç' do farë vepër !

MANUSHJA
(*Ganiut*)

Pse biri im, sillesh kështu ?

GANIU

Prindër, ju lutem, mos nxitoni,
Kam edhe unë një qëllim, mos shtyhi shpejt të më martoni.

RAKIP BEU
(*veçan*)

O Zot i math !

LATIFEJA
(*gjithashtu*)

O Perëndi !

BIDUA
(*gjithashtu*)

Më vjen se lojt' i ziu nga mëntë !
Zotit i arthtë keq për ty, të mëshiroftë e t' i dhëntë !

RAKIP BEU
(*Ganiut*)

Përse t' a zgjatim, o Gani, çpalle sa kaqe ç' do të thuash,
Se më vjen keq të druhesh kaq, të rish të heqësh e të vuash.

ZYLYFTARI
(*Ganiut*)

Qëllim në ke përveç këti këtu përpara nesh tregohe
Fjalën e fundit, se më s' pres preje sa kaqe e shkurtohe,

GANIU
(*i zëmbëruar*)

Âtë të kam, po jo kështu ! kërkon me hir me të pahirë,
Tani të bëhet volli yt ! Mos, se më vjen që s' e ke mirë !

ZYLYFTARI

Ku e harriva un' i ziu, im bir të flasë kaq çpenguar !
(*Ganiut*)

Bre qen ! T’ it et’ i flet ashtu ? Pa më trego kush të ka msuar ?

MERSINI

U ngatrua puna fort.

ELMAZI

U bê ujem, u turbullua !

ALI PRODANI

S’ di si të thot’ i ziu njeri

AHMET ZABOVA

Zjari u ndes e u afshua.

ZYLYFTARI

Do flaç, a ç’ thua ? Mos për fat s’e ke me zemër Latfenë ?

GANIU

E vure pikë, âta im ?

ZYLYFTARI
(*vet-he me vet-he*)

Më vjen t’ a vras t’ a pres për Qell’ e Dhenë !

GANIU
(*më s’ mba dot vet-hen*)

Mund më apç nëm, mallkim, të më mohosh me gjithë fuqinë
Po mos kërko të më çkulç nga zëmbra ime dashurinë.

E dhashë gjetkë, e me të jam lidhur fort e jam shtrënguar,
Kjo dashuri veç po të vdes ndryshe s' ka kurrë për të shuar.
Po dhe pas vdekjes s' e harronj, atje në Qiell do t' i jem pranë
Flaga që ndjenj, që më zhurit s' tregohet dot as që ka anë.

ZYLYFTARI
(*gjith' ashtu*)

Cila ajo ? Pa të dëgjonj ! Më fute zjarrë në mushkëritë,
Gani, për besët, s' mbahem dot, të përvëlonj të djek mëlçitë !

MANUSHJA
(*e trëmbur*)

Burrë, të keqen më mbulo mua, t' ët shoqe tek të lutem
Pastaj ç' të duash munt të bësh !.... Ah, s' di ç' të bënj e ku të futem.

LATIFEJA
(*keq e dëshpëruar*)

Ah, s' mbahem dot !

MARRUA
(*pa shpirt*)

Unë theror, të bëhem që mos shoh Ganinë,
Të vritet, ah, përpara sysh !

BIDUA
(*me hidhërim*)

Kur s' më pikon mua të zinë !

ZYLYFTARI
(*i zgurdulluar*)

Për Zotin folë !

GANIU
(*si i marrë*)

Do të msosh ? Më vure thikën ? Cilën dua ?

(*sulet dy çape edhe tregon Marron me të dy duart*)

Ja ! këtë !... Marron !!!
Të gjithë habiten e qëndrojnë si të ngurosur.
Latifesë i bie zali edhe bie nër duart e Rakip Beut.
Bidua çkul cullufet edhe bën si i marrë)

ZYLYFTARI
(*s' mbahet dot*)

Ah, bre qen ! më turpërove faqen mua !!
(*zgurdullon sytë dhe me një rëmbim*
të math qit koburen nga brezi)

Për një kopile gjith këto ? Për një Kaurkë të pështirë ?
Na ! mer një plump, se s' të kam bir, për mua çporu i vështirë !
(*Zë t' ia heqë, po Marrua i del përpara,*
hyn në mest të Ganiut e të Zylyftarit
dyke mpruar Ganinë me trupin e saj.
Elmazi i zë koburen)

MARRUA

Na ! vramë mua ! (*hap krahëror' e saj*)

MANUSHJA
(*derdhet e përqafon të birë*)

Po, po, po !!!

ZYLYFTARI
(*i mahnitur*)

Hapi t' a vras, t' a pres me pallë !

GANIU

Na ! bjerë, vramë, po mos prit të rronj pa Marron un' i gjallë !
(*e madhe bujë në sqenë, të gjithë*
shastisen e mallëngjehen).

BIJE NAPA
Funt i Pamjes III

Pamj' e katërtë

Theatrua tfaq një kopsht me lule e me shelgje. Një rap i math e i dëndur përhap hijen e tij të gjerë. Nënë të ri një shtrat tek është shtrirë Latifeja e sëmurë, keq. Vuan nga lyngjeri[1], tani fle. Rakip Beu i rri mbi kryet e i fshin dirsët me një rizë të bardhë. Bidua i rri pranë këmbëve dhe e shërben.

[1] Lyngjer = sëmundje e keqe, në rastin konkret tuberkuloz

Sqen' e I

RAKIP BEU, LATIFEJA, BIDUA

RAKIP BEU

Ah, un' i ziu ! Unë fat ziu ! Sa jam fatkeq e i përdhunë !
Nga m' ishte thënë mua sot, që të më ngjasë kjo punë !
Pra sot ne mua, që po jam i vetëmi nga fisi ynë,
Kjo e keqe e ky turp më nxinë faqen edhe synë !
Pika ë mirë s' më pikoj ? Rrufe e zjartë s' më goditi ?
Se sa më lanë që të rronj, si një i poshtër, si evgjiti!
(*dyke fshirë djersët Latifesë*)

Ah, po ç' të bënj që s' ka njeri dhe kjo murga Latifeja,
Pa ndryshe, mua q' atë çast le të më kish rënë rrufeja !
Ç' e desha jetën kësisoj, jetë të çndershm' e të fëlliqur ?
Më mirë vdekjen sa kështu në këtë jetë të mërzitur !

LATIFEJA
(*zgjohet dyke kollitur*)

Këtu më qënke âta im ?

RAKIP BEU
(*i zë duart*)
Këtu të jam, o bija ime,
Ah, qysh të shoh, moj Latife ç' janë për ty këto hidhërime !

LATIFEJA
(*kollet*)

Jam mirë, atë, mos ki keq për mua fare, mos helmohu
Ah pse vrerohesh kaqe fort, qesh, ata im, folë gëzohu.

RAKIP BEU

Gas të kem unë, Latife ! Unë të qesh, o bija ime !
Pas ksaj dhune që na ngjau, që më varroj, më bëri thrime !

BIDUA

Mos o im zot, o Rakip bej, pluhur e baltë Bido plaku,
Mos m' u helmo dhe kaqe fort, mjaft t' u nxi jeta t' u prish gjaku !
Ka Perëndia dhe për ne, besonj të shkretë mos na lerë.
Do vinjë dita që dhe ne në vënt t' a vemë tërë nderë.

LATIFEJA
(*bën të ngrihet edhe bie prapë,*
dyke kollitur gjithënjë)

Mbamëni pakë,... s' qëndronj dot... jam e venitur si e vdirë,
M' u tretnë kockat....s' mbahem dot, as që lëvis me të pahirë.
(*kollet nja dy herë edhe bie prapë.*
Rakip beu me Bidon po e mbajnë)

RAKIP BEU

Ah, bija ime, ç' je kështu !

BIDUA

O zonj' e dashur pse m' u vdare
Nuk të vjen keq për âtën t' ënt, që e plagos që e vret fare ?

LATIFEJA
(*e andrallosur*)

Ah, seç më digjet koka zjarr, krahror' i shkretë mënt më hapet,

Flaga më djek, më përvëlon, m' u prenë gjunjët edhe çapet.
(*po kollet me shtërzim*)
Kjo koll' e thatë që s' pushon ! më griu mëlçinë an' e mb' anë,
Dhe djersët lumë gjithënjë edhe ethet kurrë më s' më lanë !
(*shëkohet në pasqyrë*)

M' u futnë sytë mun në trut, ah, mbeta koskë e lëkurë,
Ah, po më s' rrohet dot kështu ! jeta m' u nxi e m' u bë urë !

LATIFEJA
(*e mallëngjyer*)

Je ti, e zeza Latife ? Je ti që ishe si burbuqe ?
Ku i ke faqet ? Pse s' të njoh ? Që ish' e bardhë e e kuqe !
Pse Perëndi të vuanj kaq ? Pse të lëngonj e varfra unë ?
Të gjithë bredhinë me gas ! Për mua vetëm këjo dhunë ?
Po mos më ler' o Zot i Math, të vuanj më në këtë jetë,
Ti që dhe vdekjen mblithmë sot, o Zot i math e i vërtetë

RAKIP BEU

O bij e vetëm, Latife, mjaft më pikllove, më këpute,
Mba shpresën, bijë, mos kështu,zëmbrën e varfër mbahe, zbute !

LATIFEJA

Shpresë për mua më s' ka më, po qasuni t' u shoh dhe një herë,
Se kështu vajti filli im, ç' do shpresë sot më ësht' e prerë !
(*Rakip beu me Bidon i hasen pranë.*
Latifeja i pushton që të dy)

O ju të dashurit e mij, që lini jetënë për mua,

O âta im, Bido besnik, jeta m' u pre m' u shkurtua.
Më mirë vdekjen sa kështu, se s' munt të rronj në këtë jetë,
Mbamëni burra që të dy, se unë shkonj, te Zoti vetë.
(*e dëshpëruar*)

Qamëni ju, o miqt' e mij, qamëni ju, o fusha male
Dhe ti bilbil ligjromë sot këngën e fundit me nga dale !
Qani bregore, o përrenj, qani o pylle dit' e natë
Ju le shëndenë, sot po shkonj, thoni që kurrë nuk më patë !
(*dyke shtërnguar t' atnë edhe Bidon*)

Ti ât' i dashur të më shtrosh varrë të shkretë plot me lule,
Siç me ke rritur në vogëli, siç më ke mbajtur në pekule,
Të vish për dit të më vajtosh, t' ujitësh varrë gjithë lottë
Të vish të qaç, të threç më zë mi varrë t'im, te bija jote
(*Rakip beu me Bidon fshinë sytë*)

RAKIP BEU

Pusho, moj bijë, nuk ke gjë do shërohesh, mjaft u sose,

BIDUA

Na mallëngjeve shumë fort, na vdiqe fare na plagose !

LATIFEJA
(*si e prishur mënç ze leshrat e i çkul*)

Ah, ç' jam kështu, o Perëndi, pse s' të vjen keq për një të vobët
Pse u venita kaqe fort ? Pse jam e mpirë e e dobët ?
(*dyke qenë në ekstas*)

Gani ku je ? Pse nuk të shoh ? shum' u mënove të vish pranë,
S' di se kurrë s' rronj pa ty, se dashuria s' më ka anë ?
...Ç' u bënë shërbëtorët t' im ? nuk do t' ormisin[1] sot shtëpinë ?
Dit' e martesit s' është sot ? S' u mblodhë të han e të pinë ?
Pse nuk i shtroni fët e fët dhomat me shtresa me qilime ?
Për kur i mban ? shtroni shpejt, shtroni të tërë pajën t' ime
(*dyke shtuar zjarrë*)

Ah, ëndra ime ish vërtet, ja tek më dolli siç e pashë,
Sikur më dogji q' atë dit, q' aher' u pika e u vrashë.
(*përsërit prapë fjalët e para*)

Gani, s' je ti që m' ato sy, më shihnjë dëndur, m' adhuronjë,
S' je ti që vdisnje q' atë ças, që kurrë tjatër gjë s' mentonje ?
S'je ti që vdisnje, Gani ?... po tani pse u dëshpërove ?
Pse, o Gani, thuam përse u ftohe kaq, u ashpërove ?
(*Do të pasonjë êdhe, po s' ka fuqi, e ze kolla*
edhe këputet e bie përmbi shtrat.
Rakip beu me Bidon e zenë).

RAKIP BEU

I mjeri unë !

BIDUA

Un' i ziu, m' u prenë këmbët, m' u shkurtuan,

RAKIP BEU

Këto më vranë, s' kam fuqi, më tretnë fare më rëzuan !

[1] ormis = vej në rregull, zbukuroj

LATIFEJA
(*bën kurajon e fundit*)

O shpresa ime e perëndijt' u shove fare, ikë meje
O Zot, më s' mbet për mua gjë, përveç t' afrohem afër teje !
O jeta ime, q' ikën sot, jet' e mërzitur, e brengosur,
Ikë, largohu, dhe ti shpirt futu në jetë të pa-sosur.
(*dyke parë t' atnë edhe Bidon*)

Ju le shëndenë që të dy, bëhuni trima e mos qani,
Latfenë t' uaj q' u do fort, mos e harroni, zi e mbani.
O lamtumirë Gjithësi ! I hapa krahët fluturova
Qofshi t' uruar që të dy juve....që kurrë... s' ju gëzova...!!
(*Bie poshtë e vdekur. Rakip beu e përqafon*
me mallëngjim të math; Bidua i fërkon këmbët.
I ndezin një qiri e ja mbajnë në firomën e saj,
pra si pikasin që s' ka shpirt)

RAKIP BEU
(*i dëshpëruar kopsit duartë*)

Shkoj vajza ime !

BIDUA
(*hidhet si i marrë*)

Ç' flet ashtu, o Zoti im, të qofsha falë,
(*si i qaset dhe e shëkon*)

Popo të zinjtë ! mjer ne ! Ç' është kjo pikë, këjo valë !

RAKIP BEU

O Latife, ah, un' i ziu ! O bija ime ik' e shkove,
Jetën e shkretë e le pas, po mua fare s' më kujtove !

BIDUA

Ah, un' i mjeri ç' rrojta kaq pse e harriva këtë ditë,
Paskam mëkate un' i ziu Latfêsë t' ime t' i mbyll sytë !

Sqen' e II

TË PARËT edhe GANIU

(*Porsa e shohin Ganinë egërsohen që të dy, po unjin sytë ne i vdekuri. Ganiu sulet përmi Latifenë*)

GANIU

E madh' e keqe që na mbiu ! Si mjerë ne, ah, o poterë
O Latife, ç' të qe kështu, vdiqe, na shkove, moj e mjerë !

BIDUA

(*me zembërim e ze Ganinë për krahu*)

Përhapu, hiqu nga ky vënt, të vdekurin lere në preje,
Unj qaf' e gju hijesë saj, në mos mërgohu, hiqu meje.

GANIU

(*dyke mos vënë re*)

O Latife, s' t' harriva dot, ah un' i gjori që s' të pashë,

Ah, pse kështu, moj Latife, moj virgjineshë, o moj vashë !

RAKIP BEU
(*ngrihet si i marrë dhe e shtyn*)

O shkakëtar, o arrakat, hesht e pusho, mos folë kurrë,
Ikë, largohu që këtej, në je njeri e në je burrë !

GANIU
(*dyke vënë re gjithë Latifenë*)

Fajtor e di që jam tek ty, po haj i folë zëmbrës shkretë
Flagës përhapur në krahror që s'mërë në të qetë !

RAKIP BEU
(*me mëri*)

S' do të pushoç ? Edhe kuxon t' i prishësh vdekjes qetësinë ?
S' të ishin mja gjithë këto po na shton edhe mjerësinë ?
Ikë, largohu që këtej në je njeri e në je burrë,
Në mos po çporru, munt të them, se babëzinë[1] na ke prurë !

GANIU
(*Rakip beut*)

Gjithë kjo sharje, kjo mëri e ky çnderim e këjo bujë,
S' kan' asnjë vënt, o Rakip bej, s' ardha këtu të bënj rëmujë.

RAKIP BEU

Të ishe burrë, t' ishe trim nuk do zireshe me fjalë,
Po je i frikshim, s' ke kuxim, zëmbra të dridhet palë palë.

[1] babëzi = kuptimi i dytë i kësaj fjale është: zi e madhe, varfëri e mjerim, fatkeqësi e rëndë

GANIU

I frikshim unë ? Kush të tha ? Lerna, o zot, në daç Perëndinë,
Pe ato s' trëmbem, ti e di, po mos, të lutem na prish zinë.

RAKIP BEU
(*i egërsuar*)

Ç'zi, haj, i mjerë ka për ty, s' ke turp t' a thuaç këtë fjalë ?
E shoh që s' paskërke as turp, frika akoma s' të ka dalë.

GANIU
(*gjith' ashtu*)

Ç' fjalon për frik' a derëzi! Edhe s' ke njohurë Ganinë ?
Ç' kërkon, të vritem këtu, që të rëfejmë trimërinë ?

RAKIP BEU
(*me një mospranim*)

Unë më tepër s' të duronj ! ja rroke shpatën, ja po çporru,
Bjerë të bie, a në po ikë, mbytu a varrohu !

GANIU

Të lutem, mos u sill ashtu, s' të përket fare zotris s' ate,

RAKIP BEU
(*përnjëheresh çkul jataganë*)

S' qënkërke burrë e mjerisht për fam' e embrinë që pate !

GANIU
(*kap dhe ay kordhën*)

Më plase shpirtin, Rakip bej, dashke të vritemë një herë !
(*bën nj' a dy çape përpara Rakip beut, po prapë pendohet.*
E zë kordhën me të dy duart e e thyen, e bën dy copëra
e ja heth përpara këmbëve Rakip beut,
pastaj kryqëzon duart mi krahëror
edhe i thotë Rakip beut:)

Do të marrç gjakun kësisoj ? Ahere bjer' o Rakip bjerë.

RAKIP BEU
(*shastiset*)

Ah, un' i mjeri, ç' është kjo ! Ah, kë të vras, as un' i gjori,
Këtë q' e rrita në pëqi ! Vdekja mê mirë pse s' më mori !
(*kthehet nga an' e Latifesë*)

O Latife, o ylli im, s' shërohet kurrë këjo plagë,
Për gjakun t' ënt s' di qysh të bënj si të të bije nonjë çpagë !
(*dyke mentuar bën një kuxin të plottë*)

Po pritmë se po të vinj pas, kështu i gjallë nukë mbahem,
Një varr të presë që të dy, o Latife, nuku të ndahem,
Merr dhe këtë shpirtinë t' im, këtu të vetëm mos e lerë
Atje ku ti po flytyron, merr edhe mua më shpjerë!
(*kthen shpatën me vrap mi vetëhen e tij dhe plagosetpër vdekje.*
Bie poshte. Ganiu me Bidon derdhen t' a ngrehin)

GANIU me **BIDON**

Popo ç' na gjeti !

RAKIP BEU
(*Ganiut e Bidos, dyke hequr shpirt*)

Qasi pak...një porosi...kam për të thënë
(*Ganiu me Bidon qasen*)

Vraponi...pakë...sa jam gjall...sa më dëgjoni edhe zënë,
Bini-ma shpejto, këtë ças...këtu përpara Latifenë.
(*e sjellin me vrap Latifenë përpara Rakip beut,*
i cili e shikon me dhëmburi të madhe)

Ah, Latife sa me gas pres...në varr të dy...kështu të na venë !
Sa jam i lumtur...pranë ty...ja...tek po vdes...shum' i kënaqur
E shoh parajsën...që na pret...ja atje lart na është tfaqur,
Sa më pëlqen... të vdes më ty... sot që çel ver' e lulëzuar
Bashkë me ty, o Latife...ah... ç' do të prëhem... i gëzuar !!
(*Mbaron së foluri edhe shtrihet i vdekur*)

GANIU
(*i mbyll sytë*)

Shkoj edhe ky !!

BIDUA
(*keq i helmuar*)

Oh, un' i ziu !

GANIU

Hiqni n' uratën e Perëndisë !

BIDUA

Juve shpëtuat që të dy, veç unë jam katran e pisë !

GANIU
(*thëret*)

Ku jini, jakni, eni shpejt, mblidhi këtu tok të vajtojmë,
Kjo gjëmë e madhe s' ka tregim, qysh, ne të zinjtë do t' a shkojmë !

Sqen' e III

TË PARËT pastaj ZYLUFTARI, AHMET ZABOVA,
ELMAZI, ALI PRODANI, MERSINI,
MANUSHJA, NGJELINUA, MARRUA

ZYLYFTARI
(*porsa hyn kopsit duartë*).

Oi ç, n' a gjeti !!

MERSINI

Ç' është kjo !

ELMAZI

Ç' është kjo gjëmë, kjo poterë !!

MANUSHJA

O Rakip bej, o Latife, ç' ju ishte shkruar kjo e thënë !

NGJELINUA

Mjer' un' e zeza, që të dy, të vdekur poshtë paskan rënë !

GANIU

Kjo zi e madhe që na gjet s' tregohet dot, me gojë s' thuhet,
Po mern' i bini në konak, t' i qajmë bashkë po si duhet,
(*Ngjalinua edhe Marrua zënë të ngrehin*
mê parë Latifenë, po Bidua me të parët
hidhet në mest të tyre i egërsuar)

BIDO

Prapsi, moj dosa, çpori lark, mërgohi, ikni, të pështira,
Jam vet' i zoti për të dy, këputni qafën, faqe nxira
(*Bëhet një buj' e madhe për të qetësuar Bidon,*
po ky merr Rakip bejnë pastaj edhe Latifenë
edhe i heq që andej. Elmazi i ndih pakë.
Manushja edhe Ngjelinua dalin tok)

Sqen' e IV
TË MBETURIT

ZYLYFTARI

Si ngjau kështu ! kush qe këtu ? Le Latifejaq' ish sëmurë,
Po Rakip beu ç' pati q' u vra, që unë vdekje s' i vija kurrë !

GANIU

Si vdiq e gjora Latife, ng' ajo smundje që lëngonte
U vra mi të dhe Rakip beu, se pa të kurr' i gjalli s' ronte.

ZYLYFTARI

Zoti i ndjeftë që të dy, e në Parajsë i lëshoftë,
E kjo e keqe që ngjau sot mos ngjaftë kurrë, kaqë qoftë

ALI PRODANI

O zot, mbaj dorën, mos më tej

MERSINI

Vdekjen dërgohe ku ka sërë.

AHMET ZABOVA

Mburona djemt' o Perëndi, kujdes trego për botën tërë.
(*dalin jashtë të gjithë përveç*
Marros dhe Ganiut)

Sqen' e V

MARRUA edhe GANIU

MARRUA
(*si merr pak vet-hen*)

Ah, shkakëtare unë jam, nga mua gjithë këto mbinë,
Jam mëkatare sa s' merr më, unë kam prurë mjerësinë !
Dua të vdes, të mos rronj më, m' u xvertit jeta e mahnitur !
Jam rëndësirë përmi dhê, rrojtja më duket e mërzitur.

GANIU
(*i cili e dëgjon me vërejtje*)

Fajin, o Marro, s' e ke ti, barrënë tërë e kam unë,
Nga mua ngjanë gjith këto, nga mua ngjizi këjo punë.
E njoh sa faj që kam të math, ç' dënim që duhetë për mua,

Po zëmbra ime kshu u lint të vuaj për atë që dua.
Më fali jetën Zot' i math, më kalli ndjenja e vetija
Po m' i dha shpirtit një fuqi, q' ajo m' i mori mënt' e mija,
Dua të jem zot gjithënjë, të urdhëronj vet-hen kurdoherë,
Po s' munt të mposht, as që të shkul fuqin' e repët asnjëherë
Marro, s' kam faj, jo, un' i ziu, be të të bënj, të përgjërohem,
S' dua as unë kaqë fort të digjem sot të përvelohem.
Që atë ditë q' u kundrejt ky syri im me syt' e tua,
Ti m' a përfshive shpirtin t' im, më prishe mënç të gjorin mua,
Je kaq e bukur, si një yll, të dua keq sa më s' tregohet,
Kjo dashuria anë s' ka, dhe kur të shoh zjari më shtohet.

MARRUA

Ah, o Gani,sa shumë shpejt harron sa ngjanë të këqia,
Është mëkat kjo dashuri, këtë s' e do as Perëndia.

GANIU

E pse, o Marro, bënj mëkat unëi gjori që të dua,
Ahere Zoti pse më dha këtë fuqi të shpirtit mua ?
Jakë m'a nxir nga shpirti im, këtë dëshirë të afshuar,
Pastaj më folë për mëkat e jo kur jam i përvëluar !

MARRUA

Të vdekurit i lamë gjëm' edhe helmë s' numërojmë
Për mi kto, po *fe e din* s' lipset as fare të kujtojmë ?

GANIU

Të thashë, Marro, *fe e din* s' kanë asgjë me dashurinë,

Munt të besonjë gjithkush si që të dojë Perëndinë.
Seicili pe ne të dy munt të besojmë nga një besë,
Po Shqipëris' as un' as ti s' mundet t' i dalim të pa-besë.
Për Shqipërinë jemi një tërë sa shqipenë fjalojmë,
Jemi vëllezër, bijt' e saj, njëri nga tjatri nuk ndryshojmë.
Munt e Krishterë ti të jesh, a Mysliman një tjatër burrë,
Një Katolik, një Jahudi, po kombësi nukë ndron kurrë.
Para të kemi fe e din, si sot që ndodhemi të ndarë,
Një fe na lithtë gjithë tok, embri që ishim Shqipëtarë.
Fe munt të ketë cilido atë që sgjodhi, a ja lanë,
Cilën pëlqeu, a trashëgoj, për dinë qoft' a për imanë
Po gjuhë kurrë nuku ndron nga gjuh' es' ëmës, që piu sisë
Ajo e lith e e shtrëngon e iep embrin kombësisë
Kështu edhe ne sa flasim shqip vëllezër, ne të gjithë jemi,
Një far' e fis, një gjak, një shpirt, njëri nga tjatri ndryshim s' kemi.
Kish' a xhami për mua një, harin të flasë gjuhën t' ime,
Që t' a nderonj, t' a kem vëlla e mos i ndahem as thërime.
Kush nuk i njeh këto që them, kush s' ep të madhe rëndësirë,
S' është përveç se fanatik, njeri i dëmshim egërsirë !
Si mjer' ay i zi që s' njeh vet-hen e ti e komëbsinë,
Është fatzi, është i lik, ay s' beson as Perëndinë !

MARRUA

Të keqen unë, o Gani, sa bukur flet edhe sa mirë,
Të lumtë goja që po derth mjaltë, sheqer e ëmbëlsirë.
Tani të njoh me të vërtet, se shoh një burrë, trim të rralla,
T' a njoha zëmbrën, o Gani, haj të të puth në ballë.
(*e puth*)

Sa të kam dashur s' t' a tregonj, se s' më ka masë dashuria,
Ku ta dish ti si t' adhuronj, tek ty kam patur mënt' e mia.

GANIU

Marro, më dehe, s' jam nër mënt, fjalët e tua si mëllagë
Më ballsamojnë shpirtin, q' e kam lënduar, e kam plagë.
Folë, ah folë, mos pusho, me atë gojë posi mbleta,
Vërshon gëzimi që po ndjenj, fjalët më çpojnë si shigjeta !

MARRUA

Ah, o Gani, ku t' a dish ti, me sa fuqi që të kam dashur,
Hap, Gani, zëmbrën e m' a shih si ka duruar e s' ka plasur.

GANIU

Marro, më dogje m' ato sy, më përvëlove m' ato fjalë,
Zëmbrën m' a trete si qiri, dirsët me vëne palë, palë.

MARRUA

Endër mos shoh, o Perëndi, a këtë hirtë më bie.
A në Parajsë mase jam ! Zëmbra më bëhet fie, fie

GANIU

Oh, sa i lumtur do të jem kështu të dy jetën t' a shkojmë,
Parajsa ime ti do jesh, kur të pa ndarë të rrojmë.

MARRUA

Bota për mua do jesh ti, Qielli me yjtë që s' ka anë,
Det' i pasosur, Gjithësi, Engjëll i artë gjithë ç' janë !

(*përqafohen*)

GANIU

Më ndje, o Marro, për pak gjë, kam një detyrë për të bërë,
Të vdekurit t' i përciell tok, do jenë mbledhur të tërë
(*Marrua i ep dorën. Ganiu del jashtë*)

Sqen' e VI

MARRUA
(*vetëm*)

O Zot i math, o Perëndi, sa jam e lumur këtë ditë,
S' më duket gjë përpar' ati, e dua keq si të dy sytë.
Është i bardhë si pullump, i bukur fort posi pallua,
I holl' i gjatë si selvi, i fortë, burrë si dragua.
Syt' edhe vetullat e ti të vrasin keq posi shigjeta,
Nga goj' e ëmbëlë që ka të shtohet gazi edhe jeta
Un' e kam dashur ca më fort, zëmbra më rijte valë, valë
Po s' munt të nxirnja dot as zë, as që të flisnja nonjë fjalë,
Ky gas më bëri të harronj sa që kam shkuar të këqia
Veç pranë tij të ndodhem, veç të dëgjonj fjalët e tia.
O Zot shëndet e jet' e dit m' i fal Ganiut, të lutem shumë,
Dhe ç' do që erthtë përmi të mi mua qoft' e heqça unë.
(*hyn Ngjelinua në sqenë*)

Sqen' e VII
NGJELINA, MARRUA

NGJELINUA

Ç' u bëre, Marro, që më s' vjen, ç' të bënj më parë nuk mentohesh,
Se jam e vetëm që shërbenj, po hallavitesh e harohesh

MARRUA

Më ndje, o nënë, bëra faj, se gjer tani kisha Ganinë,
S' di si e kam zëmbrën kështu, s' kujtohem fare për shtëpinë.

NGJELINUA
(*me habitje*)

Kish nonjë punë Gani beu këtu të dy që të fjaloni,
A mase zutë prapë sot lodrat e para të kujtoni ?
Keq më vjen shumë për të dy q' ini të rinj e nuk mentohi,
As zi, as helmë s' vini re, ascip' u mbet, as turpërohi
(*me nga dale*)

Më fort çudi më vjen me të dy që je mënt shkurtër e lesh të gjattë,
S' menton as fare q' është Turk e ti Kaurkë, moj e ngratë.
Si t' a pret mëndja, që të dy, të rroni tok ? Pika të rentë !
Që s' kam as sy, as faqe sot, s' kam qetësi, më more mëntë.
Në mos heqç dorë pe këto do t' të mallëkonj do t' të ap katarën
Do t' të mohonj për gjithënjë, do t' ha farmaqnë me të parën.

MARRUA

O Nënë, mos u vra, u sos po pa mentohu pak më mirë
Se s' ësht' ashtu si thua ti, s' është as fare e vështirë.
Na kanë ritur kësisoj në fanatismë, në pa dije
Njërinë Turke, tjatrin Kaur, gjëra që s' kanë fare hije,
Besën a fenë cilido le t' a urdhëronjë si të dojë
Po kombësinë gjithëkush s' mundet as pakë t' a mohojë !
S' lipset vërejtur asnjë fe, përpara Kombit nuk ka hie
Eshtë vëlla ay që flet gjuhënë tënde që vogjëlie.
Leri më nj' anë këto mënt s' janë për shekullin që rojmë,
Na lindi gjithë një Atdhe, jemi vëllezër, s' e mohojmë !

NGJELINUA
(*me zëmbërim*)

Vëllezër jemi ne me tá !!! (*e munxos*[1]) Për ato paç o bija ime !
U prishe fare, lojte mënç ?? (*ikën e zëmbëruar dhe e le*)

MARRUA

Pse s' të pëlqejnë kto mentime ?

[1] Munxos = shenjë përbuzëse me pëllëmbën e dorës shtrirë dhe duke e lëvizur atë pranë veshit, zakonisht shoqëruar me shprehjen "Hê+ndonjë frazë tallëse apo mallkuese"

Sqen' e VIII

MARRUA
(*vetëm*)

Kanë të drejtë, si të thom, i kanë tepër magnitisur,
S' njohënë dot vëllan' e vet ! Pa shih ç' i kanë fanatisur !
Që sot e kaqë qindra vjet prindrit e vjetër, gjyshët tanë,
Dyke na kallur bes' e fe na ndanë fare, napërçanë
Së ardhuri me shpirt besën e fenë e uruar,
Kombin e gjor' e lanë pas q' është më fort i shënjtëruar
Pse ky mëkat vetëm për ne ? Pse vetëm ne në arrësirë ?
Pse u verbuam kaqe fort ? Për ne u shua ç' do mëshirë ?
(*dyke mbërthyer duartë e dyke*
rënë më gjunjazi)

Ah, Perëndi nxire në shesh, trego të drejtën gjat' e gjërë,
Ndaj erësirën, e përhap, vëllazërona ne të tërë !
Tfaqe të drejtën, mos e mba, ki edhe për neve pak mëshirë,
Falna njësi, vëllazëri, bashkim të plottë, ç' do të mirë.
Përndahe natën e urdhro të hapetë, të bëhet ditë,
Rezet e Diellit na lësho, Qiellin e çel të bjerë dritë !
(*mbaron së foluri dyke patur sytë në Qiell*)\

BIJE NAPA.

(*Pas ca ngrihet napa prapë për*
tablon' e katërtë e të fundit)

TABLO E KATËRTË

Theatrua tregon një kopsht në avlli të konakut Zylyftarit. M'anën të djathtë duken konakët e tij. Zylyftar Poda me të shoqen e me trimat e tij janë ndenjur rrotull kopshtit.

Sqen' e I

ZYLYFTAR PODA edhe TË PARËT

ZYLYFTARI
(*me buzën vrer*)

Na iknë duarsh dhe këta ! Na lanë keq pa ngushëlluar,
Nukë qe mjaft një po na dhe një që s'e kam kurrë për ta harruar

MERSINI

Ishte e thënë dhe kjo, njeriut ç' do gjë i është shkruar,
E ka për t' hequr nuk shpëton, e ka me vojtur e me shkuar.

AHMET ZABOVA

Tani t' i lemë gjith' këto, shkuan e vanë, prapë s'vinë,
Le të fjalojmë tjatër gjë, qysh t' hapim derën e shtëpinë.

ZYLYFTARI
(*me habitje*)

Qysh ? t' i hedhim prapa gjith këto ?

AHMET ZABOVA

Un' ashtu thom, ashtu ka hie,
Kur mi një helmë vjen një gas duket nga Qielli sikur bie.

ZYLYFTARI

Shum' i përgasçim dukesh sot, ke lejen, folë ç' do të duaç,

AHMET ZABOVA

Unë të thashë, ti e di, veç në mos daç, pa s' ke të thuaç

ALIKO PRODANI
(*Ahmet Zabovës*)

Folë dhe njerë[1] ç' ësht' ajo, neve gjësendi nuku dimë,
Pa na gëzo e na trego qysh mundet t' hamë e të pimë.

AHMET ZABOVA

Ja, qysh të thom..., me që Ganiu do Marron keq sa mënt marrohet,
S' lipset dhe ne, q' e duam kaq t' a lemë djalën të tërbohet.

ZYLYFTARI

Ç' fjalon, mor Mete, si t' a pret ? me një kopile të Krishterë ?
Oxhaku ynë kësisoj të bjerë poshtë, t' hedhë nderë ?

[1] njerë = edhe një herë

AHMET ZABOVA

Më ndje të, lutem, un' ashtu nuku fjalonj, s' jam i përdhunjur
Njerzit u bënë gjithë një, s' ka më të lart' e më të unjur.
As fe, as besë nuk ve re, kështu urdhron dhe Perëndia,
Për ne Shqiptarët bes' e fe është Atdheu e Shqipëria !

MERSINI

Dhe un' ashtu, o zotërinj, thom që s' ka hie midis t' onë,
Të ndrojmë udhë e zakon q' i kemi patur gjithë monë.

ELMAZI

Prindrërit t' anë ishin një, një lusje kishin e një besë
Pse neve sot t' i vemë re ? Kjo s' është r udhës as ka pjesë.

ALIKO PRODANI

Një mëndje kam me ju, o Shoq, po që ra fjala kombësie,
Besë, a fe, oxhak, bejllëk nuk na takon, as na ka hie.

MANUSHJA

Mase dhe unë s' di sa ju, s' felloj dhe aqë,se jam grua,
Po kombësin' e ngreh më lart nga fe e besë, Zylfo ç' thua ?

ZYLYFTARI
(*tek ri i mentuar, këcen një herjesh*)

Më munde ! Bravo ! s' ka dyshim ! helmi m' i prishi mënt' e mia,
Është vërtet si thoni ju, s' ka gjë m' e lartë se kombësia.
(*Të gjithë ngrihen e i zënë dorën Zylfos të gëzuar*)

AHMET ZABOVA

Të lumtë ! Do t' a vërtetosh fisin e gjakun që ke pasur,
Mua kështu më shëmbëllen sado në mykët që kam vatur
S' mdrohet, or jo, gjuha e vet, s' blihet me para kombësia,
S' është këmishë, thash' e them, na e ka falur Perëndia !!

ZYLYFTARI

Kemi një mëndje gjithë tok, këjo s' do më kuvënt e fjalë,
Po sa për Marron qysh të bënj që s' e ka sërën m' atë djalë ?

AHMET ZABOVA
(*i zëmbëruar*)

Prapë të parat ! Zylfo bej, këngën e Mukes paske zënë ?
Këta oxhakët kësisoj ç' na ndan' a mos na qoftë thënë !
Ore, me mua do fialonç ? Pa më trego ç' ishim më parë ?
Mos, më bëj, të bëhem derr !.... ne bujqër ishim a pëndarë !
(*Të gjithë qeshin me Odon*)

Unë të drejtën gjithënjë dua të thom pa makar qeshi,
Doni t' u them edhe një gjë ? S' më dërsin fare nga k' to veshi.
(*Të gjithë qeshin ha, ha, ha*)

MANUSHJA

E po qysh thua, Mete plak, një shërbëtore një e vobek,
Grua të jet' e Ganiu beut një kaq' e varfër kaq' e dobët ?

AHMET ZABOVA
(*i vrulet Manushes*)

E po në qënkërka kështu që begatia paska vlehë,

Ahere merrni ç' do vobeke flakëriteni në plehë.
(*Qeshin të gjithë; Ahmet Zabova po pason*)

Për mua s' ka asnjë dyshime e bij e Sulos a e Faces;
Unë kështu të thom, pa ti në mos e do merr i' a hith maces.
(*Çkulen së qeshuri të gjithë)*

Djali e do, vritet për të si i harbuar është bërë
E ju po thoni ka as ka, jo dorë hollë, jo s' ka sërë !
Ç' ju paska zënë nata lark, ç' më paski fjetur të zbuluar,
Prandaj po shohim prokopi, prandaj kemi përparuar !

ZYLYFTARI

Po si të duket ky bashkim ?

AHMET ZABOVA

Ka fjalë ? Ka se ku të vejë ?
Mua më vjen që si këtë herë të çanjë nuk do gjejë ?

ZYLYFTARI

Manushe ç' thua edhe ti ?

MANUSHJA

Si që të thuashë Zotrote,
Unë e puth, në ball' e ve, pranon ç' do gjë gruaja jote.

ZYLYFTARI

Ju shokë ç' thoni ?

MERSINI

Bukur fort, më pëlqen tepër kjo vlesë,

ELMAZI

Për Zon' e math ç' e gjette paq !

ALIKO PRODANI

Lejën u epni pa përtesë.

ZYLYFTARI
(*i enthusiasur*)

Ja dhe unë ku e ap, thrisnimë Marron e Ganinë,
T' u ap uratën, t' i bekonj dhe pregatitni shpejt shtëpinë.

AHMET ZABOVA
(*sulet e përqafon Zylyftarë*)

Të faltë Zoti ! Ja tani ma bëre qefin, më të lumtë,
Qofsh Zot i math, qofsh blett e plott' e Perëndia mos të humtë.
(*të gjithë sulen e i zënë për dore*
Zylfon edhe Manushen)

TË GJITHË TOK

U trashëgofshin ! Për hair !

AHMET ZABOVA

U bëfshin pleq u rënçin dhëmbët

ZYLYFTARI, MANUSHJA

Na rrofshi miq

AHMET ZABOVA
(*dyke qeshur*)

Dhe Metja tok, që u përpoq i ranë këmbët !

MERSINI
(*gërget Ahmet Zabovën*)

Arrifshimë dhe më gas t' ënt !

AHMET ZABOVA

Amin, të lumtë ajo gojë !

ALI PRODANI

Po ti u thinje derëzi !

AHMET ZABOVA

Pse ? mos pandeh se do mos dojë ?
(*qeshin të gjithë*)

ZYLYFTARI
(*Ahmet Zabovës*)

Të mart' e mira, që s' pushon, veç kur të vdeç do të rish urtë.

AHMET ZABOVA

Frikën m' a kini dhe atje, veç në m' u bëftë shpirt' i gurte !

ZYLYFTARI

Thrisni Ngjelinon që t'a shoh, t'a lajmeronj për këtë punë.

AHMET ZABOVA
(*veçan*)

Ç' kam frikë se mos kush e di... është e vê dhe e mar unë (!)
(*Mersini edhe të tjerët e dëgjojnë*
dhe çkulen së qeshuri)

Sqen' e II

NGJELINUA edhe TË PARËT

NGJELINUA
(*hyn dyke bërë falënderje*)

T' u ngjattë jeta !

TË GJITHË

Mirë se vjen

ZYLYFTARI

Të thirmë tok të të gëzojmë,
Të març dhe ti një gas si ne, Ganin' e Marron t' i martojmë.

NGJELINUA
(*e habitur*)

Po bën ashtu, o zoti im ? S' është mëkat për punë bese ?

ZYLYFTARI

Pse, ç' ka të bënjë, ne kështu i dhamë funt kësaj martese.

AHMET ZABOVA
(*Ngjelinos me zëmbrim*)

Pse ? mos ndryshon ndonjë pe ne, o mysliman o i krishterë,
Mos kemi brir' a kini ju ? Gjithë një mëmës' na ka lerë ?
Iq dorë' o plak' ashtu më rrofsh, jakë me neve në daç Zonë,
Jemi të gjithë një lloji, vëllezër qemë gjithë monë.

NGJELINUA
(*dyke dyshuar i flet Manushes*)

Zotrote ç' thua ?

MANUSHJA

Ç' do të thom ? Unë Ganiut i-a dhashë lejen

NGJELINUA
(*me gas e vendim të plottë*)

Kur qënk' ashtu, dhe unë tok ! Le të bashkohem të çkëmbehen.

TË GJITHË TOK

U trashëgofshin ! Për hair !

NGJELINUA

Më rrofshi, i- a paça hua.

AHMET ZABOVA
(*i enthusiasur*)

Dhe më të mijat tani shpejt !

MERSINI
(*shokëve*)

Mor ky do lidhur, u harbua !

ZYLYFTARI

Pa le të vinë dhe ata këtu përpara t' i bashkojmë,
T' u ap uratën t' i bekonj, pastaj te vemë e t' i-a shtrojmë.
(*Ahmet Zabova del jashtë.Pas ca hyn me*
Marron e me Ganinë të cilët
i ka zënë për krahu)

Sqen' e III

GANIU, MARRUA edhe TË PARËT

ZYLYFTARI
(*dyke qeshur*)

Qasi këtu, o bijt' e mi, t' u pyes nj' herë, mase s' doni,
Pastaj uratënë t' u ap, të rroni tok edhe të shkoni.
(*Ganiu me Marron afërohen*)

Duji të dy, nuk ka dyshim, po thojni prapë që t' a dimë.

AHMET ZABOVA

Të lutem, Zylfo, mos e ngjat, se do sheshohemi të rimë.
(*Ganiu me Marron unjen më gjunjëzaj,*
Zylyftari i bekon)

ZYLYFTARI

Uratën paçi që të dy, qofshi fatbardhë edhe rrofshi,
Qofshi të lumur gjithënjë, jetën me gas për her' e shkofshi.

MANUSHJA
(*gjith' ashtu*)

Zoti u dhëntë jet' e dit, u mplakçi, qofshi të begattë.

NGJELINUA

Rrofshi pa ndarë me gëzim, me duart plot e jetë gjatë !
(*Ganiu dhe Marrua u puthin*
dorën me radhë që të treve)

AHMET ZABOVA

Amin, o Zot ! po mos harro që e kam sërën edhe unë,
Si të mbarosh pa urdhro, bëj dhe për Meten nonjë punë.
(*Qeshin të gjithë ha, ha, ha*)

TË GJITHË TOK

U trashëgofshin !

ZYLYFTARI

Vemi shpejt t' i-a shtrojmë brenda pas zakoni,

Bëni gati ç' do që mungon, pini, dëfrehi e këndoni.
(*Të gjithë ca nga ca futen nër dhomat e Zylyftarit edhe sqena mbetet zbrazët.Nga ana e mëngjër del Bidua, i cili është fshehur dhe dëgjuar të gjitha ç' u folë).*

Sqen' e IV

BIDUA
(*vetëm*)

O bot' e shkretë !! Mjer' ata që mbyllë sytë edhe shkuan,
Pa për këta s' u bë asgjë, këta më tepër u harbuan !
Ty të vendosnë Latife, dhe ty Rakip,o trim, o burrë !
Të gjithë derdhë nga ca lott, po unë s' ngushëllonem kurrë !
Ç' e dua jetën, un' i ziu, kështu pa ju i dëshpëruar
Mbeta kërcu, mbeçë jetim, mbeta i mjer' i përvëluar !
Kush më shikon mua tani ? Kush do më mbyllë mua sytë ?
Ah, o Latife, o Rakip bej, si ju më s' pillet më i dytë !
Këta po lozin këtej, dasmë po bëjnë, po këndojnë,
Po un' i ziu, ah, si duronj, mua këta s' më numërojnë !
Gjaku më zien sido jam plak, dua me vrap t' i-a marr çpagën,
Pastaj të vdes në qetësi, se sa jam gjall s' e harronj plagën !
(*egërsohet*)

E ç' e pandehtë, derëzinj, se do t' u le të na shkelmoni ?
Mos kini keq se do t' u bënj gjëmën e madhe t' a kujtoni !
Mas' e harruatë sa kaq po s' kam harruar edhe unë,
Unë s' ndahem asnjë çap gjer sa t'u bënj një farë punë,
Do të lëshohem përmi ju po si i marrë, si i pirë,
E do t' u shuaj, t' u përlanj, si i harbuar, i rëpirë !
Po ty më fort, ore Gani, e ty o Marro, o e gjorë,

Të shihni njerë Bidon ju, t' a njihni mirë këtë dorë !
(*dyke u mejtuar pak*)

Jo, nuk jam fare fanatik, e mora vesh, e kupëtova,
Që kombi qënka përmbi fe nga sa që fol' e vëshgëllova.
S' jam fanatik, s' dua t' i vrasse prishnë besën edhe fenë,
Po se s' mejtuan helm e zi, Latfenë' e gjorë, Rakip benë.
(*Dëgjohen zëra nga konakët e Zylyftarit,*
tek janë shtruar dhe han' e pinë)

ZYLYFTARI
(*që brënda*)

Hani e pini gjithë tok sot që harrimë këtë ditë !

BIDUA

Gremisi gjithë mos u shoh !!

MANUSHJA

Zoti n' a pruftë mirësitë,

BIDUA

Zoti mënon po nuk harron, tani do shihni seç do ngjasë,
Syri i tij shëkon kudo, se kapërxyetë ç' do masë !

MERSINI

Ky gas për derë

ELMAZI
(*Ahmet Zabovës*)

Dhe më ty harrifshim, Mete, për së shpejti,

AHMET ZABOVA

Amin, u bëftë që tani, laraskë kurrë pa bisht s' mbeti.
(*qeshin me zë*)

BIDUA
(*me mëri*)

Qeshni e talli, o të zinj, njerës pa ndjenjë, pa mëshirë,
Qesh, more Mete, ulku plak që të roìtnë[1], mor i nxirë
(*egërsohet*)

Ah, po gjer kur do t' u duronj ? Ju s' latë gjë e tepruat,
(*qit pisqollën*)

Tani pa shihni o të zinj q' u lojtnë mënttë, u harbuat !
(*Sulet të hyjë brënda po sheh Marron që del më*
t' ëmën nga dhomat edhe i qëndron këmbët.
Rri fshehur e i shëkon. Është natë)

[1] roìtje = shkalloj, luaj nga mendja,ikje mëndjeje

Sqen e V

MARRUA, NGJELINUA, pastaj BIDUA

MARRUA
(*dyke zbritur*)

Vërtet gëzimi s' ka tregim, po s' di pse jam si e pa mundur,
Më vjen që s' jemi gjithë tok, jam e këputur e e humbur.

NGJELINUA

Ndofta, moj bijë, se nuk sheh edhe të mjerët që na shkuan,
S' kishimë fat t' i kishim tok, iknë na lan' e na shkretuan
(*Bidua po dëgjon*)

MARRUA

Ah, Latife, o Rakip bej, më vjen sikur s' u pamë kurrë,
Na copëtuat mish e shpirt dhe zëmbrën na e bëtë urë !!

NGJELINUA

Ah, le të rronte Rakip beu, pa që të dyja le mos ishim,
Përpar' atij dhe Latifes, ç' e donim rrojtjen, le të vdisnim !

BIDUA
(*me vet-he. Pak i qetësuar*)

Qënkan besnike, sot i shoh, paskan në zëmrë mëshirë,
S' qënkan gjakpirës si ata, tani e njoh, e gjykonj mirë.

MARRUA

Sikur të donte Gani beu të hiqte dorë që nga mua,
Edhe të mirte Latifenë, që ish e bukur si pallua.
Pa le të mbetesha pa sy, le t' u shërbenja dit' e natë
Unë le t' isha një kopil, po veç t' i shihnja të begatë !

BIDUA
(*zë mallëngjehet*)

S' e dinja fare kësisoj Marron me ndjenja kaq të rralla,
S' kisha të drejtë t' a ndjek aq sa për një fill në varr e kalla !

NGJELINUA

Pika s' më ra e s' më pikoj, po m' i ra Zotit e Latifesë,
S' na ra të dyjave rufe, këmbë pe ne të mos kish mbesë,
Pa do mos bëheshin këto që na kërusnë e na vranë,
Na lanë helm që s' ka shërim, plagë të madhe që s' ka anë !

BIDUA
(*mallëngjehet shumë*)

S' qënkam veç unë që m' arth keq, paskam edhe shokë s' qënkam vetë,
O Rakip be, o Latife, veç ne u deshmë me të drejtë !

MARRUA

Kujtonj akoma dhe një gjë dhe zëmëra më bëhet thrime,
Që s' pata fat atën të kem që më la foshnjë e jetime.
U riç e vobekt, pa baba, s' njoha përveç se hidhërime,

Kujt t' i mvar kokën, kujt t' i thom sa më ndjen zëmbra pikëllime !

BIDUA
(*me zëmbër keq të mallëngjyer*)

Ah, vajz' e gjorë, ç' më vjen keq, tani kujtonj se ç' âtë kishte,
Një burrë trim, e kisha shok, i ziu sa zëmbrë bardhë ishte !

NGJELINUA

Pusho, moj bijë, ja ku ke Zylyftar benë, mos qaj kotë.

MARRUA

E kam vërtêt, po sot baba s' ngjalletë mê në këtë botë!

BIDUA
(*mê s' mbahet nga mallëngjimi*)

Kjo s' ka baba, po e kërkon, sikundër unë bijën t' ime,
Q' e humba foshnj' e fluturoj, e m' a ka bërë zëmbrën thrime !

MARRUA

Ah, o baba, ah ku të kam, që të gëzonesh pranë mua !

BIDUA
(*del në shesh e i sulet Marros*)

Ja dhe babanë ku e ke ! Unë si bijë do t' të dua !
(*E përqafon. Marrua me Ngjelinën shastisen*)

MARRUA

Ti Bido je ? A ëndër shoh ? bijë më quan as më thuaj.

BIDUA

Bijë të kam edhe s' të ndanj, po si babënë t' ënt më duaj.

NGJELINUA

Pa mos pandehur dhe ky gas ! O Perëndi të qofsha falë,
Si bën ç' do gjë me dituri ! Zëmbra më dridhet palë, palë !

BIDUA

Vemi atje, të gjithë tok, dua dhe unë të gëzohem,
Nje vdekje kemi sot a mot, do të zbavitem, do t' harrohem !
(*Zënë të hyjnë që të tre në konakët e Zylfo Podës,*
po të brendëshmit dalin jashtë dhe kështu u
presin udhën në kopsht)

Sqen' e VI

BIDUA, NGJELINUA, MARRUA
(edhe të brendëshmit gjithë)

ZYLYFTARI

Bidua na qënkërka këtu !

TË GJITHË

Urdhro, Bido, këtu jemi

AHMET ZABOVA
(*më vet-he*)

Mor, si çudi, qysh me këto, si u bashkua, si të themi !

BIDUA

O zotrinj, u qofsha fal, mos u habitni, po qëndroni,
T' u thom se qysh po jam këtu, urdhëroni pak e më dëgjoni.
Isha i humbur e pa shpres, po një fuqi këtu më pruri,
Një frymë shpirtitë m' i dha, një forcë zëmbrësë m' i vuri.
Sot gjeta vajzën që më la e që e humba nga kjo jetë,
Te Marrua zbriti shpirt' i saj, bijë e kam me të vërtetë !
Kish humbur âtën dhe këjo e e kërkonte dit' e natë
Në vënt të tij u ngjalla û, kështu nga Zoti ish urdhratë !
(*Ganiut dhe Marros*)

Jakni t' u puth e t' u uronj, jakni te Bidua mos vonohi,
(*Ganiu me Marron i afrohen.*
Bidua i puth që të dy në ballë,
ata i puthin në dorë)

Rroni të lumtur gjithënjë, rroni fatbardhë, trashëgohi !

TË GJITHË

Njer' e me jetë !

ZYLYFTARI
(*ngreh duartë përpjetë*)

Ti, o Zot, bekoji, epu mirësitë,
(*Shokëve gjithë*)
Shokë, më rrofshi se ju sot jetënë t' im' e përsëritë !

BIDUA

Sot jam i lumur se po msonj një gjë të vjejtur që s' e dinja,
Që s' ka m' i vyer se atdheu ndonse gjë tjatër mi fe s' vinja.
Jam shumë i lumur e harronj sa që më ngjanë të këqia,
Bes' edhe fe për mua sot është Atdheu e Kombësia !!

TË GJITHË TOK

Na rrofsh, o Bido !

BIDUA

Me ju tok, rroftë Atdheu e Kombësia,
Jemi vëllezër, s'na ndan gjë, rroftë për jetë Shqipëria !!
(*Të gjithë enthusiasen edhe këndojnë*)

Jemi vëllezër, ndryshime s' kemi,
Fetë s' na ndajnë as sot as mot,
Pe një shtëpijë, një vatre jemi,
Kush na sjell çarje lodhetë kot.
Rroftë Atdheu e Kombësia
Qoftë për jetë Shqipëria !

*
* *

Atdhen' e dashur nga prindrit t' anë
E trashëguam me gjak me lot
Ata si burra, pa dhunë ranë,
Për tê dhe neve të vdesim sot.
Rroftë Atdheu e Kombësia
Qoftë për jetë Shqipëria !

BIJE NAPA
F U N T

KRISTO FLOQI

PIRRO NEOPTOLEMI

TRAGJEDI NË 5 AKTE

Mbas EUROPIDIT E RACINËS

VLORË
SHTYPSHKRONJA "VLORA" – G. DIRETTORE
1923

Të dashur këndonjës,

Me këtë tragjedi që po ju paraqit kam dashur të heth pak dritë mbi ca ndollina të hershme proistorike për me rritë edhé më shumë kurreshtimin e popullit t'onë e për me i dhanë një shkak më tepër dramatollogëve t'onë për paravajtjen e mbrothësin' e sqenës s' onë theatrore. Po edhé një tjetër arsye më ka shtyrë për këtë vepër edhé kjo është dëshira që kam pasur për me kundjellë patriotët e mij në stërvitje më të gjatë e më të plottë që, përmes poesive epike të Homerit e të Hesiodhit, të tragjedijanëve klasikë Grekë Aesqyllit, Sofokliut edhé Europidit e të histori-shkronjësve Heradotit e Thuqididit të munt të gjejnë historin' e vërtetë të kombit të tyre.

Tyke qenë e pranuar përgjithësisht se Epiri ka qenë qysh në kohët e lashta një pjesë e madhe e Pelasgjisë, si kur se Thraka, Thessalia, Maqedonia, Illyria, etj. e se kjo Pelasgji ishte shumë më parë se filloj historija hellenike, po edhé Pelasgët e ahershëm s' janë zhdukur krejt mbassi rrojnë sot nipshtërnipat e tyre né Shqiptarët, një tragjedi pra, që bën fjalë për mbretin më të parë të Epirit **Pirro Neoptolemin**, nuk ësht' e huaj për dramatollogjinë Shqipëtare mbassi ajy Epiri i vjetër (Haonìa, Thesprotia, Mollosia etj. etj.) është gjith' ajo Shqipëri e sotme edhé Epirotasit e ahershëm si në gjak e në zakon si në tiparet e në sjelljet nuk ndryshojnë shumë me Shqiptarët e sotmë, si kur se Grekët e Homerit e të Thukididit me ata të kësaj kohe.

Lënda e dramës sa do që është marrë prej tragjedisë **Andromaque** të tragjedianit frënk **Jean Racine**, po zhdrivillimi i saj në këtë tekstin t' onë ndryshon shumë prej asaj së Racinës. Racina ka marrë para sŷsh Euripidin po më fort është bazuar te **Aeniada**[1]e Virgjilit, po edhé vet' ajy mjaft e ka ndryshuar themën, si kundër e pohon edhé në parathënien e tij të Andromakës. Unë kam marrë për thezë më fort Homerin, i cili heth mjaft dritë mbi të ngjarat e hershme të kombit t' onë, po edhé Euripidin (Troâdhes) si edhé stërhollimet që rrjedhin prej krahësimit të këtyre për dobì të historisë s' onë kombëtare.

[1] Eneida

Hypothez' e Racinës bazohet mbi këto strofe të vjershtorit latin **Virgilius** (Aenias libër III strofa 292 gjer 332):

Littoraque Epeiri legimus portuque subimus
Chaonio et celsam Buthrotiascendimus urbem,
Solemnes tum forte dapes et tristia dona
Libabat cineri Andromache, Manesque vocabat
Hectoreum ad tumulum viridt quem cepiste inanem,
Et geminas, causam lacrymis sacraverat aras.....
Dejecit vultum, et demisa voce locuta est :
"O felix una ante alias Priameïa virgo,
"Hostilem ad tumullum, Trojae sub moenibus altis
"Jussamori ! quae sortitus non pertulit ullos,
"Nec victoris heri teligit captiva cubile.
"Nos patria incensa, diversa per aequora vectae,
"Stirpis Achileae fastus, juvenemquae suberbum,
"Servilio enixae, tulimus, qui deinde secutus
"Ledaeam Hermionem, Lacedaemonios que hymenaeos".
Ast illum, ereptae magno inflamatus amore
Conjugis, et celerum Furiis agitatus, Orestes
Excipit incautum, patrias que obtruncat ad aras.

Në këto strofa përmblidhet gjithë lënda e "Andromakës" të Racinës. Këto për lehtësi të këndonjësvet po i përkthej në shqip :

"Po lundrojmë rreth brigjeve të Epirit,
Po hyjmë në një liman të Haonisë
E po ngjitemi në qytetin e naltë të Buthrintit.
Në këtë ditë cok, Andromaka do binte
Disa kujtime e kushtime të hidhëshme
Hîrin e Hektorit për kujtimin e përjetëshmë

*Po i pëzante **Manesi**[1] mbi varrin e Hektorit*
Të zbrazur e të mbuluar me bimë të rimta[2]
Të cilat këjo i kishte ormisur[3] e kushtuar
Bashkë me dy alltarë ku lëshonte lotët
Unji kryet edhé pëshpëriti me një zê të vrazhdë :
"O ti e lumja virgjineshë midis vajzave tjera, e bij' e Priamit[4]
Që u dënove për vdekje për mbi varr të një armiku
Nënë kështjellat e nalta të asaj Troje !
Ajo nuk mundi të duronjë fatin që po e priste
Edhé sa do që ishte robneshë nuk e përketi
Shtratin e një gadhnuësi, që ishte dhespoti i saj !
Për kundrazi unë mbasi u shkrumbua Atdheu im
Tyke u larguar së gjati deteve të mbëdhenj
Pata edhé fëmijë si robneshë që isha zënë
E ka duruar mënin' e të birit Ahilefsit[5],
Të këtij trimi të rî e krye naltë
I cili ishte fejuar me Hermionën
Prej racës së Ledës nga Laqedhemona
Por se Oresti, i harbuar nga një dashuri e madhe

---

[1]Menés ishte themeltari i fes së Manikejvet, i lindur në Persì. Fjala këtu përdorohet për me shpjegue të mirën e të keqen, ashtu si e pat thënë edhé Zoroastri që besonte mbi dy principe, në Perëndinë e cila është *mendja*,ose *drita*, edhé në Djallin, i cili është *lënda* edhé *herrësira*.Prej kësaj derivon edhé fjala "Manikeïsmë" që do me thënë *doktrinë* e themeluar *mbi dy parime të përkundërta me njëra-jatrën, mbi të mirën e mbi të keqen.*(K. Floqi)

[2] rimta = Që ka ngjyrë qielli të mbyllur në të hirtë a në të gjelbërt

[3]ormis = përgatit dikë a diçka, bëj gati, rregulloj, zbukuroj e stolis

[4] e bija e Priamit ishte Polyksena, e cila u sakrifikua prej Pirros Neoptolemit për mbi varrin e t' et Ahilefsit (K. Floqi)

[5] Ahilefsi = me këtë emër grekët i thërrasin Akilit. I biri i Akilit (Ahilefsit) ishte Pirro Neoptolemi

Për të fejuarën e tij që ja patnë grabitur
E i ndjekur prej Furijavet ndihmës të keqbërësve
E hasi (Pirron) në një kohë që nuk e ruan askush
E e ther pranë alltarëve prindorë !

Ne, për titull të tragjedisë s' onë preferuam atë të Pirro Neoptolemit në vënt të "Andromakës" për arsye se deshim t' a paraqesim si një tragjedi në të cilën ka pjesë edhé historija e jonë, mbassi Pirro Neoptolemi, si thamë, ish mbreti i parë i Epirit e mbassi i ati i tij Ahilefsi ish mbreti i Thessalisë, një pjesës së madhe të Pelasgjidhës së vjetër. Që Ahilefsi nuk ishte grek merret vesh edhé prej Iliadhës së Homerit ku figuron si një ndihmës i huaj në expedicionin e famshëm të Troâdhës, edhé më fort prej një përshëndetje që i adreson Hŷjit Dodonas Pellasgjik të cilin e kujtonte si një Perëndi, protektor të Atdheut të tij[1]. Po edhé për një tjetër arësye preferuam titullin e naltpërmendur, sepse ndër gjithë bisedimet që Pirrua bën me Orestin ose Oresti me Pylladin kuptohet se Pirrua e heq vehten e tij prej një kombi tjetër krejt të huaj prej kombit grek e se këta dy të fundit e quajn gjithënjë Pirronsi një të huaj e barbar, si një armikun e Grekëve. Pylladi vetë i thotë Orestit se s'munt t' ja u marrë vesh gjuhën këtyre Epirotasve sa do që kish aqë muaj që ndodhej me ata, d.m. thënë se Epirotasit flasin tjetër gjuhë e jo greqishten.

Intelektualët t' onë sa do të meta që të gjejnë në këtë tragjedi lé të mos harrojnë se arësyenat për trajtimin e saj kanë qenë pikërisht dy : 1º Një

---

[1]**Zεϋ "Ανα Δωδωναΐε Πελασγικέ, τηφόϑι ναίων**
Δωδώνης μεδέωνδυσχειμέρρου, άμφίδέΣελλοί
Σοί νέουσιν ϋποφήται άνυπτόποδες χαμαιεϋναι.
(ΌΜΗΡΟΥ Ίλιάς XVI, 233)

Do me thënë:
"O Zot, Mbret, Dodonas Pelasgjik që banon nder ata vende
"Sunduës i Dodonës që ësht' e ftohtë si akulli, Ti që ké rotull
"Selinjtë (Sulotët) dragomanët t' ënt, të cilët për nderin tënd
që flenë për dhé zbathur e me këmbë pa larë"(K. Floqi)

dokument që Shqiptari ka jetuar edhé në kohën proistorike të prrallavet, 2º Një vepër më tepër për begatin e dramatollogjisë s' onë.

Në aktin e pêstë jemi larguar pak si prej tekstit të Euripidit ashtu edhé prej atij të Racinës. Për shëmbëll **Racina** n' a e paraqit Pirron të masakruar prej Orestit pranë alltarit prindorë, kur sé né përkundrazi tfaqim Orestin të zënë prej Pirros, mbassi s' u krye plani i tij për të assasinuar Pirron. Ndryshime të këtilla shihen shpesherë midis të tragjedianëve e të poetëve. Euripidi fjala vjen, në tragjedin' e tij "Ελένη" mendon se **Hellena** e shoqja e Menellaut nuk shkeli kurrë tokën e Troâdhës, ndonse Homeri gjithë Iliadhën e tij e ka trajtuar për shkak të Helenës, e cila sipas tij ka qenë në Troâdhë gjer sa mbaroj lufta, si shkaktare e vërtetë e gjithë asaj potere që shkrepi mbi Hellenët, psé e rrëmben **Paris** ose **Aleksandri**; po thotë se, mbas rrënimit të Troâdhës Menellau e gjeti të shoqen në Egjyptë ! Në këtë mendim ishte edhé **Herodhoti** (CXIII – CXV). Gjithashtu **Ahilefsi** , pas më të shumëve vjershëtorë ka qenë i plagosur në thembrën e këmbës, kurse Homeri thotë se u varrua në krahun (Iliadë XVI, 167). Tragjediani **Sofokliu** e tregon të vdekur Iokastën në atë çast që ajo ka njohur se burri i saj **Oedipus** ishte edhe bir' i saj (**Sofoklés**, Oedipus Tyrannos 1224 etj.) më një që Euripidi e paraqet të gjallë gjer sa të bijt' e saj Eteoklés e Poliniqis luftojnë me shoqi-shoqine vriten që të dy (**Euripidis** Foinissai 1456).

Tyke përfunduar them, se një tragjedi si këjo, si një tragjedi e historisë s'onë e prezantuar disa herë në Shkodër e në Tiranë e e mirë pritur prej popullit – si edhe dramat e mija të tjerat "Fé e Kombësi" e "Karllo Topija" – nuk do të kritikohet edhe aqe shumë.

Auktori

HYPOTHEZ' I TRAGJEDISË

Mbas rrënimit të Troadhës e vrasjes së Hektorit,e shoq' e tij Andromaka me të birin Astyanaxin ranë robër në dorë të Pirros Neoptolemit, të birit t'Ahilefsit, i cili bashkë me këta vjen në *Buthrinto* (qytet i vjetër afër Delvinës) kryeqytet të Epirit, si kundër e qojti ajy. Menellau, mbret' i Spartës për me forcue edhe më tepër miqësinë e alleancën me Pirron, vloj[1] me këtë të bijën e tij Hermionën, të cilën ja dërgoj në Epir për martesë. Po Pirrua kishte hedhur të madhe dashuri mbi Andromakën, sado që këjo nuk desh as t' a shëkonte me sŷ. M' anë tjetër Oresti, i kushëriri i Hermionës me shkak si kur të marrë Astyanaxin prej Pirros për me ja dorzue si pênk Grekëve, vjen në Butrint, kû gjen edhé mikun e tij Pylladin e bashkë me këtë mendohen si të grabitin Hermionën, të cilën Oresti e dashuron fort. Pirrua, i dëshpëruar se nuk e bint Andromakën t' a marrë grua e tremp se do t' ju dorëzonjë Grekëve të bir' e saj Astyanaxin, që këjo e do tej shpirtit. Andromaka, mbassi nuk e shpëton ndryshe të birin, tregohet si kur se i bindet Pirros, po me këtë e bën me sigurue djalin prej mënisë së Grekëve, kurse këjo qellon të vrasë vehten, posa që zyrtarisht t'i marrë besën Pirros që do t'a rrittë Astyanaxin e do t'a restorasnjë[2] mbi fronin e Troâdhës. Hermiona, e cila është rivale e fortë e Andromakës tyke parë se Pirrua kot u tall me këtë kaqe kohë, merret vesh fshehtazi me Orestin e vendosin të vrasin Pirron e Andromakën kur këta të kurorëzohen pranë alltarit e kështu të grabitin edhé Astyanaxin e t' i venë zjarrin qytetit (Butrintit) tyke ikur me anijet e tyre, të cilat prisnin në liman. Kur Pirrua gjendet përpara alltarit në tempull vjen Oresti me shokë e jep kushtrimin e vrasjes së Pirros, po nuk i lijet kohë t'a mbaronjë e kështu ky bashkë me konspiratorët e tjerë bijen robër në duart e Pirros. Hermiona në dëshpërim e sipër vret Andromakën e tyke parë vehten e saja në rrezik të math prej Pirros vret edhé vehten e saja. Pirrua i topitur krejt prej aksidentit të papritur e i pangushëlluar i çon përshëndetjet e fundit

[1] vloj = fejoj.

[2] restoras = rivendos ; storas = vendos, ul në fronin mbretëror.

Andromakës e cila tyke dhënë shpirt në duart e Pirros i lutet të kujdesohet si babë për Astyanaxin tyke mbajtur porosinë që i pat dhënë.

Pirro Neoptolemi

Dramatis personae

PIRRO NEOPTOLEMI - Mbret i Epirit

ANDROMAKA - Robneshë e Pirros

HERMIONA - E vlumja e Pirros

ORESTI - Kushëriri e i dashur i Hermionës

PYLLADI - Miku i Orestit

KLEONA - Kujdestarja e Hermionës

QEFISSA - Miqesha e Andromakës

FOENIX - Miku e këshilltari i Pirros

Ushtarë Epirotas e Grekë
Sqena në Buthrinto në pallas të Pirros
më 1260 para Krishtit

SHENIM. Të drejtat e auktorit janë të reservuara

AKT i I-rë
(Theatri çfaq një sallë në pallasin e Pirros)

SQEN' e I-rë
Oresti e Pylladi

Oresti

Kush t' a besonte, miku im i dashur, se do haseshim këtej më këtë qytet të neveritur për mua, kryeqytetin e Epirit, ku mbretëron Pirro Neoptolemi, i biri i atij Ahilefsit që shkak i kaqë dëmeve u bë për Helenët! Ti e di sa n'a kushtoj zënia e tij me babanë t' em Agamemnonin për shkak të një robneshe. Lufta e shkretë ngjati më shumë se dhjetë vjet për prishjen e shkatërrimin t'onë ! Po, qofshin të lavdëruar perënditë që të pashë edhé një herë në një kohë që kujtonja se të humba krejt.

Pylladi

Edhé unë i qofsha falë Athinasë e perëndive mbrojtës të kombit t'onë, me gjithë që Neptuni n' a shtyri anijet t' ona gjer këtu me tallazet e tij të harbuara. Isha fort i dëshpëruar se ngela këtu në Epir, i cili më duket si një arratì e trishtuar, se gjindem midis njerësve, të cilëve as gjuhën s' ju marr vesht, njerës që zembra ime i përbuz e s' i do as pak. Ah, gjendem lark nga vendet t' ona të bukura ! Të dish sa lotte të hidhura kam derdhur në këta shëmbinj të shkretë, sa të rahura zembre kam pasur lark jush, miqve e bashkatdhetarëve të mij ! Sa kam duruar e sa jam dëshpëruar, o miku im,sa rrezike e potera më shkonin ndër mënt për ju ! Po sot, lavdi Zotit po të shoh përpara meje e në pamjen t' ënde harronj gjithë mjerimet e mija e ngushëllohem se gjenj një shokun t' em me të cilin të

qanj të këqijate mija. Po këtë s' e marr dot vesh, ç' të shtyri ty nga këta mjegjet[1] epirote, a ndo një fat i mirë, apo ndo një rrezik për atdhenë t' onë ?

Oresti

Mjerisht ! Një dashuri e fortë e pa kufij, dashuri e përmallshme, dashuri shpirti, një flagë që s' munt t' a shuanj, ato më suall këtu edhé mos u çudit shumë në ardha këtu e gjenj lumërinë, ose vdekjen.

Pylladi

Si ? Për çështje dashurie paske ardhur këtu ? Qënka kaqë e madhe kjo dashuri ? Pa folë, pa shpjegohu. Ti këtu nuk ké tjetër të njohur përveç se Hermionën, të bijën e Menellaut, kushërirën tënde, të vetëmen grua ndër këta vënde, se Epirotaet, grâ të hashpërta e të trasha nuk vlejnë gjê përpara gocave të buta e të lëmushme të Spartës e të Mekinës. Folë pra, cila dashuri të ka shituar[2] kaqe fort sa të hodhi gjer këtu ?

Oresti

Pyllad, miku im nuk kam si fshihem përpara teje, të kam mik e munt të të zbras gjithë zembrën t' eme, edhé po të thom se ènkas për këtë dashuri ardha këtu, të cilën duhet t' a dish edhé ti e do më mëshirosh tyke mos më mohuar ndihmën t' ënde.

Pylladi

Ahere çile gojën, i dashuri Orest edhé zbrazi mikut t' ënt zembrën, e të betohem mbi Apollonin e Afërditën që nuk do t' t' a kursenj krahun t'em si do që të jetë.

---

[1] mjegje = kufi
[2] shituar = plagosur

Oresti

Tepër të falem nderit. Nuk dyshonja as pak prej një mikut si ty. Pra, si të të them, unë dua fort....(*me vehte*) O perëndi si t' ja thom....(*Pylladit*) Unë dua fort....

Pylladi

Cilën , cilën ? Pse s' e thua ?

Oresti
(*me kuxim*)

Ah, si të të them....dua Hermionën !

Pylladi
(*i habitur*)

Hermionën ? Kushërirën tënde ? Të vlumen e Pirros ? Orest, a jé ndër mënt ?

Oresti

Po, i dashuri Pyllad, atë dua Hermionën, edhé të betohem se një prej të dyjave, ja se do t' a rrëmbenj t' a bënj t' imen, ja se do lé edhe eshtrat e mija këtu !

Pylladi

O, Perëndinj, kurrë s' e prisnja këtë prej të birit të Agamemnonit, prîjsit të sundimtarëve të Greqisë ! (*Orestit*) Po, qysh kur e dashuron Hermionën që unë s' e ditkam ?

Oresti

Ah, jemi rritur me atë bashkë që në vogli edhé kemi njohur mjaft mirë njëri – tjetrin. Mjerisht lufta e gjatë e shkatëruese e Troâdhës n' a ndau e n'a

ftovi, e tash, kur unë me gëzim të math po kthehesha prej lufte gati për me bashkue jetën t' eme me të sajnë, im unq Menellau e paska vluar, me cilin të thuash, me Pirro – Neoptolemin, të birin e atij Alehfsit, një të huaji, një barbari, armikut më të math të shtëpisë s' onë !

Pylladi

Të drejtë ké vërtet ajy ish shkakëtari i mjerimeve t' ona, ajy, që e hiqte vehten si bir perëndeshe ! Po nuk më thua, ti â ja pate kërkuar Menellaut Hermionën ?

Oresti

Shpesherë, sa edhé në Troâdhë, në pushimet e luftës, tyke bujtur në shatorren e tija, ja kisha përmendur edhé ajy m' a kish dhënë fjalën e ushqenja shpresën se kur të kthehem prej luftës do të martohesha me Hermionën e bukur.

Pylladi

I gjori djalë ! E m' andej, psé të dolli fjalet Menellau ?

Oresti

Mbassi u vra pabesisht im' atë prej s' ime njerke Klytemnistrës e mbassi unë e vrava këtë për të marrë gjakun e t' im ati, ungji im Menellau nuk di psé mori aqé hidhërim kundra meje e më nami e më mallkoj, sa s'desh as të më shohë përpara e kështu as Hermionën s' m' a dha, po e fejoj me Pirron !

Pylladi

E tani ç' mendohesh të bësh ?

Oresti

Të thashë, se jashtë dëshirës së t' et unë vendosa t' a rrëmbenj e prandaj lypa edhé ndihmën t'ënde, edhé në e marsha nuk do kthehem më në Spartë, po

do jetonj në vënde të huaj harrin[1] të jem me Hermionën. Anijet e shokët që kam janë nënë urdhrin t' em, besnikë e gati të bëjnë ç' do therorì për mua. Kështu po të heqim edhé ty së këtejmi e po shpëton një her' e mirë prej ç' do rreziku.

Pylladi

Ah, Oresti im, më duket se ti s' e njeh mirë Pirro Neoptolemin ! Ti ndofta nuk di si ruhen këta bregjet e Epirit prej të cilëve s' kuxon as një mizë të dalë jashtë. Ké të drejtë se nuk e di si ruhet Pirrua e si e ruan Hermionën. Mbi këto do të them se më vjen shumë keq se ké ardhur tepër von, se nesër bëhet zyrtarisht martesa e Pirros me Hermionën !

Oresti

(*i trëmbur*)

Nesër ? Folë mirë !

Pylladi

Mjerisht nesër !

Oresti

(*me një vendim*)

Ahere është nevoja sonte të marrë funt këjo punë.

Pylladi

Shumë frikë kam se do mos bëjmë gjê !

Oresti

Pyllad, mos më dëshpëro. Kam shpresë se Apolloni e Vullkani janë kurdoherë me né !

[1]harrin = boll që, mjaft që.

Pylladi

Nuk më thé a ju paraqite Pirros ?

Oresti

Sot në mëngjes.

Pylladi

Si e vërtetove ardhjen t' ënde këtu ?

Oresti

Qinse jam i dërguar prej kryetarëve Grekë për Astyanaxin, i cili n'a përket nevej si rop lufte, që të jemi të sigurtë se nuk do përkëmbet mê froni i Priamit.

Pylladi

Edhé kujtove se e binde Pirron t' a besonjë ?

Oresti

Më priti mirë e s' më tha se jo.

Pylladi

Të këshillonj të ruhesh e të mos i zesh edhé shumë besë; dije se po morri vesh shkakun e vërtetë të ardhjes t' ënde jé i fikur edhé ti edhé shokët e tu.

Oresti

Kam marrë të gjitha masat. Po nuk më thua, ti a shihesh shpesherë me Hermionën ? A të ka thënë gjê për mua ? A të ka çfaqur gjê ?

Pylladi

E shoh për dita, po kurrë ndo një herë s' më bëri fjalë për ty.

Oresti

A e di ajo psé kam ardhur ? Ah, t' a dinte ! Unë s' e kam parë akoma, po sa herë e kujtonj ndjenj një drithmë që më depërton eshtrat e mija !

Pylladi

Munt edhé t' a ketë mësuar që ardhe, po mos kujto se është gjë e lehtë të hasesh me një grua në pallasin e Pirros.

Oresti

Pylladi, miku im, flitet atjé poshtë në Greqi se Pirrua është marrë mentsh me të vehnë e Hektorit, Andromakën, të cilën kërkon t' a marrë grua, sado që është i vluar me Hermionën. Në është e vërtetë këjo, ahere shpresonj se edhé Hemiona do jetë ftohur prej Pirros e ky është rasti mê i mirë për mua t'a rrëmbenj ca më parë e të ikim ca më shpejt, prandaj nuk marr vesh si ësht' e mundur të martohet nesër, si po thua me Hermionën, kur ajy do të martohet me Andromakën ? Këtë a mundesh të m' a shpjegosh ?

Pylladi

Janë të vërteta këto që thua, por se Andromaka, besnike gjithëmonë në dashurin e kujtimin e të shoqit Hektorit, jeton vetëm me kujtimin e tij edhé nuk do as kurrë të bëhet gruaja e Pirros. Prandaj edhé Pirrua i dëshpëruar krejt se nuk e bindi, vendosi të martohet me Hermionën edhé kurorëzimi, si të thashë, bëhet nesër në tempullin.

Oresti

Këjo do jetë vdekja ime, Pylladi !

Pylladi

Më vjen shumë keq, po mjerisht punët ashtu gjënden.

Oresti

Duhet një or' e më parë të piqem me Hermionën e t' i kallxonj qellimet e mija.

Pylladi

Do të të ndihmonj, po ja ku po të thom edhé një herë, mos e kij për punë të vogël të rrëmbyerit e Hermionës.

Oresti

Un' e kam menduar edhé të thashë se kuximi im është aqe sa, në mos e rrëmbefsha dot, dobarem të më shohë ajo të shtrirë e pa shpirt përpara këmbëve të saja që të besonjë se sa tepër e kam dashur.

Pylladi

Perëndit' e Olimpit të mbarofshin qellimet ! Si të të thom, më rren edhé mua pak uzdaja[1] se mundet më në funt diçka të bëhet.

Oresti

Më ngushëllon tepër ! Po si, pa më thuaj.

[1]uzdaja = shpresa

Pylladi

Pirrua e ka trembur shumë Andromakën, sa më së fundi, që t' a bindë, tha se do t' ja dorëzonjë Grekëve Astyanaxin dhe ata do t' a bëjnë si të duan, ose prej marazit munt edhé ky vetë t' a therë me duart e tija përpara s' ëmës, e kështu, në qoftë se nga frika bindet Andromaka e martohet me Pirron, ti e ké punën të lehtë ahere të marrësh Hermionën e të shkosh.

Oresti

(*me gëzim të math*)

Oh, sa më ngushëllojnë fjalët e tua (*E puth në ballë*) Të lutem ahere, më rëfé si të sillem në këtë rast.

Pylladi

Në qoftë ashtu si të tregova, kam shpresë së munt t' a bësh t'ënden Hermionën, po në qoftë se edhé Hermiona e do Pirron, si e kam dëgjuar, tyke parë një rivale të fortë në personin e Andromakës, ahere unë s' di si të sillemi. Po ti, Orest, a jé aqe i sigurt se të do për njëment Hermiona ?

Oresti

Kam përpara jetën t' onë të djalërisë që kemi shkuar bashkë me atë, që kurrë ndonjë herë s' hidhëruam njeri-tjetrin tyke u rritur në një mendim që një dit do rronim burr' e grua. Andaj kurrë s' e besonj se Hermiona munt të dojë një njeri të ashpër si Pirron, veç munt t' a pranojë për të mos prishur zembrën e t' et Menellaut, i cili si zembër-gurtë që është, në këtë rasë ka vepruar gabimin më të math !

Pylladi

Ah, Orest, Orest, mos u rrejt aqe shpejt. Ti s' e di se gruaja shumë herë shkon pas shkëlqimit, ose pas trimërisë së dokujt. Po me gjith' ato kij durim, se kush e di si kthehen punët.

Oresti

Ah, unë e shoh se jam një fatzi !....Po të lutem, a s' më ka zënë kurrë një herë në gojë Hermiona, sa kohë jé ti këtu ?

Pylladi

Po, më ngjan se dikur në dëshpërimin e saj kundra Pirros të ka kujtuar ty.

Oresti
(*me gëzim*)

Vërtet ? E mjera vajzë ! Ah, ta dinja, kurrë do mos ja kursenja këtë krahun t'em. Hî e pluhur do bëhesha për dashurin' e saja !

Pylladi

Më duket se po vjen këtej Pirrua. Të lutem shtrëngoje zembrën e mos e rëfé as pak hidhërimin t' ënt. Unë po shkonj të pregatit në muntsha Hermionën, tyke i treguar mendimet e tua se s' bën të n' a gjenjë këtu të dy mbreti. Ti kij mendjen (*del*).

SQEN' e II-të

Oresti, Pirrua e Foenix

Pirro

Gëzohem që ju shoh këtu në mbretërinë t' eme, e sado që prindët t' onë kanë pasë atë armiqësi të vjetër ndërmjet tyre, sikurse e dijni, né bijt' e tyre lipset të jemi miq përgjithmonë. Prandaj edhé urdhër kam dhënë t' ju bëhen gjith' ato nderime që i përkasin të birit të një mbreti të math të Greqisë.

Oresti

Qofsh me nder e me famë gjithënjë, o bir i Ahilefsit, mbret i math i Epirit. E shoh edhé unë vehten të lumur, se ndodhem përpara birit të atij fatosit të math që u ndâ në shenjë mbi gjithë prijësit e asaj lufte së madhe! Në qoftë se Hektori i math gjet vdekjen prej shigjetës s' atij Ahilefsit, po edhé Troâdha u gadhnua prej atij krahut t' uaj. Né Grekët, mirënjojtës kurdoherë përpara jyve, dëshërojmë të jemi me Epirotasit miq të përzembërt e të pandarë. Po, madhni, me qenë se nuk dijet se ç' munt të ngjasë më von e tyke pasur kurdoherë vesvesën[1] se mos ky zogu i Troâdhës Astyanaxi përkëmbet një dit e zé selin e t' et tyke çfryrë mënin' e tij kundra nesh, prijësit grekë, të luten me anën t' eme që këtë djalë të n' a e dorëzoni nevej t'a kemi si një penk të sigurt, që të mos vinjë edhé një herë ajo e zeza ditë që ky të frikësonte gjindjen e kombin t' onë, si kurse i ati ahere me zjarm në dorë doq anijet t' ona e faroj gjithë lulen e trimërisë greke !

Pirro

E shoh se Greqija qënka tepër e paqetë për të birin e Hektorit e kështu paska dërguar sot të birin e Agamemnonit me një dërgatë aqe të madhe e të vështirë. Unë, prisnja një bujari më të madhe prej aleatëve të mij e jo të më lypin një djalë të vogël, një mituri të pafajshëm, i cili mirë gjendet në dorë t' eme. Nuk është mjaft për Greqinë se ky djalë është nënë fuqinë t' eme e se ata duhet të jenë krejt të prejtur ? Për ç' arsye duan të m' a nxjerin duarsh ? Mos, duan t'a sakrifikojnë ? A thua se ka njeri të drejtë mbi jetën e këtij djali ? Mos harroni, se ahere, kur nënë gërmadhat e tymosura të Troâdhës kemi ndarë fitime të luftës me ju, mua më ra në pjesë ky djalë bashkë me t' ëmën e tija, të cilët i kam në dorë me të drejtën e plottë e një gadhnuësi. Pra, si Grekët duan të më çkëputin duarsh një sent që ata vetë m' a dhanë ? Kur ajo Troâdhë u shduk krejt edhé vetëm ca shémtyra e një lumë gjaku mbetnë, si grekët paskan frikë se mos

[1]Vesvesë = dyshim, ndërdyme

ngjallet prapë Troâdha ? Jo, Orest, jo. Grekët munden të lypin ç' tjetër të duan prej meje, po kurrë Astyanaxin. Është punë që s' bëhet.

Oresti

Qëllimi i asaj lufte, madhni, ka qenë rrënimi i plottë i asaj Troâdhe, e kur né shohim që rron akoma një pingjuell[1] i asaj race, kujtojmë se nuk paska vdekur édhe Hektori i tmeruar, sado që yt atë e la të kafshonjë tokën e e hoqi tré ditë xvarë rotull fortesave të Troâdhës ju lutem edhé një herë, për kaqe gjë mos ju prishni zembrën aleatëve t' uaj.

Pirro

Më vjen keq se po shoh se Grekët paskan harruar gjith' ato therorì që bëmë né për 'ta, sado që ishim të huaj. Né s' kursyem gjakun t' onë për nder' e shtëpisë s' uaj. Pa gjakun e t' im ati Grekët s' kishin fituar kurrë gjith' atë luftë; këtë mos e mohoni.

Oresti

Mos u zemroni, madhni, po e vërteta është që rritjen e Astyanaxit nuk e kqyrin me sŷ të mirë Grekët.

Pirro

Do me thënë edhé prej meje u drojtkan ? Ahere lé të bëjnë edhé ndryshe, unë jam gati të pres ç' do poterë nga an' e tyre, se e shoh që nuk ësht' e para herë që ata n' a bëjnë miq gjer sa të mbarojnë punë.

Oresti

Mos i shtyni punët aqe lark, madhni. Grekët po të kishin atë dyshim që po thoni, nuk do bënin atë krushqi me ju, tyke ju dhënë edhé të bijën e Menellaut për grua.

[1] pingjuell = pinjoll, trashëgimtar, pasardhës

Pirro

E shoh se ç' do që bëjnë e bëjnë për interesin e tyre. Nuk jam i verbër. Po a kujtoni se bij' e Menellaut do jetë aq e zonja sa të më përdorë si vegël për interesat tuaja ?

Oresti

Unë miqësin t' onë dua t' a bazonj në lidhnin' e vërtetë t' onë e të pa hile. Koha do t' a tregonjë. Tani, lé t' i lemë këto fjalë si t' anët që jemi, kemi kohë kur të flasim edhé me qenë se nesër do kem fatin e mirë të shoh kushërirën t'eme Hermionën nënë hymenenë e krahut t' uaj, me jep lejen të vetë t' a shoh e të fjalosem me 'të, se më ka zënë tepër malli.

Pirro

Jé i lirë t' a shohësh kur do herë të duash, urdhro.

Oresti
(*tyke qeshur*)

Falem nderit. T' u ngjatë jeta (*del*).

SQEN' e III-të
Pirro, Foenixi

Foenixi

Ku e lé Orestin të vejë ?

Pirro

Te kushërira e tij, psé ?

Foenixi

A e di se ajy ka pasur me ‘të dashuri qysh vogëlije ?

Pirro

E pra ?

Foenixi

Pra nuk kujton se ajy munt t’ a bindë e t’ a marrë për vehte atë që ti do të marrësh grua nesër ?

Pirro

Ah, Foenix, ti e di se unë s’ e kam me zemër Hermionën. Do gëzohesha si kur t’ a merrte e të m’ a shkarkonte qafet. Si kur të m’ a kërkonte do t’ ja jepnja me gjithe qefë e do t’ i përcillja të dy. Ti e di se unë s’ dua tjetër për grua veç se Andromakën, até mbretëreshën e grave,edhé në qoftë se kam thënë edhé se e di populli që do martohem nesër zyrtarisht me Hermionën, e kam bërë që t’ a njoh Andromakën a ësht’ apo jo rivale e Hermionës edhé në mos qoftë unë prapë do t’ a shtynj dasmën gjer sa ta bint. Hermionën s’ e dua as pak !

Foenixi

Habitem tepër, madhëni, prej këtyre fjalëve, edhé ju thom të drejtën që nuk i prisnja këto prej madhnisë s’ uaj, po...

Pirro

(*i pret fjalën*)

Tjetër herë flasim, Foenix, të lutem preje fjalën e largohu pak se po vjen Andromaka, e cila duket di ç’ ka do më thotë.

SQEN' e IV-të

Pirro,Andromaka

Pirro

Urdhno, mbretneshë.

Andromaka

(*me lott ndër sŷ*)

Mbret, kisha shkuar të shoh djalin t' em si nga hera, si pas fjalës që më ké dhënë që t' a shoh nga një herë ditën, po mjerisht nuk më lanë rojtarët t' uaj e kështu më duket se jam edhé mê fatzezë e e përvajshime se isha më parë ! Ah, o mbret, fort mir' e dijni se në këtë jetë s' më mbet tjetër veç se ajy djalë, Astyanaxi im. Kur nuk muntkam t' a shoh edhé këtë ahere pse më mbani kot në jetë, pse nuk më vrisni të shpëtonj ?

Pirro

Ah, Andromakë, ti nuk e di akoma sa të këqija të tjera e sa lottë të pikëllyera po të presin!

Andromaka

(*e trembur*)

Prej kujt em Zot ?

Pirro

(*tyke tundur kryet*)

Mjerisht prej Grekëve. Ata s' janë nginjur me shkatërimin e Troâdhës e me vrasjen e Hektorit. Duan edhé të birin !

Andromaka

Astyanaxin ? djalin t' em ? Oh, kûkû qyqja unë !....O mbret, zoti im, Perëndia ime, babë, vëlla, atdheu im, gjithë ç' ka, ah, mos u bint ti për një mynxyrë kaqe të dobët e të pashpirtë! në duart' ënde jam, kij mëshirë për djalin t' em.

Pirro

(*seriozisht*)

I biri i Agamemnonit, Oresti ka ardhur këtu i porositur prej Grekëve që t' ju dorëzonj atyre t' ët bir. E merr vesh tani, Andromakë, psé Grekët e kërkojnë e janë vënë kaqe fort për Astyanaxin.

Andromaka

(*Pa durim*)

E madhnija e jote ç' ju përgjiq Orestit ? A mundi zembra juaj të duronjë një mëkat kaqë të math e të padëgjuar ? Një kalamaq i vogël të bëhet kafshatë e gojës së ujkut ? Ah, mos madhëri ! Kujtoni Perënditë; mëshirë për djalin t'im, mos u përkûli aqe fort sa t' ja falni xhelatëve !

Pirro

Qetsohu, mbretneshë, se i biri i Ahilefsit nuk është aqë i poshtër sa të bënjë një marrëzi të këtillë. Përgjigja ime përpara Grekëve ka qenë negative. Si kur kush e di si të ngjasë, si kur luftë të më deklarojnë, Astyanaxi nuk del prej dorës s' eme; në dorë armiku kurrë s' e lé.

Andromaka

Tani po marr frymë. Ah, Hŷji qoftë me ty, o mbret i Epirit !

Pirro

Po Andromakë, për këtë zembrim që ju kallzonj Grekëve faqe kësaj therorije që po rëfenj për ty, ti psé s' do të më dëgjosh edhé mua atë lutje që ta kam zgjatur kaqe herë tyke lutur ? Ah, harronj se jam mbreti i Epirit e se ti jé një robe përpara meje ! Të kam rënë unë në këmbë si kur të ishe një mbretneshë edhe unë një rop !

Andromaka

Zot, mbaj rëndësinë t' ënde e mos e unj vehten t' ënde krenare përpara një gruaja të mjerë e ta hallakatur ! Kujto se ç' farë përshtypje të keqe do të bënte këjo ndër Epirotët, kur të shihnin se mbreti i tyre lé një virgjineshë, një bijë mbreti, tyke u martuar me një të vehë, një robneshë. Ti s' kishe ndofta me pâ kurrë një ditë të bardhë prej meje, se jeta ime do ishte gjithë vaj e lott për mua ! Munt, madhni, unë të harronj Hektorin t'em të rallë, i cili kaqe tepër më varfëroj e më shkretoj ? Unë do rronja me kujtimin e tij me uzdajën e djalit t'em, prandaj prej një gruaje të tillë, mbret, s' ké as një të mirë të preç, përveç se mjerime e vrerë ! Si një mbret i dëgjuar e fisnik që jé, tregohu shpirt-math e mëshironjës për të mjerët ! Në qoftë se më shtërngoni të pranonj një gjë që s'ma do zemra, në më shtërngofshi me përdhûnë të bëhem gruaja juaj mos harroni se nesër do thonë për ty që i bir' i Ahilefsit s'ishte një bujâr po një tyran, se dhunoj një grua !

Pirro

Ah, Andromakë, po unë s' kam qënë para teje aqë i ashpër e i egër sa ti té mua. Kij mëshirë për mua që të dua kaqe fort edhé mos m' a thyej dëshirën që kam për ty. Do të përkujdesohem si âtë i vërtetë për djalin t' ënt; do të t' a fal në gji t' ënt t' a kesh për gjithënjë, do t' a stërvit e t' a ushtronj vetë në armët e do t' a bënj të birin e merituar të atij fatosit të math Hektorit. Do të përpiqem të storaset edhé një herë mbretrija e Priamit e mbi selin' e Troâdhës do hipinj

mbret Astyanaxin, tyke ngjallur *Ilion*[1] e vjetër, po nem, ah, nem fjalën t' ënde që do bashkohesh me mua!

Andromaka

Ah, o mbret i Epirit, unë s' besonj të ngjallet dhe një herë Troâdha! Muret e fortesat e asaj të famshme nuk ngrihen edhé një herë përpjetë! Rreth atij qyteti të dëgjuar sot po rrethojnë sorrat e shkabat. Unë si humba ç'do gjë të vlefshme në këtë botë, sot rronj e mjerë e robneshë në arratì e s' kam tjetër përveç se hirin e shêjtë për kujtimin e Hektorit edhé djalin t' em Astyanaksin për ngushëllim. Më lerë madhnì, më lerë në mjerimin t' em e shko atjé ku të pret hymenêu[2] i ri e fati buzë qeshur !

Pirro

Andromakë i ké përsëritur kaqë here këto fjalë,nuk munt më të të shoh kështu; nuk duronj të jesh gjithënjë e përzishme e fatkeqe. Folë edhé ji e sigurt se me një shënjën t' ënde të gjitha ndryshojnë fytyrë në këtë pallas. Ti jé mbretnesha e Epirit dhe ajo që ti kujton se ka ardhur të bëhet ime shoqe, Hermiona, ka me qenë robnesha e shërbëtorja jote, po folë, veç folë!

Andromaka

Jo, kurrë ! Nuk dëshironj të bëhem shkaktare që të bëhet ajo e mjerë nga ana ime ! Sot unë jam një e vehë, prapë prej jush: ju më vratë burrin, ju më latë të mjerë ! Si kërkoni, mbret, të miqësohem me një armikun t' em, me vrasësin e burrit t' em ? Folë, nuk ish Ahilefsi vrasësi i Hektorit ? Munt të bashkohem ahere me të birin e vrasësit t' em ? Një besë që i dhashë një burri si munt t' ja jap edhé një tjetri?

[1] **Ἴλιον** (Ilion)= emër tjetër i Trojës

[2] imene = martesë, shtrat martesor (nga italishtja poetike)

Pirro
(*me hidhërim*)

Ashtu ? Mjaft mê ! Zonjë, mbassi s'mundem të të bint, po i shtrohem vullnetit t'ënt. Mbassi s' munt të më duash, ahere urréjmë dhe hodhbitmë. Shajmë e mshomë kur s' më do edhé unë po të harronj që sot e tutje. E pra, kqyr o e vehë e Hektorit, se një mbret i Epirit nuk përbuzet aqe lehtë; Qysh sot djalin t' ënt nuk do t'a shohësh mê me sŷ ! Grekët e kërkojnë edhé unë do t' ja dorëzonj edhé më qafë e paç ti !

Andromaka
(*si e lojtur mentsh*)

Si, e shkelni fjalën që më dhatë ? Fjalën mbretnore ?

Pirro

Në qoftë se ti nuk i bindesh dëshirës s' ime unji ahere kryet rrezikut ! Në të dhimbet Astyanaxi shpëtoje, në dorë e ké ! Folë pra fjalën e fundit se nuk kam kohë me bjerrë. Po, a po jo ?

Andromaka
(*i bije ndër këmbë*)

Mbret, për kryet t' ënt, mos u sill kështu përpara një gruaje të mjerë e të pafuqishme ! Zemra e jote duhet të kallzonjë një fisnikërì e një përdëllim për mua. Ti e di sa e dua atë djalë; më shtërngon të vepronj një të keqe që s'ma do zemra ?

Pirro

Ah, sa jé e rrejtur ! Ah, sa jé kokë-fortë ! Ti po e vret vetë me dorën t'ënde t' ët bir, kur se mundesh me një fjalë t' a shpëtosh, të shpëtosh edhé vetë (*Me inat*). Ç' thua, se s' kam kohë të të pres ? Ndaje për të fundit herë.

Andromaka

Ah, po si ësht' e mundur ? Unë.....

Pirro

Ahere, e paç më qafë, lamtumirë ! (*E shtyn*)

Andromaka
(*e dëshpëruar*)

Ah, ah !....Hektor !...kush e priste këtë ditë ! (*rëzohet përmbys tyke qarë*).

FUNT I AKTIT I-rë

AKT i II-të

(Një dhomë e veçantë në pallas të Pirros)

SQEN'e I-rë

Hermiona, Kleona

Hermiona

Kurrë s' e shkonja ndër ment se munt të vinte Oresti këtu. Zembra ime ndjen një ngushëllim të math në ardhjen e tija. Për fat të mirë ndodhet edhé Pylladi këtu, miku i Orestit e i shtëpisë s' onë. A e msove, Kleonë, pse ardhi Oresti ?

Kleona

Jo !

Hermiona

Ardhi të kërkonjë Astyanaxin për t' ja dorëzuar Grekëve.

Kleona
(*tyke qeshur*)

Thuaj mê mirë se ka ardhur për ty.

Hermiona

Për mua, e psé ?

Kleona

Se Oresti, zonjë,s' ka harruar edhé sot atë dashuri të madhe që ka pasur tjetër herë për ty. Pylladi, miku i tij, m' a besoj me përgjërime këtë sekretë e më tha të të pregatit sa të mundem që të shkojmë të gjithë në Greqi bashkë me Orestin me anijet e tija që po n' a presin.

Hermiona

Si thé, unë të shkonj në Greqi, unë e vluemja e Pirros edhé nesër gruaja e tija? Ç' thua Kleonë ? Çuditem si e paska kujtuar Oresti atë dashuri fëmijore që kishim dikur në vogli, si një dashuri të vërtetë sa të mundë të më ndanjë prej burrit t' em ! Më vjen shumë keq për Orestin në qoftë se ka ardhur këtu me një qëllim të këtillë !

Kleona

Qysh, princesë, harrove ti sa herë më ké bërë fjalë për Orestin? Harrove sa herë m' a ké zbrazur zembrën ?

Hermiona
(*tyke u mentuar*)

Ké të drejtë, po dije se ç' do që të thashë e bëra në zembrim e sipër prej zhaluzije, se s' munt të duronja një robneshë Trojâne, një të vehë të përbuzur, të bëhet gruaja e Pirros. Po tani që e shoh se Pirrua ndroj mendje edhé nuk e do,

tani po të siguronj se Pirrua do bëhet i jemi edhé si t'ju dorëzonjë Grekëve Astyanaxin, Andromaka nuk do rronjë as një orë pa 'të e kështu do të n'a çporret edhé kjo brengë e keqe. Po prapë po të thom edhé këtë se në qoftë se Pirrua fillon të parat me atë, unë do shkonj me Orestin në Greqi se s' munt të duronj mê atë poshtërsi.

Kleona

Tani po merremi vesh. Pra unë, si mikja jote, po të këshillonj se Pirrua ty nuk të do me të vërtet, se ajy nuk heq dorë prej Andromakës, andaj edhé merr masat e tua.

Hermiona

Kujton ti, o Kleonë, se Pirrua do më dalë fjalet ?

Kleona

Mjerisht ashtu më duket !

Hermiona

Në qoftë këjo e vërtetë do duket nesër, nesër është dita e martesës; pra në se ndryshoftë prapë e në zëntë të parat, po të jap fjalën se edhé unë do t'a neverit e do mos e dua edhé do ikinj t' a lé. Mjaft durova gjer më tani !

Kleona

Edhe unë po të thom, o princesë, se kur sheh kështu një njeri, që të tradhton sheshazi psé të mos bashkohesh me Orestin, i cili kaqe fort të do edhé i cili ènkas për ty ka marrë gjithë këtë rrugë të gjatë ?

Hermiona

Kleonë, mos më ngut edhé kaqe fort të bashkohem me një njeri, të cilin nuk m'a ka dashur zemra. Në qoftë se bindem që Pirrua nuk më do, ahere vërtet

do t'a braktis edhé unë, po si t' i shkaktonj dâme, për të cilat do pendohet tepër. Po që të bashkohem me Orestin këtë s' e mendonj as pak.

Kleona

Unë s' kuptonj ç' të mban akoma këtu, bija ime, edhé ç' dobi pret ti prej një të huaji, i cili s' ka as pikën e gjakut helenik ? Me një njeri që familja juaj ka një armiqësi të vjetër si kërkon ti të miqësohesh ? Unë kujtonj se yt 'atë bëri një gabim të math që të vloj me Pirron.

Hermiona

Psé, Kleonë, më lëndon zembrën ? Psé s' më jep një ngushëllim? Po në qoftë se Pirrua pendohet me të vërtetë për sa ka bërë e sa më ka përbuzur e vjen e kërkon ndjesë prej mejet unë si duhet të sillem ?

Kleona

Mos e beso kurrë.

Hermiona

Ahere si të bënj ?

Kleona

Të këshillonj t' i lesh kapriçjot më nj' anë. Ti e çprovove kaqe herë besën e tij. Ajy ç' do gjë që bën, e bën për Andromakën, edhé sikur të dojë ajo t'i hedhë një bisht sŷri ajy të lé ty si gunën e vjetër. Sa të preç t' a pësosh edhé një herë atë që ké pësuar gjer tani prej atij, është më mirë të bësh një kurajo të fortë e t' i japësh shkelmin sa të t' a japë ajy. T' a lesh vetë e të ngrihemi të ikim të gjithë në Greqi.

Hermiona

Po të jap fjalën që do të të dëgjonj si po më thua, po me kushtin në më daltë prapë i pabesë Pirrua.

Kleona

Prapë të parat ! Të thashë princesë harroji ato fjalë edhé kujto që këtu s'ké më nder ti. Kujto Orestin që të do aqë shumë. Kujto sa e lumur do jesh në vënt t'ënt (*Tyke parë tutje)*. Më duket se po vjen Oresti; të lutem hap sŷtë e mblidhe mendjen t' i përgjigjesh edhé ti në dashurinë që ajy ushqen për ty.

SQEN' e II-të

Të parat, Oresti

Oresti

(*Tyke përshëndetur*)

Oh, e dashura Hermionë, sa e ndjenj vehten i lumur që po të shoh edhé një herë pas kaqe vjet mërgimi ! Nuk t' a kallzonj dot mallin që më ka pushtuar për ty, o e dashura ime ! A e kujton pak Orestin t' ënt ?

Hermiona

Ti munt të pyeç zembrën t' ënde, Orest. Pylladi më tregoj gjer' e gjatë për ardhjen t' ënde, e cila më ka ngushëlluar tepër. Po lé të flasë më mirë këjo Kleona për mua.

Kleona

Princesa u rit[1] gazit, Orest, për këtë ardhjen t' ënde të papritur. Gjer tani fjalën t' ënde kishim edhé të siguronj se ti e përsërite edhé e ikura e saj me ty e lehtëson prej gjithë mjerimeve që ka hequr këtu.

Oresti

M' i tregoj të gjitha Pylladi edhé gëzohem tepër që kam ardhur me kohë këtu. Anijet t' ona, princesë, presin me velat hapur urdhrin t' uaj. Jam gati me gjithë shokët t' ju shërbejmë për ç' ka të doni.

[1]u rit = u përlot nga gëzimi

Hermiona

Ah, Orest, sa të mjerë po më gjen ti mua në këtë ditë ! Pirrua më të cilin pa vullnetin t' em më vloj im 'atë, nuk më sheh me sŷ të mirë. Ësht' i pabesë, se nuk më do mua po atë robneshën Trojâne Andromakën! Po ti, ti Orest, a do durosh t'a shohësh kushërirën t' ënde të përbuzur e të poshtëruar në këtë mënyrë?

Oresti

(*Tyke mbledhur grushtin*)

Për Perënditë jo ! Ky krahu im do të marrë shpërblimin shpejt, e dashura Hermionë. Bazohu te mua.

Hermiona

Orest, të përgjëroj mbi kujtimin e t' yt eti Agamemnonit, të cilit aqe mirë ja more shpagimin, ah,mos më lerë në këtë përbuzje e dëshpërim! Shpëtomë prej këtij tyrani, i cili përdor si kopile të bijën e Menellaut !

Oresti

Mos u zgjat më tepër e dashura ime, i mora vesh të gjitha. Tani që ardha kij durim se me ndihmën e Vullkanit e të Neptunit do mbarohen të këqijat e tua. Po, o Hermionë, nuk më thé, a ndjen akoma zembra e jote atë dashurin' e parë që ka ndjerë dikur për mua ? A e do Orestin si ajy të ka dashur ty ? Ah, besomë se kur u ktheva në Spartë e s' të gjeta, nuk e di si s'më lojtnë menttë ! Kur dëgjova që yt' atë të vloj me Pirron nuk e di si s'vrava vehten ! Rrufet' e Olymbit të grumbulloheshin mbi mua nuk do t' i ndjenja, sa lajmin e helmit të fejimit t'ënt me Pirron! I dëshpëruar edhé krejt si i marrë gjeta shkak dorëzimin e Astyanaxit që të munt të vinj të të shoh një herë e të të shkëput prej thojve të një barbari! Jam gati t' a bënj theror jetën t' ime për ty !

Hermiona

Të paça sa malet për therorit' e tua. Më sheh pak të ftohtë, po kjo s' do me thënë se harrova dashurin' e parë. Si vajzë nuk munt t' i kundrështonja vullnetit të babës t' em. Të kishe ardhur në Spartë përpara se të vlohem do ndryshonte puna.

Oresti

Ké të drejtë, Hermionë, faji është i jemi, këtë e shoh mirë.

Hermiona

Orest, më duket se kot po i zgjatim fjalët. Kemi kohë për ato. Tani lipset të mendohemi si të shpëtojmë ikjen t' onë së këtejmi.

Oresti

Atë ma lerë mua, Hermionë. I kam pregatitur të gjitha.

Kleona

(*Orestit*)

A e dijni, Orest, se Pirrua ka dekllaruar që nesër do martohet zyrtarisht në tempull me Hermionën ?

Oresti

M' a kallzoj edhé këtë Pylladi edhé e kam marrë parasŷsh.

Kleona

Mendohu mirë se do gjeni shumë kundrështime përpara se t'a mbaroni punën. E ahere?

Oresti

Ahere, ja se i shkel të gjitha ndalimet, ja se bije theror i një detyre të shenjtë. Por....unë kam frikë se mos princesa Hermionë gënjehet edhé një herë prej fjalëve të Pirros edhé atbotë i mjeri unë !

Hermiona

Ah, Orest, sa pak besim ké mbi mua ! Të lutem mos më folë mê për këtë çështje; mos më lëndo plagët që kam dashur t' i harronj. Në daç të pyeç unë lyp edhé një shpërblim tjetër prej Pirros për ato përbuzje që më bëri.

Oresti

Urdhro folë, jam gati për ç' do shpërblim për ty.

Hermiona

Përpara se të lemë këto vende dua t' i shkaktonj një të keqe të madhe, po edhé kur të shkojmë dua të marr edhé rivalen t' ime me vehte, Andromakën, se nuk duronj t' a shoh në duart e tija.

Oresti

Princesë, harrin të më duash si të dua e të kesh besim ndaj meje, të tjerat m'i lerë mua. Krahu im do të ta sjellë nderin në vent.

Hermiona

Shumë më premtohesh, Orest, po a do jesh i zoti të nxjerësh mb'anë të gjitha këto?

Oresti

Princesë, në qoftë se përnjëment ti s' e do Pirron, ç' qeder ké se ajy merr Andromakën për grua ? E në qoftë prapë se nuk do të ndahesh prej tij, psé më

merr edhé mua më qafë? Këjo është dashuria jote për mua? Këjo është besa? Nuk më thua më mirë të largohem së këtejmi ca më parë, ose më mirë të vras vehten?Ah, Hermionë, sa jé e paqendruar në fjalën t' ënde !

Kleona

Orest, të lutem, mos u zembro kaqe tepër. Mos i merr fjalët për ndryshe. Princesa ndofta flet ashtu prej marazit të math që ka kundra Pirros. Unë e njoh fort mirë dëshirën e saj; mos kujto kurrë se ajo nuk të do.

Oresti

Sjelljet e saj, Kleonë, e mënyra e fjalimit më venë në një dyshim të math, prandaj kam të drejtë të ankohem. Shkurt dua të di a më do me të vërtet princesa, a po vetëm sa të mbarronjë qëllimet e saja me anën t'eme.

Hermiona

Orest, në qoftë se edhé ti më do me të vërtet e në qoftë se me të vërtet për mua ké ardhur, priti me gjakftohtësi fjalët e mija, fjalët e një gruaje që sot nuk urdhëron vehten. Shpëtomë nga kjo gjëndje, pastaj më folë për dashuri.

Oresti

Nuk të janë mjaft, princesë, premtimet e një biri të Agamemnonit? Të mos ushqenja këtë dashuri të flaktë për ty a munt të merrnja përsipër një barrë kaqe të vështirë ? A munt të bënja fjalë për të rëmbyerit t' ënt ? Pra, po t'a përsërit edhé një herë, se në qoftë se jé penduar për Pirron, m' a thuaj sheshazi të rregullonj edhé unë punët e mija e të mos zgjatem më tepër.

Hermiona

(*e zemruar*)

Do me thënë ti s' më zënke besë si do që flas ! Ahere, pra, lé të përmbyset bota, lé të bëhet ç' është m' e keqja, lé të derdhet gjak më tepër se sa u derth për

t' im ëmë Helenën, lé të bëhet hî e pluhur gjithë Epiri edhé bashkë me 'të edhé unë ! A ka ku të shkonjë më tutje ?

Oresti

Mos u zemro ! Unë të fola n' atë mënyrë se shihnja një dyshim në fjalët e tua. Po prapë po të thom se fjalës s' ime i qëndronj si burrë, veç dua të më thuash e të më sigurosh mbi nderin t' ënt mbretnor, më do me të vërtetë, po a po jo ?

Kleona

Orest, mos dysho për këtë. Dorëzënëse të bëhem unë. Princesën mos e shty më tutje. Ti nise punën e çështjen tjetër m' a lerë mua. Shpëtimi jonë në duart e tua (*Hermionës*) Né, princesë, eja të shkojmë të mos n' a gjenjë Pirrua këtu se munt të vinjë kudo që të jetë.

Oresti
(*Hermionës*)

Princesë, jemi pra në një mëndje ?

Hermiona
(*Tyke dalë*)

Vepëro, në më do edhé mos më pyet fare (*Kleona dhe Hermiona dalin).*

SQEN' e III-të

Oresti

(*vetëm*)

Oresti

Un' e shoh se Hermiona e do me të vërtet mbretin e Epirit, e do të martohet me atë psé ka edhé rivale Andromakën. Po edhé mua më do si kujtonj unë, po vetëm sa të mbaronjë qëllimet e saja. Unë si duhet të sillem? Si duhet të bënj ? Në qoftë se ajo s' më do psé t' i hynj këtij rreziku ? Psé të marr më qafë edhé vehten time edhe Pylladin e gjorë edhé gjithë shokët e mij ? Të shkonj së këtejmi pa kryer as një punë ? Edhé këjo s' bëhet ! E në qoftë se nuk marr me vehte sidomos as Astyanaxin, si do t' ju dal përpara atyre që më dërguan? Po as këtë s' po m' a dorzon Pirrua. Të ikinj pa rëmbyer Hermionën që këtej? T' ja lé në duart këtij të huaji, këtij tyrani? Si kur t' i shpornja së këtejmi Andromakën e di sigur se Hermiona nuk do të desh të ndahesh prej Pirros. Si të bënj? Të bëhem një gjakpirës e të marr njerëz më qafë, tyke u bërë një vegël e dobët e kësaj (*mentohet*). Jo, jo duhet t' i japim funt kësaj çështje, koha, s' pret, lipset të zgjedhim njerën ose tjetrën ! Edhé në mos më dashtë Hermiona, unë s'lipset prapë t' a lé në duart e Pirros. Nuk duronj t' a shoh t' a ketë për grua. Si kur t' a gjenja të martuar edhé ahere do vrisnja njërin ose tjetrin, ose vehten t'ime ! Dua t' a lé se s' më do, po prapë nuk mundem me gjithë që s' më do. O, Perëndinj, un' e dua, ah, e dua me të vërtet të pabesën ! Ç' them unë, në e dua? Ah, po unë kam bjerrë gjithë të drejtat e fronit nga hatri i saj ! Humba gjithë pasurinë t' ime, u arratisa, u fika, e tani të ngrihem t' a lé? T' a lé në duart e tija? Jo, kurrë ! Do t' a marr edhé në mos dashtë, do t' a marr me pahir, do t' a shtije në anijen t' eme, edhé në më preftë udhën dikush, do t' a vras, do t' a shtyp, do t'a mbyt kush do qoftë ! Hermiona do që të mbarronjë qëllimet e saja me anën t'eme, po edhé unë lé të mbaronj punën t' eme!...Po qé, po vjen Pirrua, lé të pushojmë.

SQEN' e IV-të

Pirrua, Oresti

Pirro

Princ, po të kërkonja. Më ndjé se kur kemi folur të parën herë kam qënë pak i rëmbyer. Është karakteri im i ashpërt, nuk munt t' a mohonj, prandaj vinj të të lyp ndjesë në qoftë se fjalët e mija të shkaktuan ndo një hidhërim.

Oresti

Madhnija jote, lé të mos trazohet. Unë s' e mora për të keq atë bisedim, andaj edhé nuk ishte nevoja të më lypnit ndjesë. Né jemi si vëllezër në mes t'onë; vëllezërit nuk zëmbrohen kurrë.

Pirro

Ashtu vërtet; pra edhé unë po të thom se ndrova mendim. E shoh se kanë një të drejtë Grekët të kërkojnë prej meje Astyanaxin. Njoh mundimet e therorit e Grekëve në atë luftë shkatruëse të Trojës, edhé bindem t' ju dorëzonj Astyanaxin, po bashkë me këtë do t' ju dorëzonj edhé t' ëmën e tij Andromakën e ju do më garantohi për jetën e këtyre edhé se do rriten me nderimet e lehtësit' e duhura mbretnore në pallasin e Menellaut.

Oresti

Ju falem nderit madhni (*me vehte*) Si ndryshoj kaqe shpejt mendim ? Këjo është më e madhe çudi ! Mos fshihet ndo një sent tjetër prapa këtyre fjalëve? Lé të shohim.

Pirro

Sot, mbassi fati të pruri këtu o princ i Spartës, e mbassi nesër martohemi zyrtarisht me princeshën Hermionën, dëshironj shumë që ti vetë t'a shoqërosh

t' yt kushërirë, si më i afërmi i saj e të m' a bijësh për krahu në tempullin ku do kurorëzohemi !

Oresti
(*i turbulluar, më vehte*)

O Perëndij, Plluton e Tartarë! O rrufé të Olymbit, si do t' a duronj unë gjithë këtë të keqe, këtë të sharë, këtë koritje? (*Tyke fshehur hidhërimin, Pirros*). Edhé unë, madhni, e ndjej vehten të lumur se pata fatin të ndodhem këtu e të bëhem vëllam[1] i kushërirës s' ime së dashur.

Pirro

Ti kushëriri i saj do më ndodhesh për dëshmitar nga an' e gruas.

Oresti
(*më vehte*)

Të jem edhé dëshmitar ! O Perëndij, si nuk hapet dheu të më pijë më mirë! O Qiej, o vdekje pse s' më merr?

Pirro
(*pason sa do që e sheh të turbulluar*)

Unë, o princ, të kam ty edhé në vënt të vjehrit t' em Menellaut, se jé gjak e fis me atë. Kur të jesh ti pranë nuses edhé përpara alltarit të shënjtë, kur të qëndrosh ti dëshmuës i kësaj martese, unë do kujtonj se po kam gjithë Grekët përpara, me të cilët dua të rrojmë më një harmoni të plottë pas këtaj.

[1]vëllam = kuptimi i dytë : një i afërm i dhëndrit, që shoqëron nusen kur i vihej kurora; seicili nga të dy fëmijët që rrinin pranë dhëndrit e nuses kur këta vinin kurorë

Oresti

(*si i lojtur mentsh, më vehte)*

O Hŷ e Posidhon e Apollon e Hermes, për mua gjithë kjo ironi, për të birin e mbretit të mbretërvet ? Ah,si po e duronj !

Pirro

(*bëhet si kur s' merr vesh gjë*)

Hé, princi im, ç' po mentohesh ? (*Tyke i fërkuar supet)*. Shko, pra, kushëriri i gruas s' ime e siguroje princesën t'ët kushërirë,se unë e dua tepër, thuaji të niset mirë e të pregatitet ca më parë hymenenë[1], se nuk pres orën, sa t'a shoh të bëhet gruaja ime. Lajmo edhé gjithë Grekët që ké pru këtu me anijet e tua; dua të gjithë të ndodhen në ceremoninë e martesës s' onë.

Oresti

(*më vehte*)

A ka mê të madhe përbuzje ? A ka mê të dobët poshtërsi për mua? Po mos kij keq, o tyran, do të t' i shpaguaj të gjitha (*Tyke ju sjellë Pirros me nënëqeshje)* S' ka mê i math gëzim për mua se ky, madhnì, edhé po shkonj t'a pregatit kushërirën t' eme të dashur si të jetë mê mirë. Po shkonj (*me vehte*) Ah, mos e harrifasha kurrë atë ditë (*del*).

SQEN' e V-të

Pirrua, Foenix

Pirro

Tani posa përcolla Orestin.

[1]hymen = kuptimi i dytë i kësaj fjale është "martesë".

Foenix

Ku e dërgove ?

Pirro

Te princesha e kushërira që t' i kallzonjë se nesër vé kurorë me atë në tempull e se dëshëronj ky të m'a sjellë për krahu përpara alltarit si mê i afërmi i saj.

Foenix

Si t' u duk Oresti

Pirro

Mjaft i trubulluar. E pashë që s' i vinte mirë kur i thashë ato fjalë. Në sŷt'e tija njoha një melankolì të trishtuar. E kupëtonj se ky e do tepër kushërirën, po sot s' ka se ç' bën.

Foenix

A të tha gjë ?

Pirro

Drejt për së drejti jo, përveç se fjalë të ëmbla e të buta, po veçanërisht ajy dijti si i gëlltiti fjalët e mija, edhé ç' munt të bënte po të më kish në dorë!

Foenix

Për Astyanaxin a bëtë fjalë mê ?

Pirro

I thashë se munt t' ja dorëzonj Grekëve edhé Astyanaxin edhé t'ëmën e tij Andromakën.

Foenix

Po Oresti a u duk i kënaqur ?

Pirro

Po edhé jo, po mê mirë munt të them se këjo s' i bëri as një përshtypje si e pashë nga fytyra e kështu më dha të kuptonj se s' është qellimi i tij Astyanaxi, po Hermiona.

Foenix

Si kur të kënaqeshe me dorimin e Astyanaxit e Andromakës, ti a kishe me ja dhanë ?

Pirro

Zoti mos e dhashtë ! Kujton, Foenix, se jam aq' i pashpirtë ? Po a munt të lé unë Andromakën në duart e tyre, Andromakën që vdes për të ? Po ç' do që i thashë Orestit ja thashë vetëm sa t' i marr mendjen se qysh e ka e psé ka ardhur pikërisht.

Foenix

Mirë ké bërë.

Pirro

Ti e di se s' më ndahet shpirti prej asaj bujareshë grua, Andromakës së rallë. Talentet e virtutet e saj, sjelljet e fisnikëria më kanë marrë mentsh. E shoh, Foenix, që është një typ gruaje i mbaruar. Vërtet mbretëreshë është. Ah, si kur të më desh mua një të dhjetën nga sa ka dashur Hektorin, sa i lumur do isha! Në qoftë se e tremp nga ndo një herë për Astyanaxin se do t'ja dorëzonj Grekëve, ti e di se e bënj vetëm e vetëm që t' i kthenj mendjen, të bindet t'a marr për grua. Në qoftë se i thom se do martohem me Hermionën e bënj prapë që t' i shoh në është zhalloze, po mjerisht Andromaka, as për të birin s' tutet se e di se unë s'e bënj atë, as çështja e Hermionës s' e tunt nga vendi. Si të sillem?

Foenix

E në qoftë se Oresti ka ardhur për Hermionën, si do silleshe ?

Pirro

S' kam as një kundrështim t' ja dorëzonj e t' i përsjell gjer në skelë. Ti e di se unë nuk ndjenj ndo një dashuri për Hermionën, sado e bukur që është edhé sado që ësht' e bij e një mbreti.

Foenix

Për këtë të m' a falë madhnija jote t' i bënj verejtjen se ka gabim.

Pirro

Si gabim ?

Foenix

Një vajz' e ré, një bijë mbreti me të cilën zyrtarisht jé vluar e të cilën po e mban kaqe kohë në pallasin t' ënt t' a lesh pastaj të përbuzur e të çnderuar në rrugën e madhe dhe këjo është një pun' e dobët, një pun' e keqe ! Një mbreti, edhé mbreti si ty, një të birit të fatosit të math Ahilefsit këjo s' i vete aspak! Mendohu, madhni, ç' do thonë të huajt për ty, mendohu që munt të të shkaktosh gjakderdhje të mnershme e do t' a bësh këtë qytet si Troâdhën e dytë!

Pirro

E di edhé vetë se s' është pun' e mirë, po ç't'i bënj kësaj dashurie që s'më ka anë? Sa për gjakderdhjen që po më thua atë as e shkonj ndër ment as e peshonj. Lé të bëhet ç' të dojë, lé të dalë ujë,lé të përmbyset bota, harrin Andromakën të kem.

Foenix

Po si, madhni, kërkon të martohesh me Andromakën kur ajo s' të do ty, si po thua?

Pirro

Kam shpresë se do mê dojë mê von si të martohemi. Po dije mirë edhé këtë, Foenix, se edhé pa Andromakën s' mundem të rronj. Unë Hermionën nuk e kam dashur, as që i porosita Menellaut të m' a dërgonjë, po as këjo s' ka mundur të më tërheqnjë e të më bënjë t' a dua, sa kohë që ndodhet në pallasin t' em, që kështu t' a harronja dal-nga-dal Andromakën.

Foenix

I marr vesht të gjitha, po nga ana ime nuk të këshillonj kurrë të përbuzësh e të lesh të shkretë një princesë ! Bujarija jote ësht' ajo kur të marrësh Hermionën për grua e kur t' i japësh Andromakës djalin e saj, tyke ju dhënë dhoma të veçanta e tyke i nderuar më shërbëtorë e me shërbëtore brënda në pallasin t' ënt e tyke i lënë rehat në hallin e tyre po edhé tyke i ngushëlluar.

Pirro

(*si mentohet pak)*

Foenix, ké të drejtë. Gabimin t' em e njoh, po si të vepëronj kundra dëshirës s' eme ?

Foenix

Shko e i fal Andromakës të birin, m' andej kthehu e miqësohu me Hermionën e jepi fjalën e nderit që po vé kurorë me atë, e Orestin përcille si mik. Në tregoftë pakënaqësi, ose ndo një kundrështim per Hermionën, ahere rëfeji vendin. Unë po shkoj të ormis[1] mê mirë pregatitjet e dasmës, edhé ti, o mbret, pafsh Perënditë, mos ju shmang kësaj këshille (*del jashtë*).

[1]ormis = Përgatit dikë a diçka, bëj gati; rregulloj, vë në rregull; e zbukuroj, e stolis.

SQEN' e VI-të

Pirro

(*vetëm)*

Sa turp, për Perënditë tërë, një mbret si unë, një i biri i Ahilefsit të math të jem kaqe i pa qendruar në fjalët e mija ! Edhé vetë e njoh fajin, i kuptonj gabimet, po, ah, ç' t' i bënj kësaj flage, ç' ti bënj kësaj dashurije? Ah, Andromakë, Andromakë, mê mirë mos të të kisha njohur! E mallkuar qoftë ajo ditë që më hasi me ty, e u njohmë për të parën herë!Tri her' e mallkuar qoftë Helena, që u bê shkak i asaj lufte, ku u vra Hektori e mbet e vehë Andromaka!.... Por, ah, un' e dua, e dua, s' munt t' a fsheh ! O Perëndij, dëshmorë ju të ankthit t' em, të agonisë s' eme, me ndjeni për fajet e gabimet që po bënj njërin pas tjetrit. Edhé vetë s' e dua, po nuk jam i zoti i vehtes s' ime ! S' ka gjë se s' më pret kurrë me të mirë Andromaka, s' ka gjë se më rëfehet kaqe e ftohtë, unë prapë e dua. Sa i math është halli im, ju e shëkoni, o Perëndinj ! Ti, Hŷ Pellazgjik i Dodonës tregomë ç' udhë duhet të marr. A ka gjë më të vështirë, se sa t' a kesh robe, t' a kesh në dorë, të mundësh t' a kthesh e t' a vërtitësh nga të duash, t' a njohë e t' a dijë fort mirë rrezikun që po e pret e me gjith' ato të mos mundesh t' a bindësh, të mos epet, të mos përkulet?.... (*me një vendim të plottë)*. Jo,jo !.... këjo punë duhet të marrë funt, duhet të mbarohet ! Ndryshe s' bëhet ! Në qoftë se qellimi im shkon kot, në qoftë se s' marr Andromakën për grua ahere qjelli e dheu lé të bëhen bashkë, lé të dalë Posidhoni me trijênën[1] e tija e lé të tundë detet an' e kant të shkumbëzuara, lé të mbytet gjithë bota, lé të shuhet shkëndij' e Djellit, lé të shuhet Jeta ! (*Zé kryet me të dŷ duart)*. Ah, Andromakë, Andromakë !

FUNT I AKTIT II

[1]Poseidoni = një nga të 12 perënditë e Olimpit. Sipas mitologjisë Greke ishte perëndia e detit, fortunës, tërmeteve dhe kuajve.Në skulpturat e pikturat e bëra për të ai paraqitet me një heshtë në dorë në majë të të cilës ishin tre "dhëmbë" të mprehtë,pra trijêna (fjalë greqisht) është cfurku tridhëmbësh që mbante në dorë Poseidoni.

AKT i III-të

(Theatri çfaq një shesh afër pallasit të Pirros. Nga an' e djathtë një kopsht, nga e mëngjra duket pallasi)

SQEN' e I-rë

Pylladi, Oresti

Pylladi

Qetsohu e mos trego gjithë këtë hidhërim të math që ké. Sŷri yt, fytyra,lëvizjet t' a kallzojnë kjartazi turbullimin t' ënt, të tradhtojnë. S' je Oresti i parë, e ké humbur krejt, po ndro fytyrë se jé në rrezik.

Oresti

Pylladi, këshillat t' ënde s' kanë mê vleftë për mua,nuk i dëgjonj. Sot duhet t'a ndanj njërën dysh, ose do t' a rëmbenj Hermionën, ose do lé edhé jetën t' ime këtu. U mbush gota nuk nxé mê !

Pylladi

Ani, rëmbeje, nuk kundrështonj, po mos trego sheshazi gjaknxehtësinë t'ënde, se kjo munt të të hajë kokën para se të mbarosh punë.

Oresti

S'kam qedér si do më ngjasë. E kam vendosur të vdes më gjithë që Hermiona nuk e meriton këtë therorì !

Pylladi

Psé s' e meriton ?

Oresti

O Perëndinj ! Po pyet akoma Pylladi ? Për të këqijat që po heq lermë e mos më skëlfit[1] plagën që kam !

Pylladi

Psé s' më thua, prej meje druhesh ?

Oresti

Jo, s' druhem prej teje, po s' dua t' i përsërit edhé një herë.

Pylladi

Ç' ka ngjarë nuk më thua ?

Oresti

Prej fjalimit të fundit u binda se Hermiona nuk më do as pak, ajo do Pirron me gjithë që e ka poshtëruar kaqe herë. Mua do më përdorë veglë për të mbaruar ambicjet e saja. Këtë e pashë në sŷt e saja e e njoha mirë fort !

Pylladi

Do me thënë s' të do. Ahere edhé mê mirë për ty. Mos e duaj edhé ti edhé eja të ngrihemi të ikim e t' a lemë të bënjë si të dojë me atë.

[1]skëlfit = malcoj,pezmatoj, mahis.

Oresti

Mjerisht s’ e bënj dot !

Pylladi

Mos jé i marrë ?

Oresti

Jo, i dashur mik, nuk jam i marrë, po nuk mundem t’ a bënj.

Pylladi

Për sé, ç’ të ndalon ?

Oresti

Nuk duronj të shoh Hermionën nënë përgëdhelimet e një rivali t’em! Mendoje e peshoje mirë, Pylladi, si munt të qëndronj unë i ftohtë e apathik kur të vërë kurorë me Hermionën përpara sŷve të mija ? Duhet të kem humbur mëndjen, të kem humbur ndjenjat e mija e pastaj të qendronj dëshmitar i pandërgjegjtë në këto ngjarje ! A ka përbuzje mê të madhe për një që dashuron në të vërtetë ? Folë !

Pylladi

Të drejtë ké, por kur e sheh se ajo s’ të do, s’ t’ a njeh të mirën, ahere psé çan kryet kot, psé futesh në rezik për atë ?

Oresti

Ashtu është, po s’ më lé zembra të vepëronj si po thua.

Pylladi

Po kush të siguron ty se do të shkosh mirë me atë, në qoftë se e rëmben sot e e merr grua mê von ? Në vënt të gjesh një lumní do preç një fatkeqësi. Ajo që s' të do sot as nesër s' të do.

Oresti

E di po s' kam ç' bënj. Pirros s' munt t' ja lé në dorë.

Pylladi

Nuk mendohesh se bëhesh një grabitës i dytë nderi, si kur se Párisi që grabiti Helenën? Si do thotë Menellau kur të marrë vesh që i rëmbeve të bijën, që ajy vet e vloj me tjetër kënt ? A nuk peshon sa armiq do bësh me këtë punë? Pa lé pastaj po as e besoj t' a qitësh mb' anë me Pirron e do n'a marrësh edhé né më qafë.

Oresti

Të gjitha i kam para sŷsh, po nuk bënj dot ndryshe !

Pylladi

Ahere po të thom shkurt se qënke i marrë ! Përpara, pra, lé t' i japim funt kësaj çështje kur qënka kështu. Lé t' a rëmbejmë Hermionën, lé të futemi në rrezik kur dashke ti, lé të lemë edhé lëkurat t' ona këtu!

Oresti

Pylladi, miku im, e di se të kam mërzitur tepër, po e di se s' kam edhé tjetër mik veç teje në këtë shekull. Të lutem falja fajin një të mjeri si mua, që sheh se ka bjerrë tërë shpresën e tija !

Pylladi

M' a dëgjo një këshillë, Oresti, se s' të flas për të keq. Mbaje vehten mos trego ç'ké se do tradhëtohesh, harroje, përkohësisht Hermionën dhe mosmirënjohtjen e saja gjer sa të mbarojmë punë. Kqyr se filluan të çohen tallazet e detit kundra mureve të kështjellave të Buthrotës; anijet t' ona po lëkunden, duket se po n' a presin né të paduruara. Lé të mos humbasim kohë, lé të ikim ca mê parë prej këtij vendi të shkretë ! Un' i di të gjitha rrugat e monopatet e fshehta të këtij pallasi me rrethet e tij e kjo n' a ndihmon shumë për vështirësitë që munt të n' a takojnë. Kij durim edhé shpreso mbi mua. Po shkonj një herë, të pregatitemi.

Oresti

Po Hermionën ?

Pylladi

Leri tani ato marrina; bëhu burrë e dëgjomë mua (*del*).

Oresti

Do bënj durim, s' kam ç' bënj tjetër. Hŷji e bëftë mirë !

SQEN' e II-të

Hermiona, Oresti

Hermiona

Orest, ku ké qënë gjithë ditën që s' të kam parë ? Shumë u bëra merak.

Oresti

(*më vehte*)

Pa lé t' a shprovojmë edhé një herë se mos e kam gabim. (*Hermionës*). Fola mjaft me mbretin e Epirit, o princesë, edhé po e shoh se Pirrua nuk është

ashtu si thua ti. Pirrua të do me gjithë zembrën, po s' t' a ka thënë gjer sot se ka dashur të të shprovonjë në e do edhé ti më gjithë zëmër si të do ajy ; edhé në qoftë se ké parë dikur që ajy i ka kallzuar një farë dashurije Andromakës, këtë e ka bërë vetëm që të të njohë karakterin t' ënt, se në e do vërtet Pirron, ahere do t' a shohësh me sŷ zhalluzije Andromakën, po kurrë mos e mbeso se, mbreti i Epirit munt të marrë për grua një të vehë, një robneshë, një të mjerë, e cila më në funt nuk e do !

Hermiona

(*veçanërisht, me buzë në gas*)

Oh, sa gëzim i math ! Kush t' a kujtonte se Pirrua më dashka kaqë fort? Oh, sa e ndjenj vehten të lumur sot ! (*Orestit*). T' i tha me gojë Pirrua këto fjalë ty ?

Oresti

Jo vetëm m' i tha po edhé m' u lut të t' i them edhé ty edhé të të pregatit ca më parë si t' imen që të kam edhé të të heq për krahu gjer në tempull ku do vini kurorë zyrtarisht me atë.

Hermiona

Oh, sa më gëzon me këto fjalë. Po ti ç' ju përgjigje ? A i tregove një kënaqësi për kushërirën t'ënde ? Si i thé pa më thuaj.

Oresti

(*ndron fytyrë me një herë*)

Si deshe t' i them, si t' i përgjigjem ? Ah, mizore, e pabesë, ty që të fryn era nga të dojë ! Tani e marr vesht sa e do Pirron e se shpirti yt nuk shkëputet prej atij ! Tash e shoh sa qënkam i rrejtur pas teje, o gjarpnushe, o hyjenë! Qoft'e mallkuar ora që u nisa prej Greqije me anijat e mija për ty ! Qënke gjarpër helmatuës, qënke shpirt-keqe !.....

Hermiona

Orest....

Oresti

Largohu prej mejet bish' e tmeruar, shkaktare e mjerimeve të mija! Ty Menadhat e Errinjat t'a shpërblefshin atë që më bëre! Qofsh e mallkuar!(*Largohet me vrap*).

SQEN' e III-të

Hermiona

(*vetëm*)

U hidhërua tepër ! Ani, s' na prish punë. Funt i fundit unë nuk e dua. Për mua harrin të më dojë Pirrua, ajo është lumnija ime. Në qoftë se heq dorë prej asaj fatkeqes Andromakë, unë po ja ndjenj të gjitha sa më ka punuar. Dhashtë Hŷji e marrtë funt këjo martesa jonë e kështu shpëtojmë edhé nga Oresti, i cili më në funt lé të marrë edhé mikun e tij Pylladin, e lé të n'a kthejnë krahët së këtejmi. Po dikush po vjen, lé të pushojmë....A !.... qënka Kleona. (*Kleonës*). Eja, Kleonë, këtu jam.

SQEN' e IV-të

Hermiona, Kleona

Kleona

Këtu je ? Pse të shoh të zbetë ?

Hermiona

Ishte Oresti gjer tani këtu edhé bëmë ca fjalë.

Kleona

Po të bije një lajme të mirë. Pirrua urdhroj pregatitjet e dasmës se po martohet me ty. Msova se u dëshpërua krejt prej Andromakës e e braktisi fare. Gëzohu pra, se zû të nënëqeshë fati yt.

Hermiona

Çudi më vjen si u ndrua kaqë shpejt Pirrua !

Kleona

Ndofta ky ndryshim ardhi prej dëshpërimit që pat nga Andromaka. Po ti, si do që të jetë, gëzohu sot, se edhé për pak orë do të jesh e shoq' e Pirros e mbretëreshë e Epirit.

Hermiona

Po me Orestin si do pajtohemi ?

Kleona

Unë isha që të ngutja për Orestin, po tani e kuptova se ajy është një kacék me erë edhé jo gjë tjetër. Një rival i keq i Pirros që ka fjalë shumë e s'është i zoti të bënjë gjë. Përpara një Pirro-Neoptolemi, përpara të birit t'Ahilefsit a munt të preferonjë të birin e Agamemnonit, assasinin[1] e së njerkës edhé më në funt një kushëririn t' ënt?

Hermiona

Edhé unë ashtu them e të falem nderit që jé me mendjen t' ime.

Kleona
(*tyke parë për te*j)

Po shoh se po vjen këtejzaj Andromaka tyke qarë. Nuk e di ç' ka e si lipset t'i themi.

[1]assasin = vrasës.

Hermiona

Lermë të hiqem që këtej se s' munt t' a shoh atë fatkeqe. (*Merr edhé Kleonën për dore e fillojnë të dalin, por hasin ne dera Andromakën e Qefissën*).

SQEN' e V-të

Të parat, Andromaka

Andromaka
(*Hermionës*)

Ku po shkon me aqë ngutësi e lumtura princesë ?

Hermiona
(*me zëmrim*)

Shkonj atjé ku kam punë e po më presin. Ti ç' do prej meje ?

Andromaka

Në mes të këtij gëzimi që po të çfaqet përpara, o princesë, kij mëshirë për një të ngratë grua, e cila me flokët e çthurura e me sŷtë me lott e vjen të të lutet për një hîrë të vogël.

Hermiona

Folë shpejt se s' kam kohë.

Kleona
(*Andromakës*)

Mos n' a ndal prej rrugës për një hîrë aqë të vogël, si po thua.

Andromaka

O zonja, mos u tregoni kaqe krenare përpara një robneshe ! Nuk kini

qënë nëna edhé nuk dijni ç' do me thënë evlad[1] ! (*Hermionës*) Ah, o princesë, të përgjëronj mbi kurorën që po të pret, ndërmjetso të më japin djalin t' im Astyanaxin !

Hermiona

Ajo s' është puna ime.

Andromaka

Princesë, po të sbulonj një sent që s' e ke ditur gjer më sot.

Hermiona

Folë shpejt.

Andromaka

Jot' ëmë Helena, kur Troja ish qarkuar prej Grekëve, një dit u dënua për vdekje edhé do ishte vrarë prej Troasve si shkakëtare e gjithë atyre të zezave po të mos ndërmjetësonja unë e t' a shpëtonja. Ju luta burrit t' em Hektorit që të mos vritet Helena e jot' ëmë shpëtoj. Kur të haseni me 'të do mbesoni fjalët e mîja. Pra, o princesë, atë që kam bërë unë edhé Hektori për nënën t' ënde shpërbleje ti këtyre tyke ndërmjetësuar përpara Pirros për djalin e tyre. Ah, duan të më marrin djalin, djalin t' im të vetëm, duan t' ja u dorëzojnë Grekëve ! Po më grabitin jetën, shpresën, të vetëmin thesar që kam në botë ! Ç' fitim kanë Grekët prej një foshnje ? Ç' rrezik munt t'i gjejë?

Hermiona

Ç' do prej meje ahere ?

[1] evlad = bir, djalë, fëmija im etj.

Andromaka

Ti që për pak bëhesh e shoq' e Pirros dhe mbretëreshë e Epirit, të lutem binde Pirron të më japë djalin t' im. Dua t' a marr e të ikinj me gjith'të; dua t'a fsheh ku të mos duket.

Kleona

(*Andromakës*)

Ti e kishe vetë në dorë, kaqe kohë si s' munde t' a bindësh të të japë t'ët bir? Ti ké fuqi mbi vullnetin e mbretit, pse n' a thua nevej ?

Hermiona

Ti jé armikja ime, ti më ké shkaktuar gjith' atë përbuzje e mëri nga an'e Pirros. Po të mos ishe ti, martesa jonë do ish mbaruar me kohë. E tani që e prure punën kështu ç' pret prej meje ? Jo, s' të dëgjonj, ké qënë e jé armikja ime !

Andromaka

Për mëshirat e perëndive, zonja, mos tregohi kaqe të pamëshirta. S' ju kam faj un' e shkreta; jam një e mjerë e fatit, ah, mos më shkelmoni edhe ju! (*Ju bije më gjunjë*).

Hermiona

Mos u loth, ësht' e tepër të n' a lutesh.

Andromaka

Princesë, mendohu se munt të jesh edhé ti nënë një dit. Dhëntë Zoti mos arthç në këtë ditën t' ime. Ah, të lutem bëmë kaqë hîrë, o princesë! Mëshirë për mua fatkeqen !

Kleona

Kot mos u mundo !

Andromaka
(*e dëshpruar*)

O, ju njerës, a mermerë, hekur a granit, a ç' ka jini ! Dua djalin, djalin t'em, me ç' të drejtë m'a rëmbejnë ? Ç' kanë me djalin t' im ? Ah, e dua, e dua djalin ! (*i përfshin prej gjunjëve).*

Hermiona
(*me inat*)

Do rish urtë a po t' ju thres rojtarëve të të heqin së këtejmi me përdhunë? (*E shtyn).* Çporru, mos t' i shoh sŷtë. (*Shkojnë bashkë me Kleonën*).

Andromaka
(*rënë përmbys*)

Ah,....ah, ...e mjera unë ! (*I bije vilani*)

SQEN' e VI-të
Qefissa, Andromaka

Qefissa
(*tyke hyrë*)

Më vjen se dëgjova një zê, kush bërti kaqe fort ? (*Tyke kqyrur Andromakën përmbys)*. O, qenka zonja ime këtu ! (*E ngreh*). Ç' pate, o e dashura zonjë, ç' të ka gjetur ?

Andromaka
(*tyke ardhur ndër mënt)*

Ah, o Qefissë, të kam sidomos ty për ngushëllim !

Qefissa

Po ç' pate, moj bijë, që të ra të fikët ?

Andromaka

Ah, më mbyti vreri, o Qefissa ime, s' di se ku jam !

Qefissa

Ka qënë kush këtu ?

Andromaka

Princesa Hermiona me Kleonën.

Qefissa

Kini shkëmbyer fjalë ?

Andromaka

Ju luta si njerës, si tjetrës të ndërmjetësojnë të më japin djalin.

Qefissa

E ato ç' të thanë ?

Andromaka

Më neveritnë, më shanë, më shtynë e iknë e më lanë !

Qefissa

Ah, njerës të pa shpirtë ! Ah, ju arthtë edhé juve mbi krye këjo poterë e ahere të mbesoni!

Andromaka

Mos i mallko Qefissë ! Hŷji mos më lëntë edhé mua në të keqe !.... Ah, t'a dish, Qefissa ime, sa më dridhet zëmra për atë djalë se mos u dorëzohet Grekëve, pastaj lumi e deti për mua!....Ah, nëna mos qoftë, o Qefissë !....

Qefissa

Qetsohu moj bijë, se nuk mbesonj Pirrua i math të bënjë një poshtërsi aqë të madhe! Nuk ka t' atillë zëmër !

Andromaka

Frika më depërton eshtrat; djersë e ftohtë më përshkon shtatin !

Qefissa

Jo, jo, ngushëllohu; të siguronj se karakteri i Pirros edhé burrnija e tij nuk munt të bëjnë një çnderim kësodoret ! Po nuk të thashë, se u habita. Pirrua deshte të hasej me ty sot që të të thoshte disa fjalë. Ashtu mora vesh (*Tyke parë tutje*). Edhé më duket se këtej po vjen bashkë me Foenixin. Kam një shpresë të mirë për ty se po m' a ndjen edhé zëmra. Qetsohu edhé prite mirë, të lutem.

Andromaka

Ah, moj Qefissë, po ç' tjetër munt të më thotë mbreti përveç se fjalëve të para ? Të të thom, nuk duronj më ! M' u nxi jeta, më plasi shpirti, u shojt çdo shpresë për mua !

SQEN' e VII-të

Të parët, Pirrua, Foenixi

Pirrua

Ç' po bën këtu Andromakë ?

Andromaka

Po qanj hallin t' em se e shoh që më kanë lënë të gjithë !

Pirrua

Të thashë, Andromakë, ti fatin t' ënt e ké në dorë; do e sillesh kot. Me gjithë që alltari më pret për kurorë, me gjithë që jemi gati për martesë me Hermionën, prapë po të them se një fjalë e jote i ndryshon të gjitha këtu brenda edhé ti edhé yt bir shpëtoni prej rrezikut e rroni të lumur. Në mos daç; ahere po martohem me Hermionën edhé Astyanixin po ja u dorëzonj Grekëve.

Andromaka

O mbret i Epirit, o i bir' i të famshmit Ahiléut, mos u trego kaqe i pamëshirtë kundra një gruaje të pafuqishme e fatzeze !

Qefissa

Për mëshirën e Hŷjit pellasgjik, mos e shtyni, madhní, në dëshpërim këtë të mjerë ! Faljani djalin e kësaj, tjetër gjê s' ju kërkon.

Pirrua

(*Qefissës*)

Ti hesht e mos folë, nuk është nevoja të hysh ndërmjetëse.

Foenix

Madhní, në qoftë se më jep lêjen, do të të lutesha edhé vetë për këtë të mjerë. Lere në mjerimin e saj që ka. Lere të rronjë me kujtimin e burrit të saj, që aqe mizorisht dha jetën e tija përpara kështjellave të Trojës ! Madhnija jote sot është pregatitur për një tjetër fat. Atjé në tempull po ju pret hymënêu i shkëlqyer me të bukurën princesë Hermionën. Ajo të përket për grua e jo një e vehë e mjerë, që nuk ndjen gjë tjetër në këtë jetë përveç se helm e vrer ! Jepja djalin, të vetëmen uzdajë që ka këjo e shkretë, e do shohsh sa do jesh i prehur e sa kënaqësi do të të ndjenjë zëmra. Perënditë do të t' a shpërblejnë dyfijsh këtë mirësí! Ç' fitim ké në ja u dorëzofsh Grekëve ? Për ty është një mëkat i math e i pandjerë, se Grekët nuk do t' a lenë të gjallë djalin që posa t' ju bjerë në dorë. Zëmra jote, ndërgjigja do të helmojnë shpirtin në i bëfsh kësaj një të keqe të këtillë edhé kurrë do mos kesh qetësí ! Madhëní, edhé një herë po të këshillonj për të mirën t' ënde, jepi djalin kësaj të mjere edhé lere të qetë në hallin e saj.

Pirrua

Foenix, të thashë, po edhé sado që t' a dhashë fjalën prapë s' heq dorë nga të parat. M' u mbush mëndja, s' dëgjonj më këshilla. Sot është çashti i fundit që Andromaka duhet të mentohet mirë e të përfundonjë. Njërën prej të dyjave, ose do bëhet gruaja ime, do marrë djalin e do rronjë e lumur si mbretëreshë, ose do martohem me Hermionën edhé djalin do t' ja u jap Grekëve !

Andromaka
(*tyke i rënë ndër këmbët*)

Madhëní, të përgjëronj për shpirtin e atij famë madhit Ahilefsit !

Pirrua

Me përgjërata mos prit të më bindësh !

Andromaka

Të betohem se do jem shërbëtorja jote e do të të shërbejmë besnikërisht bashkë me djalin t' im sa të rrojmë !

Pirrua

Leri ato fjalë !

Andromaka

Më bën një të mirë që s' ta harronj kurrë !

Pirrua

Nuk dëgjonj as gjë !

Andromaka

Do t' i falem nat' e ditë Hŷjit për lumërinë t' ënde !

Pirrua

Në daç mos ju fal, s' më hŷn në punë.

Andromaka

Vramë mê mirë, po djalin mos t' a shoh në duar të Grekëve !

Pirrua

Po të të vras shpëton, po dua të mundohesh si mê mundon !

Andromaka

Sillu si bujar përpara një robneshe !

Pirrua

S’ dua të jem bujar përpara një pamirënjohtëse !

Andromaka

Rënkimet e një nëne s’ të bëjnë përshtypje ?

Pirrua
(*me zëmrim*)

Mjaft fole ! (*Foenixit*) Foenix, eja të shkojmë, s’ dua të rri mê këtu. Vendimi im ësht’ i dhënë, vemi t’ a vëmë në veprim.

Andromaka
(*si e çartallosur*)

Ç’ farë vendim ? Të lutem....ç’ farë ?

Pirrua

Vendimin që di; t’ ju dorëzonj Grekëve Astyanaxin !

Andromaka
(*e dëshpëruar*)

Do t’ a bësh këtë të keqe, a t’ a duron zëmra ?

Pirrua

Tani pa e sheh !

Andromaka
(*me agoní*)

Vërtet ? Ah, e mjera unë ! (*Bije përmbys*).

Foenix

Madhní ! ....

Pirrua

(*me inat*)

S' dua të dëgjonj fjalë, eja shkojmë. (*Pirrua me Foenixin dalin tyke lënë Andromakën e Qefissën).*

SQEN' e VIII-të

Qefissa, Andromaka

Qefissa

Ah, fat, i shkretë fat ! Ah, e mjera Andromakë, ku të qënkan rojtur gjithë këto të këqija! Ah, mos e hump shpresën, o bija ime, se ka Zoti i math edhé për ty !

Andromaka

Ah, perëndonj hýlli im, Qefissë !.... Po mê marrin djalin, ah, ah, po m'a marrin ! Ku të vete, ku të përpjek kokën ? S' më ish mjaft që humbi Troja, që humba prindët e mij e gjithë të dashurit edhé mê në funt edhé Hektorin t' em të paharruar, po të humbas edhé djalin ? Djalin t' em të vetmin ? Ah, si duronj e gjallë pa djalin t' em, Qefissë ! (*I bije grushta kokës).* Ah, si nuk mê rëmbeu edhé mua kosa e vdekjes bashkë me njerëzit e mij po mê la të vuanj kështu ?

Qefissa

Në këtë dëshpërim të math që ké mbaje vehten, o bija ime. Shko e këshillohu me hîjen e Hektorit, me shpuzën e hirit të tij ! Shko e këshillohu një herë, nuk besonj të të qertonjë !

Andromaka

S' të marr vesh se ç' thua.

Qefissa

Në mes të rrezikut që të ka rethuar shpëto djalin, tyke marrë për burrë Pirron. Nuk është mëkat përpara një rrezikut të këtillë.

Andromaka

Qefissë, mos m' a përsërit edhé një herë këtë fjalë. Një burrë mora unë, Hektorin, atij i dhashë besën, nuk munt t' i dal e pabesë ! Shoqi i tij nuk lindet më në botë. Do të rronj me kujtimin e tij gjer sa t' a ngrys këtë jetë, gjer sa t' i vete pranë !

Qefissa

Po djalin t' ënt, Andromakë, djalin t' ënt nuk e menton ?

Andromaka
(*tyke unjur kryet*)

Djalin t' em ?....Po, mirë thua, djalin t' em !....Astyanaxin, djalin e Hektorit t' em ! Ah, mendja më hikën kur e mendonj ! Më terren sŷtë ! nuk di ku jam!....Ah, djalin t' em, djalin ; ah h h h !

SQEN' e IX-të

Të parat, Foenix

Foenix
(*me zê të përvajshme*)

Zonjë, zonjë të lutem dy fjalë.

Andromaka
(*e habitur*)

Foenixi ! (*me vehte*). Pse të jetë kthyer prapë ? Ç' kërkon të më thotë? E mjera unë ! (*Foenixit*). Urdhro, zotni.

Foenix

Mezí që e kam ndaluar mbretin për të mos bërë atë poshtërsi të pashoqe, t' ju dorëzonjë Grekëve djalin.

Andromaka

Ah, Foenix, më tmeron !

Foenix

Tmer nuk është lajmi që ju jap, tmer do ishte po të dorëzohej djali. Andromakë, për të shpëtuar djalin un' i dhashë fjalën Pirros se do t' ju bint që t' a merrni burrë !

Andromaka

(*tundet vendit*)

Unë Pirron ? Kurrë !

Foenix

Mos thuaj kurrë ! Mendo rrezikun, mos jí kokë-fortë !

Qefissa

(*Foenixit*)

Aman, Foenix, binde të lutem.

Foenix

Fjalën, Andromakë, se s' pret koha.

Andromaka

Unë t' i shkel besën Hektorit ? Unë, unë ?

Foenix

Hektori vdiq, tani shpëto Astyanaxin. Né që po të shofim se ç' rrezik po të mvarret mbi krye të japim të drejtë. Tyke vënë këmbën ti s' bën gjë tjetër përveç se dënon djalin për vdekje; vret Astynaksin !

Andromaka
(*me lott ndër sý*)

Po si më këshillon mua të ngratën ?

Foenix

T' i japësh fjalën. Këjo është më e mira. Të siguronj se nuk do pendohesh.

Andromaka

Ah, sa këshillë e rëndë për mua !

Foenix

E rëndë vërtet po shpëtimtare ! Jam plak e më vjen shumë keq për ty. Nuk duronj të të shoh në këtë hall.

Andromaka

Ah, sa jam e mjerë, Foenix !

Foenix

E di edhé unë, bija ime, po s' ké se ç' bën !

Andromaka

Ah, si të bënj qyqarja unë !

Foenix

Mos e xgjat më tepër, të lutem, se s' kemi kohë.

Qefissa

Jepe fjalën shpejt e shpëto djalin.

Andromaka
(*e dëshpëruar*)

Ah, Hektor, Hektor, ku di ti se ç' heq sot jotë shoqe ! Ah Astyanax!.... Ah, Foenix !

Foenix

Folë pra !

Andromaka
(*me një ndërdyme*)

Shko Foenix dhe thuaj mbretit si të t' a marrë mëndja, po aman, të përgjëronj, djalin ! Dua djalin !

Foenix

Tash shpëtove, edhé djalin e kërko prej mejet. Hŷji të dhëntë kurajo e durim! (*Del jashtë).*

SQEN' e X-të

Qefissa, Andromaka

Qefissa

Tani jam e lumtur ! Andromakë mos u pendo për fjalën që dhé

Andromaka

Qefissë, të lutem mos më folë më për këtë punë.

Qefissa

Pa mendohu sa e lumtur do jesh kur të shtërngosh t' ët bir në gjî!

Andromaka

A thua se do t' a shoh Astyanaxin me sŷ ? Do t' a shtërngonj në krahrorin t'em ? Do t' a puth ? Ah bir' bir, sa lotte e pikëllime i ké kushtuar s' at ëme!..... Ah, Qefissë, a menton se cilin me jepni për burrë? Të birin e atij që vravi t' em shoq ! Ah, ironí e dobët e Fatit ! Duhet t' i unj kryet ! Duhet t' a pi gotën gjer në funt !... O hije e t' em shoqi, o prindët e mij, njerëzit e mij, Atdheu im i dashur, që u shduktë për mua, ah kujt Hýjit' i falem tani ? Qënka shumë e madhe dashurija për evladin! Vemi, Qefissë, shkojmë.

Qefissa

Kû ?

Andromaka

Atjé ku më çon fati i verbër !....Qënka urdhri i Perëndive !

FUNT I AKTIT III.

AKT i IV-të

(Salla e parë e aktit të parë në pallas të Pirros)

SQEN' e I-rë

Pirrua, Andromaka

Pirrua

Me të vërtetë, e dashura Andromakë, tani munt të them se jam i lumtur. Jam i lumtur, se e shoh ëndrën t' ime të çfaqur, e shoh qellimin t' em të mbaruar. Andromakë, ti ké pasur shumë çprova të dashurisë s' ime, m'a ke njohur zembrën që, tjetër grua veç teje nuk ka dashur. Pra, po thom se jam mê fatbardhi i mbretërve; hŷlli im nisi të ndritë, se ti më dhé fjalën, më do. E kur ti pas pak do vesh kurorë me mua, kur të vesh mbi krye stemën epirote, për mua lint një tjetër jetë. Oh, m' a fal m' a fal Andromakë, se u tregova aqe i egër e aqe mizor përpara teje. Mos e beso se isha i zoti të bënja një dobësi aqe të fëlliqtë sa t' ju dorëzonj Grekëve Astyanaxin, të cilin un' e di fort mirë sa e do; jo nuk e kam dashur, po nevoja e madhe më shtyri gjer atjé. Tash që ti po bëhesh gruaja ime edhé Oresti do kthehet me duar zbrazët në Greqi. Hermiona që pregatitej të verë kurorë me mua tash lé të kthehet dhe ajo në prehërin e t' et. Kush munt kuxojë prej Grekëve të verë dorë mbi Astyanaxin ? Lé të më msyjnë po të duan, jam gati këtu t' i pres, edhé të betohem mbi hijen e shêjtë të t' im eti, se me gjithë që u farros kryekëput Troâdha, unë do të ngreh një dit fronin e Priamit e të Hektorit edhé mbi selin' e famëshme do kurorëzonj për mbret nipin e djalin e tyre. (*Tyke i rënë mê gjû*). Tani, a mê fal, Andromakë, për sa të shkaktova vojtje e mjerime ?

Andromaka

Mbret i Epirit, im zot, të lutem mos i përsërit mê këto fjalë, të cilat sa të më gëzojnë zëmrën mê tepër m' a helmojnë. Kështu ishte thënë prej Perëndive: unë ju shtrova Fatit, mbassi nuk delte ndryshe.

Pirrua

Të lutem mos u tundo; nuk të bijë më më qafë e tani, mbassi duhen ormisur të gjitha nevojat e martesës, ty po të lé këtu në qetsinë t' ënde e unë po shkonj të jap urdhrat e duhura (*e përshëndet).*

SQEN' e II-të

Andromaka

(*vetëm*)

O fat, fat i zî e i mallkuar ! O biri im, mburrimi i gjithë të këqijave të mija! Edhé për pak kam me qënë gruaja e ati që m' a vrau t' em shoq, e atij që farroj njerëzit e mij e Atdhenë t' em ! Edhé për pak duhet të harronj Hektorin t'em e të marr tjetër embër ! Të flé me tjetër burrë, unë që u betova të mos bashkohem me tjetër njeri veç se me Hektorin, atë luân që për dhjetë vjet rreshtas mbajti më këmbë gjith' atë ushtëri greke me aqe mbretërinj e prîësa! A do m' a ndjenjë këtë faj Hektori im ? A do mos më qortonjë ndërgjegja ? Oh, sa dridhem, sa tmerohem! Vetëm kujtimi fatal më përshkon trupin e më kllet tmerin ! (*Tyke parë hîjen e Hektorit që po del si fandazmë).* O, o ! Ç' është ajo hîje ? Ç' është ajo fandazmë? Mos jam në kllapí, mos shoh ëndër ?

Hîja

Andromaaaakë, Andromaaaakë !

Andromaka

(*e topitur*)

O ! Kush flet ? Cili jé ti ? Ç' ké me mua ? Folë !

Hîja

(*nga dale*)

Andromakë, këjo është besa jote ?

Andromaka

A ! Hektori, Hektori im ! O Perëndîj !

Hîja
(*me zê të rëndë*)

Andromakë, e harrove Hektorin !

Andromaka

O, tmerohem, o Zot, o Hŷ (*Tyke u dredhur*) He...kto...ri !

Hîja
(*nga dale*)

Andromakë, po e trathëton Hektorin ! Merr vrasësin t' em ! Harrove gjakun t' em, harrove Trojën !

Andromaka

Hektor, Hektor, të lutem pusho; largoje atë fytyrë se s' e shoh dot! Ah, hiqu s' andejmi.... mjaft më mundove. Ah,.... vramë më mirë e .... mos më qorto!

Hîja
(*tyke u shmangur*)

Lamtumirë, Andromakë, kujto Hektorin ! (*Hîja shduket*).

Andromaka
(*si vjen ndër mënt*)

O Perëndîj, vërtet e pashë Hektorin ? Vërtet i dëgjova zërin? O Apollon, e Dianë, unë të bëhem bês-shkelëse ? Unë të tradhëtonj Hektorin? Jo, kurrë! Hektor, Hektor, ah, të jam besnike kurdoherë, edhé në rashë në gabim më shtyri

dashurija e madhe e djalit t' onë ! Mbassi ti s' e aprovon këtë martesë të keqe, pritmë, o pritmë Hektor, se do të vinj për pak edhé unë pranë teje. Ty s' të këmbenj me gjithë botën, e sa për djalin t' onë lé t'a kenë kujdés Perënditë !

SQEN' e III-të

Andromaka, Qefissa

Qefissa

(*tyke qeshur*)

Ah, zonja ime sa jam e gëzuar që u sosnë taksiratet e tua. Me një fjalën t'ënde shpëtove djalin edhé vehten t' ënde. Sot lipset t' i harrosh të gjitha të këqijat; lipset të gëzohesh. Ah, t' a dish ç' bëhet përjashta! Hermiona e ka marrë vesht edhé gati duket si e çartallosur, si e prishur mentsh; Grekët po bëjnë të madhe poterë për pabesin' e Pirros, i cili as Astynaxin s' ja u dorëzoj, as Hermionën s' e mori grua; Pirrua më tjetrën anë po i ngut të ikin ca mê parë; a e sheh, zonja ime, sa e rëndë paska qënë fjala jote ? E sheh se ç' bën dashurija?

Andromaka

Ti munt të jesh e gëzuar, Qefissë, për zonjën t' ënde po jo edhé zonja jote! Zonja jote kurrë s' munt të harronjë Hektorin e saj të vlertë ! Pirrua s'munt të zërë vëndin e Hektorit të math, sado që ësht' i biri i Ahilefsit e mbreti i gjith'Epirit !

Qefissa

Këto leri, të lutem, më nj' anë, mos më kujto mê të parat. Alltari ty po të pret me gëzim; edhé për pak jé mbretëresha e këtij vëndi.

Andromaka

Ah, Qefissë, po ti kur më pé një herë të më qeshë buza? Kujtimi i Hektorit, hîja e tij më ndjekin kudo. E shoh në ëndër natën, më çfaqet edhé ditën!....O .... kam shumë frikë prej tij !

Qefissa

Frikë prej një të vdekuri ? Frikë prej hîjes së tij ? Pusho, moj bijë.

Andromaka

Po, po, prej hîjes së tija ! (*Tyke parë*). Ah, tí s' e di Qefissë, se edhé tani, tani, këtu brenda e pashë hîjen e Hektorit ! Dëgjova zën' e Hektorit, Qefissë, atë zê aq të përmallshmë e të tmershmë ! Jam krejt e dëshpëruar; s' më bëjnë këmbët të shkonj në tempull !

Qefissa

Harroji të gjitha tani, o zonja ime, edhé eja të pregatitesh për kurorë.

Andromaka

Për kurorë ? Ah, ç' flet ashtu, Qefissë, për hîrët e Perëndive ! Të lutem eja shkojmë një herë të piqem me djalin t' em e t' a shtërngonj me gjithë fuqinë në krahërorët e mija e të çmallem. Eja (*E merr përdore*).

Qefissa

Psé ngutesh kaqe ?

Andromaka

Shkojmë, po të thom, t' a shohim për të fundit herë.

Qefissa

Për të fundit herë ? Ç' thua kështu ? Ti po më tmeron !

Andromaka

Po, për të fundit herë. Nuk dua të t' a fsheh, Qefissë, si kundrë nuk kam fshehur as gjê prej teje. Si thua, Qefissë, është e mundur t' i dal un' e pabesë Hektorit, t' a trathëtonj ? Kam një djalë, edhé e dua që ky të rritet e të rronjë,

pra fjalën mbretnore ja kam marrë Pirros edhé e di se do t' a mbanjë. Mbassi djali im ka shpëtuar nga rreziku që do t' ju dorëzohej Grekëve edhé qellimi im ahere mbaroj. Andromaka e gjallë nuk do shtrihet kurrë mbi shtratin mbretënor të Pirros, ajy po të dojë lé të përfshinjë një kufomë. Edhé ti, Qefissë, mos harro se jé në këmbën t' eme e do t' i vlesh si nënë djalit t'em.

Qefissa

(*me një ngashërim*)

Ç' flet ashtu, Andromakë ? Për Perënditë tërë a jé ndër mënt? Ç'farë punë të këqija mendohesh ? O Hŷ, o Foebus Apollon, o Det e Dhé e Djellë e Qiej mos ka lojtur mentsh e ngrata ? O Andromakë, të përgjëronj për kryet e djalit të vetëm, rehatohu e mos më ngrî gjakun! Fjalët e tua më përshkojnë zembrën si shigjeta të flakta, si rrufé të zjarta ! Eja të shkojmë ku n' a pret gëzimi edhé çporre mentsh atë dëshpërim !

Andromaka

Mos më pengo, Qefissë, mos më ndalo nga rruga që kam marrë. E di se Pirrua, sa do që do mos e harrinjë atë ditë që të më ketë grua, po për kujtimin t'im e për fjalën që më ka dhënë do m' a rritë djalin mirë e do m'a ketë kujdes.

Qefissa

Andromakë, të thashë, mos më zerë në gojë kësij fjalësh. Më shtije tmerin!

Andromaka

Gjer në tempull do vete, Qefissë, po t' a dish se vete vetëm sa t' i marr edhé një herë fjalën zyrtarisht Pirros për rritjen e Astyanaxit. Si të kryhet këjo ahere do jesh ti dëshmore e të mbaruarit të detyrës s' eme edhé ti do më mbyllësh sŷtë kur të nisem edhé unë për të hasur Hektorin t' em !

Qefissa

E shoh se nuk heqke dorë nga ky mendim i keq e fatal, po mos kujto se do të të lemë t' i japësh funt aqe mizorisht jetës ! Ta dish se edhé unë pa ty nuk munt të rronj.

Andromaka

Jo Qefissë, ti s' mundesh të vish atjé ku shkonj unë. Në qoftë se gjer tashti ké jetuar për mua, duhet edhé paskëtaj të jetosh për djalin t' em. S'kam tjetër veç teje në këmbën t' eme. Ty po t' a besonj thesarin e vetëm t' im. Vego[1] për mbi 'tê, vego që t' i përmëndësh Pirros fjalën që më ka dhënë edhé besën që m'u betua. Vego që t' i kallzosh t' im biri racën e tij, Atdhen' e babën e tij. Mento sa ké me i vleftë Trojës një ditë!

Qefissa

Oh, ç' farë porosí të këqija po më lé, o zonja ime ! Ah, mos i rënça këmbës unë atë ditë që të gdhihem pa ty ! Për djalin s' të vjen keq ? (*Qan*).

Andromaka

Mbaji lottet, Qefissa ime, se nuk dua të shohë njeri, që të marrë vesh mendimet t' ona. Pusho .... po vjen Hermiona me Kleonën. Bëjmë mirë të dalim jashtë të mos n' a gjejnë (*dalin*).

SQEN' e IV-të

Hermiona, Kleona

Hermiona

Hé, nuk të thashë unë që kisha të drejtë të dyshonja ?

[1]vego (me vegue) = qëndroi pranë, hapi sytë, shife, etj.

Kleona

E psé ?

Hermiona

Pirrua ndrroj mendje prapë e po martohet me të vehnë e Hektorit!

Kleona

Qysh ? Po fjalët e tija, po premtimet e pregatitjet ? O trathëtí e pashoqtë, o pabesí e poshtër !

Hermiona

Kleonë, leri fjalët edhé shko shpejt më thirrë Orestin këtû.

Kleona

Po shkonj ku të duash, o princesa ime.

Hermiona

Vrapo e mos bjerrë as minutën (*Kleona del*)

SQEN' e V-të

Hermiona

(*vetëm*)

E kisha ditur ! Fjalët e sjelljet e tija e trathëtonin gjithënjë përpara meje, edhé ahere kur zyrtarisht m' a dha besën e më nguti të pregatitem për martesën, prapë sŷr' i tij i trubull fshihte një tradhëtí e një rrezik për mua! Ajy e donte fort robneshën Frigjane, e kisha çprovuar shpesh herë. O tradhtí e keqe ! Un' e bij' e një mbreti, e bij' e vetëm e Menellaut të përbuzem e të poshtërohem në këtë

mënyrë prej një barbari ! E kam dashur të pabesin, po ajy këtë dashuri m' a ka shpërblyer me çnderime ! .... Jo, jo, s' e duronj dot këtë koritje, këtë njollë të poshtër ! Duhet të shbërthenjë e pamëshirtë ahmarrja ime ! Duhet të çilet Ferri e të përpinjë një gjaksor të tillë të pashpirtë ! O ti Hŷ i Olymbit, Zoti i Taygjetit e i shtërgjyshëve të mij, protektorët e Helladhës çfryni mninë t' uaj mbi tradhëtorin, mbi çorroditësin t' em ! Mos pranoni kurrë të poshtërohet prej një të huaji një princesë Greke! (*Hyn Oresti*).

SQEN' e VI-të

Oresti, Hermiona

Oresti

Më kishe kërkuar, o princesë ?

Hermiona

Po, afrohu shpejt e pa vonim.

Oresti

Dukesh tepër e turbull e më ngjan se do kesh nevojën t' eme.

Hermiona

Orest, leri mê nj' anë ironitë edhé më thuaj seriozisht a mê do ti mua me gjithë fuqin' e shpirtit ?

Oresti

Prova të kam dhënë disa po ti s' ké dashur t' i besosh.

Hermiona

Mirë fort të zê besë. Ahere a jé i zoti të bësh ç' do farë therorije për mua?

Oresti

Nuk është pyetje ajo. Unë të kam thënë vetë se ç' munt të bënj për ty, harrin ti të duash e të kesh besim mbi mua.

Hermiona

Pra, Orest, unë jam poshtëruar fort prej Pirros e po të betohem për mbi prindët e mij e mbi të këqijat që kam hequr, se unë s' dua mê t' a shoh me sŷ, po dua t' i marr edhé shpërblim të rëndë me ç' do therori ! Orest, dua të m' a marrësh hakkun ti.

Oresti

Jam gati. Pra, lé të fillojmë, lé të bëhet ç' të bëhet, lé të derdhet gjak, lé të digjet gjith' Epiri më keq se Troja. Eja t' i vemë zjarë këtij pallasi të mallkuar e të të grabit, si Pârisi t' ët ëmë, edhé lé të shkojmë me anijet t'ona.

Hermiona

Ashtu jo ! Unë dua të qëndrojmë këtu. Dua që, kur të verë kurorë me atë robneshën e keqe, ju me shokët të jini në tempull e para se të kurorëzohen t' i vrisni m' atë çast që të dy, m' andej të rëmbeni Astyanaxin, t' i vini zjarin kryeqytetit te Epirit edhé ashtu të shkojmë. Dua të kullonjë në gjak e në lotte gjithë raca Epirote ! Këto a jé i zoti t' i marrësh për sipër?

Oresti

Shumë kërkon me një herë. Janë sende të pa mundura.

Hermiona

A, t' u dhimka lëkura ! Ahere cila është therorija jote faqe dashurisë për mua?

Oresti

Mjaft shpërblim është ajo që të thashë, që munt të më kushtonjë edhé jetën t' ime.

Hermiona

Ahere pohoje këtu përpara meje që s' qënke i zoti e mos u zotô tjetër herë! Hiqmu qafet pra, se jam e zonja vetë t' a marr hakën.

Oresti

Mos më rëzo kaqë poshtë, o princesë. Mos harro se unë jam ajy Oresti që vrava Klytemnistrën e i mora gjakun t' im ati !

Hermiona

Mua mos m' u mburr me vrasjen e një gruaje. A jé i zoti të vraç një burrë si ky, një tyran kaqe të math ? Po duket se të ka lënë zëmra.

Oresti

Mua më ka lënë zëmra ? Jo, as pak, atë s' e pranonj. Po më thuaj, si munt t' a vras ditë më drekë edhé përpara popullit, i cili e adhuron? Unë pardje ardha këtu edhé nuk di edhé vendin mirë; nuk di cilin vent të zgjeth për më të sigurt për këtë qëllim. Ti do që më një or' e sipër të rrëzohet e të shembet një Mbretërí e tërë prej duarve të mija. Si ësht' e mundur ? Do që të vritet një mbret, i rrethuar kaqe shumë prej ushtërisë së vet, edhé s' më jep as pakë kohë. Si bëhen gjithë këto kështu? Lermë ahere të bënj pllanin t' em për këtë barrë e pastaj flasim.

Hermiona

(*me zëmrim*)

Unë tash e dua shpagimin e jo prapa. Pirrua edhé për një orë shkon atjé përpara tyke ja mbajtur për në tempull, pa rrojtarë, pa njeri. Është barabar si kur të të thotë që "kryet t' ime në duart t'ënde". Shko shpejt, pregatit pllanin e jep kushtrimin më atë çasht që do t' i kish vrarë të dy. Shko dhe ktheu me duar lyer në gjak të atij tyrani e ahere do bindem e do besonj se më do me të vërtet.

Oresti

Princesë, mendohu mirë edhé pêshohi ato që thua !

Hermiona

Nuk kam pse mendohem. Ti kot po e shtyn kohën. Ndaje njërën dysh kështu a ashtu, në mos po lermë të shkonj vetë edhé ti shko t' ju lëvdohesh të tjerëve që ke vrarë një grua ! Po shkonj atjé ku ti s' kuxon të shkosh e të çponj atë zemër që s' munt t' a bint të më dojë edhé të vdes bashkë me atë se sa të rronj me një frikaç si ty !

Oresti

Ahere të siguronj se Pirrua do vdesë prej krahut t'em, jo prej t'ëndit.

Hermiona

Nisu, pra e shko se mjaft ké bjerrë kohë edhé pregatitni anijet.

Oresti

T' u mirë mbeç, Hermionë, edhé ja kthehem i gjallë, ja mbetem këtu, ti do dish t' a çmosh dashurinë t' eme për ty.

Hermiona

Zoti me ju; kemi kohë kur të flasim për dashuri. Udhën e mbarë e kij kurajo (*Oresti del).*

SQEN' e VII-të

Hermiona, Kleona

Kleona

U qetsove pak, princesa ime ?

Hermiona

As un s' di ku jam Kleonë !

Kleona

Shëko mirë, zonjë, se mos marrësh vehten më qafë !

Hermiona

I kam menduar që të dyja si rrojtjen, ashtu edhé vdekjen, harrin të marr shpërblim ! Shko shpejt, Kleonë e pregatiti. Shko i thuaj Orestit që kur t' a vrasë të pabesin t' i thotë se e vrau dora ime për tradhëtinë që më bëri. Shko shpejt. (*Zé të dalë Kleona, porse sheh Pirron që po vjen).*

Kleona

O Perëndí ! .... O zonja ime, ç' ka po shoh ? .... Pirrua !

Hermiona

(*më vehte*)

Nuk po marr vesh ç' do ky këtej e psé nuk shkoj në tempull për të vënë kurorë ? Mos i ngjau gjê ? Mos është penduar ? Apo vjen të më kallzonjë edhé

një herë tradhëtit' e tija ? (*Kleonës*). Shko shpejt e ndaloje Orestin, mos bënjë gjê gjer sa të shihet me mua. (*Kleona del*).

SQENË VIII

Pirrua, Hermiona

Pirrua

Princesë, ndofta nuk më prisnje në këtë orë. Vinj të të thom se e kam marrë vesht fort mirë psé ka ardhur këtu yt kushëri Oresti. Dashurinë që paski pasur qysh tjetër herë me njëri-jatrin, mjerisht e msova edhé po të siguronj se nuk dua t' ju ndalonj nga ky bashkim as pak. Në vënt t' a marr për liksht punën, për kundrazi gëzohem që e msova edhé me gjith zembër po ju lé të lirë. Munt të shkoni kur të doni; munt t' ju përcjell pa hidhërim edhé t' ju jap gjithë lehtësitë që të kërkoni edhé në dashçi që këtë orë.

Hermiona

(*e egërsuar fort*)

O ti i pabesë, shkakëtar i mjerimeve të mija, nuk të janë mjaft gjithë të këqijat që më punove gjer më sot, po ké kuximin edhé të dalësh përpara meje e të m' akuzosh me një bigoní, për të cilën unë s' jam as pak fajtore ? Në vent të më kërkosh ndjesë e të pendohesh për tradhëtínë të pashpirtë që më ngjize, vjen të më ngarkosh edhé me të tjera gjëra fandastike, të pangjara e të paqëna? Kush të ka thënë se unë dua Orestin? Këjo është një çpifje e dobët, qesharake! Unë që për ty humba të ritë t' im, unë të dua Orestin? Ku i ké provat? Me këtë kërkon të fshehësh fajin e math, e paudhësinë që më ké shkaktuar? Kujton se këto të shkarkojnë prej mëkatit të math që bën? Kujton se të lehtësojnë ndërgjegjen ? A nuk i di unë marrëdhënjet fajtore që ké me atë robneshën e dobët, me atë magjistaren Frigâne? Nuk ké turp të lidhesh me një virgjineshë, bijë mbreti të dëgjuar e pastaj të kesh relacjone me një të vehë, me një armiken t' onë? Kush të shtërngoj të më heqësh prej gjirit të prindvet të mij? Psé s' më lé në qetësinë t' eme kur kishe këto qëllime? Vjen të shtosh helmin t' im ? Vjen

të më poshtërosh edhé më tepër me fjalët e tua çpifarake ? S' ke frikë nga Perënditë? S' ké turp nga njerëzija?

Pirrua

Princesë, mjaft fole. Jé në pallasin t' em e nuk dua të sillem jashta zakonit, po edhé të thom që nuk i duronj dot këto fjalë. Ndofta ké marras e do të zbrazesh, po fajin s' e kam unë. Kur i kishe dhënë fjalën Orestit psé të vish gjer këtu ?

Hermiona

Ngul këmbë akoma në një rrenë, në një mashtrim, në një çpifje të dobët? Ké prova për këtë që thua ? Ti, kur jé i zoti e martohesh me atë që i farrove ç'të shenjtë kish mbi dhé, që vrave me duart e tua Priamin, një plak të shkretë, që s'kish për veç një pikë gjakut edhé atë të akullt, që therre të bijën e tij virgjineshën Polyksenë e që shkaktove mijë mjerime, nuk mundesh sot të bësh kurban edhé një virgjineshë tjetër, mua? Ç' kërkon prej mejet ? Nuk më lé me gjithë hallet që kam ?

Pirrua

Të këshillonj të ikni sa më parë me gjithë Orestin edhé Grekët e tjerë. Këjo është mê e mira punë që munt të bëni, mbassi edhé Oresti për këtë punë paska ardhur. Sa të të grabitnjë nuk është më e mira të shkoni tyke pasur edhé lêjen t' eme ?

Hermiona

Më dbon? Më ndjek së këtejmi? O Perëndinj, e harriva edhé këtë ditë? Unë të dbohem në këtë mënyrë, un' e bij' e Menellaut? O rrufét' e Olymbit pse nuk shbërtheni ? Shkëmbënjt' e Taygjetit pse nuk rrëkëllehi? (*Pirros*). Jo, mbret i Epirit, jo, nuk shkonj; dua të të shoh si do martohesh me atë robneshë, dua të rri të të veshgëllonj; si thua s'më bën as këtë hîrë?

Pirrua

Do të rrish sa për këtë ? Qendro; në daç eja edhé në tempull.

Hermiona

Po, do vinj. Do vinj, i pabesë, do vinj !

Pirrua

Si të mbarohet ceremonija lipset të ikni. kam dhënë urdhër të mos ju lenë më tepër. Sa do të më tregohesh e pafajshme në dashurinë mëkatare me t' ët kushëri, unë e di çështjen me rrënjë edhé nuk dëshëronj t' a zgjat më tepër, as që dua të të jap prova. Mjafton të të thom se e di, ashtu si e di edhé ti edhé Oresti. Prandaj të them se pas ceremonisë të martesës s' eme me Andromakën duhet të lini kryeqytetin.

Hermiona

S'ka mê bukur ! Edhé né ashtu do bëjmë, qetësohi ! Tani shko shpejt te hymenêu që po të pret, shko t' i betohesh edhé robneshës vejushe ato që m'u betove mua ! Shko i pabesë edhé në daç përbuzi edhé Perënditë që të kanë mbajtur gjer sot në fuqí. Prej meje qofsh i mallkuar edhé të arthçin mbi krye ato që kam vojtur gjer më sot për ty. Kurrë mos t' u heqshin poteret e travajet! Menadhat e Erinijat t' a shpërblefshin! (*Del me inat*).

SQEN' e IX-të

Pirrua, pastaj Foenix

Pirrua

I prisnja të gjitha këto prej bijës Menellaut ! Gojën e shpenguar edhé gjuhën e rreptë të saj i kam shprovuar shpesh herë. Nuk e kam dashur edhé fajin e ka i ati që m' a dërgoj ! Kaqë kohë që ndodhet në këtë pallas s' ka mundur të

më tërheqnjë që t' a dua. Kërkonja një shkak t' a largonj edhé shkakun e gjeta. Oresti më tha se ardhi për Astyanaxin, një sent që as unë s'e besova, se Oresti ardhi vetëm për me grabitë Hermionën së këtejmi si Aleksandri i Troâdhës që rrëmbeu Helenën tjetër herë, ndonse Menellau e priti me nder si një shtektar. Ajy shkaktoj një luftë dhjetëvjetshe edhé shgatërimin e Trojës prej themeleve; po këjo nuk do ngjasë edhé me mua. Mbassi u sigurova se edhé këjo e dashka ësht' e tepër të martohet me mua, ësht' e tepër të rrijë këtu. Kështu vjen të përmbarohet vullneti i Perëndive, i cili është që Andromaka e bukur, Andromaka bujare e krenare të bëhet gruaja ime, mbretëresha e Epirit e jo një greke. Lavdi paçin Perënditë që i prunë punët kështu !

Foenix

(*hyn me ngutësí*)

Madhëní, të gjitha janë gati; populli është grumbulluar e po ju pret në tempull pa durim. Për se vonohi ?

Pirrua

Kini të drejtë. Vonova pak këtu pa dashur. Po, Foenix, nuk më thua, Andromaka është aty?

Foenix

Si urdhron aty është. Ka ardhur bashkë me besniken e saj Qefissën e po presin përpara alltarit.

Pirrua

(*me vehte*)

E gjora Andromakë ! (*Foenixit*) Si po të duket fytyra e saj Foenix? Ësht' e vrazhët si më parë, a po nënëqesh ?

Foenix

Do t' a shohësh vetë, madhni, po tani ju lutem mos u sillni, se po ju presin.

Pirrua

Kam frikë se mos nënëqesh vetëm për sŷt' e vullgut[1], se asaj kurrë s'i del hidhërimi ! Po ç' po thom ? Për mua mjaft është që Andromaka e rallë të bëhet për pak gruaja ime. Eja shpejt Foenix, eja të vemi ku n' a presin. (*dalin).*

FUNT I AKTIT IV.

AKT i V-të

(Theatri çfaq dhomën e veçantë të Hermionës)

SQEN' e I-rë

Hermiona

(*vetëm*)

Ku jam? Psé po sillem akoma? Ah, e arratisur, e mërguar prej prindve të mij pa një gëzim, pa një shpresë, e mjerë, e përbuzur e çnderuar, po qendronj edhé në këtë pallas, në këtë vënt të mërzitur! Ah, tradhëtor i pashpirtë, ti që qesh e tallesh me të këqijat e mija, me lotët e pikëllimet që derth, ti po pregatitesh taní të vesh kurorë me tjetër grua! Edhé për pak po vjen përpara alltarit bashkë e po kurorëzohesh me rivalen t' eme përpara sŷve të mija pa pikën e turpit, pa frikën e Perëndive! Oh, sa e madhe e keqe për mua ! E un' e shkreta ! .... ah, duhet të mbyll sŷtë e të duronj! (*Egërsohet*). Jo, jo, s' durohet kështu; vendimin që dhamë s' duhet t' a marrim prapë ! Lé të vdesë dhe ajy, lé të humbasë kështu si humbas unë, mbassi nuk rron për mua ! Gjakpirësi po triumfon e po qesh me taksiratin t'em, edhé kujton se vetëm në lote e në ngashërime kufizohet helmi im; kujton se e turpëruar e e pafuqishme do marr sýt e këmbët e do kthehem në Spartë ! Ah, jo, jo tyran, gjaksor, tradhëtor, nuk jam Hermiona e parë; nuk t'a fal kurrë këtë faj; sot s'e kam fjalën unë; fjalën e ka *marrazia, cmiri, ahtmarrja*

[1] vullg = popull, të pranishëm etj.

edhé mbassi ti po më shtyn të kërkoj vdekjen t' ime, qé edhé unë po kërkonj t'ënden mê parë, pastaj edhé t' imen. Lé të vdesë, ...po, lé të vdesë ! Lé të mbaronjë sot këjo lodër e keqe. Kështu e do puna, kështu e do nderi im!

SQEN' e II-të

Hermiona, Kleona

Hermiona

Hé, u mblodhë ? Pirrua me atë rivalen t' ime jan' atjé

Kleona
(*tyke qarë*)

Ah, zonja ime, mjerisht atjé janë të gjithë rrotull alltarit !

Hermiona

Si t' u duk Pirrua ?

Kleona
(*gjithashtu*)

Mê tepër krenar e kryelartër se kurdoherë !

Hermiona
(*me vehte*)

Krenar e kryelartër ! (*Kleonës*). E ajo, ajo si t' u duk ?

Kleona

Edhé ajo nuk dukej mê pak e gëzuar se ajy !

Hermiona

Ah, bish' e Frigjîsë !

Kleona

Populli po pret pa durim ceremoninë, e cila është gati të fillonjë.

Hermiona

Po, Oresti, Kleonë, Oresti a shihet gjëkunt ?

Kleona

Sa do që veshgëllova nuk pashë as Orestin, as Pylladin.

Hermiona

Ah, o Perëndinj, ku të jenë këta? Mos pregatitin planin e vrasjes? Si mjerë né, në qoftë se janë shmangur prej planit prej ndo një frike! Kleonë, shpejt shko të gjesh Orestin e shih ç' po bëjnë e më thuaj. Po të pres. (*Kleona del*).

SQEN' e III-të

Hermiona

(*vetëm*)

Ah, ç' kam frikë se do mos bëhet gjê ! Duket se Oresti vetëm fjalë të trasha ka pasur, ndryshe i dhimbet shumë lëkura ! Ah, sa trembem se mos n'a tradhëtoj edhé ky ! Kush e di, në vënt të verë në zbatim pllanin ajy nga frika është nisur për në Greqi bashkë me Pylladin! Anijet do kenë hapur velat tani e janë nisur e un' e shkreta kot këtu po pres, edhé ç' pres? Vdekjen! Ah, sa paskam qënë fatzezë! Çudi s'e pashë gjëkunt sa do që e kërkova. Po, u bê ç'u bê. Unë psé rrî këtu? Psé bjerr kohën? Ajy tash po shkon pran' alltarit bashkë me

robneshën e tij, unë kur do gjenj kohë të marr shpërblim? Në qoftë se nuk e marr sot, këtë orë, këtë çast, ahere nuk do t'a marr kurrë! Duhet të bënj mendimin e fundit, unë e humbur jam kështu ose ashtu. Në vepërim pra. (*Fillon të shkonjë po haset me Kleonën*).

SQEN' e IV-të

Hermiona, Kleona

Hermiona

Hé ! E gjete ?

Kleona

Mjerisht jo, princesa ime, Oresti nuk shihet gjëkundi edhé nuk di se ku t'a kërkonj !

Hermiona

(*me dëshpërim)*

Ah, i dobti, n' a tradhëtoj ! (*Kleonës*). Po Pylladin a e pé ?

Kleona

Nuk duket as ajy !

Hermiona

Mirë e mendova. Kanë shkuar që të dy ! Ah, Kleonë, e shoh se më lanë që të dy në mëshirën e Pirros të pamëshirtë ! Ah, fatzeza unë, jam e tradhëtuar, e fikur krejt ! (*Zé kryet me të dy duart).*

Kleona

Zonjë, princesa ime, të lutem mos hump shpresën.

SQEN' e V-të

Të parët, Oresti, Pylladi

Hermiona

(*tyke parë Orestin*)

Ah, tradhëtor, ç' më bëre ! Kështu m' a mbajte fjalën ? Kështu m'a mbarove porosinë? Ah, sa jé i keq, i pamëshirtë, i pa-zoti !

Oresti

Mos u zembro, Hermionë, qetsohe gjakun. S'jam i pabesë, as tradhëtor e i pazoti. Né me Pylladin kemi qënë mê së pari në tempull, edhé pllanin e kemi shtruar, tyke zgjedhur edhé vendin prej të cilit do të msymë. Kemi marrë edhé shokë me vehte, ata mê të mirët e i kemi sheshtuar në pritat e nevojshme. Ata presin vetëm kushtrimin t' onë. Synthemën[1] gjithashtu ja kemi kumtuar. Edhé anijet t' ona janë gati të gjitha.

Hermiona

Më ngjan se është tepër von. Ajy me atë do jenë tani përpara alltarit edhé në qoftë se nuk vepëron tani, kurrë s' kini për të kryer gjê edhé kam frikë se do tradhëtohemi të gjithë e do t' a pësojmë.

Pylladi

Qetsohu, princesë, i kemi marrë të gjitha para sŷsh.

[1]synthema = kuptimi në këtë rast është që plani është hartuar e zbërthyer deri në detajet më të vogla dhe ja kemi bërë me dije të interesuarve

Hermiona
(*Pylladit*)

Mjerisht unë s' po shoh gjê; gjer tani duhej të ish vrarë Pirrua. Kujtonj se kot do mundohemi, se tash munt edhé të kenë shkuar. S' po dëgjohet zê, s'jan'atjé.

Pylladi

Mos dyshò aqe fort, princesë, se e dijmë në orën e minutën.

Oresti

Hermionë, né s' arthmë këtu që të bjerrim kohën, po arthmë të të qetësojmë një herë për planin që kemi bërë e të të themi bashkë me këtë se duhet tani,tani të shkoni bashkë me Kleonën në anijet t' ona; do t' ju çonjë atjé Pylladi. Hyni në anijen t' eme e më prisni, e në qoftë se mê ësht' e thënë të mbetem këtu, ahere ju shkoni shpejt e shpëtoni prej rrezikut. Besonjse do të të jepet rasti të njohësh dashurin' e madhe që kam pasur për ty. Shkoni pra, e u pjekshim shëndoshë. Lamtumirë, Hermionë ! (*E përqafon*). Në mos u pjekshim të gjallë, do piqemi në atë jetën tjetër ! Lamtumirë !

Hermiona

Perënditë të protektofshin[1] ! (*Oresti del*)

[1]të protektofshin = të mbrojtshin

SQEN' e VI-të

Të parët, përveç Orestit

Pylladi

Ejani të shkojmë sa mê parë.

Hermiona

Ah, Pylladi, nuk di se ç' kam, nuk jam nder ment. S' di psé s' më bëjnë këmbët të ikinj që këtej !

Pylladi

Princesë, ora po kalon edhé rreziku po afrohet; në qoftë se nuk nguteni të shkojmë kam frikë se mos n' a gjenjë potera !

Kleona

(*e zé për krahu Hermionën*)

Eja shpejt, princesa ime, të shkojmë ca më parë në liman.

Hermiona

Ah, Kleonë, ti mendon të shpëtosh vehten po unë mendonj edhé një gjë tjetër, mendonj edhé shpërblimin që duhet të marr!

Kleona

Atë barrë e ka marrë përsipër Oresti, po né duhet të ikim.

Pylladi

(*me ngutsi)*

Princesë, fjalën e fundit, se ndryshe jemi të humbur. Doni të ikim, apo jo?

Hermiona

(*tyke trokitur kêmbën*)

Jo, nuk shkonj, dua të rri këtu gjer më në funt !

Pylladi

(*ngreh duart përpjetë*)

O Perëndinj ! .... Princesë, a jé ndër ment ? Ç' kërkon të bësh ? Ti po n'a merr më qafë të gjithve; a s' e sheh rrezikun që n'a mvarret mbi kryet?

Hermiona

Jo, Pylladi, unë nuku shkonj. Do rri këtu si do që të ngjasë. Ju me Kleonën mundeni të shkoni, jini të lirë. Dua me sŷt' e mija të shoh vrasjen e tija edhé në mos qoftë i zoti për këtë Oresti, do t' a marr vetë shpërblimin me këtë dorë.

Pylladi

Princesë, s' e ké mirë, mendohu. Të lutem eja me né.

Kleona

Zonjë, mos merr vehten më qafë.

Hermiona

E kam menduar e pêshuar mirë !

Pylladi

Princesë !

Kleona

Zonjë !

Hermiona

Mos m' u lutni më; ju thashë, jini të lirë, shkoni.

Pylladi

N' a more më qafë !

Kleona

Kemi sharruar !

Hermiona

S' dëgjonj kurrgjë prej këtyre. Po shkonj të mbaronj qëllimet e mija. Lamtumirë (*i zë përdore Pylladin edhé Kleonën).*

Pylladi e **Kleona**

Për kryet t' ate, princesë, mos !

Hermiona

Lamtumirë ! (*shkon*)

Pylladi

Kleonë, ç' thua, a do vish ti, mbassi princesa kërkon kot të humbasë kryet? A vjen ti me né të pregatitemi ca më parë, se ndofta munt t' a sjellë Oresti princesën kur të kthehet ?

Kleona

Unë të vinj vetëm pa t' ëme zonjë ? Unë t' a lé atë këtu e vetë të ikinj? Jo, Pylladi, ajo s' bëhet kurrë ! Kur u nismë prej Spartet bashkë u nismë edhé prindët e saj m' a besuan në dorën t' eme. Unë jam shoqja e kujdestarja e saj;

nuk munt t' a lé kurrë vetëm. Mendohu Pylladi ç' do më thoshnin në Greqi kur të kthehesha pa zojûshën t' eme ! Ah, jo, kësij pabesije nuk munt të bënjë Kleona !

Pylladi

Ahere do rish edhé ti me princeshën bashkë?

Kleona

Ësht' e ditur, s' kam si të bënj ndryshe; ç' të vinjë mbi 'të lé ta heq edhé unë.

Pylladi

Më qafë pra paçi vehten, s' kam se ç' t' ju them tjetër. Unë po shkonj shpejt se më presin shokët, se s' kam të drejtë t' i marr më qafë dhe ata për shkak t' uaj (*ikën*).

SQEN' e VII-të

Kleona

(*vetëm*)

Ah, qyqarja unë, ç' poterë e tmerrshme po n' a vërvitet ! Sigurisht atjé në tempull do t' a gjejmë vdekjen ! Ësht' e rrezikshme ahtmarja e një gruaje ! Kush e di se ç'do bënjë; ah, e mjera unë që do t' a humbas zonjën t' eme! Po psé bjerr kohën këtu ? Duhet të harrinj shpejt atjé, duhet t' i ndodhem afër ! Ah, ti o Athinâ, o Afërditë, bëjuni mprojtëse të zonjës s' eme! (*Shkon me vrap).*

BIJE NAPA

Tablô

Theatri çfaq të brendëshmen e tempullit; në mes të tempullit një alltar; dy pishtarë të ndezura nga e djathta e nga e mëngjra; mb' at' anë alltarit qendrojnë Pirrua me Andromakën, veshur me roba zyrtare. Prapa Pirros e Andromakës duken Qefissa e Foenixi; rrotull këtyre janë popull burrash e grash edhé ushtarë e shtizëtarë Epirotas. Një fonksionar fetar gjindet përpara alltarit për kurorëzimin e drejtimin e ceremonisë.

SQEN' e I-rë

Pirrua, Andromaka, Qefissa, Foenix

Pirrua

Po të shoh, o Andromakë, përpara këtij alltari të shenjtë edhé munt të mendohesh sa i math është sot gëzimi im ! Shoh që ëndra ime u realizua, se edhe për pak ti jé gruaja ime edhé unë yt shoq. Dëshpërimi im i gjertanishmë u kthye në një gëzim të patreguar. Tani e besova se lumërija afrohet nga mua, tani e shoh sa do rronj me ty fatbardhë. Gëzohu, Andromakë, se jé mbretëresha e Epirit, gëzohu se jé mê e lumura e gjithë gravet !

Andromaka

Edhé unë nuk i mohonj sa thua, o mbret i Epirit. Po të lutem edhé një herë zyrtarisht e përpara këtij alltari, përpara Perëndive protektorë të Epirit, të më japësh fjalën t' ënde mbretnore, të më japësh besën se, djalin t' em Astŷanaxin do t'a rritësh si një babâ i dytë, do t' a kesh si djalin t' ënt, si kur te ishte vetë Hektori ! Betohu këtu, se do t' a bësh njeri të mirë e të drejtë, të zotin që një ditë të ngjallë Troâdhën e shdukur, kû, mbi selinë mbretnore t' a storasësh ti. Jepmë fjalën se do mos kursesh gjê për të, se në as një mënyrë nuk do t' ja u dorëzosh Grekëve edhé se do t' i dalësh zot në ç' do rrezik të tij.

Pirrua

S' ishte nevojë, e dashura ime, të m' i përsëritnje gjithë këto fjalë për besën, të cilën t' a kam dhënë disa herë. Po mbassi e kërkon sot zyrtarisht, (*ngreh dorën*) po të betohem përpara këtij alltari të shenjtë, përpara Perëndive, të cilët i thres dëshmitarë, përpara hîjes së t' im ati, se kam me i krye një nga një gjithë porositë t' ënde që më sajove për Astyanaxin. Do t' a kem bir' e do t'a rit si baba, do t' a mpronj e do përpiqem t' a bënj mbretin e Trojës edhé të dêjtin djalë të fatosit të math Hektorit ! Betohem se kurrkush nuk do kuxojë të verë dorë mbi djalin t'ënt; edhé në kuxoftë do gjenjë gati këtë krahnorin t' em edhé gjithë shigjetat epirote përpara ! Armiqt' e tij kam me i kqyrë si armiqtë të mij edhé kurrë nuk do t' i ndahem këmba-këmbës. (*Andromakës*) Por, Andromakë, ç' janë, të lutem gjithë këto lotte që po derth si rrëké përpara këtij alltari? Ç' është gjithë këjo paqetësí e kjo e dredhur që të kanë hipur? Ç' janë gjithë këto vesvese[1] e dyshime që po shëkonj? Nuk ju zé besë fjalëve të mija? Nuk do t' a rritim bashkë Astyanaxin? Qetsohu, Andromakë, e shtroje gjakun. (*Duket në funt të sqenës Oresti, i cili hyn i shoqëruar me disa Grekë të tjerë ushtarë të armatisur. Nga an' e djathtë duket Hermiona, e cila po i afrohet alltarit)*.

Andromaka

(*tyke fshirë lotët*)

Të jam falur, o mbret i math i Epirit, e të jam tepër mirënjohtëse për betimet që më dhé. Jam e sigurt se do m' i kryesh gjithë këto porosi. (*Qefissës*). Ti Qefissa ime, mos harro ç' të kam thënë !

Pirrua

(*tyke marrë diademën – kurorën mbretnore – prej alltarit)*

O, Andromakë, merre këtë kurorë që po të jep mbreti i Epirit, burri yt, e po të quhan këtu zyrtarisht gruan e tija e mbretëreshën e Epirit. (*Kur fillon t' i*

[1]vesves = që dyshon për çdo gjë që nuk beson dhe e ha meraku gjithnjë se s'është ashtu, që shqetësohet e bëhet merak për çdo gjë

verë kurorën mbi krye Andromakës, Hermiona me leshrat lëshuar e me fytyrë të zgurdulluar afrohet me një herë edhé me të shpejtë ja rëmben kurorën Pirros prej duarsh, e çqyen copë, copë e heth për dhé e e shkel).

SQEN' e II-të

Të parët, Hermiona, Oresti

Hermiona
(*tyke shkelur dîademën*)

Jo, jo, nuk bëhet mbretëresh' e Epirit një robneshë, një e vehë, një armike! (*Pirros).* Gjer këtu, mos shko mê tutje, o i pabesë, tradhëtor, gjakpirës! (*Turbullim i math*).

Andromaka
(*më vehte*)

O Perëndij, ç' është gjithë kjo bolbë[1] e madhe!

Foenix
(*gjithashtu)*

O, sa e madhe mnija e një rivale !

Pirrua
(*tepër i egërsuar*)

O ti, bij' e Grekut, kuximtare e paturpshme, ku e gjete gjithë këtë kurajo? Mos ké lojtur mentsh, e marrë ! Nuk di sa faj i math është ky edhé se ndëshkohet reptësisht ?

[1]bolbë = e keqe e madhe, fatkeqësi e madhe, gjëmë, e zezë; ngatërresë, bela, hatâ

Hermiona

Tyran, çorroditës i nderit t' em, ti që më more prej gjirit të prindëve të mij e më prure këtu që të më lesh rrugave e të më çnderosh në këtë mënyrë, ké kuxim akoma të më shohësh në sŷ? Ké kuxim të martohesh me një tjetër, tyke qenë i vluar me mua ?

Pirrua

(*më vehte*)

O Apollon e Posidhon, Hermiona ka lojtur mentsh ! (*bërtet*). Ushtarë Epirotas ku jini? Do lijni kështu të përbuzet mbreti juaj ? (*Dëgjohet një fishkëllim. Oresti jep kushtrimin Grekëve për me vrâ Pirron; bëhet një zhurmë e madhe*) Kush fishkëllen kështu ? Ç' është këjo zhurmë?

Oresti

(i *derdhet Pirros me një kamë në dorë*)

Unë jam, tyran, unë ! (*Tŷke dashur t'i bjerë*) Mso, o tyran, si çnderohet një princesë greke ! (*i bije me kamë po s'e mbërthen dot se shmanget Pirrua me një herë).*

Foenix

(*tyke i zënë dorën Orestit*)

Ndalu assasin, nuk vritet kështu mbreti i Epirit !

Pirrua

Tradhëtor i poshtër, ti kundra meje? (*Ushtarëve*). O burra, binjuni, ç' i lijni të gjallë ? Bini, mos shpëtonjë këmbë së këtejmi! (*Ushtarët Epirotas lëshohen mbi Orestin e grekët e tjerë e i zenë. Një bujë e madhe në tempull)*

Oresti

(*tyke u hequr prej Epirotasve*)

Mbret i Epirit, nuk do të të lemë të gjallë ! Mos kujto se Grekët do harrojnë gjakun e Orestit ! (*Oresti me Grekët konspiratorë shduken krejt prej sqene*).

Andromaka
(*Qefissës*)

Mbrini ora, Qefissë, që të bënj edhé unë detyrën t' eme !

Qefissa
(*i bije mbë gjunjë*)

Për të këqijat që ké hequr, ndale dorën, zonjë !

Pirrua
(*Hermionës*)

Çporru edhé ti fytyrë-keqe, ikë mos të t' i shoh sŷtë!

Hermiona
(*më vehte*)

Mbaroj punë jeme ! Oresti s' e kreu dot detyrën e tija edhé çorroditësi im mbet prapë herôji i patalokut[1]. Ajy po triumfon, po unë ç' pres më?

Pirrua
(*Hermionës*)

Ty po të them, hiqu shpejt s' andejmi, se për ndryshe vijn' e të heqin ushtarët e mij me përdhûnë.

Hermiona

O mbret i pabesë, o tradhëtor, kujton ti se pa një shpërblim munt të ndahet e bij' e Menellaut prej teje? Mbassi mbaroj për mua ç'do shpresë, merr edhé ti ndëshkimin që të meriton ! (*Nxjer një thikë prej xhepit edhé i bije Andromakës)*. Na, vdis o robnesh' e keqe ! (*E vret Andromakën e cila rëzohet mbë dhé. Pirrua*

[1]patalok = vend i rrafshët, shesh; shesh i madh ku zakonisht bëheshin dyluftime

unjet i trembur t'a ngrehë si dhe Qefissa. Hermiona passon tyke ju adresuar Pirros). Tani martohu edhé ti me këtë !

Pirrua

(*sulet të kapë Hermionën*)

Ah, bish' e Greqisë, magjistare e dobët, vrasëse, t' u thaftë krahu ç'bëre! (*Kur i vërsulet Pirrua, Hermiona mprohet me kamën që ka në dorë*).

Hermiona

Ndalohu ! S' jé ti i Zoti të më përkatsh mua ! Këtë lêje s' ta kanë dhënë Perënditë !

Pirrua

Ah, tigër, hyenë e tërbuar ! (*i sulet*).

Hermiona

(*tyke u mbrojtur*)

Gjer aty ! Tash mso, tyran, si vdesin virgjineshat e Greqisë (*Ngreh duart*). O Perëndesha të shpërblimit Erinnŷja e Furrîja, ju merrjani hakkun këtij tradhëtori ! (*qellon zembrën e saj me thikën edhé me një herë rëzohet e vdekur. Një poter' e madhe bëhet; disa ushtarë shkojnë e ngrehin Hermionën e e nxjerrin jashtë)*.

Pirrua

(*i hutuar*)

O Apollon e Turmës ç' janë gjithë këto betaje[1]? (*tyke ju sjellë Andromakës)*. O Andromakë e dashur, hap sytë, çohu, unë po të thres Pirrua, burri yt !

[1]bëtaje = frikë e madhe, lemeri; diçka që të ngjall frikë ose që sjell fatkeqësi; poterë

Qefissa
(*tyke qarë*)

Ah, e mjera unë, më shkoj zonja ime ! O Hefestion[1] psé s' më shigjetove me rrufetë t' ënde të zjarta përpara se të harrinj këtë ditë !

Pirrua

Andromakë ah, folë, ngushëllomë të mjerin mua !

Andromaka
(*tyke levizur nga pakë*)

Ah ..... sa ..... jam ..... e ..... mjerë !

Pirrua
(*si i dalë mentsh*)

O, folë, folë të dëgjonj edhé një herë zërin t'ënt të ëmbël ! Ngjallu për mua, Andromakë, mos më lerë në këtë dëshprim. Të betohem që do t' a marr shumë shtrenjt gjakun t' ënt !

Qefissa

O Perëndí e Perëndesha e gjithë sa jini, bëni një mrekulli për zonjën t'eme e në vent të saj merrni, në daçi shpirtin t' em!

Foenix
(*tyke parë damarin e Andromakës)*

Madhní, këjo është plagosur shumë rëndë, nuk ka shpëtim.

[1]Hefestion = Efes, Perëndia mythologjike e zjarrit e e mjeshtrive

Pirrua
(*fort i trëmbur*)

Si? Nuk shpëton? Oh, i mjeri unë! (*Zé kryet me të dy duart*).

Andromaka
(*me zê të përvajshme*)

Mbret ..... urdhro ..... të ..... më ..... bijen ..... këtu ..... djalin .....t'em ..... t'a ..... shoh ..... për ..... të ..... fundit ..... herë !

Pirrua
(*Qefissës*)

Shpejt, Qefissë, bjere Astyanaxin këtu, bjere shpejt.

Andromaka
(*Qefissës*)

Ndalu ..... pak ..... Qefissë.

Qefissa

Urdhro, zonja ime.

Andromaka

Po ..... vdes ..... mos ..... u largo !

Pirrua
(*me zê të ngashëruar*)

Jo Andromakë, nuk do vdeç, do të ngjallesh për mua!

Andromaka

Mbret ..... i ..... Epirit ..... po ..... vdes ! ..... Bëhu ..... babë ..... për ..... djalin ..... t' em ! ..... Ah ! ..... mbamë ..... porositë ..... (*Qefissës*) Ti ..... e dashura ..... Qefissë ..... tregohu ..... nënë ..... për ..... t' em ..... bir ..... Ah ! ..... bi i i i i ri ..... im ! (*rzohet e vdekur. Foenix e Qefissa e mbajnë)*.

Foenix

(*tyke nxjerë krenaren*)

Vdiq ! (*Pirrua e ushtarët të gjithë si edhé populli nxjerrin krenaret e kësulet e tyre)*

Pirrua

(*tyke rënë më gjunjë*)

Ah, Andromakë, Andromakë, sa fort më plagose zembrën ! Sa më fike shpirtin ! Ah, sa i mjerë jam pa ty !....Foenix, çohu e shko shih djalin, Astyanaxin t' em edhé jep urdhër të ruhen mirë Oresti edhé robët e tjerë Grekë. Ndaloni ikjen e anijeve të tyre, ruani limanin. Ah, tani do shohin ata këtë krahun t' em sa i rëndë do bjerë mbi 'ta ! Oh, sa i lumur isha e sa i mjerë jam ! A jetohet kështu ? (*ngreh duart përpjetë e e sheh me sŷ dëshpërimi*). Ah, Andromakë, Andromakë!

(BIJE NAPA)

FUNT I AKTIT V. E I TRAGJEDISË

KRISTO FLOQI

_____

KARLLO TOPIJA

Dramë kombëtare

Në 5 Akte

VLORË
Shtypëshkonja • Vlora • G. Direttere
1923

PERSONAT E DRAMËS

TANUSH TOPIJA	- KRYEZOT I MATJES
NDREK[1] TOPIJA	- I BIR' I TIJ
IRENA	- E SHOQ' E NDREK TOPIJES, E BIJ' E ROBERTIT
ROBERT GUISKARDI	- MBRET I NAPLIT E SIÇILJES
ELISABETA	- E SHOQ' E TIJA.
KARLO TOPIJA	- I BIRI I NDREKËS E IRENËS
GJERGJ TOPIJA	- I BIRI I NDREKËS E IRENËS
MARK LALA	- MIKU I NDREK TOPISË.
RROK GJULI	- BAJRAKTAR PREJ KRUJE
GJERGJ BALLÇA	- PRINC I SHKODRËS.
KATERINA	- E MOTR' E TIJA
ZEF GJONI	- PRIJËS I USHTRISË MATJANE.
TEF MUZAKA	- RROGTAR I ROBERTIT, PASTAJ MËKËMBËSI I PRINCESËS ELENËS TË DURRËSIT

Tre shërbëtorë (valêtë[2] të Robertit).
Populll, ushtarë, shtijëtarë, bajraktarë e parësi.

[1] Ndrek = Andrea (në dialektin Geg)
[2] Valetë = roje personale (shoqërues)

Të ndarit e sqenavet

Akti i I.	Në Napël.	Në pallas të Rorbert Guiskardit
Akti i II.	Në Shkodër.	Në pallas të Ballçavet.
Akti i III.	Në Krujë	Në pallas të Topejve.
Akti i IV.	Në Krujë	Në pallas të Topejve.
Akti i V.	Në Durrës.	Në pallas të Elenës së 'I'arantit.

Ngjarjet në vjetet 1328 - 1349 .

Të drejtat e auktorit reservohen
Drama nuk çfaqet pa lejen e auktorit,

Dy fjalë këndonjësvet

Mbas mirëpritjes që pati drama ime e parë Fé e Kombësi prej popullit Shqipëtar, trajtova dramën e dytë e origjinale Karllo Topija në 5 akte, të cilën sot po e botonj. Këjo dramë shkruar qysh më 1916 në poesi pastaj edhè në prozë u çfaq shumë herë edhè me sukses, të plottë prej grupit theatral të shoqërisë "Vllaznija" në Shkodër, tyke lënë edhè sot kujtime të mjafta e të pa-harruara.

Janë disa sende të historisë s'onë kombëtare që populli ynë nuk i di, ose nuk i ka kënduar. Disa prapë prej masës intelektuale s'onës, sado që i kanë përshkuar, s'u kanë dhënë rëndësinë që duhet, ose i kanë sajuar për të huaja, si kurse Ballçajt e Shkodrës, tyke kujtuar se i përkasin historisë Serbo-Kroate, si kur se Karllo Topînë e veprat e tija, tyke i numuruar për vepra normane ose angoane, me gjithë që si Ballçat si Topîjat janë fisit e gjakut të kulluar shqipëtar, me gjithë që Karllo Tapîja ish ajy që krreu jashtë Shqipërisë të huajt e e zmadhoj qysh prej bregut jugor të Dallmacisë e gjer te lumi Ahellôos ose Aspropotamos në provincën e Akarnanisë të Greqisë së sotme. Këto nuk duhej të liheshin në harresë e të dënoheshin për vdekje. Populli ynë duhet të dijë e të njohë se, përveç Filipëve, Lekëve, Bardhyllëve, Agronëve e Teutës, Gjençëve, Pirrove, etj. etj. të kohës para Krishtit e të Skënderbeut të math pas Krishtit ka edhè disa mbretë, ose burra të tjerë kryetarë të tij si Topejt, Arianitët, Muzhakajt, Gropajt, Bue-Shpatat, Loshajt etj. etj. me të cilët duhet të shkëlqenjë historija e kombit t'onë, një prej të cilëve edhè ndofta më i madhi ish Karllo Topîja i nipi i të famshmit Tanush Topisë, Matjan prej fisi.

Ky ka qënë pikërisht qellimi i kësaj drame. S'ka dyshim se shumica e popullit sendet më me rëndësi i mson më fort prej gojëdhënjevet e prej të çfaquravet nga sqena, se sa tyke kënduar historin'e tij, të cilën s'e këndon kurrë. Kjo dramë sa do që munt të këtë shumë të meta në pikpamjen dramatollogjike e sqenare, ka këtë të mirë që, bazohet mbi disa argumenta të vërteta historike, pra edhè kritikimi i saj si do qoftë, është kurdoherë për fitimin e dramatollogjisë kombëtare.

Kr. Floqi

Subjekti i dramës

Robert Guiskardi, mbreti i Naplit e i Aragonës, mbassi nuk e shtivi Durrësin në dorë me fuqi e me të holla, dinakërisht martoj të bijën e tij Irenën me Ndrek Topinë, të birin e Tanushit, kryezotit të Matit, kështu që me anë të krushqisë e të miqësisë të mundet të shkelë Shqipërinë. Si nuk mundi të. përmbushë qellimet e tij, pas disa vjetsh mentohet të farronjë shtëpin' e Topejve për me shkatërue këso doret fuqin' e Shqipëtarëvet e prandaj fton në gosti të dhëndrin me të bijën me të dy djemt' e tyre Karllin e Gjergjin edhè cok atë natën e parë i therr që të dy në gjum' e sipër e kërkon të therrë edhè të dy djemtë. Po, Mark Lala, kujdestari i fëmijve e i rritur prej Tanush Topisë i shpëton djemtë tyke i sjellë në Shqipëri, ku për shumë vjete jeton i pa njojtur si rrogtar në pallasin e Ballçës në Shkodrë, tyke ndryshuar edhè embrin e tij e të Karllit prej frikës të spiunëve të Robertit. Kur merr vesh ky Mark Lala se Tanush Topija gjendet në orën e fundit breth në Krujë e ja paraqit të dy djemtë në një kohë që Tanushi kujtonte se vdes pa lënë një trashgimtar. Tanushi ahere vdes i lumur, tyke ju lënë porosi djemvet që lipset të marrin gjakun e prindve të tyre.

Pas vdekjes së Tanushit edhè mbasi luftoj kundra Serbëve e i mundi, Karllo Topija kurrëzohet prej popullit si mbret i Shqipërisë edhè fiton sympathin' e plottë të kombit. Robert Guiskardi, tyke parë se Karlli u bë mbret i fuqishëm edhè munt kësodoret të hynte edhè ky në rrezik, me shumë mjete bint princ Gjergj Ballçën e Shkodrës e kështu, të bashkuar msynë rrebtësisht mbi Karllin, i cili i shtërnguar përdoroj gjithë fuqinë e Shqipërisë së mesme e jugore e i theu që të dy armiqtë tyke i zënë që të dy prijësit si robër lufte. Prej këtyre Roberti vritet me urdhrin e Karllit i cili kështu u merr gjakun e prindvet e Gjergj Ballça jo vetëm falet po edhè bashkohet me Karllin nënë flamurin e tij, tyke i dhënë edhè të motrën e tij pincesën Katerinën për grua, me të cilën Karlli njihet qysh se ishte rojtari i saj në Shkodër, pa ditur veten e tija i biri i kujt ishte. Kështu Karlli bashkon gjithë Shqipërinë nënë flamurin e vet, tyke krijuar një fuqi të madhe e të duruëshme, e cila lojti roll të math në historinë, tyke qënë mneri i

fqinjëve Serbokroatë, Normanë, Tarantinë etj. etj. po edhè i Venetikasvet akoma.

Akt i I

(Një sallë në pallas të Robertit në Napël)

SQEN' e I-rë

Ndreka e Irena

NDREKA

Pasha Zotin, lrenë. shum' i bukur është ky qytet i Napolit! Natyra i ka shpërndarë këtu gjithë bukurit' e saja;· qielli i kalltërt, deti i kulluar e i qetë, kopshte e ullishta të begatshme, kodra e bjeshka të hieshme e blerim an' e kant malet rreth e rrotull të veshura me shelgje plot gjethe, që endin gjithëmonë lule e pemë që zërdëllijnë ; oh sa e madhe stoli! Kujtonj se jam në parajsën e vërtetë! Më anën tjetër Vesûvi i naltë e *Pompêja* e famëshme, *Vomer'* i bukur e *Sorentua* e kandëshme sa shije e bukuri i shtojnë këtij vendi, sa më vje n të jetonj këtu gjithënjë, i larguar nga poterat e andrallat e tjera ! Sa ndryshim ka ky vent i bekuar me ato vendet t' ona të bukura vërtet po jo të punuara e të goditura si këto ! Po. ah, o Irenë, gjithë këto sqime, gjithë kjo parajsë e vërtetë, nuk ka si krahësohet me ty, me ty. o Irenë, që je thesari me i math e me i vlefshëm për mua se sa giithë shtolit' e botës !

IRENA

Vërtet i bukur është atdheu im, o Ndrekë i dashur, por atdheu yt përtej atij Adriatikut, atdheu i fatit t' em, që aq' e dua dhe e adhuronj, ka për mua më tepër vleftë e bukuri se sa bukuritë që përmende. Dheu i burrave kreshnikë, që nuk njohin frikë e trembje, ajo toka atje arbnore që ka lin dur trima e drangona, rrufè qielli e të flakta shkëndija, që i njeh e i dron gjithë bota, për mua, po thom,

ka një rëndësi me të madhe! Me ju u lidha e me ju dua të rronj, ose të vdes. Jam gruaja jote e dhe krenohem se jam Shqipëtare!

NDREKA

Oh, sa i lumur jam që po dëgjoni këto fjalë! Folë, folë, o Irenë, zbraze mjaltën që po vershon nga buzët e tua, si bleta kur e derth në zgjojin e saj. Ah, sa më ngushëllojnë ato të bukura fjalë ! Mbësomë, o Irena ime, se, sado që kaluan kaqe vjete qysh se u martuam, mua s'më duken as një orë, e kur flet ti, kujtonj se shoh një ëngjëll gojë-artë që nuk di qysh t' a adhuronj !

IRENA

Edhe unë s'di si të t'a tregoni dashurinë që ndjen zembra ime për ty, o i dashur burrë. Dita ditën më vjen se kjo dashuri shtohet dhe nuk gjenj fjalë të mjafta t'i falem Zotit që më dhuroj një shok të këtillë. As *Drini* e *Shkumbini* as *Vjosa* e *Devolli* nuk m'a shuajn dot këtë flagë qo ndjejnë për ty krahrorët e mij. E Ektorit e ralla grua Andromaka, nuk mbesonj t'a desh më tepër të shoqin, se sa Irena jote ty. A munt të numurohen hyjet e qiellit? A munt të sajohet rana e detit? Aqë munt të njehen të rahurat e zembrës s'ime për ty !

NDREKA

Të jam falur e Zotit të matih i jam true për këtë lumëri. E pra, në këtë gostë që jemi· thirur, mentonj sa do gëzohen edhe prindët e tu, mbreti Roberti e mbretëresha Elisabeta. Do shohin sa bukur shkojmë e do fatmirojnë bijën e vetëm të tyre, që me aqe llastime e përgëdhëlime e kanë ritur. Po, nuk të pyeta, ku i lè djemthit t'cnë Karllin edhe Gjergjin?

IRENA

Gjyshrit kur shohin nipat e tyre, ndjejnë një kënaqësi shpirti të posaçme, ndofta më të madhe se kur shohin të bijte tyre. Pra, i dashuri im, nëna ime, mbretëresha, qysh se i pa djemtë nuk ju ndahet, as minutën, po me 'ta bashkë

po shetit kopshtin, tyke lënë më nj'anë ç'do punë tjetër. S'rëfehet dashuri, e saj për ata.

NDREKA

Shpirtmira nënë ! A e di sa e dua edhe unë, o Irenë ? Për nder po të them se e dua si nënën t'eme. Ti fort mirë e ke msuar që unë u rita pa nënë, se më vdiq e mjera që voglijet; prandaj në vënt të asaj këtë kam nënë. Po edhe mbretin, babën t'ënt e dua me gjithë zembër, si kur se edhe t'im atë Tanushin. Po, le t'i lemi tash për tash këto fjalë, o Irenë e dashur, edhe po të duash, shkojmë edhe ne të shetitim në kopshtin e të dëfrejmë.

IRENA

Gruaja jote, si grua shqiptare, është gati të shkonjë ku t'a urdhëronjë burri. Vemë ku të duash. (*Zihen për krahu e dalin*).

SQEN' e II-të

Roberti Elisabeta

ROBERTI

Vërtet duhet të gëzohemi me djemt' e nipat që n'a ardhë. Tani me këtë rast. po të kujtonj edhe një gjë tjetër. A e mban ment kur më kundrështonje ti tjetër herë për këtë farë krushqije ? A mban ment që s'e gjenje të drejtë bashkimin e Irenës me Ndrekën ?

ELISABETA

Po, ke të drejtë. Po unë kujtonja ahere, se Shqiptarët, si njerës të trashë e malsorë, grat' e veta i përdorin si robnesha. aq sa ato dridhen përpara burrave të tyre. Po tani që shoh se sa mirë shkojnë Irena me Ndrekën e sa e nderon njëri

tjetrin, zembra më mbushet me gëzim e jam e lumur për këtë lumërin' e pashoqtë që ka sot ime bijë.

ROBERTI

Ashtu është, po unë t'a kam fjalën ngjetkë. Të kam thënë edhe tjetër herë që ka qënë një nevojë pa u bë kjo krushqi. Shqiptarët vërtet janë njerës të egër e të trashë, si the, po janë edhe burra burrash. Këtë të drejtë të mos ja u hamë. Ne me keta nuk e nxjerim mb' anë, sa do të fortë të jemi. Shëmbllë lè të jenë provat e hidhura që më kanë dhënë sa herë jam ndeshur me këta në luftë, kur kam dashur të ve këmbë n'atë bregun tej Adriatikut për atë të shkretin Durrës. Pra, ti ahere mentonje si grua e s'e pëlqenje atë krushqi, po unë që mentohesha si një mbret Norman, si një Angoan, që desha te xgjeronj mbretërinë t'eme, kujtonj se bëra mirë me këtë krushqi që e mbarova. E merr vesh tani ç'dua të them? Desha me anë të kësaj krushqije të xgjeronja mbretërin t'eme.

ELISABETA

Ç'farë zgjerimi munt të presim ne prej kësaj krushqije?

ROBERTI

Ç' farë zgjerimi ? Ah, sa më vjen keq që s' e kupëton ! Po ti nuk e di qëllimln e math që kam ushqyer për atë Durrës? Shpresa ime ëndra ime gjith'ajy Durrës ka qenë. Kurrë s'kam qënë i qetë, as do të jem gjer sa t'a shtije në dorë. Ti s'e di sa rëndësi të madhe që ka pasur ajy qytet për mest shekujve. Merr e këndo historinë e do të shohësh që Durrësi, *Epidhamni* i vjetër ka qënë *molla e grindjes* si për Grekë e Romanë e Byzantinë, si për Venetikas e popuj të tjerë. Ashtu edhe për mua, si mbret i Naplit e i Aragonës, si Norman i dëgjuar, ky qytet ka një vleftë të veçantë, se dua të kem dy seli, një në Perëndim e një në Lindje, si tjetër herë Romanët që kishin Romën e Byzantin Tani a i sjell ndër ment sa pengime kam gjetur unë prej atyre Shqipëtarvet për Durrësin, edhe më

fort prej krushkut t'onë Tanush Topisë ? A i njeh ti Topejt? Mos haro se këta janë shtërnipët e Filipit e të Lekës, të Bardhylit e të Gjençit, t'Agronit e të Teutës, të Pirros e të Persit.

ELISABETA

Mirë, mirë, po Durrësin, që po thua, Ulqinin e Tivarin sa herë i kanë zaptuar Venetikasit !

ROBERTI

Me trimri? Jo, kurrë, përveç se me dukata ! Shqiptarët mos kujto se s'e dijnë interesin e tyre, se edhe të holla pa masë merrnin prej Venecianëve edhe shokë e aleatë i kishin kundra armiqve të tyre. Po, mjerisht sot nuk e gënjen më Shqiptarin. Qe, pra shkaku që e bëmë këtë krushqi, do me thënë atë që s'e fituam dot me trimëri, ose me pare, t' a fitojmë me dhelpëri e me dredhime. Tani, kujtonj se më kupëtove ç' dua të them.

ELISABETA

Po, po e kupëtonj; kè të drejtë edhe Zoti t'i mbaroftë qellimet.

ROBERTI

Gëzohem fort që më more vesh te e mbramja, edhe dëshironj që edhe ti si mbretëreshë që je e si ime shoqe të më ndihmosh gjer sa t'a qitim në skaj këtë qellim. Kështu pra, edhe ti do mundohesh t' a bindësh t' ët dhëndër që të lidhë aliancë me mua gjer sa të shtije këmbën në Durrës; punën tjetër m' a lerë mua, se mbas Durrësit nuk është pun' e madhe të ve në dorë gjithë zallet e tjera të Shqipërisë.

ELISABETA

A e pe sa mirë ka shkuar Irena jonë në shtëpi të Topejvet?

ROBERTI

(*Me zembrim*)

Ç' të thom unë e ç' më thua ti ! Po, edhe si shërbëtore të rronte ime bijë ne ata, unë s'do të ankohesha aspak ; për mua është mjaft të shtije Durrësin në

dorë. Po tanithi nuk është koha të bëjmë kësij fjalësh. Ti duhet t'i marresh me të mirë e t' i kënaqësh që të dy, që kur të fillonj unë t'ju përment lidhjen e bashkimin që duhet të bëjnë me ne, t' a kemi rrugën të pregatitur. Tjetër s' po të thom, veç se kij mendjen.

ELISABETA

Qetsohu, burri im; do të vepëronj si pas dëshirës s' ate. (*Dëgjohen jashtazi Ndreka me Irenën që po vijnë*). Më duket se ata janë; po vijnë; lè të ndrojmë fjalë, punën e more vesh.

SQEN' e III-të

Të parët, Ndreka e Irena

NDREKA me **IRENËN**

Mirë se ju gjejmë, o prindër të dashur.

ROBERTI me **ELISABETËN**

Mirë se urdhruat që të dy.

NDREKA

Kemi qënë në kopsht, tyke shetitur me Irenën e fëmijët.

IRENA

Burrit t' im fort i pëlqen Napli e për atë po më fjalon gjithënjë.

ROBERTI

Vërtet ashtu është. Kush do që vjen këtu mbetet i habitur me natyrën e bukur e me begatitë e këtij vendi. Për këto edhe me mbretëreshën po fjalonim

gjer tani, që gjithë këta vende të kandëshmë e gjithë këto bukuri, këtë pasuri e këta thesare që po shihni gjithë ju do t' i trashëgoni.

ELISABETA

Si e dini, lum Ndreka, nevej s' na fali Zoti tjetër fëmijë përveç Irenës edhe mbassi n' a dha perëndija edhe një bir si ty, ësht' e ditur se ju të dy edhe fëmija juaj do jenë trashëgimtarët e këtij vendi, e kësaj mbretërije, pas vdekjes s'onë.

NDREKA

Ju falemi nderit tepër për dashurinë që n' a rëfeni e nuku dijmë si t' ja u shpërblejmë.

ROBERTI

Ndreka im, o bir i dashur, ti e di se s'është mjaft vetëm t' a ketë njeriu këtë mbretëri e të gëzohet. Sot që jemi edhe të rethuar me armiqë nuk lipset të flemë mbi trëndafilet. Më duket, se si jemi ne ashtu edhe ju jini, e me qenë se, si rreziku, si interesat t' ona janë të përbashkëta, për me u sigurue edhe njëri edhe tjetri duhet të jemi të bashkuar, duhet të bashkojmë që të dy fuqitë; duhet të lidhim një besë të atillë me shoqi shoqin, sa jo vetëm të mbajmë vendet që kemi po edhe t' i shtojmë.

NDREKA

Fort i bukur e i pëlqyer mendim i juaj, i dashuri âtë. Mirë kishte me qënë që këto të dyja seli, Aragona dhe Shqipëria të lidheshin me një bashkim të plotë, por mjerisht sot është tepër von për një aliancë të këtillë, se pse bajraqet e fiset e Shqipërisë janë lidhur sot për sot nër vehte për një Shqipëri të madhe edhe kujtonj se, si janë punët, nuk ju hynj dot në vleftë, se si Shqipëtar nuk munt të çart besën që dhashë e më vjen keq se po ja u thom.

ROBERTI

(*Tyke fshehur hidhërimin*)

Shpesherë këtë gjë edhe t' yt ati princ Tanushit ja lypa edhe përpara se ju të lidhnit këtë besë që po thoni, po krushku im kësaj çështje s'i ka dhënë as një rëndësi kur se Elena, e vehja e princ Filipit të Tarantit edhe sot është sunduëse e atij Durrësit atje, e lidhur në besë me ju. Këjo është një e huaj e jo Shqipëtare e kështu vetëm vjehri yt Roberti mbetet jashtë këtij bashkimi, i përmbuzur e i fyer !

NDREKA

Lark qoftë nesh e Zoti mos e premtoftë të përbuzet kush nga ana jonë! Princ Filipi ka qendruar atje qysh n' atë kohë që Shqipërija ka qënë e ngatëruar në luftë e mbasi ky ju ndihmoj tepër krezotëve t' onë si me të holla, si me fuqi e me qënë se vdiq, ishte detyra jonë t' a mbanim të shoqen, një grua të shkretë e të pa fuqishme; e kur këjo ndejti me ne e n'a lëshoj gjithë sundimin në dorë edhe ç' do tjetër që trashëgoj nga i shoqi, ne si munt t' a qitnim jashtë Shqipërisë një grua kaqe bujare ? Te e mbramja Elena nuk është sundimtarja e Durrësit, po ne, edhe titullin që ka e ka vetëm një titull nderi.

ELISABETA

(*Irenës*)

Ti bija ime ç' thua për këtë lidhni që po flet yt shoq ?

IRENA

Unë nuk përzjehem në punët e burrave e dashura nënë.

ROBERTI

(*Irenës*)

Një nuse, ose një grua mbaron shumë punë pranë vjehrit, ose burrit të saj, po të dojë.

IRENA
(*Robertit*)

Jam një gjymtyrë e shtëpisë së Topejve, o baba im, pra është e ditur se nuk munt të ndahem prej atyre; prej meje mos kij as një shpresë; unë s' munt të flas as një tjalë.

ROBERTI
(*Tyke kafshuar buzët*)

Ç' ka moj bija ime, lè t' i lemë këto fjalë tani për tani, se nuk na prishet edhe ndo një punë. Kemi kohë kur t'i fjalosim për këto. Tash është kohë dëfrimi. (*Elisabetës*). Eni, mbretëreshë, shetitni gjithë bashkë ku të jëtë më mirë gjer sa të afrohet darka.

ELISABETA
(*Ndrekës e Irenë*s)

Shkojmë të dashurit e mij, të gjejmë edhe fëmijën e të shëtitin pak qytetin. (*fillojnë të dalin*).

IRENA

Po ti nuk vjen me ne baba im ? Roberti. (*Tyke nëneqeshur*). Kam disa punë të Shtetit, andaj po ndalem këtu, bija ime; mua më falni, pa tjetër herë dalim bashkë.

IRENA me **NDREKËN**
(*Robertit*)

Lamtumirë, o atë.

ROBERTI

Udhën e mbarë (*Irena, Ndreka, Elisabeta dali*n).

SQEN' e IV-të

ROBERTI
(*vetëm*).

Kanë lidhur besë për një Shqipëri të madhe ! Ha, ha ha! Edhe Shqiptari besën nuk e çart kurrë; edhe nga ana tjetër princesa Elena e Tarantit po sundon edhe sot .Durrësin e dhëndri im do të më shesë mua dokra ! Po edhe kjo bija ime Irena tani e mora vesh se qënka një gjymtyrë e shtëpisë Topejve e s'u përzjeka as pak në· punët e burravet ! Kështu pra po merret vesh se kot qënkam munduar për këtë krushqi të dobët që bëra me këta ! (*Si sillet pakë*). Po ç'ka, nuk duhet të dëshpërohemi. Puna munt të dalë edhe ndryshe. (*Tyke u ergësuar*). Po, jo, jo ! Këjo përbuzje e poshtër faqe një mbreti nuk durohet ! Duhet shpërblim. shpërblim, po, duhet shpërblim! (*Tuke u sjellë prapë*). Hej, more Tanush Topija, more kryezot i Matjes, që gjithmonë je tallur me mua ! Tani ke për të parë se kush është Robert Guiskardi ! Nuk është dhëndër; jo, ky i pabesë as t' ime bije nuk e dua më t' a shoh me sy ! Të gjithë janë kundra meje ! (*Me një ironi*). Mbesoj i shkreti Ndrekë se vërtet do trashëgonte gjithë këtë mbretri, pse e bëra dhëndër. Sa është i gënjyer ! Ah, more horr horri, kur ke sy e faqe ti për këta vende ! Mjaftojnë për ju ca shkëmbënj e ripa të thatë, mjaftojnë për ju currat e shkrepat e ranishtet që kini ne atë Shqipëri të shkretë atje. O shtëpi e Topejt e mallkuar, që gjithëmonë kè qënë një pengim i qëllimeve të mija, shuhu e farrohu, shduku, po thom e çkatërohu me gjithë ç' ke !

SQEN' e V-të

Roberti, Tef Muzaka

TEF MUZAKA

Madhni, tryeza është gati edhe të gjithë janë shtruar. Madhëni e saj mbretëresha ju lutet të urdhëroni. (*Saluton*).

ROBERTI
(*Tyke fshehur hidhrimin*)

Të gjithë kanë ardhur ?

MUZAKA

Po, madhni, pëveç madhënisë tuaj.

ROBERTI

Ç'ka, lè t'a mbarojmë edhè këtë detyrë (*del*).

SQEN' e VI-të
Muzaka e Mark Lala

MUZAKA
(*vetëm*).

Ah, për një të shkretë rrogë po gjendem mjerisht edhè në këtë vent të huaj të Latinit, larguar prej Shqipërisë së dashur ! Edhe se mos jam i kënaqur? A thua se ndjenj një kënaqësi tyke i shërbyer një tirani? Qoftë i mallkuar ajy që lè vendin e vet e ju shërben të huajvet ! Mallkimi i atdheut më ndjek këmba-këmbës e s' kam as prehje, as qetësi ! A thua se do të agonjë dikur ajo dita e lumur, dita fatbardhë që të shoh edhe një herë Shqipërinë t' ime ? A do munt t'i thyenj këta vargonj të dobët e të vështirë që më ndalojnë këtu ? Ah, të shkelnja edhe një herë në Shqipëri, t' a puthnja edhe një herë atë tokën arbnore, të bashkohësha edhe një hërë me vëllezërit e mij, t' a rroknja edhe një herë shpatën mizore për nder e lavdë të vendit t'em, pastaj lè të vdisnja, nuk do më vinte keq. Ah i mjeri unë, ah, mëkat të math që kam bërë! (*Vè kryet në të dy duart e qan*). Mark Lala (*Tyke hyrë*).

MARKU

Mirë mbrëma, brè burrë.

MUZAKA
(*Tyke fshirë lotët*)

Mirë se vjen Mark Lala, eja urdhra.

MARKU
(*Tyke ndenjur*)

Hè, si ke shkuar, miku im, a të ka marrë malli për Shqipërinë ?

MUZAKA

Besa po s'rëfehet, o vllathi im, malli që kam për atdhenë. Ti do kthehesh prapë në Shqipëri e do hasesh me shokët e me miqtë, do shohç edhe një herë ato kodrat e bukura e fushat gjelbërore, po un' i shkreti që jam dënuar të ri këtu, a menton sa i mjerë jam? A e ndjen këtë dhembjen t' ime ?

MARKU

Me t' ët zot si ja çon, a je i kënaqur ?

MUZAKA
(*I pikëlluar*)

Ah. mos e folë atë fjalë edhe një herë! Un' e di e shpirti im si shkonj këtu, po s'ka ardhur edhe ajo e bardha ditë që t'i thom këtij vendi "lamtumirë"!

MARKU

Psè, a shkon keq ?

MUZAKA

Mos e pyet ! Mjerisht këtu nuk është vendi të të zbras barkun, se kanë edhe muret veshë. Do të flasim më von. Po, nuk të pyeta, a ke ngrënë bukë?

MARKU

Jo, për Zotin edhe turp më vjen të them se më shoj urija.

MUZAKA

Ahere eja të hamë bashkë e pastaj fjalojmë.(*Dalin të dy*)

SQEN' e VII-të

Roberti, Elisabeta, Ndreka, Irena, një shërbëtor

ROBERTI

(*Tyke hyrë i pari*)

Le të fjalojmë pak këtu në sallë gjër sa të pregatiten shtratet për të fjetur. (*Unjen e rijnë të gjithë*).

ELISABETA

(*Ndrekës e Irenës*)

A mbettë të kënaqur prej kësaj dite ?

NDREKA

Pa masë munt t' ju thom, e dashura nënë. Kurrë s'i kam për të harruar bukuritë e këtij qyteti, edhè me vjen keq se do qëndrojmë vetëm pak dit këtu. Ç'të shohë njeriu më parë ? Të gjitha duken si kur i ka krijuar vetë dor'e Zotit.

IRENA

Qysh nesër do fillojmë të shetitim edhe gjithë zallet e Naplit që të. shohë im shoq edhè bukurit' e detit. (*Hyn një sherbëtor*).

SHËRBËTORI

(*Tyke salutuar, Robertit*).

Madhni, të gjitha dhomat janë gati. Shtratet gjithashtu janë të goditura mirë. (*Shërbëtori. saluton e de*l).

ROBERTI

(*Ndrekës e Irenës*)

Kujtonj tani se ardhi ora e gjumit edhè lipset të ndahemi e të flemë. (*Tyke përshëndetur Ndrekën e Irenën*) Të dashurit e mij ju munt të shkoni në dhomën t' uaj të qetësohi, se jini të lodhur.

ELISABETA

Nesër gjithë dita prapë jona është. Do shetitim e do dëfrejmë edhè më tepër. Bëfshi natën e mirë.

NDREKA

Vërtet ora është. Natën e mirë. (*E merr Irenën për krahu*).

IRENA

(*Tyke qeshur*)

Natën, e mirë. (*Dalin të d*y).

ROBERTI

(*Elisabetës*)

Karllin e Gjergjin a i vure të flenë ?

ELISABETA

Ata si fëmijë po flenë qysh herët afër odës s' onë. Si të duken fëmija? Shumë janë të dashur e të shkathët.

ROBERTI

Pa dyshim.

ELISABETA

Si duket, Shqipërija qënka një vent i shëndoshë, se edhe fëmija edhè Irena janë mjaft të shëndoshë nga trupi e të bardh' e të kuq. Dëshëronj edhè unë të vete t' a shoh një herë Shqipërinë.

ROBERTI

Po, po do të vesh t' a shosh Shqipërinë, mos kij merak, po tani do bënje mirë të vinje në krevat t' ënt e të flinje, se kaloj koha.

ELISABETA

Ti nuk do shkosh të flesh ?

ROBERTI

Unë do rri pak këtu për të sheshtuar ca punë pastaj do shkonj.

ELISABETA

Tani është natë nuk punohet. Nesër ke kohë, po eja.

ROBERTI

Ç' ka. Kur do ti lè të mbeten punët për nesër.

ELISABETA

Më rrofsh, që s' m' a prishe qefin. (*Zijen për dore e dali*n)

SQEN' e VIII-të

Të tre Shërbëtorët

SHËRBËTORI i I

(*Tyke shkundur fron*at)

Sonte mbesonj të hamë mjaft mirë.

SHËRBËTORI i II

Edhe unë ashtu kujtonj, i qofsha falë nderit Zotit.

SHËRBËTORI i III

Thuaj më mirë shtektarëve, ose dhëndurëvët.

SHËRBËTORI i I

Tamam; mir' e ke ti. Shtektarët mos n' a mungofshin, se nga shkaku i atyre mbushim edhè ne barkun mirë.

SHËRBËTORI i II

(*Tyke spastruar*)

Si ju duket princ Ndreka, o shokë ?

SHËRBËTORI i III

Mjaft i mirë burrë, shoqin s' e ka.

SHËRBËTORI i I

(T*yke ujdisur fronat*)

Për princesën Irenë, kujtonj se nuk e kishte ky sërën.

SHËRBËTORI i II
(*Tyke fshirë*)

Ah, mor vlla, e ç'nuku bën dashurija !

SHËRBËTORI i III

Po mbret Roberti si ja dha kështu pa një pa dy ?

SHËRBËTORI i I

Ja dha pse ja dha. Kishte tjetër·qellim pa ndryshe s' ja jepte.

SHËRBËTORI i I e II

Pa n' a trego të lutemi.

SHËRBËTORI i I

Nuk i dijni ju qëllimet e Robert Guiskardit mbi Durrsin ?

SHËRBËTORI i I e II

Pa folë, folë.

SHËRBËTORI i I

Mbasi nuk e shtiri në dorë me fuqi; u zu pas dhelpërije edhè bëri këtë krushqi që të mundë lehtas t' a zaptojë atë qytet.

SHËRBËTORI i I e II

Vërtet ?

SHËRBËTORI i I

Vërtet, vërtet, po më duket se do bëjmë mirë të mos flasim për kësij punësh këtu. Ju a mbaruat punë ?

SHËRBËTORI i I e II

Po. po.

SHËRBËTORI i I

Ahere shkojmë në odën t' eme e e mbarojmë fjalën.

SHËRBËTORI i I e II

Shkojmë. (*Dalin të gjithë*).

SQEN' e IX-të

ROBERTI

(*Vetëm, tyke hyrë me robat e natës)*

Flenë të gjithë ! Zë gjëkunt s' dëgjohet. Gjithë kush qetsohet mbi shtratin e vet edhè vetëm unë, un' i mjeri vetëm po vegonj ! Kot po përpiqem t'a çporr ankthin që po më shtyp krahrorin; kot po mundohem t' a harronj dhunën që pësova ! Kaluan plot 6 vjet qysh se e dhashë t' ime bijë në këta horra; qëllimi im s' u mbarua dhe tani po shoh se paskam qënë i rrejtun! Durrësin jo vetëm s'e vura në dorë, po u armiqësova edhè më tepër me Shqipëtarët. Për mua mbaroj ç' do uzdajë ! Flytyroj ç' do shpresë !... He, për Ferrin nuk hiqet më këjo korritje !.Një mbret, një Angoân. të përbuzet në këtë mënyrë është turp ! S' duronj më, u mbush gota, tash lè të derdhet .... Ah, o krushqi e dobët, krushqi e mallkuar që mos të ishte gdhirë ajo ditë që u bë! Shtëpi e Topejve të ishe faruar më mirë,·se sa u ndodhè për të këqijat e mija! Në mos u gjent gjer tani një bolbë a

një poterë për ty, oh, mos u tremp, se do gjendet një dorë që të të shuanjë racën t' ende krejt ! Mbrini dita, o Tanush Topija, që të·shohësh cili jam; sonte, sonte, këtë natë do m' i shpaguash një her'e mirë të gjitha mjerimet që më ke shkaktuar! E kur të dëgjosh gjëmën e madhe që po të pret. kur të shohësh sorrat e zeza të vërviten rreth pullazit t' ënt, kur të shohësh të shkretë vatrën t' ënde, ahere do mendosh më mirë të keqen që më punove !.... Është nata e fundit ! E fundit natë e dëshpërimit t' ëm! Mjaft gjer më sot jam vaditur me farmaqe e me vrere, tani të tjerë lè të helmohen e jo unë ! (*Tyke u egërsuar*). Si kur djajtë të githë të çohen prej fundit të Ferrit, si kur Orrat, Nëma e Vampiri të vërsulen mbi mua nuk kanë si m' a ndalin këtë krah; nuk kanë si të shpëtojnë ! Hakun, hakun dua, të kam në dorë! Qielli si kur të shbërthehet e të më qëllonjë me rrufe të flakta, *Vesûvi* e *Etna* të derdhin llavat shkrumbore mbi mua, s'kanë si më kthejnë nga udha ! .... Dridhu, more Tanush Topija, dridhu, se edhe për pak i lajmë hesapet. Mbaron për ty ç'do punë. As engjejt e Parajsës, as dreqnit e Ferrit nuk të shpëtojnë prej rrezikut ! Edhe ti o Perëndi e Vampirit forcoma këtë krahun t' im, çile Sketerën edhè shtyje natën të mos agonjë dita gjer sa të kryenj qëllimin t' em ! (*Afrohet afër derës së dhomës ku po flenë Ndreka me Irenën, hap derën nga dale edhe përgjon*).

SQEN' e X-të

Roberti, Ndreka me Irenën në gjumë.

ROBERTI

Po flenë! Kush e di se ç' ëndra gëzimit e dëfrimit po shohin! (*Bën disa çape përpara po prapë kthehet*). Psè kthehem? Pse shmangem? Prej kujt trembem? Jo, jo, duhet të mbarojmë sonte. Un' e di sa e madhe e keqe është kjo që do vepëronj, po cmiri e vreri janë më të mbëdhenj se sa gjithë mbretërija ime! Duhet,... duhet ... Shih, pra, o Ndrek Topija ëndrën t'ënde të fundit. (*Nxjerr një thikë prej xhepit*). Në Paradhis, a në Skëterë ku do që të vesh për mua është barabar! Vdis pra ... (*E godit me thikë në parzmë të zembrës*) Që, kështu merret shpërblimi !....

IRENA

(*Çohet e trembur*)

Baba, ti këtu ? Ç'jè kështu ? Ç'do në këtë orë ? (*Tyke i parë thikën*). Po kjo thikë ç'do në duart e tua ? (*Tyke parë Ndrekën të mbytur në gjak*) Po, po, e mjera unë ! Ah, qyqja unë ! (*E tunt Ndrekë*n). Ndrekë, o Ndrekë ! (*Tyke e parë pa shpirt*). Po. po, ç'më gjet ! (*Bërtet*). Ah, gjaksor….ti e ke vrarë! ... Ah, ... t'u thaftë ajo dorë, njeri i pa-shpirtë !

ROBERTI

Pusho .... Hiqu m'at'anë ... Desha pa e vrava !

IRENA

(*Tyke bërtiture tyke millovatur*)

Ah, ty të vraftë Zoti, ç'më bërë ! (*I sulet*).

ROBERTI

Hiqmu qafet, të thashë një herë, se për Zotin ....a për Ferrin edhe ty po të vras .....

IRENA

(*Mundohet t' i marrë thikën*)

Vramë edhe mua, ahere, i pashpirtë .....

ROBERTI

Irenë ! ... Më ngjan se po të tirret edhe ty !

IRENA

Vramë, s'e dua vehten përpara Ndrekës ! (*Gjithë po e shtyn*).

ROBERTI
(*I egërsuar*)

Irenë ! ... E shoh, se t'u rënt jeta !

IRENA

Bjerë, gjaksuer, vramë ... ah, vramë ! . . . (*E shtyn*)

ROBERTI
(*Gati i çartallosur*)

Ahere, ... na . . . edhè ti ! (*E vret*)

IRENA
(*Tyke u rëzuari*)

Ah…. aaah…. Ndre…. kë ! (*Vdes*)

ROBERTI
(*Si i prishur mentsh*)

I vrava ... që të dy ! ... (*Tyke u shmangun*) Kush po flet ? (*I duket një gjë si hije*). Je ti Tanush Topija ? ... O, hiqu mejet ... Se për Ferrin edhè ty ... po të mbys ! (*Tyke kqyrur të vrarët*) I ... vrava! . . . I. . . vra ... ava ! (*I bije thika nga dora edhè zè kryet me të dy duar*t).

FUND I AKTIT I

Akt i II

(Një sallon në pallas te Gjergj Ballçës në Shkodër)

SQEN' e I-rë

MARK LALA

(*Vetëm*).

Heu! si kaluan këto motet e shkreta, tuke lënë në harresë gjithë ndollinat! I shkreti Ndrek Topija me Irenën as nuk përmenden më! Kurrkush s'bën fjalë për tragjedin' e tmerrshme të Naplit; të gjitha i mbuloj moti ! Ehu, o mot' i gjatë shekullar i trishtimevet ! Karllin e Gjergjin gjithkush i di të vrarë prej asaj dorës mizore të atij gjaksorit Robertit. Cili munt të besonjë vallë se këta të dy janë gjallë? Shtëpija kreshnike e Topejvet sot duket se mbaroj e se s'ka kush ja zë këmbën plakut të ngratë Tanushit ! . . Por jo, orè Tanush Topija, se Zoti s'e ka thënë të shkretohet shtëpija jote e të mbetet froni yt pa trashëgimtar ! I qofsha falë asaj bujares mbretëreshë Elisabetës që i shpëtoj që të dy nipat. I kam mbajtë fshehur gjer tani prej spiunëve të Robertit të pa-shpirtë po kam uzdajë se do vinjë dita t'i shohësh e t'i gëzosh ... Ah, po të ngratin Mark Lalën kush vall e kujton ? Sot i pa njojtur, tuke ndryshuar edhe embrin si edhe atë të djemve kam shetitur toka e dete, krejt i harruar e vetëm që të shpëtonj djemt' e mij të dashur, të cilët kujtojnë se më kanë babë edhe të cilët fati m'i besoj në duart e mija. Karllin po e mbajta me vehte, se ashtu ishte puna, po edhe Gjergjin, që e dërgova ne miku im në Ohri, sot shpresonj të kem fatin t'a shoh e të gëzonem me të dy bashkë. Por edhe ti, o Tanush Tapija, qetësohu e bëj ballë, se nuk është lark dita e lume që do t'i shohësh që të dy sokolat e malit e do të harrosh gjithë mjerimet t'ënde. Hè kështu ish thënë prej Zotit !

SQEN' e II-të

Mark Lala e Rrok Gjuli

RROKU

(*Tyke hyrë edhè pa e njojtur Markun*)

Mirë mëngjes, o burr' i dheut.

MARK LALA

(*Gjithashtu*)

Mirë se të pruri Zoti, urdhro unju. Dukesh mjaft i lodhur.

RROKU

(*Tyke ndenjur*)

Të qofsha falë e Zoti të rujtë. Besa mjaft lodhur jam.

MARKU

Për se kini urdhruar, zotni? Jam nënë urdhrin t'uaj.

RROKU

Kam ardhur qysh dje këtu, i dërguar me një dërgatë të posaçme. Shkurt të të thom, miku im, jam i çuem prej Kruje për me lajmue gjithë Krutanët që ndodhen në këto rrethina, që të vijnë sa më parë në Krujë të shifen me princ Tanush Topinë e të dëgjojnë disa porosina prej tij tani sa ësht gjall.

MARKU

(*Me habitje*)

Si ? Qënka sëmurë Tanush Topija ? Folë mirë.

RROKU

Sëmurë fort, besa, edhe kjo besonj të jetë sëmundja e fundit.

MARKU

Pafsh Zotin kaqë liksht qenka sëmurë ?

RROKU

Sa më s' bëhet. Kujtonj se dit e ndajnë prej kësaj jete.

MARKU
(*me hidhërim*)

Mos e folë, brè burrë. Ah, sa më dhimbet i mjeri plak !

RROKU

Njëment është për t'u dhimbur ajy farë burrit, vdekjen e të cilit do t'a qanjë me lott të pikëlluara gjithë Shqipërija !

MARKU
(*Tyke derdhur lote*)

Qyqari i shkretë ! Ah, sa më fike zembrën; ky lajm, besa, tepër më depërtoj!

RROKU

Të falem nderit fort për mirësinë. Vërtet kush e pa e kush e njohu këtë njeri do të përgjërohet. S'ka sy Shqiptari të mos derdhë lot për këtë trim të rrallë, s'ka shpirt të mos mallnjehet. (*Tyke parë Markun që po qan*) Po edhe ti po qan,

brè burrë; për ç'ka i derth këto lotte, si me qënë edhe ti një Krutan, një njeri i brendshëm ?

MARKU

(*i millovatur*)

Krutân jam edhe vetë, brè burrë, po më ka ndryshuar moti sa nuk njihem sot, edhè në qoftë se më sheh që po derth lotte, këto janë një penk, një detyrë faqe një mirëbërësit t'em !

RROKU

(*I habitur*)

Faqe mirëbërësit t' ënt? Pa folë mirë, se këtë zëthin t' ënt me ngjan se diku e kam dëgjuar, po s'e sjell dot ndër mënt.

MARKU

Jam një i vobektë, një rob' i dheut që fati më dënoj të rronj në vendin tem si i huaj e i panjojtur, po sot e shoh që mbrini dita të çel gojën e të flas kush jam. Pra po të them, o vllathi im, se unë jam Marku i Ded Lalës !

RROKU

(*Tepër i habitu*r)

Mark Lala je ti ? Ti je Mark Lala ? (*E përfshin për qafe*). O Zot të qofsha true për mrekullit' e tua ! Qënke i gjallë ? (*E puth në ball*) Edhè un'ahere, po të thom cili jam. Jam miku yt i vjetër Rroku, i biri i Luc Prênkës. (*Puthen prapë*).

MARKU

(*me gëzim*)

Zoti qoft' i math që u poqmë edhè një herë, i dashuri mik. Më ngjan se jam në ëndër…. Po…. më duket se po vjen këtej princesa e Ballçës Katerina e nuk bën të n'a gjenjë këtu, po të lutem, dalim pak jashtë e fjalojmë me gjatë.

Si të duash. (*Dalin jashtë*).

SQEN' e III-të

Katerina

(*Vetëm*)

Ah, sa jam e lodhur tuke pritur e përcjellë kaqë bajraktarë e miq të tjerë shtektarë. E do puna, po edhè im vëlla princi dëshëron që t'i pres vetë miqtë këjo më loth tepër. (T*yke u sjellë pak*). Si mora vesht tërthorazi që sot n' a kishin ardhur edhè shkuës, mblesër, e im vëlla desh të japë fjalën për mua. Kish të drejtë, po ajy nuk di pse s' i jap fjalën unë e pse e shtynj punën . . . Ah, ku t'a dinte im vëlla arësyen, ku të dinte mendimet e dëshirat e mija ! Kam dashur disa herë t' ja zbulonj të drejtën, po kam frikë se kush e di si do më thotë. Po më së fundi duhet t'ja thom. Kam tash disa kohë që po shoh e po habitem me virtutet e sjelljet e pëlqyera të atij Gjonit, atij djaloshit të hijeshm' e të ndershmë, që po shërben këtu në pallasin t' onë, si rrojtar i princit. Në ushtrinë t' onë nuk e ka shoqin ajy farë trimi. Eshtë për njëment burrë fisnik. Sa më vjen keq se këjo dëshira ime është gjë që s'bëhet ! Sa mëkat i math të mos ketë gjak mbretnor, që të munt të kuxonja t' ja rekomandoj t'im vëllaj, sa do që për mua Gjoni është më i mirë e më i vlefshëm se një princ ! E Gjoni i shkretë ? Ky as e shkon kurrë në për mënt që një pricesë, një Katerinë e Ballçejt e dëshëron për shok ! ... Ah, si do vejë filli i kësaj pune ? ... Po s'ka gjë që s' bëhet në këtë botë; duhet të mos dëshpërohem.

SQEN' e IV-të

Katerina, Karllo Topija

KARLLI

(*Tyke sallutua*r)

Naltësisë s' uaj ditët i qofshin të bardha ! Urdhrin e naltë posa e ndjeu shërbëtori juaj, brodhi me vrap e me dëshirë e po ju paraqitet. Urdhroni, naltësi, për ç' farë do që ju duhem. (*Përunjet*)

KATERINA

Të thira, o Gjon, që të të pyes në ka ardhur njeri sot këtu prej Mirditet, Kthellet, ose prej Bregut të Matit.

KARLLI

Përveç krenave e bajraktarëve që vetë kini prit' e përcjellë, e nalta zojushe, tjetër kush nuk ka ardhur. Tani veç se po marr vesh se paska harritur këtu prej Krujet një farë Rrok Gjuli, i dërguar prej anës së Princ Tanush Topisë për me lajmue Krutanët kudo që janë të shkojnë andejzaj për me u hasë për të fundit herë me kryezotin e Krujës se ka afruar në orën e vdekjes.

KATERINA

Ç' po flet ? Tanush Topija qënka në orën e fundit ? Oh, sa më vjen keq për atë farë plaku, sa më dridhet zembra për të ngratin që do t'a humbasim ! Ti a e njeh?

KARLLI

Jò e nalta zojushe, veç se embrin e tij e kam dëgjuar shpesh herë si edhè veprat e tij kreshnike e bujare.

KATERINA

Tanushi ësht' i vetëmi zot që ka Shqipërija : i vetëmi po thua që nuk ka drashtë as një armik prej atyre që i ranë më qafë Shqipërisë. Ky ja ka zbardhur faqen gjithmonë. Trimëri e tija nuk tregohet dot, fama e tija është an' e kant e përhapur edhè tani kujtonj se nuk do mbetet sy Shqiptari pa derdhur lot për humbjen e këtij luani që nuk do t' i gjendet shoqi që t' ja zërë këmbën ! Për Krutanët vdekj' e tij është një bolbë e madhe por edhè nè Ballçajt me vdekjen e Tanushit bjerrim atë më të mirin mik e më të dashurin shok të shtëpisë s' onë. I mjeri plak sa më dhimbet, edhè më fort se vdes fatzi pa lënë një trashëgimtar si do mos. Po ti, Gjon, a dëshironje të vinje e t' a shinje Tanushin ?

KARLLI

Po të ishte urdhri i zotnis s' uaj, unë me gjith shpirt dëshironja t'a shoh. S'po ja u msheh, e nalta zojushe, se shumë herë kam dashur me shkue në Krujë për me u pa me këtë princ të dëgjuar. Nuk di çka më tërheq atje, po zembra ime gjithënjë e ka ëndëruar një gjë të tillë, e sot që naltësija juaj po më paraqit këtë rasë të kandëshme, do merrnja guximin t'i lutesha për me më dhënë lêjen me shkue pak deri në Krujë sa është edhè gjall ky burrë.

KATERINA

Un s'kam as një kundrështim, o Gjon, përpara kësaj dëshirës s'ate, po kam frikë se …. kush e di se si, kjo lëngat e tij zgjatet tepër edhè kështu ti vonon të kthehesh. (*Me vehte*) Ah, s'di qysh të bënj ; s'di qysh t'i jap të kuptonjë ndjenjat e mija për të ! (*Karllit*). Ti e merr vesh fort bukur, Gjon, se kam nevojë të madhe të të shoh dit për dit në pallasin t'onë. E tash si po thua? A do të shkosh? A do të më lësh vetëm ?

KARLLI

I kënaqur tepër prej mirësive të rralla që naltësija jote ka treguar për një shërbëtorin t'uaj besnik, nuk dua as pak t' i kundrështoj dëshirës s'uaj, po ...

KATERINA

Esht' e tepër; e marr vesh që do të shkosh edhè ti në Krujë, po nga ana tjetër ti e di se nuk munt të bënj as një orë pa ty. (*Tyke përtrypur fjalët*). Gjer më sot nuk kam çelur gojën, dua të të besohem di ç'ka. po prapë kam dyshim. (*Më vehte*) Ah, po ky ankthi im nuk munt të durohet më; dita ditën po më shtyp krahrorin; do të flas nuk e mbanj më. (*Karllit*). Gjon, mos u habit për ç' ka sot e bija e Ballçajve Katerina vjen me të zbulue. Po, t' a dish mirë; se po dolli fjala, gjendja ime nuk di si ka me qënë. Te besa e burrnija jote kam shpresë të plottë se kurrë kjo e mshehtë që do të të thom nuk do dalë sheshit. Kështu shkurt po t'a kallzonj shkakun pse të thira këtu edhè shkurt po të thom me tri fjalë ...unë të dua!

KARLLI

(*I topitur krejt*)

Prej gojës së naltësisë s' uaj, shërbëtori unë nuk prisnja t'a dëgjonj kurrë këtë fjalë ! Unë s'jam përveç se një shërbëtor i përvujtun i naltësisë s' ate e për mua është mjaft nderi që gjendem në shërbim të së naltës princesës s' eme.

KATERINA

E shoh, o Gjon, se fjalët e mija tepër të turbulluan. Ti flet në këtë mënyrë se e kujton vehten t' ënde si një rrojtar besnik të pallasit t' onë. E thua tyke ditur se s' je prej gjaku mbretënor, po sa për mua, dije mirë se i kam marrë të gjitha para sysh e po të thom se s' ka gjë në botë që të m' a ndrojnë këtë mendim, se zembra ime as njeh, as di, as s' do të dijë ç' do me thënë gjak mbretënor.

KARLLI

Zojusha jeme krenare meritonte një tjetër naltësi si pas rendit të saj e jo një sherbëtor të vobektë si mua.

KATERINA

Për mua, o Gjon, naltësi janë karakteri yt burrnor e virtutat bujare që po dallonj tash sa vjet mbi ty. Po tani s' kemi edhe kohë t' a zgjerojmë këtë fjalim se edhe për mua mjaftojnë këto të paka sa për sot edhè ti po ngutesh për me shkue në Krujë. Një herë tjetër e pasojmë bisedimin. Tani po të lè të mentohesh. (*E zè për dore tyke e parë me një sy të ëmbël*) Udhën e marë, mos harro, mos vono, kij mendjen.

KARLLI

S'kam fjalë si t' i falem nderit zembrës bujare s' uaj për mirësitë e lêjen që po më jepni me u nisë për Krujë. (*Unjet i puth dorë*n). Me lejen, naltësi, lamtumirë.

KATERINA

Udhën e mbarë, mos harro, kij mendjen. (*Del vetëm Katerina*).

SQEN' e V-të

KARLLI

(*Vetëm*)

A jam në ëndër ? Në jetën t' eme kurrë do mos besonja se një princesë do më thoshte një të tillë fjalë ! A thua të jetë tallur princesa me mua, a po unë s' i mora vesh mirë fjalët e saja ? mua të më dojë princesa, mua, një rrogëtar të vobektë, një njëri që s' ka as bab' as nënë ? ... Vërtet sa jam fatzi e i mjerë të mos kem njohur prindët e mij në këtë botë, të mos kem njohur fisin t' em, shtëpinë t' eme e mê fort nënen t' eme ! Ah, nënen, s'e kam ditur të mjerën cila ka qënë ! As njeri s' më ka treguar gjë për atë. I vetëmi kujdestar e babë që kam Kol Marra[1] as ajy s' ka dashur të me rëfenjë gjer më sot gjeninë t' eme. Po ky

[1] Pseudonym i Mark Lalës (K. Floqi)

myster a do shkonjë edhè më gjatë ? Kam edhè një arësye tjetër per këtë problemë edhè do e mos do t'a shtërngonj babën t' em Kol Marrën, të më tregonjë mirëfillit fisin t' em të vërtetë, se s' munt të harronj kurrë fjalët e hidhura që më kanë ardhur në vesh, si kurse unë s' paskam gjak Shqiptari, po qënkam një iltin i huaj! Sot kësaj çashtje duhet dhënë funt. (*Fillon të dalë jashtë po haset me Gjergj Topinë, pa e njohur se e ka vëlla*).

SQEN' e Vl-të

Karlli e Gjergj Topija

GJERGJI

(*Tyke hyrë*)

Mirë se ju gjenj, o mik e dita ju qoft' e mirë.

KARLLI

Mirë se n'a vjen e Zoti qoftë me ty. Urdhro e çlodhu, se dukesh se ke hequr rrugë të gjatë.

GJERGJI

Ju falemi nderit. Kam ardhur prej Ohrije, tuke ecur me ditë me natë gjer sa ja mbrina këtu.

KARLLI

Prej Ohrije vjen the ? Të gjatë rrugë paske marrë. A më falni t'ju pyes pse paski marrë gjithë këtë mundim ?

GJERGJI

Dërguar jam prej një zotnije të hasem këtu për një punë me një zotni tjetër, që mik e ka zotnija i parë.

KARLLI

E cili është ky zotni këtu a munt t'a marrim vesh, në, qoftë se ju ësht'e mundur të m'a kallzoni, ju paçi faqën e bardhë ? Se ndofta e njoh unë e ja u tregonj.

GJERGJI

Eshtë një Krutan edhè embrin e ka Kol Marra.

KARLLI

Kol Marra ? Po ajy është baba im, brè burrë.

GJERGJI

Ahere ca më mirë.

KARLLI

Kam gëzim se paske qëlluar miku jonë, pra edhè baba im tash edhè pak kthehet e do t' a shohsh. Po nuk të pyeta, miku im, i bir' i kujt je e cili është fisi yt?

GJERGJI

Zotni, tash po mbush pêsë-mbë-dhjetë vjetë e deri sot kurrkush s'pat mirësinë të më tregonjë fisin t'em e prindët që kam pasur. Eshtë turp me të vërtet të mos njoh prindët e mij për me t'i kallzue cilët janë. Veç këtë di që më quajn Gjergj.

KARLLI

Shëndoshë qofsh, po mos u hidhëro për këtë, miku im se edhè mua kështu më ka qelluar. (*Dëgjohen këmbë së jashtmi*). Më duket se dikush po vjen. (*Sheh nga dritorja*) A, që, po vjen. Po vjen baba im e tash do t'a njohësh edhè zotrote.

SQEN' e VII-të

Të parët Mark Lala

MARKU

(*Tyke hyrë*)

Këtu qënke Gjon ? Të pata kërkuar. (*Tyke parë Gjergjin edhè pa e njojtur*). Zotni, e tij tash paska ardhur ?

KARLLI

Po, babë.

MARKU

Që nga vjen edhè cili është ?

KARLI

Vjen prej Ohrije, i dërguar te zotnija juaj e quhet Gjergj.

MARKU

(*I gëzuar që dëgjon embrin*).

Ti je Gjergji ? (*E zè për qafe e e puth*). Qoftë i lavdëruar Zoti që të pashë, o biri im e mirë se n' a ardhe.

GJERGJI

Shumë shëndete kini nga miku juaj Lek Gropa, kujdestari jem. E pra për ç'ka jini fjaluar më çoj me të shpejtë te zotnija juaj e jam gati t'ju shërbenj për ç'do të kii nevojë.

MARKU

(*Me lott ndër sy*).

Të paça, o bir, sa malet e Zoti të prijtë rrezikut.

KARLLI

Ti më ngjan se qan, o babë; për se i derth gjithë këto lotte?

MARKU

Jo biro, s'kam gjê po qanj prej gëzimit që po ndjenj, se pashë këtë të dashur djalë Gjergjin që e kisha ndarë prej gjirit që vogliet. Pastaj kam edhè zembrën tepër të plagosur se paçë përcjellë një mik të vjetër Krutan që kisha kaqe vjet pa e parë.

KARLLI

Kush ish ky mik edhè për ku u nis ?

MARKU

Quhet Rrok Gjuli e u nis me të shpejtë për në Krujë.

KARLLI

A pat ndo një punë këtu ?

MARKU

Ish dërguar prej princit Tanush Topisë për me lajmue Krutanët e këtij qarku e Matjanët të bredhin me të shpejtë në Krujë që të dëgjojnë porosit' e tija të fundit, se ndodhet në orën e vdekjes!

KARLLI

Po, e di edhe vetë këtë e jam fort i helmuar.

MARKU

A, e ditke ? Fort bukur.

KARLLI

Princesa Katerina kish mirësinë të më pyes në dua të vete edhe unë në Krujë të shoh Tanush Topinë, e i thashë se po, me gjithë që s'mora edhe lêjen t'uaj, po princesa m'a dha lêjen për me shkue.

MARKU

Ashtu ? Ahere shumë mirë, se e kisha ndër ment edhè vetë t' ja lypnja këtë lêje për ty. Tani bëhu gati për në Krujë se do nisemi ca më parë, s'kemi kohë të presim.

GJERGJI

Po shkoni në Krujë që të dy ?

MARKU

Edhe me ty bashkë, biro, kështu të tre si jemi.

KARLLI

Me ne po vjen edhe Gjergji ?

MARKU

Vetë e kërkova edhè nergut për këtë punë ardhi Gjergji.

KARLLI

(*Tyke parë Markun që derth lott*).

Ti prapë po qan, o babë, duket se di ç'ka të ka ndodhur. Pse s'më kallzon t'a di edhè vetë ?

MARKU

E kam tepër të varrosur zëmbrën, biri im për atë të shkretin plak Tanush Topinë, që sot gjendet buzë varrit e si bamirës që e kam pasur e gati si babë të

dytë, parzmi i zëmbrës më dridhet për të kur kujtonj se do n' a ndahet prej kësaj jete ; edhè në sheh këto lotte që po më derdhen si rëkè prej syvet, janë një tagër mirënjohtje e respekt faqe një bamirësi t'em!

KARLLI

Bamirësit t' ënt thè ? Pa folë mirë, o âtë; çudi po bënj se ti tash kaqe vjetë s'më ke kallzuar ndo një herë për këtë çështje.

MARKU

Ke të drejtë, i dashuri djalë, se vërtet s'të kam thënë gjë për ketë çështje, po tani po të thom se unë kam mbetur i varfër e bonjak qysh në vogëli e vetëm ajy Tanush Topija u ndoth aqe fisnik e i mirë për mua sa më përmblodhi, më rriti e më bëri burrë. Në shtëpi të tij jam ritur, andaj edhè si një misë i asaj shtëpije munt të numurohem. E tash e merr vesh, djali im, pse kam të drejtë po edhè detyrë të shejtë të qanj për këtë njeri që u ndoth shpëtimtar e babë për mua!

KARLLI

Sa shpirtmirë e bujar paska qënë i mjeri !

GJERGJI

Atij i ndrittë shpirti atje ku të vejë.

MARKU

Po, lum djelmosha, ky jo vetëm për mua po edhè për gjithë botën ka qënë i mirë, prandaj sot e qan gjithë Shqipërija.

KARLLI

Tash po dëgjoj për të parën herë prej teje se paske qënë i varfër e rritur në duart e nj' atij burri, që me të drejtë të plottë e quan bamirës, e kështu as ti

s'ke njojtur babë e nënë, ashtu si edh' ky Gjergji më pat thënë tanithi, ashtu si edhè unë që në duart t tua u rrita edhè përveç tejet s'kam njojtur tjetër njeri i ngrati; Të kam pyetur edhè tjetër herë, po s'di pse je drojtur të më tregosh të vërtetën. E tani po të pyes për herën e fundit e të lutem, babë, mos më mshih as gjê, se po të siguronj se as vetë nuku shmangem gjer sa të marr vesh fisin t'em të vërtetë edhè cilën kam pasur nënë, mbassi ty të kam babë.

MARKU

(*Tepër i mallnjyer*)

Kij pak durim, o bir i dashur. se tash po i merr vesht të gjitha, mbassi edhè dita ardhi sot për me t'i kallzue. Po përpara se të të zbulonj të vërtetën, është nevoja të të tregonj edhè një histori tjetër, të çilën dëgjoje edhè ti Gjergj.

GJERGJI

Falem nderit, po e dëgjonj edhè unë.

MARKU

A kini dëgjuar, djemt' e mij, se princ Tanush Topija ka pasur një djalë të vetëm që e quanin Ndrekë ?

KARLLI

Po kam dëgjuar një fjalë të këtillë, e se ky Ndreka ish martuar me një iltineshë[1] e një dit u gjent i vrarë në Napël me gjithë të shoqen.

MARKU

Mjaft mirë e paske dëgjuar. Po a e di vrasjen e tmeruar të atij të shkreti Ndrekë, si edhè të së shoqes Irenës ?

[1] iltineshë = me origjinë latine

KARLLI

Jo, nuk e di e të lutem të n'a e tregosh se më intereson tepër

MARKU

Ahere po ju thom se vrasësi i të dyve këtyre të mjerëve është vetë ajy Robert Angjevini, ose Guiskardi, mbreti i Naplit e i Aragonës; i vjehri, mjerisht i Ndrekës.

KARLLI

I vjehri i Ndrekës ?

MARKU

Po, i vjehri i Ndrekës e i ati i Irenës !

KARLLI

O, i pashpirti !

GJERGJI

Bishë e tmeruar !

MARKU

Ndofta edhè më i tmeruar se sa kujtoni.

KARLLI

Cili ka qënë shkaku ?

MARKU

Tyke pasur qëllim të vërë Durrësin në dorë e mbassi nuk e la Tanush Topija, ky njeri i keq, Roberti i pabesë, mendoj t' a farrosë krejt shtëpin' e

Topejvet. Kështu pra, u zû prej dhelpërisë e me qenë se bijën e tij Irenën ja kish dhënë grua Ndrek Topisë, një dit i thret në gosti që të dy në Napël, bashkë me të dy djemt' e tyre Karllin edhè Gjergjin, dy djelm si dy pullumba edhè bash ate natën e parë që këta mbrinë në pallas të Robertit, ky gjaksor i pamëshirtë i theri që të dy !

KARLLI

Oh, shkerbë[1] e tmershme !

GJERGJI

Gjakpirës i tërbuar !

MARKU

(*Tyke pasuar*)

Edhe si kur s' ishte mjaft këjo, ky i mallkuar ka dashur të therë edhè të dy djemtë Karllin e Gjergjin.

KARLLI

O egërsirë e harbuar !

GJERGJI

Lugat i Ferrit !

MARKU

Po Zoti i math nuk e pat premtue këtë të keqe ! Nuk e pat thënë të mbetej froni i Topejve pa një trashëgimtar. U ndoth atë natë një grua fisnike e bujare,

[1] Shqerbe = egërsinë, bishë (K.Floqi)

e cila i pat fshehur të dy djelmat e i pat shpëtuar prej thonjve të atij mizori. Kjo zonjë ka qënë e shoq' e Robertit edhè nën' e Irenës, ka qënë mbretëresha Elisabetë.

KARLLI

Shpirtmadhja grua !

GJERGJI

Atë Zoti e faltë !

MARKU

Aty ka ndodhur edhè një shërbëtor, besniku trim e rojtari i Ndrek Topisë të cilit mbretëresha ja pat besue të dy djelmtë, i pat dhënë të holla, i pat çilur rrugën, i pat nxjerë tinas e me shumë kujdesje prej Naplit e i pat përcjellë që të tre. Kështu ky shërbëtor i shkretë me shumë rrëziqe i pruri djelmat në Shqipëri, tyke ndruar edhè emrin e vet e të djalit parë, mbassi të dytin ja besoj një mikut të tij të larkmë.

KARLLI

Shpirtmadhi njeri !

GJERGJI

Pastë bekimet e Zotit !

MARKU

Sherbëtori i ngratë vepëroj kështu nga frika e Robertit; i cili me spiunët e tij kërkonte vërë më vërë fëmijët për me shkretue kryekëput shtëpin' e Topejvet.

KARLLI

Po sot ku gjenden, o babë këta të dy fëmijë ?

MARKU
(*Me ngashërim*)

Këtu, o bir, këtu në Shqipëri gjenden që të dy si dy petritë.

KARLLI
(*Me kurreshtim)*

Në Shqipëri ? E në cilin vënt të 1utem ? Pash Zotin n'a e trego, babë, mbassi e di.

MARKU

Brënda në këtë Shkodër.

KARLLI me **GJERGJIN**
(*Të habitur*)

Në Shkodër ?

MARKU

Po, po në Shkodër.

KARLLI
(*i pa durua*r)

Po ahere cilët janë këta ?

MARKU
(*Tepër i mallëngjyer s'flet dot*)

KARLLI

Ti po qan, o babë, si një fëmijë, ç'pate sot ? Mbaroje fjalën cilët janë këta të dy ?

MARKU
(*Tyke qarë përqafon Karllin*)

Njëri ... jè ti ! ... Ti ... jè njëri ... Karlli !

GJERGJI
(*i pa mbajtur*)

Po tjetri ? Folë pafsh Perëndinë, folë kush është.

MARKU
(*Tyke përfshirë edhè Gjergji*n)

Tjetri .... jè ti ..... Gjergji ..... edhè shërbëtori ...

KARLLI me **GJERGJIN**

Edhe shërbëtori ?

MARKU

Jam unë !

(*Të tre shëkojnë shoqi-shoqin në sŷ*
edhè qajnë prej gëzimi).

FUNDI I AKTIT II

Akt i III

(Një sallë në pallas të Tanush Topisë në Krujë)

SQEN' e I-rë

Tanush Topija, Zef Gjoni
e disa bajraktarë të tjerë

TANUSHI

(*i shtrirë në shtrat të vdekjes*)

Të gjithë këtu jini ?

ZEF GJONI

Këtu naltësi, këtu të gjithë rotull n' a ke.

TANUSHI

Mos u largoni ju lutem, se kam shumë nevojë t'ju shoh të gjithë pranë e të çdëfrenj për të fundit herë. Eshtë ora e mbrame e dua t'ju lè porosit' e mia që t'i vini në veprim passi të vdes

ZEF GJONI

Jemi gati të bëjmë ç'të n' a urdhronjë lartësija jote.

TANUSHI

E shoh që u mshtuall lëmshi. Ardhi dita që të kryenj detyrën t'eme. Nuk kini si më ktheni nga kjo rrugë.

ZEF GJONI

Mos e hump shpresën, naltësi, se kush e di si e bën Zoti e n'a shërohesh e të shohëm edhe një herë të shëndritsh në mes t' onë.

SQEN' e II-të

Të parët, një lajmëtar

LAJMËTARI

Naltësi, ju qoft' e shkuar. Marr nderin t'ju lajmëronj një lajmë të hidhur edhè helmohem tepër se vinj t' ja thom naltësisë s' uaj në një orë që s' duhet po është nevoja.

TANUSHI

Afrohu, biro, e folë për se ke ardhur.

LAJMËTARI

Prijësi i Sërbëvet Mark Kralijeviçi bashkë me disa urdi Turqsh msye zotninë t' em, princ Ndrek Muzhakën e Kosturit. E kanë piskuar ngushtë, edhè sa do që im zot mbahet me burrat e vet tue luftue armikun, prapë rreziku është' i math. Në këtë dëshpërim të pa shoqtë ka lypë ndihmën e bajarqeve të Shqipërisë. Kushtrimi është dhënë an' e mb'anë. Prandaj po vij edhè përpara naltësisë s' uaj tue kërkue këtë ndihmë sa mê parë, si mbas urdhrit të t'em zoti

TANUSHI

O Perëndi, edhè në këtë orë të fundit të mos vdes i qetë ? (*Zefit*) Ti, djali im, prijës i ushtërisë s' eme e kupëton mirë rëndësin' e këtyre fjalëve. Rreziku së është vetëm për princ Muzhakën, po për gjithë Shqipërinë. Muzhaka n' a ka ndihmuar nevej shumë herë, pra edhè ne s'duhet të kursehemi për të. Vrulu, pra, pa përtesë, pregatit sa burra të mundësh edhè në qoftë nevoja priju edhè vetë. Kur të shkoni nga Malësi e Dibrës, jepjuni të fala prej anës s' eme, merruni vesh edhè me barjraqet e Dibrës për këtë punë e ngani sa mê shpejt.

ZEF GJONI

Po për naltësinë t' ënde këtu kush përkujdesohet ?

TANUSHI

Biro, kjo është një detyrë m'e madhe me i ndihmue vllathit t' onë e me largue rrezikun prej vendit t' onë. Shqipërija duhet të rronjë e të mos coptohet. Unë jam një plak që sot me nesër do vdes, po Shqipërija duhet të jetonjë sa të jetë bota në jetë, e kupton, biro? Pra, mua lermë në kujdesje të Perëndisë e të këtyre djemve të mij që kam rotull e ti shko shpejt ku të thashë, se puna s'pret.

ZEF GJONI

(*Tyke fshirë lotët*)

U bëftë ashtu si thè naltësija jote e si e ka thënë Zoti. Pra tu mirëmbetshi e ju gjeça shëndoshë (*i puth dorë*n).

TANUSHI

Ju qoftë udha e mbanë edhè Zoti me ju. (*Zefi e lajmëtari dalin*). Deh, o Zot i math, të mos n' a lenë qetë edhè sot armiqtë t'onë !

SQEN' e III-të

Të parët, Rrok Gjuli

RROKU

Mirë se ju gjënj prapë, naltësi (*puth dorën*).

TANUSHI

A ardhe Rrok Gjuli ? Ty të lumtë kèmba se po të prisnja pa durim. Tani posa u ktheve nga Shkodra ?

RROKU

Njëtash, naltësi, po sa i zdrypa kalit.

TANUSHI

Ç'kemi, ç'bëre andejzaj ?

RROKU

Sa munda i kreva urdhrat e porositë që më ngarkoj naltësija jote. Lajmova gjithë Krutanët e Matjanët të atij rredhi. Disa ardhë me mua e disa po vijnë mê pas.

TANUSHI

Të falem nderit, o Rrok, eja tani e rri afër meje. O Rrok Gjuli e ju të gjithë sa jini këtu, po e shoh se nuk shpëtonj prej kësaj lëngate. Kujtonj se edhè për pak ju lè shëndet e ndahem prej jush e prej kësaj bote. Nuk më vjen keq se po vdes, se plak jam, po më vjen keq se vdes i shkretë, se vdes pa një trashëgimtar. Më vjen keq se me vdekjen t' eme shuhet edhè shtëpija jonë. Dora mizore e atij gjaksori Robertit më korri gjithë fëmijën[1] t' ime ! Ah, Ndrek o Ndrek, ah, Karlli e Gjergji, që s' m'u ndothtë në këtë orën e fundit! . . . S' dua t'a mallkonj në këtë orën e vdekjes, atij veç Zoti i martë hakkun ! Në këtë moshë, në këtë pleqëri në këtë orë të mos kem as një prej njerësve të mij ! Ah, sa jam fatzi ! Po vdes krejt i dëshpëruar ! Eh, kështu ndofta qënka thënë nga Perëndija! Burra Shqiptarë, porosi të madhe po ju lè të më kini kujdes fronin; të më kini kujdes Shqipërinë e t'a mbroni me ç'do fli gjer në me të mbramen pikën e gjakut t' uaj, t'i zbarthni faqen e t' a nderoni gjithmonë. Mos u kapni me shoqi shoqin, lijni me nj' anë cmiret e gjaqet, bashkohi e vllazënohi për jetë e të pandarë. Ruani nderin e zakonet t' ona katragjyshe edhè shtërngoni e mbani kurdoherë

[1] Fëmijë = familje

kryenaltë e krenuar flamurin t'onë kombëtar ! ... Në bashkim qendron fuqija. Mos harroni se jini Shqiptarë të gjithë prej një vatre e prej një gjakut (*Do me pasue fjalën, po nuk mundet e rëzohet prapë mbi shtrat të vetë. Rrok Giuli e të tjerë e ujdisin, tyke mbuluar. Hyn një shërbëtor*).

SHËRBËTORI

Naltësi, tre shtektarë posa që kanë ardhur prej Shkodre e dëshirojnë të shihen me naltësinë t' uaj ; urdhroni po të doni t'i shtije këtu brenda.

TANUSHI

Mirë - se të vijnë. (*Shërbëtori del tyke salutuar. Pas këtij hyn Mark Lala me Karllin e me Gjergjin*).

SQEN' e IV-të

Të parët, Mark Lala, Karlli e Gjergji

MARK LALA

(*Tyke i puthur dorën me të tjerë*t)

E naltësisë s' uaj qoftë e lehtë sëmundja e Zoti ja u largoftë.

TANUSHI

(*Tyke kqyrë me verejtje shtektarët*)

Mirë se ju pruri Zoti, miqt' e mij, e paçi këmbën e mbarë. Urdhroni e rini. Prej kah ju kemi zotërinë t' uaj ?

MARKU

Naltësi, shërbëtori juaj është prej Kruje e tash mbas kaqë vjete prapë po kthehet, tyke dëgjuar me hidhërim lëngatën t' uaj.

TANUSHI

Ty Zoti të faltë. Prej Kruje thè se jè ?

MARKU

Po, naltësi, por se kanë kaluar tash aqë vjete qysh se jam i larguem prej Krujet edhè sot gati jam si i panjojtur. (*Të gjithë e shëkojnë në sy*).

TANUSHI
(*I habitur*)

Hè, i biri kujt jè prej Krujet, nuk më thua ? Për Zotin s'm'a merr mendja të jesh ti prej Kruje, se, si Krutan që jam, Krutanët i njoh të gjithë mirë fillit.

MARKU

Po, naltësi, prej Krujet jam, më zini besë e tani mbassi t' ju dëftonj embrin t' em edhè i kujt jam, ahere do bindet për njëmënt naltësija jote. Pra po ju thom se jam Mark Lala, i biri i Ded Lalës, bajraktarit. (*Të gjithë, përveç Rrok Gjulit po e shohin nër sy, e më fort Tanushi i cili çuditet*)

TANUSHI

I bajraktarit Ded Lalës i biri ? Ç' ka po flet, brè burrë ? A mos jè në gabim? Pa me thuaj edhe një herë.

MARKU

Nuk jam as pak në gabim, naltësi, jam vetë ajy që po ju thom.

TANUSHI

Besa më fal, o shtektar i im, në qoftë se prapë kam dyshim; se Lala jem, ajy burrë burri që ka vdekur aqë i ri, nuk ka pasur për veç se një djalë. (*Tyke*

unjur zërin nga mallngjimi). Ka pasur Markun e shkretë, që ka dekë edh' ajy bashkë me Ndrekën t' em e me niprit në Napël, si kundër kam msuar !

MARKU

Ndofta ashtu ke dëgjuar, naltësi, po i madhi Zot dikur bën edhe mbrekullina edhè munden që të ngjallen, edhe të vdekurit. Pra, ajy që naltësija jote ka kujtuar se ka vdekur, nuk ka vdekur po është gjallë !. . . Që, Marku i Ded Lalës jam vetë !

TË GJITHË

Mark Lala!

(*Marku unjet përpara Tanushit e i puth duart*).

MARKU

Po, Zotrinj, Mark Lala unë jam, që po më shihni !

TANUSHI

(*Tyke qarë*)

Mark Lala je ti ? Marku jem ? Mos shoh ëndër, a jam në kllapi ? Jè Marku ti ? *(Çon duart përpjetë*) O Zot të qofsha true për këtë mrekulli të madhe! (*E përfshin për qafe*). O Mark, Mark, vërtet po të shoh ! Vërtet u ngjalle ti për mua? O Zot i math e i vërtetë !

MARKU

(*millovatur*)

Po babë, po bamirësi jem, unë jam Marku ! (*Qan e unjet mbi Tanushin*).

TANUSHI

(*Tyke shtrënguar Markun*)

Oh, Marku im, oh, biri im, o sa gëzim që po ndjen zembra ime e varfër, që e ka mbushur vrer hidhërimi! Perëndisë i qofsha falë që të paska shpëtuar

prej thonjve të atij gjaksori ! Pandehnja se edhè ti, si ajy gjëmë-madhi Ndreka im me Irenën e fëmijën jini vrarë prej Robertit të mallkuar. Po Zoti qënka i math; e tash që po të shoh pranë më vjen se m'u ngjall Ndreka im, ajy Ndrekë që më ka përvëluar zëmbrën ! Ah, qyqari unë si kam mbetur; s'mjaftoj i mallkuari me Ndrekën e me nusen t' ime, po me vrau edhè nipat e mij. Ah, Ndrekë, Ndrekë ! ... Irenë ! . . . Ah, o Karllo, o Gjergji ! . . . Ah, o Mark, m' u mbyll shtëpija ime !

KARLLI

(*Tyke dalë përpara*)

Jo, naltësi, jo, ! Nuk e ka thënë Zoti të mbyllet dera e Topijve. (*Të gjithë po habiten*).

TANUSHI

(*Karllit*)

Po ti, mor djaloshi im, kush jè ? Pa më thuaj. A thua se të vdekurit çohen prej varrit ?

KARLLI

(*Me gjak-të nxehtë*)

Të vdekurit, naltësi, vërtet nuk kthehen prapë në jetë, po të gjallët që s'kanë vdekur, ata rrojnë !

TANUSHI

A thua, pra, se jetojnë, të dy nipat e mij Karlli e Gjergji ?

KARLLI

Jetojnë, naltësi, jetojnë, si njëri, si tjetri. Zoti i math më së pari, pastaj edhè ky burr'i burravet (*tregon Markun*) t' i kanë shpëtuar që të dy e sot janë gjallë.

TANUSHI

(*Çohet përpjetë*)

A jam nër mënt ? A t'a mbesonj ? (*Karllit*). E pra, ku janë? Folë pash Zotin, folë.

KARLLI

(*Kap për dore Gjergjin*)

Kqyri naltësi, kqyri nipat e tu që të dy ! Që, gjyshi i dashur. Karlli jam unë edhè ky është Gjergji ! (*Të dy ulen e i puthin dorën Tanushit. Të gjithë habiten edhè derdhin lotë gëzimi Tanush Topija i zbetë, i shtërngon që të dy në krahrorët e tij*).

TANUSHI

O Zot, a mundem t'a besonj ? Të jet e vërtetë këjo ? Këta të jenë djelmt'e mi ? O, o, Zot, o Perëndi, ti qofsh i bekuar për jetë ! O Karllo, o Gjergj, nipat e mij, djelmt' e mij ! (*I shtrëngon*) A ju kam ndër duart ? A ju shtrëngorinj ? O Tanush Topija, vdis tani i lumur, se gëzim më të math se këtë as kè parë, as do të shohsh ! (*qan si fëmijë)*.

KARLLI

Gjysh i dashur, babë, atë !

GJERGJI

Oh, sa të lumur jemi pranë teje !

TANUSHI

(*Me mallngjim*)

Djelmt' e mij, o bij të dashur, tash m'u ngjall Ndreka, baba juaj i ngrati; tash m'u çfaq përpara nusja ime e dashur Irena, nëna juaj e mjera! Ah, sa të mirë ishin që të dy ! Ah, Robert, Robert, ty të vraftë Zoti ç'më punove !

KARLLI

S'e premtoj Zoti të shuhet shtëpija jonë ! Zoti e shpëtoftë Mark Lalën që n'a rriti e n'a madhoi, që n'a shpëtoj prej ç'do rreziku e që u gjent babë për ne! Këtij i qofshim falë. (*Unjin të dy kryet*).

GJERGJI

Ashtu edhè gjyshes s' onë, mbretëreshës Elisabetë, që n'a mprojti prej thikës së atij gjaksori të tërbuar.

TANUSHI

Zoti i faltë që të dy e qofshin faqebardhë. Tash po i harronj të gjitha të këqijat që hoqa, mjafton se në këtë orën e fundit ju pashë edhè një herë. (*Markut*). Po n'a trego, o Marku im, si ngjau kjo punë, që ne këtu ju kemi ditur të vdekur të gjithëve.

MARKU

Me pak fjalë i tregonj naltsisë s' uaj gjithë tragjedin' e mnershme e shpëtimin t' onë. Atë natë të· tmershme e të pa harruar, mbassi dor'e Robertit therri mizorisht që të dy djalin e nusen t' uaj, ajy ka dashur të vrasë edhè djelmat Karllin e Gjergjin, të cilët po i kërkonte. Një zhurm' e madhe u ndi në gjithë pallasin mbas mezit natës. Mbretëresha Elisabetë, ajo bujare grua e zbetë e e trembur vjen më gjen atje ku po flinja, e tyke pasur pas dore të dy djelmtë, më tregon gjëmën e madhe që ngjau e më ngut sa më shpejt të ikënj me të dy fëmijët për të shpëtuar prej thikës së Robertit, i cili i kërkonte odë më odë. M'i dha në besën t'eme, më dha të holla mjaft e dy njerës të besimit të saj për me më nxjerë përjashta kufijve të mbretëris së Robertit. Veçanërisht më porositi të rronj me djelmtë lark Krujës e i panjojtur. sepse Roberti me spiunët e hafijet e tij nuk do rinte qetë deri sa t'i gjyrmonte djemtë ku janë e t' i vriste që të dy. Kështu e lashë Naplin qysh atë natë e si më shkeli këmba në Shqipëri e tue mbajtë porosit'e shêjta të asaj bujares grua, mentova të mos i mbanj fëmijën pas se mos diktohesha, pra njërin Gjergjin ja dërgova mikut t'em Lek Gropës në Ohri, të cilit i falem nderit fort që m'a riti e m'a dorëzoj burrë edhe Karllin e mbajta me vehte. Tue drashtë gjithënjë se mos n' a pikasnin, u shtrëngova të ndronj embrat edhè t'emin edhè të Karllit, kështu që krejt të huaj e të pa njojtur harrimë në Shkodër e u futmë në ushtëri të Ballçejve që të dy. Në këtë mënyrë jetuam disa

vjete gjer sa lajmin e hidhur muarm të lëngatës së naltësisë s' ate edhè me një herë brothmë këtej si po na shihni që të tre. Kjo me pak fjalë, naltësi është historija jonë.

TANUSHI

Të lumtë, o Mark, more biri im i dashur, s'kam si të t'a shpërblenj këtë mirësi. Afrohu. (*Marku afrohet edhe Tanushi e përqafon e e puth në ·ballë*). Të paça bir, se edhe ty si djalin t'em të kam. Të kam në vënt të Ndrekës, ah, të Ndrekës që s'u ndoth këtu sot të më mbyllë sytë! Ah, Ndrekë Ndrekë !. . . (*Do të pasonjë po nuk munt edhè shtrihet prapë tepër i kapitur*).

KARLLI me **GJERGJIN**

Babë, gjysh· i dashur ! (*I vijnë përsipër bashkë më Mark Lalën e e fërkojnë nga pak*).

MARKU

Naltësi, babë, çohu të lutemi.

TANUSHI
(*Tyke ardhur ndër mënt*)

Këtu . . . jini . . . të . . . gjithë ?

KARLLI,GJERGJI,MARKU
(*Të trembur*)

Këtu, këtu, babë (*E mbajnë që të tre andej e këtej*).

TANUSHI
(*Tepër i vrarë*)

Burra.. . Shqyptarë. . . edhe ju ... djelmt'e ... mij ! Kujtonj... se... ora ... e fundit. .. tingëlloi ... për ... mua ! Mbrini ... ora ... që . . . do ndahemi ... për ...

jetë. Do të ... vdisnja . . . i dëshpëruar . . . po . . . sot ... po vdes . , . i lumur …. e me ... zembër... të gëzuar se po … ju ... lè trashëgimtarë ! .... Qofshi ... të . . . bekuar prej mejet e ... Zoti ... ju faltë bashkimin ... e vëllazërinë. Ruani . .. si burra nderin e ... flamûrit ... e të Shqipërisë ! (*Sillet nga Marku*). Ti Mark biri ... jem tregohu . .. babë. . . mbi Karllin ... e Gjergjin ... si u ... tregove ... gjer më sot (*i sillet Karllit e Gjergjit*). O . . . nipat e mij . të dashur ... e ... të vyer ! Sot . . po . . . vdes si ajy ... më .. . i lumuri i gjithë ... botës !. .. Bekimet e ... Zotit ... e të mijat ... mbi ju ! . . Qofshi ... gjithmonë ... faqe bardhë ! .. (*Do që të vazhdojë, po s'ka më fuq*i.*Pak pushim. Më në funt bën kurajon u fundit*). Ka…a ... rll ... Gjeee… rgj ! ... Një porosi po. . . ju lè të fundit! … Gjakun e prindve .. , t' uaj . ....të Ndrekës ... e· Irenës ... ah, ...atë ... gjak ....të vyer e. . . të . . . pa . . . fajshmë .....mos ....e .... harroni ! ... Duhet ... shpërblim! ... (*Fjalën e fundit e tonizon tingëllisht, edhè pas kësaj rëzohet mbi shtrat i vdekur*).

KARLLI

(*Me lott ndër sy*)

Babë !

GJERGJI

(*Gjithashtu*)

Gjysh!

MARK LALA

(*Tyke ju afruar Tanushit-në firomë e sheh se s'ka më shpirt*)

KARLLI me **GJERGJIN**

(*Mark Lalës e Rrok Gjulit, të cilët po venë re Tanushi*n)

Eh. si është ?

MARKU

(*Tunt kryet me dëshprim*)

KARLLI me **GJERGJIN**

(*Pa durim*)

Flisni !.:...

MARKU

(*Zè kryet me të duart e qân me zê*)

TË GJITHË

Princi jonë ? ….

MARKU me **RROKUN**

(*Krejt të dëshpëruar*)

Vdiq !!! (*Të gjithë qitin kësullet e unjin kryjet*)

FUND I AKTIT III

Akt i IV.

(Një sallë e madhe e fronit të Karllo Topisë në Krujë.
Mbi fronin shkëlqen flamûri i shtëpisë së Topejve,
një luân me tre hyje mbi krye).

SQEN' e I-rë

(Posa çohet napa dëgjohet thellë një trumbetë, pas së cilës
pason. një marsh triumfan me anë të muzikës.
Këtë marsh me këngë e përsëritin ushtarët
Shqipëtarë pa hyrë në sqenë)

Marsh i Ushtërisë
(Muzikë "La marseilleuse)

Burra, o djemt' e Shqipërisë,
Vraponi gjithë, koha s' pret,
Flamûr' i shënjt' i Arbërisë
Valon i mburur e n' a thret.
Vruli gjithë me armë si rrufe
Kundr' armikut që msyni mbi né,
Mbrini dita të shpëtojmë
Atdhenë, vendin t' onë
Dhe famën të fitojmë
Q' e patmë gjithëmonë.
O nën' o Shqipëri,
S' të lemë në robri,
Për ty rëké do derdhim gjak
O burra zjarm e flak.

(Si mbaron marshi ushtarët me gjithë bajraktarët hyjnë në sqenë tyke përsëritur strofën e fundit e rreshtohen më të djatht' e më të· mëngjër të sqenës për qark fronit. Midis të ushtarëve dallohen:Mark Lala, Zef Gjoni e Rrok Gjuli).

Ushtarë, popull e ju bajraktarë ! Dita e sotme, kjo dit' e shêjtë për nè duhet kremtue, se është dita që n' a zbardhi faqen, dita që nderoj armët t' ona e gjithë Shqipërinë !.Eshtë dita mê e shënuar për kombin t' onë, të cilin e krijuan fuqija, kuximi e qëndrimi jonë ! Sot Shqipërija, nënë krahun e hekurt të princit t'onë Karllo Topisë i zgjeroj kufit' e saja deri te lumi *Ahellôos* ose *Asprua*, trè fijsh mê tepër nga sa i ka pasur, tyke dlirë e spastrue vendin prej gjithë armiqve të huaj ! Sot me embrin e Zotit e me fuqitë t' ona kemi në duar armë e flamurë e robër të pa numuruar të armiqve t' onë ! Historisë s' onë ju shtua ajo faqja mê e shkëlqyera. E pra, mirënjohtës përpara sundimtarit t'onë të vlefshëm për këto shërbime të mbëdha që i pruri Atdheut, princin t'onë Karllon duhet sot t'a kurorëzojmë me atë kurorë që i përket një mbreti, edhe kështu mbretin e Shqipërisë t' a emërojmë. Ju ç'ka thoni, brè burra?

TË GJITHË

(*Me gëzim*)

U bëftë

MARKU

Tash pra, kur të vinjë midis nesh princi ynë Karlli, duhet me një zë t'a thresim mbretin e Shqipërisë, (t*regon një kurorë ârit*) edhë këtë të shëndritshmen kurorë me gjithë zembër t' ja vemë mbi krye. Jini në këtë mëndje?

TË GJITHË

Po, po, për Zotin!

MARKU

Rroftë, pra, madhëni' e tij Karllo Topija mbret' i Shqipërisë!

TË GJITHË
(*Me enthusiazmë*)

Rroooooftë.

SQEN' e II-të

Të parët edhè Karllo Topija

KARLLO TOPIJA
(*I rrethuar prej të vëllajt Gjergj Topisë*
e disa trimave tjerë hyn në sqenën
i veshur si princ e qëndron
mbi fronin në mes të
sallës për fundi).

Burra Shqiptarë ! Ky fitim i sotshëm piksëparit nj'atij Zoti të jetës i detyrohet që n' a ka ndihmuar e m' andej juvej e armëve t' ona kreshnike ! Me trimërinë t' uaj e me kuximin e math e të pashoqtë që pattë, Shqipërija jonë, kjo tok' e shêjtë jo vetëm krejt u dlir prej të huajve, por edhè u smadhua. Zoti ju rujtë e i prîjtë gjithënjë rrezikut atdheut t'onë!

TË GJITHË

Rroftë shtëpi' e Topejvet !

MARK LALA
(*Karllit*)

Naltësi, mbas veprave të madhënushme e fitimtare t' uajat që habitnë gjithë botën, si për shpërblim të mundimeve e përpjekjeve që treguat, populli Shqiptar, tepër i kënaqur po ju tregon gëzimin e tij të pa mastë e mirënjohtjen që ndjen përpara naltësisë s' uaj. I porositur prej këtyre baraktarëve, që janë krenat e përfaqësuësit e atij populli, e në embër të këtyre, sot kam nderin me ju njohtë si një mbret të përgjithëshmë të Shqipërisë ju kurorëzon me këtë kurorë

ârit, të cilën e meritoni. (*E merr kurorën prej një banke e ja ve Karllit mbi krye, tyke brohoritur me gjithë fuqinë*). Ty të ka hije këjo kurorë, o mbreti jonë! (*Popullit e bajraktarëvet*). Rroftë Karlli i I, mbret i Shqipëtarëve!

TË GJITHË

Rroooooftë !

KARLLI

(*I mallëngjyer*).

Ju falem nderit, o burra, jyve e gjithë Shqipëtareve edhe Zoti qoftë me nè.

TË GJITHË

Rroftë mbreti !

GJERGJ TOPIJA

Madhni! Përpara teje, ne Shqipëtarët besnikë e të bindur gjithëmonë, besën po të japim sot që do të jemi nënë urdhrin t' uaj e do mbrojmë nderin e kombit e të flamurit t' onë ; (*Unj njërin gjû e ngreh shpatën e tij përpjetë*). Betohem !

BAJRAKTARËT

(*Tyke xhveshur shpatat e tyke i bashkuar,*
unjin njerin gjû e bërtasin).

Betohemi !

KARLLI

(*Me lott nër sy*)

Ju lumtë, o burra ! (*Tyke xhveshur shpatën. e vet*). Edhë unë, përpara jysh e përpara Zotit po betohem mbi këto shpata (*e bashkon shpatën e tij me të tjerat*) se do t' i dal zot Atdheut t' onë e do përpiqem për nderin e Kombit e të flamurit t' onë. Zoti n' a qittë faqebardhë !

TË GJITHË

U bëftë ! (*Venë shpatat nër myllet e çohen*).

ZEF GJONI

(*Si prijës i ushtërisë jep urdhër ushtërisht të dalë ushtrija jashtë; dëgjohet edhè një herë burîja e ushtria del nga dalë prej sqenës tyke përsëritur strofën e dytë të marshit të parë, të cilën e shoqëron muzika*)

Strofa e dytë e marshit

Mbi ç'do pullas e ç' do fortesë
Flamuri jonë po valon;
Vraponi gjithë pa përtesë,
Mos bjerrni kohën, që kalon.
Si sokolat e rreptë dhe nè,
Lè t' a shtijem armikun për dhè,
Eshtë turp Atdheu të vuaj
Tyke pasur djem si jy
Edhe një i ndyr' i huaj
T' u qendronj' halë në sŷ!
O nën' o Shqipëri,
S'të lemë në robri,
Për ty rrekè do derdhim gjak
O burra zjarm e flak.

SQEN' e III-të

Të parët përveç ushtërisë e Zef Gjonit

KARLLI

Mbas këtaj, o burra, duhet edhe një punë tjetër të vepërojmë për të shtuar edhè me tepër lumërinë t' onë. Duhet të pajtohen edhe gjaqet, ashtu si n'a ka hije, se është turp e mëkat të derdhet kot gjaku i Shqipëtarit e jo atjè ku duhet. Si vëllezër që jemi duhet t' i harrojmë mëritë e të përkrahim shoqi-shoqin. Sot këtë dua prej jush, pajtimin e gjaqeve; pra një nga jyve lè t' a marrë përsipër këtë barrë.

GJERGJI

Jepni urdhër, madhni, edhè vetë po e marr sipër këtë barrë.

KARLLI
(*Gjergjit*)

Të lumtë, i dashur vëlla. (*E puth në ballë*). Lêjen e kè prej meje edhè nisu, po të duash ca me parë tyke zgjedhë edhe shokët e pleqtë që pëlqen. (*Gjergji përshëndet Karllin fillon të dalë po ne dera haset me Tef Muzakën*).

GJERGJI
(*Karllit*)

Një shtektar. (*Tef Muzakës*). Urdhroni, zotni.

TË GJITHË
(*Tyke parë Muzakën*)

O ! ... Muzaka !

KARLLI

Urdhro, Tef Muzaka, mirë se të pruri Zoti.

SQEN' e IV-të

Të parët edhe Tef Muzaka

MUZAKA

(*Tyke salutuar Karllin*)

Madhni të qofsha falë edhè më falni në qoftë se ardhja ime e papritur vjen t'ju trazonjë gëzimin t' uaj edhè këtë të bukur kremtim të sotmë. Pa dyshim do të habitet gjithcili, tyke parë sot mua Tef Muzakën në mest t' uaj me një ngutësi kaqë të madhe; po mbassi të kini mirësinë të më dëgjoni shkakun që kam ardhur, do më jepni të drejtë.

KARLLI

Urdhro folë.

MUZAKA

Vinj prei Durrësit tyke ngarë në pikë të vrapit për me lajmue me të shpejtë madhninë t' uaj për gjendjen e ndollinat e reja për me marrë masat e duhura t' i bëjmë ballë rrezikut të math që n'a shkrepi.

KARLLI

(*Me habí*)

Ç' është, Tef Muzaka ?

MUZAKA

Sunduësja e Durrësit, princesa Elena, si këshilltarin e saj që më ka pasur, më besoj një të fshehtë me rëndësi.

KARLLI

(*Fort i interesuar*)

A munt të n' a thuash ?

MUZAKA

Princesa Elena, madhni, e shtyrë prej Robert Guiskardit, mbretit të Naplit e ish em zotit, për me u çfaqë armike kundra Shqipëtarëve e me ju râ befas mbas shpinet bashkarisht për me ju çkatërue e me zaptue tokën arbnore, lidhi aliancë më këtë Robertin.

TË GJITHË

O, trathti !

MUZAKA

Trathti vërtet, o burra, para një bamirësit të saj si Tanush Topisë!

KARLLI

Folë, o Muzakë, folë.

MUZAKA

Tyke parë fitimet e mbëdha e të pashoqta të madhnisë s'uaj e tyke u trembur se mos edhè vetë ndodhet në rrezik nesër, Robert Guiskardi shpërndau shumë të holla edhè me shumë premtime e bindi princesën Elenë për me çpallë luftë kundra jush e me ju msye që të dy befas e pa pritur, si në tokë ashtu edhè në det. Mjerisht, në këtë qellim dëmprurës, madhni, kanë mundur të tërheqin edhè një mikun t'uaj, një mikun e shtëpisë s' uaj.

KARLLI
(*Me kurreshtim*)

Si thè, si thè ? Miku i shtëpisë s'onë ?

MUZAKA

Si urdhron, madhni !

KARLLI
(*Gjithashtu*)

E kush ësht' ajy, të lutem ? Folë për Zotin, folë.

MUZAKA

Gjê e pa mbesuar. (*Unj kryet*) Princ Ballça i Shkodrës !

TË GJITHË

Ballça?

MUZAKA
(*Popullit*)

Po, po, Ballça ! (*Zhurmë midis të popullit Mark Lala bisedon me nga dale e me ngutësi me bajraktarë*)

KARLLI
(*Me hidhërim*)

Gjergj Ballça kundra nesh ? Mos e thuaj atë fjalë, brè burrë! Oh, sa më vjen keq !

MUZAKA
(*Tyke vazhduar*)

Posa ndjeva këto fjalë, nuk m' u durua, por brodha me të shpejtë nga këto megje, tyke lënë mbas doret vendin t' em edhè zonjën t' eme princesën për me ju kallzue çështjen madhnis s' uaj. E njoh Robertin shumë bukur se i shërbeva kaqë vjete.I di mendimet e qellimet e tija.Pra, tue peshue hollë rrezikun që munt t' i shkrepë Shqipërisë, kujtova se është detyra jeme, t' a bënj të ditur një sent të këtillë madhnis s'uaj. (T*yke i dhënë rëndësi fjalës*). E di se këjo që po vepronj është një trathti. por trathti nuk bën, jo, ajy Shqipëtar që si Shqipëtar mundohet te shpëtonjë atdhen' e tij të dashur !

TË GJITHË

Të lumtë !

KARLLI

Të falem nderit, o Tef Muzaka . Jo, nuk është nje trathti kjo sjellja jote faqe këtij atdheu ! Bëre shumë mirë që n' a i tregove të gjitha. (*Me vehte*) Për Robertin nuk çuditem. Po princesa Elena të shtyhet gjer atje ? Sa keq ! ... Ç' ka .... Keq vehtes saj po i bën ... Po Ballça, Ballça? ... Ah sa e dobët trathti ! ... Kurrë s'e pandehnja! ... Si ngjau kështu kjo punë? (*Me një guxim*) Lè të urdhrojnë, lè të urdhrojnë të matemi (*Muzakës*). Po Shqipëtatët e Durrësit e të rretheve ç' thonë?

MUZAKA

Ata janë me ju, madhni, edhè m' i pari jam unë. Përpara se të lè Durrësin kam folur me krenat e tyre, e po e qetësonj madhninë tënde se ata ju kanë dhënë besën juvej e kanë me luftue rrebtësisht ç'do armik të Shqipërisë. Pllani nga an'e tyre është gati, veç jepni kushtrimin së këtejmi.

KARLLI

Të jam mirënjohës, o Tef Muzaka, në embër të kombit për të mirën që po i bën. Kombi nuk t'a harron kurrë këtë shërbim të math. (*I sillet Mark Lalës*). Lajmoni an' e kant të gjithë bajraqet e fiset t' ona të pregatiten sa mê shpejt. Eshtë nevoja të mos i lemë të n' a msyjnë po t'i msyjmë ne mê parë. Si të jenë gati të gjitha ahere jepni kushtrimin. (*Mark Lala me të tjerët përveç Tef Muzakës dalin jashtë me ngutësi tyke salutuar Karllin. Si dalin i kthehet Muzakës)* Ti Tef Muzaka, që me këtë veprën e sotme atdhetare n'a shpëtove prej një rreziku të papritur që do n'a shpërthente mbi krye, merr kryesinë e ushtërisë së Durrësit në mos kini tjetër prijës e jini gati kur t'ju thresim ne. Udhën e mbarë, pra, (*i shtrëngon dorën*) u pjekshim dhëntë Zoti, në Durrës me një fitim të plottë. (*Tef Muzaka tyke u ûnjur përpara Karllit del edhè ky jashtë*).

SQEN' e V-të

KARLLI

(*Vetëm*)

(*Tyke patur duart prapa*
shetit posht e lart i mentuar).

Qënka shum' i math cmiri e lakmimi i të huajve mbi Shqipërinë ! Të gjithë këtej e paskan synë. Roberti nukë rri qetë kurrë. Gjithëmonë i do vendet t'ona ! Këtë radhë lufton edhè prej frike se mos forcohemi ne …. ç' ka ... Po princesën Elenën si e shtynë në këtë· punë ? Si u gënjye ? Nuk mentohet se nesër do bëhet një kafshatë e Robertit e do gllabërohet prej tij ? O, sa mëndjeshkurtë që po rrëfehet e sa mirëshkelëse faqe shtëpisë s'onë. Ah, Robert, Robert, edhè s'e paske harruar Durrësin. (*Tyke u sjellë andej e këtej*). Për Gjergj Ballçën s' m' a merr akoma mëndja pse të bashkohet ky me armikun t' em, me armikun me të math të Shqipërisë, po edhè me armikun e gjerdjeshmë të tij! Shqiptar ky kundra Shqipërisë kjo është një çudi çudije ! Ç' farë fitim do ketë prej kësaj lufte ? Si u gënjye kështu ? Ç' pret prej Robertit, prej një të huaji ?... Oh, trathti, trathti e poshtër ! ... Po durim. Ç' do gjê munt të ngjasë në këtë shekull ! Puna ka shumë rëndësi për mua e shumë me duket e vështirë. Në qoftë se s'e fitojmë këtë luftë jemi të fikur kryekëput ! (*Me një pikëllim të math*). Ah, Robert, Robert, o gjysh gjaksor e i pa shpirtë ! O, ti që s'je ngjinjur èdhe së derdhuri gjak ! Me ngjan se këtë herë fati po të shtyn nga bregu i Shqipërisë. Ajy gjak i pa fajshmë gjaku i prindve të mij që u derth prej duarve të tua gjaksore lyp shpërblim, shpërblim ! Me duket se afron koha të shpërblehet. Këtu, pra, eja o gjakpirës, këtu po të pres ! Zoti i Shqipërisë nuk do t' a lerë doret këtë tokë të shêjtë. Nuk u turpërua kurrë Shqipërija, as do turpërohet. (*Me zembrim*). Eja Robert Guiskardi, eja se për Zotin këtë radhë nuk besonj të dalësh i gjallë prej kësaj Shqipërije ! S'e kam harruar jo, as do t' a harronj kurrë gjakun e prindvet, porosinë e gjyshit t' em Tanushit.

FUND I AKTIT IV

Akt i V.

(Saloni i princesës Elenë në Durrës, i shtruar pas zakonit venetikas. Dy flamurë të Shqipërisë mvarur kryqazi andej e këtej fronit)

SQEN' e I-rë

(*Karllo Topija mbassi ka mundur armiqt' e vet*
edhè tyke pasur zënë robër lufte
Robertin e Ballçën kthehet
triumfisht në Durrës)

Karlli, Gjergj Topîja, Mark Lala, Muzaka, Rrok Gjuli e shumë krerë e bajraktarë.

KARLLI

(*Me fytyrë të qeshur*)

Vullneti i Zotit na qiti prapë faqebardhë ! Shpëtuam prej më të madhit rrezik, prej save i ranë mbi krye Shqipërisë. Armiqtë u thyen liksht e sot Durrësi gjindet në dorë t'onë. Princesa Elena mundi e shpëtoj me anijet e Robertit tyke kapërxyer në Itali, pa pasur më shpresë se do t'ja shohë sytë Shqipërisë. Mjaft ky dënim për atë. Mbret Roberti edhè princi i Ballçajve ranë lumërisht në duart t'ona si robër lufte. Keq shumë më vjen për tradhtin' e Ballçës po jo edhè për Robertin. Ajy ç' kërkoj e gjeti. Angushtimi që tash sa vjet më shtypte krahnorin, porosija e vlertë e t' em gjyshi Tanushit, hijet e shêjta të prindve të mij që nat'e për natë më çfaqeshin në ëndër tyke lypur shpërblim, sot janë të kënaqur prej mejet. Ankthi s' më trazon më edhè gjyshi jem çlodhet e prehet në varrin e tija. Roberti e lau gjakun ! (*Tyke unjur kryjet*). U vrâ prej dorës s' eme! .... (*Me një hidhërim)*. I math është vërtet mëkati që bëra se vrava gjyshin t' em. Njollë për një mbret të Shqipërisë të lyej duart e tija në gjak, edhè gjak fisi ! Ishte një gjë e keqe këjo për mua, po ishte një detyrë mbas zakoneve shqiptare ! (*Me*

zembrim). Po, vrava giyshin t' em, po…. mora gjakun e prindvet ! (*Populllit*). E ju o burra, duhet të gëzohi sot, se me embrin e Zotit kemi kryer atë më të madhen detyrë faqe kombit t' onë. për të cilën krenare e madhështore do flasë një dit historija jonë. Armët t'ona nuk do vdesin kurrë. Burrnija shqipëtarë do jetonjë sa edhè shekulli tërë e ruzullimi ! Zoti bekoftë armët t' ona e i prîjtë ç'do rrezikut Shqipërisë ! (*Sillet nga an' e bajraktarëve, të cilët për të parën herë vijnë të bashkohen nënë flamûrin e Karllo Topisë*) Burra bajraktarë e ju krena të fiseve Shqipëtare të Toskërisë, miq e aleatë t'onë, që ndihmën bujare t'uaj s' n'a e kursyet në këtë luftë, juve u qofshim falë. Me ju bashkë u fitua këjo luftë, andaj kini të drejtë të plottë të mburreni. Bashkimi jonë i paskëtajmë do të jetë tmeri i armiqve t'onë. Mburrem edhè vetë që kam shokë trima si ju e bashkë me ju do jem gjithënjë i lumur. Rroftë bashkimi jonë !

TË GJITHË

Rrooooftë !

SQENË II.

Të parët e Zef Gjoni

ZEF GJONI

(*Tyke hyrë salluton*)

Madhni, kam ardhur me marrë urdhrin t' uaj; ç'urdhroni t'i bëjmë ushtarët robër të Robertit që kemi në dorë ? Ata sa do që janë robërit t'onë, n'a shajnë shumë liksht e ushtarët t' onë, që s'janë msuar të mbajnë kësij pluhuri përsipër, nuk mbahen dot; duan të msyjnë mbi ata e të mos lenë këmbë. Tash, a urdhroni madhnija juaj t'i përshkojmë një nga një të gjithë nënë shpatën t'onë ?

KARLLI

(*Tyke u hedhur vendit*)

T'i përshkojmë nënë shpatë ? Ç'ka po flet, Kapitan ? A mos ke lujtë mentsh ? Ne me i përshkue nënë shpatë ? Zoti mos e dhashtë ! Këtë gjë e bën

një barbar e jo Shpiptari ! Po dëgjo këtu, Kapitan. Ju t' i kini kujdes mirë ushtarët e zyrtarët e Robertit e t'i ushqeni si duhet. Mos vini re se ç'thonë e pse ju shajnë. Ju duhet të tregohi fisnikë që të shohin e të njohin të huajt bujarinë Shqipëtare. Pra nesër t'i qitni këta jashtë kufive t'ona edhè armë e ç' tjetër lënde lufte që kini zaptuar prej atyreve t'i ndani si pas zakonit në· mest të ushtarëve t'onë.

ZEF GJONI

(*salluton*)

T'u ngjatë jeta, madhëni.

KARLLI

Sa për ushtarët robër të princ Ballçës, këtyre kini me ju ndalë vetëm armët e me ju lanë ç'do pasuni tjetër që kanë. Do t'i lini krejt të lirë të sillen në për qytet pa i sharë e pa i përbuzë as pak. Mos harroni se këta janë vëllezrit t'onë e një dit do jenë shokë me ne e do bashkëluftojmë. Princ Gjergj Ballcën mbajeni mirë me nderimet q'e meritojnë si princ. Si të qetsohemi do flas me 'të veçanërisht. Tani më kuptove, besoj, vepëroni pra.

ZEF GJONI

U bëftë urdhri i madhnisë s' ate. (*Del jasht*).

SQEN' e III-të

Të parët përveç Zef Gjonit

KARLLI

Për princ Ballçën ç' po thoni ju, o burra ? Vërtet ësht' e dobët pabesija e tij kundra nevej se pa një shkak u bë mik i armiqve t' onë për shkatërimin t'onë. Po me gjith' atë me folë të drejtën u bë një gabim e mua s' m'a thotë kurrë zembra për me ndëshkue një kësi farë burrit. Sot tyke qënë një nevoj'e madhe bashkimi, kisha me thënë se këtë gabim duhet t' ja falim. Ç'thoni ju ?

MARK LALA

Mirësija e shpirtmadhnija juaj janë të njohura an' e kant, madhni, edhè prindët e shtërgjyshët t' uaj gjithë këtë zembër kanë pasur. E Ballçajve shtëpija e dëgjuar ka habitur gjithë botën me trimëritë që ka treguar, e në qoftë se princ Gjergj Ballça u gabua këtë herë, nuk ësht' e drejtë të harohen shërbimet e tjera që i ka prurë shtëpisë s' uaj. M' a fal madhni, se po flas në këtë mënyrë, po këto i di e i çmonj vetë sikurse edhè shumë prej këtyre bajraktarëvet i dijnë dhe i njohin. E kështu kur flas, flas për të mirën t' uaj e të fronit t' uaj.

RROK GJULI

Edhe mua më jep lêjen, madhni, t'ju thom se falja e princ Ballçës, është një nder i math për ju e një shërbim i paçmuar për gjithë Shqipërinë.

KARLLI

E ti ç'po thua o Tef i Muzakës ?

TEF MUZAKA

Si të madhnisë s' uaj fjalët e urta ashtu edhè të Mark Lalës e të Rrok Gjulit këshillat e mira i gjenj fort të arësyshme e të pëlqyera ! Kam shpresë edhè unë se, Gjergj Ballça si trim e madhështor që është e zember mirë e bujar, kush e di një ditë si ka me ja u shpërblye këtë mirësi që do t'i rrëfeni sot edhè kush e di sa i vlefshmë mik e shok ka me qenë për madhninë t' uaj.

Një bajraktar

Këtë luftë, madhnija juaj e bëri më fort për me përzënë të huajt e me pastrue Shqipërinë prej armiqve të saj. Tani mbassi rrëziku kaloj; duhet të jemi miq me ç' do Shqipëtar edhè ca mê tëpër me shtëpin' e dëgjuar të Ballçajve.

KARLLI

E ju të tjerët ç' thoni ?

TË GJITHË

Të falet !

KARLLI

Bukur fort. Ahere jemi të gjithë më një mëndje që Gjergj Ballça duhet falur.

TË GJITHË

Po, po.

KARLLI

Po unë, po të doni, shtonj edhè një tjetër, që jo vetëm duhet falur po edhè duhet bërë mik e aleat me ne.

TË GJITHË

Rroftë mbreti ynë !

KARLLI

Rroftë bashkimi !

SQEN' e IV-të

Të parët, Zef Gjoni

ZEF GJONI

(*Tyke hyrë*)

Madhni, urdhrat që më dhatë u kryen një nga një të gjitha. Tash marr nderin me lajmue madhninë t' ate se ka një orë që ka ardhur në ketë pallas një shtektare, një zonjë, e cila ka ca fjalë t' i thotë madhni së s' uaj, porse veçanërisht, e ju lutet t'i jepni lêjen të hynjë këtu brenda.

KARLLI

Një shtektare ? Një zonjë ? E do me folë me mua ? Po cila është ajo, kapitan, nuk t' a tregoj embrin ?

ZEF GJONI

Me të vërtet nuk e njoh, e sado që e pyeta për embrin nuk ka dashur të m'a kallzonjë, veç më tha se ka fjalë të veçanta me madhninë t'uaj për një çështje shumë me rëndësi.

KARLLI

Ç'ka. Ahere thuaji të urdhëronjë. (*Popullit*). Ju lutem të urdhroni pak në dhomën tjetër sa të shohim ç' do kjo zonjë e ju lutem të më ndjeni. (*Të gjithë dalin jashtë*).

SQEN' e V-të

Karlli pastaj Katerina Ballça

KATERINA

(*Tyke hyrë brenda*)

Madhnisë s' uaj ditet i qofshin të gjata e Zoti ju prîjtë rrezikut. (*Saluton tyke u ûnjur*).

KARLLI

(*Për pa e njohur*)

Mirë se vini e ndershmja zonjë, urdhroni, ju lutem. (*I tregon fronin*).

KATERINA

(*Me zê vaji*)

Ndjesë të madhe lypinj prej madhnisë s' ate për këtë trazim.

KARLLI

Mos e folë, o lum zonja, atë fjalë. Jam nënë urdhrin t'uaj gati t' ju dëgjonj psè kini ardhur. Po më falni, në qoftë se kam kurreshtimin t'ju pyes, me cilën kam nderin të flas ?

KATERINA

Jam një grua e mjerë, që sot me lott nder sŷ vinj t'i lypinj një nder madhnisë s'ate.

KARLLI

Urdhro e folë.

KATERINA

Kam një vëlla të dashur, i cili sot është rob lufte në duart e madhnisë s'uaj. Ardha t'i lutem shpirtmadhësisë s' ate, në embër të Zotit të kini mirësinë t' i falni jetën.

KARLLI

Po të lutem, o zonja ime, kush është ky vëllaj i juaj nuk më thoni?

KATERINA

Jam tepër e drobitur e e trishtuar prej hidhërimit, andaj duket s'më njeh madhnija juaj, ndryshe shpesherë më ka parë e kam pasur nderin të flas me atë. Vllaj im, pra, madhni është princ Gjergj Ballça !

KARLLI
(*fort i habitur*)

E motr' e Princ Ballçës . . . Princesa Katerina …. (*Ulet prej fronit*). Princesa Katerina këtu e unë s'e ditkam? ... M' a fal naltësija jote habitjen t'eme. Kaluan kaqe vjete e gati s'ju njoha as pak. (*E zè për dore*).Oh, i lumur jam që po të shoh e po të dëgjonj zërin, o princesa ime, atë zê kaqe të njohur e kaqe të vjetshëm për mua, që aqë mirënjohtës jam parpara naltësisë s' ate. Mirë se të pruri Zoti, pra o princesë. dhe po e ndjenj veten tepër të gëzuar që po ju shof edhè një herë. Mirë se n'a ardhe.

KATERINA

Mirë se ju gjënj madhni,o Karllo Topîja, mbret i gjithë Shqipërisë. Jam edhè un gjithashtu e lumur që po ju shoh në këtë shkallë të madhënushme, i lutem Zotit të math t' ja u lartësonjë edhè mê tepër. Ndjenj gëzim të math që po ju shoh edhè një herë, ndonse më ka mbytur hidhrimi për vëllanë t' em të dashur që e kam rob në duar t' uaja. Me gjithë që im vëlla u shty në këtë luftë kundra jush prej atij Robert Guiskardit, po ju siguronj madhni se bëri një gabim e s' di si u ndoth e dha fjalën, po më fort ajy pati frikë mos thyheshit e kështu s'desh të ishin vetëm të huajt zotnuës të Shqipërisë pa qënë edhè një princ Shqipëtar brenda, se ahere Roberti, si të thyente fuqinë t' uaj, do thyente edhè fuqinë t'onë e do ishin Normanët sunduësit e kësaj toke, një sent që ishte rrezik i math për gjithë Shqipërinë. Ky ish shkaku me fort që e shtyri t'em vëlla në këtë luftë.

KARLLI

Po ju dëgjoj me verejtje të madhe, princesë, e me kënaqësi.

KATERINA

Me gjithë që shkaqet ja tregova madhënisë s' ate, prapë po e siguroj se për Shkodrën e rrethet e saj e për shtëpinë t' onë këto fitimet t'uaja janë të pa çmuara. Janë një shpresë e një uzdajë për ne të gjithë, për paravajtjen e lumtërin' e Shqipërisë ... (*Tyke qarë*). Po, desha të di, madhni….. a është gjallë im vëlla ?

KARLLI

Eshtë fjalë kjo për të folur, o princesë ? Gjergji i Ballçës yt vëlla e miku e bamirësi jem, ësht' e mundur të pësonjë gjê në duart e mija ? Ah, jo, moj princesë. Ti e di fort mirë, se nè Shqipëtarët as armiqtë t' anë nuk i prishim, jo ata që kemi vëllezër e gjak. Si ja u nxuri goja atë fjalë për nè ? Tash do t' a shohsh këtu përpara teje t' ët vëlla, e do gëzohesh.

KATERINA

(*tyke i rënë ndër këmbë*)

O, ti shpirtmath, o bujar i bujarëvet !

KARLLI

(*tyke e ngritur përpjetë*)

Princesë, ç'bën ashtu ? Ti të unjesh përpara meje ? Ti një princesë e bijë Ballçave ? Çohu, të lutem. zembra s' m' a pranon kurrë një gjë të këtillë!

KATERINA

(*me lott ndër sy*)

Ty Zoti të madhnoftë ! A ja fali fajin madhnija jote ?

KARLLI

Jo vetëm ja fala, po as dua me të bënj fjalë për këtë ngjarje. Tash e sheh edhè vetë. (*Bërtet*). Të vinjë një këtu.

SQEN' e VI-të

Të parët, Zef Gjoni

ZEF GJONI

Ç'urdhroni, madhni ?

KARLLI

Kapitan, shko e m'i thuaj nga ana jeme princ Gjergj Ballçës të urdhronjë. Ti do t' a shoqërosh deri këtu.

ZEF GJONI

(*tyke salutuar*)

Po shkonj madhni për të zbatuar urdhrin (*del*).

SQEN' e VII-të

Të parët për veç Zef Gjonit

KARLLI

Midis të trishtimit që më ka mbuluar zembrën kaqë vjet, sot dërgoj Zoti naltësinë t' uaj për ngushëllimin t' em ... Tani që po të shoh e që jemi vetëm, më vjen ndër mënt, o princesë, ajo jeta e bukur e kalume ato ditët e bardha e të lume që pranë jush kam shkuar. Unë kurrë s' munt t' harronj shtëpinë t' uaj edhè lumërinë që kam pasur tyke qënë pranë juvej. Pra po ju thom se vëllaj yt e vëllaj im princ Ballça është i lirë prej meje edhè për pak po t'a paraqit e po ta fal, o princesa ime.

KATERINA

Unë nuk di, as nuk gjenj fjalë si me ju falë nderit madhnisë s'uaj për këtë mirësi të madhe e të pa treguar. Ju jam mirënjohtëse për sa të jetë jeta.

KARLLI

Sot, o princesa ime,kujtonj se po n' a çilet një tjetër rrug'e re për fatbardhësinë t'onë e përgjithërisht për fatbardhësinë e Shqipërisë mbanë. Princ Ballça, edhè përpara se t' ja thom vetë besonj se do t' a ketë njohur nevojën e madhe për t'u bashkuar që sot e tutje me ne Shqipëtarët e tjerë e për t'u lidhë në besë. Shkodra kreshnike me malësit' e saja po të bashkohej me fuqitë t' ona, Shqipërija do bëhej një mbretni e zonja t' i bënte ballë ç'do armikut të përjashtëm. Pra do ishte një sent i mrekulluëshëm bashkimi i përgjithmë i Shqiptarëve. Principata juaj me Tivar e Ulqyn me Tuz e Gusinjë e Pllavë e rredhet e tjera është mjaft e gjërë, kështu që, një bashkim i plottë, e me një vetëqeverim si pas zakoneve t' ona të vjetra nënë një flamur do ishte një fortesë e çeliktë për Shqipërinë. Këtë duhet t' a kthellojë mirë princi yt vëlla.

Po tash mjaft folmë për këtë çështje. (*Tyke qeshur*). Princesë, a të bije ndër mënt pak ajy Gjoni i Kol Marrës, ruajtsi juaj besnik atje përtej në Shkodër dikûr ?

KATERINA

(*tyke kuptuar domethënien e fjalës*)

Po, madhni, un' as pak s'e kam harruar atë Gjonin e Kolë Marrës ose Karllon e Ndrek Topisë të sotshmin, po as atë fjalën e mshehtë nuk e kam harruar, fjalën që i besova karakterit të tij fisnik.

KARLLI

(*tyke qeshur*)

Edhè Gjoni, ose Karlli, Katerinë, edh' ajy beso se nuk i ka harruar as sot ato fjalët t' uaja të fundit që ishin aqë të ëmbla e të kthellta. Ahere nuk njihte fisin e tij të vërtetë e nuk kish kuxim të fliste, por sot, Katerinë, në qoftë se e ka mbajtur besën edhè propozimin e princesës e pranon me gjithë zembër, ti ç'kishe me i thënë, o princesë ?

KATERINA

(*me buzën në gas*)

Unë jam edhè tani, madhni, në atë mendimin e parshmë; mbassi Gjon Marrës atë fjalë ja dhashë asokohet edhè Karllo Topisë gjithashtu sot po i jap zembrën.

KARLLI

(*tepër i enthusiasur*)

Sa i lumur jam që po i dëgjonj këto fjalë, o Katerina ime. A e do përnjëment Karllin, o princesë, a po ëndër është këjo që po shëkonj ?

KATERINA

Mos dysho as pak, o·i dashuri im, se Katerina është krejt e jotja qysh ahere edhè sot !

KARLLI

(*jashtë vetes së tija*)

O Katerinë !

KATERINA

Në ka për mua ditë më të bardhë është këjo e sotmja. Ndofta edhè ti, o Karlli, nuk munt t'a mendosh kurrë se sa të ka dashur e të do Katerina jote. Beso se këto fjalë dalin prej thelbit të zembrës s'ime !

KARLLI

Këto fjalët e tua, Katerinë, gati sa s' më marrin mendjen ! Më dehin e më ballsamojnë zembrën, zembrën e varfër t' ime që po t'a fal sot pênk të dashurisë s'onë ! Zoti i math duket e ka thënë që të bashkohemi ne të dy.Ajy e bekon këtë bashkim të shêjtë. Qysh tash ti jè, gruaja ime, Katerinë ! (*I jep dorën e e puth në ballë*) Qysh sot jemi të bashkuar të dy e të pa ndarë.

KATERINA

(*tyke ngritur duart përpjetë*)

O Zot, të qofsha falë, sot ëndra ime u realizua !

SQEN' e VIII-të

Të parët, Zef Gjoni e Gjergj Ballça

ZEF GJONI

Madhni, princ Ballça qendron në dhomën për bri, tyke pritur urdhrin t'uaj të paraqitet.

KARLLI

Lè të urdhronjë; edhè ti o Zef Gjoni. shko e m' u thuaj gjithë parësisë e krenave të tjerë që kanë ardhur se po i pres këtu. (*Zefi del tyke hyrë princ Ballça*). Urdhroni, o princ brenda.

KATERINA

(*tyke parë të vëllanë*)

O vëllathi jem ! (*i sulet për qafe*)

GJERGJ BALLÇA

(*tyke salutuar Karllin*)

Zoti ju rujtë e ju shtoftë fatbardhësinë, madhni. (*Fillon të unjet gjunjazi, po Karlli zbret prej fronit edhè e ngreh, tyke i treguar një fron për të ndënjur, afër Katerinës*).

KARLLI

Jo princ i Ballçës, ti s' munt të ulesh përpara· meje. Je Shqipëtar e vllathi jem e miku i vjetër i shtëpisë s'onë. Më tjetrën anë unë kam ngrënë bukë në shtëpinë t' uaj e kam·qënë në shërbimin t'uaj, pa ditur fisin t' em;këtë s'munt t'a harronj, andaj edhè një përvujtje të këtillë nga ana jote nuk e pranonj.

BALLÇA

Zoti madhënoftë edhè më tepër madhninë t' uaj. Me të vërtet shpirtmadhësija juaj nuk ka shëmbëll. (*Katerinës*). E ti, o e dashura motër, qysh paske ardhur këtu ?

KATERINA

Për ty, o i dshur vëlla, ardha t' i bije në këmbë madhënisë së tija.

BALLÇA

(*i shtrëngon dorën*)

Oh, motra ime e dashur !

KATERINA

Madhëni' e tija më gëzoj tepër kur më tha se të ka falë.

BALLÇA

(*tyke ngritur duart përpjetë*)

O ty të faltë Zoti, o vllastar fisnik i Topejvet,o mbret shpirtmath i Shqipërisë !

KARLLI

(*Ballçës*)

Je i falur e i lirë, këtë po t' a thom edhè vetë, edhè çështjen ose gabimin si do që ndodhi lè t' a harrojmë mê mirë e të mos e zemë ngoje. Sot duhet folur për të tjera punë.

BALLÇA

Ju falem shumë nderit, madhni, e jam gati t' ju dëgjonj me gjithë zembër për ç'do sent që të urdhroni.

KARLLI

Sot është nevoja me tepër se tjetër herë i një bashkimi të përgjithëshmë. Zotrote e di fort mirë se sa rëndësi ka ky bashkim sot për gjithë Shqipërinë, të rrethuar an' e kant prej armiqve shekullorë. Po të pyes pra a je i këtij mendimi edhè zotrote ?

BALLÇA

Qëllimi është tepër i shênjtë e i madhnushmë, o madhni; edhè unë këtë bashkim e besë e kam dëshiruar kurdoherë me gjithë zembër edhè ca mê tepër sot. Unë qysh tash po ju jap fjalën e besën që jam i bashkuar plotësisht me ju, edhè si princ i Shkodrës e i Tivarit, madhëninë t' uaj po e njoh për mbretin e Shqipërisë mbarë.

KARLLI

(*tyke i dhënë dorën*)

Ahere Zoti e bekoftë këtë bashkimin t' onë për të mirën e Shqipërisë.

KATERINA
(*tyke ju bashkuar duart*)

Ju lumtë si burra edhè ky bashkim kurrë mos u çartë.

KARLLI
(*plot gëzim*)

Tash, vëllaj im i dashur, një tjetër gëzim vinj të të çfaq për të cilin edhè ti do gëzohesh, kujtonj, pa masë.

BALLÇA

Urdhno, madhni.

KARLLI

Për me u lidhë edhè mê fort e me qënë vëllezër të dashur, për me u bashkue edhè mê mirë dyert t' ona, të cilat kanë qënë mike e ndihmëse me njëra-jatrën për gjithmonë, unë, tyke çmuar talentat e virtutet e sjelljet bujare të motrës s'uaj së dashur, princesës Katerinës, po vinj me të kërkue dorën e saj, mbassi vendosa t'a marr për grua. Ti ç'thua, a e pëlqen këtë bashkim ?

BALLÇA

O, madhni, o vëllathi jem, këjo për mua është një lumëri e pa mastë. Motra ime në gjithë botën s'kishte me gjetë një fat mê të mirë se këtë. E di fort bukur sa e lumur e fatbardhë do të rronjë me ju. S'ka si bëhet mê mirë. Unë s'kam tjetër përveç se me bekue këtë bashkim kaqe të vlefshmë e të pëlqyer. Ju uronj, pra, jetë të lumur e fatbardhë. Rrofshi e qofshi si ju dashtë zëmbra e Zoti jµ shtoftë dashurinë. (*Ju merr duart të dyve e i bekon*).

KARLLI me **KATERINËN**

Ju falemi nderit fort.

SQEN' e IX-të

Të parët, Zef Gjoni, Gjergj Topija,
Mark Lala, Rrok Gjuli, Tef Muzaka
e bajraktarë e popull
(*Të cilët hyjnë grumbull brënda e*
rrjeshtohen më të djathtë e mê të mëngjër)

KARLLI

Burra Shqipëtarë e ju populli im! Me gëzim të math po ju paraqit dy ndollina të bukura e të pëlqyera, të cilat shpresonj se do t'i aprovoni që të gjithë, e do gëzohi fort. Sot princ Gjergj Ballçën jo vetëm e falmë e e liruam, por edhè me besë u lithmë me 'të për gjithëmonë nënë një flamur për mirësinë e paravajtjen e kombit t'onë !

TË GJITHË

Ju lumtë ! . . . Rroftë bashkimi !

KARLLI
(*pason*)

Përveç kësaj, edhè një tjetër gëzim po ju lajmëronj. Sot kësaj zonje fisnike (*rrëfen Katerinën*) princesës Katerinë të Ballçës i dhashë dorën e kjo më dha zembrën e me pëlqimin e princ Ballçës, të vëllajt të saj, u bashkuam për gjithëmonë si burr' e grua. Që sot e tutje këjo është mbretëresha juaj, mbretëresha e Shqipërisë !

TË GJITHË
(*me enthusiasmë*)

U trashëgofshi.

RROK GJULI

Një hêr e me jetë !

TEF MUZAKA

Rroftë mbretëresha jonë !

TË GJITHË

Rrooooftë !

GJERGJ TOPIJA

Rroftë bashkimi !

KARLLI
(*me gjithë zënë*)

Rroftë Shqipërija !

MARK LALA
(*tyke puthur në ballë Karllin e Katerinën*
e më lott nër sy tepër i mallëngjyer)

O Zot …. tash lè …. të vdes !

FUND I AKTIT V E I DRAMËS

KRISTO FLOQI

TRIUMFI I LIRISË

DRAMË KOMBËTARE

në 4 akte e në një tabllô



Shtyp. & Libraria **DHORI KOTI**, - Korçë
1938

IPOTHEZA E DRAMËS

Në shtëpi të nasionalistit Skëndo Gjatës në Vlorë bëhet një mbledhje e fshehtë prej disa patriotëve, të cilët vendosin dhe formojnë një komitet kryengritës me qëllim "Çlirimin e Shqipërisë nga tiranija shekullore turke". Komplotistët betohen mbi Flamurin se do përpiqen me ç' do therori për shpëtimin e Atdheut. Por disa Shqiptarë sulmojnë e zaptojnë zyrën post-telegrafike të Vlorës, kapen ashpërisht me disa oficerë turq dhe i flakrijnë poshtë, tuke i hedhur nga ballkoni, e tuke i gremisur nga shkallët ! Njëkohësisht një rojtar Shqiptar i dêpos ushtarake vret dy oficerë, sepse këta e shajnë rëndë. Punët marrin zjar dhe autoritetet e Vlorës me zembrim të math fillojnë ndjekjet kundra nacionalistëve, tuke i burgosur, tuke i internuar, ose edhe tuke i shkuar në litar ! Kaimekami i Vlorës, Hajdar bej Kaloshi, krutan, vjen personalisht në shtëpinë e Skëndo Gjatës, të cilit i heq verejtjen ashpërisht, take e trembur e tuke e kërcënuar. Po Skëndua revolton në këto fjalë, si patriot, dhe me një gjuhë bindëse e dezarmon kajmekamin dhe më së fundi e bën të pendohet e të bashkohet me nacionalistët e tjerë!

Skëndo Gjata ka një çupë të vetëm, Lulen, rritur me ndjenja kombtare, po mjerisht martuar me një turçelli, një farë Musajt, i cili është spiun i Xhonturqve dhe i cili u tradhëton atyre ç' do lëvizje te Shqiptarëvet. Ky, midis të tjerave tradhton dhe të vjehrin Skëndon, të cilin e rëmbejnë përdhunisht nga shtëpij' e tij dhe e internojnë në Konjë, po, kur e kapnin dhe kur i nipi i tij Lumoja nxjer revolverin t' a mbronjë, një komiser Policije e qëllon dhe e plagos rëndë Luman, tuke kujtuar se e vrau!

Çashtja kombëtare merr flagë; Shqiptarët marrin armët dhe dalin maleve e bashkë me ata del komitaxheshë dhe Lulja, që vjen në vëndin e babait të saj e armatosur. Përpjekje të shpeshta e gjaksore çvillohen midis bandave Shqiptare e të ushtris turke. Të giithë Shqiptarët janë betuar për "Vdekje a Liri". Themistokli Gërmënji vjen në Cakranj e u kallzon çetave një pllan të përbashkët për një kryengritje me karakter të përgjithëshmë,tuke u ngritur dhe Flamuri, për të cilën gjë janë marrë vesh edhe me Gegët. Vjen Çerçiz Topulli me Mihal Gramenon e kërkoinë armë, sepse armët që priteshin nga Korfuzi prej

Garibaldinëve u konfiskuan dhe delegatët që i blijnin u burgosnë në Janinë. Lulja e kupton se janë tradhëtuar dhe betohet të vrasë me dorën e saj tradhtarin kushdo qoftë!

Kajmekami Hajdar Kaloshi, vjen natën në Cakranj e lajmon kryetarët. e lëvizjes se po vijnë dy taborë nga Berati e do t' u bijen befas dhe i këshillon të marrin shpejt masat, tuke shtuar se: vërtet kjo që po bën është një tradhëti, po nuk tradhëton kurrë ay që i shërben Atdheut për një qëllim të shënjtë ! Nga ana tjetër i shoqi i Lules Musaj, bashkë me të vjehrën Bajkushen vijnë në Cakranj të bindin kaçaken Lulen të kthehet prapë në shtëpi të saj. Një fjalim i ashpër e i rreptë çvillohet midis këtyre, po Lulja s' bindet kurrë të kthehet e gjallë; po kur e sheh këjo se Musaj i jep të kuptonjë se punët shkojnë keq dhe se janë tradhëtuar të gjitha, e merr me të mirë të shoqin dhe i thotë se do ti vejë pas, po qe se i kallzonte të fshetat e tradhtive. Musaj ahere ja tregon të gjitha dhe kur e mer vesh Lulja se ky qënka tradhëtori vetë, egërsohet, ndizet si flaga e me një gjest të shpejtë nxjer një kamë dhe e shtrin të vdekur Musanë !

Veprimet e kaimekamit të Vlorës dalin në shesh dhe ky pushohet nga puna, burgoset dhe shkohet nga gjyqi ushtarak i Selanikut ku dënohet për vdekje dhe do ekzekutohej; po të mos kishin hyrë grekët në Selanik e t' a çburgosnin bashkë me disa të tjerë. I lirë tani vjen në Shqipri, mvishet me roba komiti e bashkohet me kryengritsit e tjerë, ku gjen edhe Skëndo Gjatën qi është kthyer nga internimi. Me një shpirt të gjithë sulmojnë kundra ushtrive turke që kthehesin të shkatruara nga lufta dhe si kombinim i këtyre ngjarjeve mbrin në Vlorë Ismail Qemali bashkë me disa delegatë të tjerë Shqiptarë dhe midis brohorive e një enthusiasmi të patreguar ngreh solemnisht Flamurin kombëtar në ballkon të shtëpisë së Xhemil bej Vlorës në Vlorë, tuke çpallur VETËQERIMIN E SHQIPRISË!

PERSONAT E DRAMËS.

SKËNDO GJATA, - kryeplaku i Vlorës, 60 vjetsh.
PETRIT SULOVA, - një pronar nga Mallakastra. 40 vjetsh.
GJENÇO SHKËMBI, - një profesionist i krishterë. 30 vjetsh.
SHPENDO RRAPUSHI, - një pasanik Kaninjot. 35 vjetsh.
BAJKUSHE, - e shoqja e Skëndo Gjatës. 50 vjetsh.
LULE, - e bija e Skëndo Gjatës. 25 vjetsh.
MUSA KARAKUSHI, - i dhëndri i Skëndo Gjatës. 40 vjetsh,
LUMO KRYEZIU, - i nipi i Skëndo Gjatës. 28 vjetsh.
ISMAIL QEMAL VLORA.
THEMISTOKLI GËRMENJI, - kapidan çetash të kryengritësve
ÇERÇIZ TOPULLI, - kapidan çetash të kryengritësve
MIHAL GRAMENO, - shoku i Çerçizit, luftëtar.
HAJDAR KALOSHI, - nënëprefekt i Vlorës.
PRENK GJO LUCI, - një bajraktar i Malcis së Shkodrës.
Një komisar Policije, gjendarë, popull burrash e grash delegatë etj.

Sqena zhvillohet midis vjeteve 1908-1912.

Akti i I e i II në Vlorë, Aktet i III e i IV në katundin Cakranj (Mallakastër).

Tablloja në sheshin e FLAMURIT në Vlorë.

Shënime. Në aktet e I e II veshja e aktorëve petka kombëtare.
Në aktet e III e IV veshja e aktorëve petka komitash.
Në tablonë veshja e aktorëve e përzjerë,

Të drejtat e auktorit të rezervuara.
Drama çfaqet vetëm me lêjen e auktorit

TRIUMFI LIRISË

A K T i I-rë

(Theatri çfaq një sallon pritjeje të shtëpis së Skëndo Gjatës në Vlorë, shtruar bukur e mobilluar, me disa piktura shqiptarësh mbi muret; në mes të sallonit një tryezë dhe frona rotull. Në faqen e fundit të murit janë mvarur disa shpata e shishane[1] të vjetra kryqazi me disa kobure e pisqolla e kordha antika. Midis tyre shkëlqen kadhrua[2] e Skënderbeut me flamurin kombëtar).

Sqena 1

SKËNDUA, PETRITI, GJENÇUA.

(*Del Skëndua dhe si mbaron prollogun hyjnë të tjerët*).

SKËNDUA

Sa qënkemi të gënjyer!.... U pajtuam me armiqtë shekullorë e u dhamë për një bashkëpunim të sinqertë; kujtuam se ishin njërës me karakter, po kot! Xhon-turqit na mashtruan !···· Na bënë vegla gjer sa fituan qëllimet satanike të tyre! Dhelprat e këqija i harruan premtimet që na dhanë, i harruan të gjitha dhe sot na vunë përpara si berrat ! Gjakpirës, xhelatë kërkojnë të na shdukin nga faqja e dheut, se na kanë âlë në sy!.. .. Po mjaft!... Gjer këtu !.... Tash hasi sharra në gozhdë dhe do ti vjellin nga hundët sa na kanë shkaktuar gjer tani!. ... Ky Shqiptar ësht' ajy që e ngriti Osmanllinë në kulmin e famës së tij dhe ky prapë ësht' ajy që do ti japë shkelmin e fundit !... (*me inat*). Dridhi, tiranë, se ardhi dita që ti shpërbleni të gjitha! Xverku jonë nuk duron mê ! Ja se do rrojmë me nder e të lirë, ja se do vdesim me nder si burrat ! Tiranë, dridhi se mbrini dita !.....

[1] Shishane = lloj pushke e vjetër

[2] Kadhrua = kuadri, piktura

(*Hyjnë të tierët*). Tamam ! Paski ardhur në një kohë që ju prisnja. (*Petritit*). A kini parë rrotull avullisë se mos kemi njeri?

PETRITI

S' ka as njeri.

GJENÇI

Familja juaj ka shkuar në Kaninë ka pak orë.

SKËNDUA

Jini të sigurt se nuk ka njeri?

PETRITI

Si na sheh e të shohim; mos kij merak se s' ka njeri !

SKËNDUA

Ahere fillojmë ... I mbështetur në besnikërinë t' uaj dhe i bindur se fjalët që do shkëmbejmë do mbeten këtu, ju thira, dhe para se të hap gojën të flas kërkonj të më betohi mbi nderin t# uaj se ato që do themi e do bisedojmë do mbeten sekrete. Betoheni?

PETRITI e **GJENÇI.**

Betohemi (*Ngrehin duart përpjetë të gjithë*).

SKËNDUA

Nuk është nevoja të zgjatem. E shihni se na vajti thika në koskë! Nuk durohet mê kjo jetë qêne, jetë mizore ! Këta na thëthitnë gjakun e na lanë të

mjerë! Lirinë gënjeshtare që na fali statuti i Sulltanit të kuq nuk e shijuam përveç se për një kohë të shkurtër dhe tani ramë në një robëri shumë me të keqe se atë të parën! Prej një tirani që kishim na u ngjallë me mijra mê të këqinj ! Xhonturqit na mbyllë shkollat, kllubet, gazetat dhe tani kërkojnë të na ndalojnë edhe gjuhën, gjuhën tonë të shenjtë, gjuhën amtare, në qoftë se nuk e shkruajm, si duan ata, me shkronja arabe!

PETRITI

Oh, sa turp!

GJENÇI

S' ka se ku shkon mê keq, Zoti na ruajt !

SKËNDUA

Dal-nga dale do na shdukin dhe nga harta gjeografike, se ju e shihni sa burgosen dit për dit Shqiptarë, sa internohen edhè sa mbarojnë jetën në litar! Durohet kështu?

PETRITI e **GJENÇI**

Jo, besa kurrë!

SKËNDUA

Duan me pak fjalë të na bëjnë Osmanllinj, cilët? Nè ! Nè që kemi jetuar në këtë tokë qysh se shkrepi reza e parë jetike e Diellit, qysh se u krijua bota! Kërkojnë të ndrojmë gjuhë e zakone e të mohojmë. gjak e fis e vatrat tona, të harrojmë se jemi Shqiptarë ! A munt të bëhet kjo ?

PETRITI e **GJENÇI**

Jo kurrë! Mê mirë vdekja!

SKËNDUA

Në qoftë se i lemë akoma këto bisha, këta çakaj të orvatin mbi kurrizin tonë, ata më së fundi do na shtypin krejt !

PETRITI

Ta merr mëndja

GJENÇI

Ah, tirani e mallkuari

SKËNDUA

Gjer kur do rrojmë kështu as të gjallë, as të vdekur ? Gjer kur do durojmë thundrën e qelbur çagate[1] të na shtypë krahrorët ? Nuk është turp për ne ? Nuk është shnderim ?

PETRITI

Një qint herë më e mirë Vdekja!

GJENÇI

Mê mirë një dit e lirë, se sa një qint vjet në robëri !

SKËNDUA

Një qint vjet? Nuk thua pesë qint? Shaka të duket?

PETRITI

Turp i math për nè si kemi duruar gjer sot!

[1] Çagate = gjuha e vjetër turke, në këtë rast = turk

SKËNDUA

Pra, bari i kësaj sëmundjeje, shërimi i kësaj është….

GJENÇI

Kryengritja!

SKËNDUA

Tamam, nga goja ma more! Prandaj ju thira këtu që të mendohemi e ti japim funt kësaj çështje. Si thoni?

PETRITI e **GJENÇI**

Jemi në një mëndje me ty.

SKËNDUA

Ahere ne këtu do formojmë një komitet "PËR ATDHENË." Nuk është nevoja të jemi shumë; do shumohemi më von edhe munt të bëjmë mrekullira, po të mos na mungonjë vullneti i mirë.

PETRITI

Bukur fort.

SKËNDUA

Mos harroni se jam plak dhe kam vojtur mjaft. Mos harroni se kur isha djalë jam përzjerë me ata fatosa të pa trembur të kongresit të Prisrenit, që e tuntnë Turqinë nga themelet e që çuditnë gjith botën.

GJENÇI

Kemi besim të plotë mbi ty.

SKËNDUA

Atëherë ishin të tjera kohra, po sot puna ka ndryshuar. Sot Shqiptari nuk ësht' ajy i pari. Ka ndryshuar krejt. Ësht' i arrirë e ka formuar gjuhën e tij shkrimore në bazë të Alfabetit të Monastirit, ka formuar idhenë kombëtare, me fjalë të tjera ka marrë vesh pse rron edhè si duhet të rronjë. S'e gënjen me njerì

PETRITI

Ashtu duket.

SKËNDUA

Pra, lè ta marrim ne këtu nisiativën, se neve na bije barra. Jam i bindur se zëri jonë do tingëllonjë dhe shembllën tonë do ta ndjekin të gjithë Shqiptarët! Do lëvizim, do tundemi, do përpiqemi, do vritemi më së fundi, po do t' i japim Evropës shtrigë të kuptonjë se ka komp Shqiptar, se Shqiptari ka vendosur të rronjë i lirë, ose të vdesë me nder!

PETRITI

Bukur flet!

GJENÇI

S'e lot as dreqi!

SKËNDUA

(*Take marrë një grup fletë-shpalljesh, të poligrafuara)*

Ja, këtu kam pregatitur një çpallje të shkurtër kryengritëse dhe po ja u këndonj. (*Lëçit*). ATDHEU NË RREZIK ! Vëllezër Shqiptarë pa ndryshim feje! "Agoj dita e shenjtë që tu japim shkelmin e.fundit tiranëve e ti dbojmë nga tokat tona. Këtë vent që na e lanë trashgim të parët s' ka të drejtë të na e shkelë njeri!

Vujtjet, mjerimet, lotet, burgimet, internimet, vrasjet e pabesta nuk durohen mê! Përpara një gjendjeje të këtillë mê mirë vdekja! Kombi ardhi në buzën e varrit! Por hassi sharra në gozhdë, nuk durohet mê ! Zjarri pra, e flaga lè të dalë an' e mb' anë! Le të bëhen hî e shkrump të gjitha, se mê keq s'ka se ku shkon! Do të shkelin mê parë mbi kufomat tona, pastaj lè të bëjnë si të duan !... Më këmbë, pra, o bijt e Pirros e të Kastriotit, sot, ose kurrë! … Si ju duket?

PETRITI e **GJENÇI**

S' ka mê bukur !

SKËNDUA

Ahere jemi d' akord, të tjerat mi lijni mua ti rregullonj.

PETRITI

Bëni si t'jua marrë mendja, nè jemi me ju.

SKËNDUA

Po këto punë duan edhe kurbane; dasma s'bëhet pa të pjekura, apo s'ësht'ashtu ? *(qesh*). Do zgjidhim pra, qeset të gjithë dhe do mbyllim sytë. Unë po jap tash për tash 1,000 lira turke për këtë qëllim. E ju?

PETRITI

Edhe unë 500 dorë për dorë.

GJENÇI

Unë jam më i vobektë; po jap 100 vetëm e pastaj të shohim.

SKËNDUA

S'ka gjë, mjaft janë për ty. Po të duhen edhe të tjera do të japim, nuk do kursehemi.

PETRITI

Nuk thua më mirë se do shkrihemi krejt ?

SKËNDUA

(*I rrok për qafe që të dy*)

Bravo! Ju lumtë! .... Do ta nënëshkruajm tani si burrat këtë shkresë, që tregon se ne sot e formuam komitetin e u betuam. Doni t'jua këndonj ?

GJENÇI

S' është nevoja, kemi besim të plottë.

SKËNDUA

Ahere nënëshkruani. (*ja u jep edhe ata e nënëshkruajn*). Qoftë për hair!

PETRITI e **GJENÇI**

Amin! Rroftë Shqipërija!

SKËNDUA

Një nga kushtet e kësaj kontrate është edhe ky: Ç' do nga nevej munt të zgjedhë e të betonjë 5 anëtarë të tjerë, të cilëvet do t' u kallzonjë qëllimin, pa treguar se prej kujt e kujt përbëhet komiteti. Ç' do tjetër prej atyre munt të zgjedhë e të betonjë edhè nga 5 të tjerë, që edhè ata nuk lipset të dijnë të parët

dhe këjo munt të vazhdonjë sa të mbushet e tëra Shqipërija me komita, por ne të tre, mos harroni, jemi themeluësit e këtij komiteti. Urdhrat do jepen që këtej edhe kush nuk i zbaton, ose na tradhton dënim ka vdekjen ! Një prej nesh me lloto do ngarkohet të exekutonjë vendimin e komitetit dhe ajy që nuk e zbaton atë vendim prapë dënohet me vdekje. E kuptuat mirë?

PETRITI *e* GJENÇI

D' akord!

SKËNDUA

Ahere betohuni mbi këtë flamur të shenjtë se do ti qëndroni besnik Atdheut dhe do kryeni me ndërgjegje të plottë detyrat që do t' ju ngarkohen dhe me gjak e ç' do therori.

TË TJERËT

(*Ngrehin duart*)

Betohemi! ....

Sqena 2

TË PARËT, LUMUA

LUMUA

(*Tuke hyrë*).

Më pate thirë dajkua im

SKËNDUA

O bravo! .... Arrive në kohë.

LUMUA

Ardha si pas porosis s' ate dhe jam gati për ç'të urdhëroni.

SKËNDUA

Kam besim të plottë ne ty, djali im, se të kam rritur edhè e di se jè i zoti për punën që të kam thirrur.

LUMUA

Jam gati të kryeni ç' do barrë, që të më vini me ç' do therori e sakrificje nga ana ime.

SKËNDUA

Të lumtë, ashtu të dua. Për atë s'ka dyshim. Sot po të paraqit një rast të bukur që ti shërbesh Atdheut të dashur.

LUMUA

Për atë bëhem edhè kurban, mjafton të më urdhroni.

SKËNDUA

(*Merr një vandak*[1] *shkresa dhe ja dorëzon Lumos*).

Na, biri im, merri këto. Është një porosi e shenjtë, me të cilën të ngarkon Atdheu. Do nisesh që tashti pa humbur kohë. Do shkosh në Gjirokastr që andej do kthehesh në Tepelenë, q' andej Këlcyrë, Përmet, Leskovik, Kolonjë, Korçë, Devoll. Që andej do ti bijesh Pogradecit, Elbasan, Lushnjë, Berat dhe do këthehesh prapë këtu. (*I jep një zarf të mbyllur*). Na edhè këtë zarf, ku ke urdhrin si të vepërosh e me cilët të piqesh, po do ta hapësh kur të kesh dalë nga kufir'i Vlorës. Do të pjekësh personat që të shënonj dhe do t' ju thuash se të ka dërguar komiteti. qendror dhe ata e dijnë detyrën e tyre.

[1] Vandak = Grumbull sendesh të lidhura së bashku si deng

LUMUA

Do të vepëronj si mbas urdhrave t' uaja.

SKËNDUA

Mirë fort. Ahere para se të shkosh betohu dhe ti se do ti qëndrosh besnik Atdheut dhe do preferosh vdekjen se sa të kallzosh gjë. Betohesh?

LUMUA

(*Ngreh dorën përpjetë*).

Betohem!

SKËNDUA

Nisu, pra, e mos bjerrë kohën. (*I jep një qese me të holla*). Merr edhe këto për harxhet e tua.

LUMUA

(*Tuke i lënë shëndet*).

U pjekshim shëndoshë dhe Zoti na i sjelltë mbarë të gjitha.

SKËNDUA

Udhën e mbarrë dhe hap sytë mirë. (*Lumua del*).

Skena 3

TË PARËT përveç LUMOS

SKËNDUA

Jam i bindur se Lumua do ta kryenj këtë detyrë të rëndë.

GJENÇI

S'ka dyshim.

PETRITI

Lumua është djalë xhevahir dhe kuximtar.

SKENDUA.

Mbi të gjitha është patriot fanatik, i djegur e i zhuritur·për idealin kombëtar. Punën që mund ta kryeni ky s' e kryen tjetër kush, ësht' i vetëmi për këtë qëllim, prandaj edhe e zgjodha.

GJENÇI

E njoh shumë mirë Lumon.

PETRITI

I qoftë udha e mbarë.

TË TJERËT.

Amin!

Sqena 4.

TË PARËT, SHPENDI

SHPENDI

(*Tuke hyrë*).

Këtu qënki ju?

SKËNDUA

Urdhroni, urdhroni. (*Shpendi i përshëndosh të gjithë*)

SHPENDI

Nuk i kini marrë vesh të rejat ?

SKËNDUA

Ç'farë të reja? Pa na thuaj, nè s' dijmë gjë.

SHPENDI

Në Parlamentin turk në Stamboll qënkan zënë shumë keq deputetët tonë me deputetët Xhonturq ....

GJENÇI

Si, si ? Pa folë !

SHPENDI

Deputetët tonë e sidomos Ismail Qemali, Myfid Libohova, Hasan Prishtina dhe Nexhip Draga u ankuan në Parlament për mizorit e për të këqijat që heqin Shqiptarët nga autoritetet xhonturke.

SKËNDUA

Kjo qënka interesante!

SHPENDI

Bisedimi u zgjat shumë e u ashpërua. U bë një poter' e madhe. Midis këtyre ngrihet një deputet turk, deputeti i Serezit Dervish beu edhe tha se "s'ka Shqiptarë në Turqi" !

SKËNDUA

Po tanët ç'ju përgiiqnë atij laneti?

SHPENDI

Myfid beu i tha "var efëndëm, var"! D.m.th. "ka, zotni Shqiptarë, ka"! Po këjo i zemroj shumë deputetët turq dhe Dervishi, si ju thashë, u çua përpjetë dhe si u ndoth afër Ismall beut, i këput një shuplak suratit!

TË GJITHË
(*Me indinjasjon*)

O !!!. ...

SKËNDUA
(*Me zembrim*)

Një shuplak suratit?

SHPENDI

Mjerisht, po, Ismail benë na e rrahnë xhon-turqit ! ....

PETRITI

Po Shqiptarët ç'bënë ahere ? Si e lanë këtë njollë ashtu pa e shpaguar? Oh, sa turp i math për ne !

GJENÇI

Të vemi të mbytemi mê mirë !

SHPENDI

Mjerisht nuk i lanë, se do t' ishte derdhur shumë gjak atje. Hassan Prishtina nxori revolverin dhe e qëlloj deputetin e ndyrë. Gjithashtu edhe Nexhip Draga, po s'e zunë dot ! Ahere u kacambitnë Shqiptarët me Xhonturqit

e u përleshnë, se edhe disa deputetë të tjerë nxuar revolveret, dhe do të kishte vajtur gjaku gjer më gjû po të mos kishte hyrë në mes ministri i brendëshëm Talhat beu e ti ndante. Deputetin sharës e nxuar tuke e shtyrë jashtë, se ndryshe nuk do kish shpëtuar!

SKËNDUA

Taksirat i math ky për në ! Ky shuplak ishte një shukretë për gjithë kombin tonë ! Hè, a durohet kështu?

PETRITI

Vdekja më mirë, se sa kjo poshtërsi !

GJENÇI

Çnderim i math ky për në !

SKËNDUA

Shum' i math ! Duhet tu marrim hakun këtyre pamirënjohtësve! Pastë faqen e zezë Osmanllija që i harroj të gjitha sa i kanë bërë Shqiptarët e gjorë, që kanë lënë eshtra e lëkurë për nderin e famën e saj ! Nè ja kemi dhënë kaqe vezira të mbëdhenj e pashallarë, nè e kemi ngrehur në kulmin e zylmës së saj edhè nè po vuajm sot prej saj ! Sa poshtërsi e padëgjuar ! Mirë të na bëhet, nè e kemi fajin !

PETRITI

Lè të na bëhet shëmbëll këjo për gabimet që po bëjmë.

SHPENDI

Qysh se u përhap këtu ky lajm, u zembruan tepër Vlonjatet dhe me një herë u turrë e zaptuan telegrafanen e Vlorës...

SKËNDUA

Si thè, si thè ? Zaptuan telegrafanën ? Folë mirë!

SHPENDI

Po, po, e zaptuan sigurisht

GJENÇI

Hallall u qoftë !

SHPENDI

Autoritetet e këtushme kur e dëgjuan këtë u allarmuan ! Me vrap disa. oficera vijnë në zyrën e Post-telegrafës dhe kërkojnë të ngjiten sipër, po rojtarët nacionalistë i ndaluan te dera e s' i lanë të hyjnë.Se si bënë e u ngjitnë sipër nj'a dy oficerë, tuke paraqitur disa telegrafe shifër për Stamboll e për Selanik. Po aty ndodheshin shumë patriotë Shqiptarë dhe protestuan. Drejtori i telegrafanës Faik Kreshpani nuk ja u pranoj ato telegrafe dhe dikush u tregoj derën të delnin jashtë po zabitët osmanllinj u zembruan fort e xhveshnë këllëçet që t'u bijnin Shqiptarëvet ! Oh, ç'ka ngjarë ahere nuk rëfehet....

PETRITI

Fol' aman, të keqen, kjo qënka tepër interesante !

SHPENDI

Me vrap nacionalistët tonë u rëmbejnë shpatat e i çarmatosin dhe njërin prej atyre e gremisnë nga shkalla e poshtë ....

GJENÇI

Tjetrin?

SHPENDI

Tjetrin e flaknë nga ballkoni në rrugën e madhe !

SKËNDUA

Ashtu deli, më u lumçin krahët !

SHPENDI

U derdhë pastaj disa oficera të tjerë e shkuan në depon që të marrin armë e municjone. Ishin dy kapitanë e një major. I kërkuan çelsat rojtarit të dêpos, që ishte një farë Nexhipi nga Drashovica, po ay nuk u a dha. Një prej oficeravet e shau me fjalët "p i s s A r n a u t" Këtë kur e dëgjoj Nexhipi i shkretë me një herë u ktheu pushkën e i vuri që të tre në nishan ...

PETRITI

Uh, ty të lumtë goja; Fol' aman, mor të keqen se s' duronj !

SHPENDI

I qëlloj që të tre ... Një nga kapitanët râ i vdekur; tjetri u plagos rëndë e tash po mbaron edhe ajy; sa për majorin, si u vu në të hikur me këmbë ljepuri, me gjithë që mori nj' a dy plagë, ajy mezi arriu e u ngjit mbi avullinë e Hassan Sharrës e u hoth për brenda, sado që u zhvat e u therr keq, se murri ishte ngarkuar me qelqurina të mbrehta !

SKËNDUA

I shkreti bimbash !.... Ta kishte qëruar edhè këtë nuk do bënte keq !

SHPENDI

Këto kanë bërë një bujë të madhe dhe autoritetet na kanë marë në gazep! Kajmekami me komandantin e ushtrisë janë zembruar fort.

PETRITI

Çudi e madhe !

GJENÇI

Le të pijnë uthull në janë zembruar !

SKENDUA

Ujë lè të dalë që tani; ç' është për të bërë le të bëhet një orë e më parë!

SHPENDI

Dëgjova se kajmekami do të vinte vetë këtu ne ty dhe do të të ankoheshe, se kujton se edhè ti ke gisht në këto.

SKËNDUA

Lè të urdhërojë kur të dojë, jam gati ta pres.

SHPENDI

Kam frikë se mos trashen punët ....

SKËNDUA

Hè, pastaj? Do na presin harxhet? Ç' frikë kè ?

SHPENDI

Mos na burgosin, na konfiskojnë gjë e mall e na internojnë.

SKËNDUA

Uh, jazëk! Që tani i dhè armët ti ?

SHPENDI

S’ kam aqe frikë për vehte, se sa për familjen t' ime. Ç’ taksirat kanë ata të ngratët?

SKËNDUA

Ç’flet ashtu Shpend ? Të dinja burrë e ti qënke frikacak ! Ç’ kërkon të thuash me atë ? Nè nuku kemi fëmijë ? Mendonj unë fëmijë e soj e fis e plank e pasuni përpara Atdheut ? Nuku u bëkërkan hi e pluhur të gjitha kur të mos kem Atdhenë të lirë? Mos folë ashtu, se s’të ka hije aspak !

SHPENDI
(*I penduar*).

Kini të drejtë .... Ahere edhe unë me ju jam.

SKËNDUA

Ashtu, deh ! Tani fole mire ! (*Dëgjohet dera që po troket*). Kush të jetë vallë? Ç’kërkojnë në këtë orë? (*Shkon afër derës*). Ha! ... Qënka kajmekami vetë!... Paska ardhur për mua ... Fshihi ju të tjerët mos ju shohë këtu, se këtij ja jap unë përgjigjen për ç’ do që të më thotë. (*Fshihen të tjerët, kur se Skëndua hap derën*). O! …. Si kështu? Zotrote qënke, kajmekam bej? Bujrum ! ....

HAJDAR BEU

(*Shef rrotull*).

Vetëm jè ?

SKËNDUA

Vetëm, vetëm, s' ka njeri ! Urdhro ...

HAJDARI

Ç' janë këto gjërra, mor zoti Skëndo? Ç' janë këto që po na bëjnë Shqiptarët e tu përpara syve të Qeverisë?

SKËNDUA

Nuk di gjë fare, as që kam haber se ç'ngjet ! Unë kam tri dit i mbyllur këtu në shtëpi e po merrem me kopshtin e shtëpisë e me punë shtëpijake dhe s'kam patur kohë të dal jashtë. Ç' paska ngjarë nuk më thoni ? Po më falni pak, se desha t' ju pyes ç'kërkoni të më thoni me fjalët "Shqiptarët e tu"? Mos kujtoni se un' i kam në dorë këta shqiptarët e ti bënj tembi ? Secili është përgjegjës për veprat e tija, unë nuk ngatërohem në punët e tyre.

HAJDARI

Bën si kur s' di gjë, po unë jam i sigurt se nuk ësht' e mundur të mos kesh dijeni ti për këto; pa fjalë që edhe ti ke gisht në këto që po ngjasin, që s' janë as pak gjërra të pëlqyera !

SKËNDUA

(*I zembruar*)

Më vjen shumë keq,kajmekam bej, pë po më ngarkoni edhè mua në këto ngjarje ! Unë po ju a përsërit se s' kam aspak dijeni për ç' ngjet, ju lutem !

HAJDARI

Nuk e muart vesh se Shqiptarët zaptuan telegrafanën e nuk pranojnë as një nëpunës tonë civilë, ose ushtarakë, të japin e të shkëmbejnë telegrafe?

SKËNDUA

Kur paska ngjarë këjo ?

HAJDARI

Sot, sot! Nuk kè marrë vesh se dy oficerat tonë i kanë përdorur shumë keq, tuke i flakëruar nga shkallët e përposh ? Turp !

SKËNDUA

Çudi, çudi !....

HAJDARI

Nuk dëgjove se na u vranë dy zabita dhe na u plagos një bimbash ?

SKËNDUA

Brè, brè, brè !! Sot paskan ngjarë gjithë këto ?

HAJDARI

Sot, sot edhè më vjen shumë keq që bëhesh si kur s'di gjë ! Po, ja ku të them, se në vazhdoftë kjo punë kështu, në qoftë se edhe zotrote je përzierë me këta revolucjonarë, vaj halli me ju ! Unë, si një administrator i kësaj krahine, do shtrëngohem të marr masa të rrepta. Jini përgjigjës ju për ç'do që të ngjasë paskëtaj dhe faji është juaji ! Unë ju thashë ç' kisha për të thënë, tani lanj duart!

SKËNDUA

Pse gjith ky zembrim, kajmekam bej?

HAJDARI

Kërkoni dhe arësyen? Ja pse, se jam memur i Dovletit e nuk munt ti duronj këto manevrat t' uaja në kurris të shtetit t' em!

SKËNDUA

Ç' munt të bëni, pra, edhe ç' masa munt të merni?

HAJDARI

Të gjitha ! ... Burgim, internim, konfiskim pasunije dhe më së fundi litarin!

SKËNDUA

(*jashtë vehtes tija*).

Litarin ?

HAJDARI

Po, edhe litarin !

SKËNDUA

Fole një fjalë shumë të rëndë, kajmekam bej ! Më lejo, se po do flas edhe unë nj' a dy fjalë, mbassi na përmende litarin ...

HAJDARI

Urdhro, folë, të dëgjonj.

SKËNDUA

Të mi thoshte këto ndo një qyrd, ndo një llaz[1], a ndo një çerqes nuk do më vinte keq, po ti thuash zotrote me gojën e një Shqiptari, po të them të drejtën, më vjen shumë keq !

HAJDARI

Leri ato fjalë tani; unë jam nëpunës edhè Dovleti më paguan !

SKËNDUA

Edhe pse të paguan Dovleti duhet tu sillesh kaqe keq Shqiptarëve të mjerë, vëllezërve të tu të një gjaku e të një gjuhe?

HAJDARI

Zure tashi me nacionalismat e tua? Të më japësh mua mësime nacionalizmi ? Munt të jem unë Shqiptar, kur jam njeriu i Dovletit ?

SKËNDUA
(*Me zembrim*).

Qysh, e mohon se nuk je Shqiptar ? Zotrote i lindur në Krujë, i rritur me gjuhën Shqipe; Shqiptar e bir Shqiptari e mohon kombësinë tënde ? Oh, sa turp, sa gjë e keqe !

HAJDARI

Të duket, po nuk ësht' ashtu.

[1] Qyrd = banor i Kurdistanit, Llaz = banor i Lazistanit,rajon i ndodhur kryesisht në Turqi e pjesërisht në Gjeorgji.

SKËNDUA

Ashtu është dhe s' ka gjë më e poshtër se sa të vrasë vëllaj vëllanë për një rrogë, për hatër të një të huaji, të një armiku !

HAJDARI

Pse? Armik e quhan Dovletin ti ?

SKËNDUA

Armik dhe shkuar armikun ! Kur më ndalon gjuhën. kur më grabit lirinë, kur më merr nderin, shpirtin si s' qënka armik ?

HAJDARI

Po si na mson zotrote, ti lemë Shqiptarët të bëjnë si të duan ? Ahere ka qeveri apo jo ? Cila është .detyra e qeverisë?

SKËNDUA

Më fal pak se po shtrëngohem t' ju flas më zhgjeshur, se ju quanj si vëlla, mbassi jè Shqiptar edhè zotrote, si unë. Nuk më thoni, si munt të quhet kjo vepra juaj, vepra e një atij që valon akoma ndër dejt' e tija gjak i kulluar Shqiptari, që është lindur në një qytet historik, atje ku lindi edhè vetë fatosi i math i Kombit Skënderbeu ?

HAJDARI

Ç' kuvëndon ashtu, daç Perëndinë, ç' punë ka këtu Skënderbeu ? Me këto kërkon të më bindësh të harronj detyrat e mija karshi Sulltanit ? Si munt ta shkel unë bukën e tija, që s' më lejon as pozita ime ?

SKËNDUA

Do me thënë për një rrogë të krimbur që të jep Sulltani, që të ushqen, ti do ti vesh thikën vëllajt tent ? Do përdorësh litarin ? Nuk është një turp ky, një mëkat nga Zoti ?

HAJDARI

(*Ri i menduar*)

SKËNDUA

Përgjigjmu, të lutem ....

HAJDARI

(*Hesht*)

SKËNDUA

(*Me një dëshpërim në zemër*).

A i duron zembra jote këto ? Nuk ngjethet ? Nuk mallëngjehet me vuajtjet e atdhetarëve të tu ? U bashkove me tiranët tonë Xhonturq që tu pijni gjakun Shqiptarvet ?

HAJDARI

(*Pushon*)

SKËNDUA

Folmë, pse s' më flet? Kaqë lote që po derdhin sot gra e fëmijë, ky vaj, këto mjerime nuk të thekin shpirtin? I duron, i duron !

HAJDARI

(*Me vehte*).

Oh, sa qënkam i gabuar ! .....

SKËNDUA

Shih pasuritë tona që po grabiten, shih hallkat e zinxhirat si u ngarkohen Shqiptarëve të gjorë, shih gjakun e pafajshëm që po derdhet për dita dhe në jè gur, në qoftë se s'ke gjak Shqiptari duroji po të mundësh !

HAJDARI

(*Më vehte)*.

Oh, Shqipëri, Shqipëri, edhe unë tradhëtori yt ! Pse s' më bije një pikë të më pikonjë? Pse s' gremisen gjithë shkëmbinjtë të më coptojnë? Pse s' lëshohen mbi mua gjith rrufet' e Qiellit të më groposin ? Ah, sa jam fajtor përpara teje, o Atdhe!....

SKËNDUA

Mohoje, po të duash gjakun tënt, fisin, gjuhën ! Mohoje, në daç, Atdhenë që të ka lindur!

HAJDARI

(*Fort i mallëngjyer e sheh Skëndon në sy*)

SKËNDUA

Tani që Shqiptarët po përpiqen për liri ti i pengon e i tremp me litarin? Rron për një rrogë, apo për një nder? Folë

HAJDARI

(*Nuk flet. dot prej mallëngjimit, po derth lote*).

SKËNDUA

(*Tuke e kqyrur me vëreitje*).

A!... Lotë po derth?...

HAJDARI

(*E shtrëngon për duarsh*).

Kini .... të .... drejtë !

SKËNDUA

(*E rrok për qafe*).

Vëlla!. .. (*E puth në ballë*). Ah, po jè Shqiptar edhè ti si unë ! .... Gjaku ujë s' bëhet! Këtu nuk të flet Skëndua, të flet një komb i tërë, të flet Atdheu me gojën t' ime !

HAJDARI

Ke të drejtë!... Paskam qënë i gabuar dhe tani po hap sytë !

SKËNDUA

Bravo të qoftë; tani fole si burrat, se s' ka njeri të mos gabonjë në këtë botë!... Piqe një herë tanithi ! (*Japin duart shoq-shoqit e përqafohen rishtazi*).

HAJDARI

Sot më vjen se u ringjalla ! Paskemi qënë të verbër ! ....

SKËNDUA

Ashk ollsun[1] ! Më mirë von se kurrë ! E tani ? ....

HAJDARI

(*Si mendohet pak*)

Tani jam me ju e po të jap besën se nuk do ndahemi kurrë !

[1] Aşk olsun = le të ketë dashuri

SKËNDUA

Shokë, ku jini ? ... Vraponi këtu ! (*Dalin të gjithë*).

Sqena 6.

TË PARËT dhe GJITHË TË TJERËT.

PETRITI, GJENÇI, SHPENDI.
(*Tuke parë Hajdar benë*).

O ! Hajdar beu !

HAJDARI

Unë jam, o vëllezër, unë ndjekësi juaj, po tani miku e shoku juaj; jam vëllai juaj, mos më mohoni !

TË TËRË
(*veç Skëndos*).

Ne të të mohojmë ? (*E rrokin gjithë për qafe*).

PETRITI

Sot na u ngjall një vëlla i ri ! Jemi të mburur ! …

HAJDARI

Edhe unë me ju bashkë!.... Poshtë Tiranët e rinj ! Poshtë armikët e Atdheut! Rroftë Shqipërija !

TË GJITHË.

Rroftë Shqipërija !

Bije napa

Fund i aktit të I.

A K T i II-të

(Theatri çfaq sallonin e shtëpisë së Skëndo Gjatës
ashtu si në aktin e parë).

Sqena 1

BAJKUSHJA, SKËNDUA

BAJKUSHJA

Të thashë, mblidhe mëndjen ! Kështu si po punon ti do na marësh më qafë edhè ne edhe vehten tënde. Ta dish prej meje se do kesh një fund të keq! Do batërdisesh fund e krejt ! Pse nuk shëkon punën tënde ? Plak njeri ti si po merresh me kësijsh punra ? Ti do ta bësh Shqipërinë? Hiq dorë, po të them. Shyqyr Zotit kemi të hamë e të pimë, ndo një borç s' kemi, një çupë të vetëm edhe atë e martuam mirë, ç' kërkon akoma ti ? Hiq dorë të lutem se do bëhesh pishman !

SKËNDUA

Nuk di si kam durim e po pres gjer sa të mbarosh fjalën ! Ti më duket se po flet si e ëm' e Zeqos majë thanës ! Nuk më thua, ç' të duhet gjëja e malli ty kur e ke kokën në rrezik, kur rron në një skllavëri si këjo e sotmja? Nuk sheh, moj e mjerë, se ç' po na punojnë këta xhemijetxhinjtë, këta tiranët e rinj ? Nuk sheh se po na rëmbejnë pasuri e mall, po na dënojnë e po na bëjnë syrgjyn për dita dhe po na venë thikën në grykë ? A durohen këto ? Mblith mëndjen, po të them edhè unë, se më duket se të paska zënë nata lark!

BAJKUSHJA

Unë di se ç' po të flas dhe mos kujto se jam një grua lesh-gjatë e mëndje-shkurtër, se i marr vesh të gjitha. Gratë e kuptojnë shumë herë punën më mirë se burrat; e ndjejnë rrezikun që për së largu. Mua më vjen se rrezikun e kemi në

pragun e derës; gjer tani nuk di se ke shpëtuar gjall, po, stomna[1] vete shumë herë për ujë, po edhe dikur thyhet. Kaqe di kaqe të them!

SKËNDUA

Tamam, tani fole mirë. Kaqe di kaqe më thua! Kjo është e vërtetë, se po të dinje më tepër nuk do më këshillonje kështu. Ti nuku sheh përtej hundës tënde edhe kè të drejtë.

BAJKUSHJA

Mos kërko të ma mbushësh, mëndjen. Në mos heqsh dorë nga këto sigurisht do ta pësosh edhe do ti bijesh kokës, po do jetë tepër von !

SKËNDUA

(*Me zembrim*)

Ç' thua, moj tu mbylltë dera ? Kaqe budalla më bëre mua ti ? Mos kujtove se jam i çmëndur ? Gratë flasin ashtu si ty, po ne jemi burra dhe burra Shqiptarë. Kemi një detyrë të rëndë e të lartër përpara Atdheut dhe këtë e ndjejmë thellë. Përpara Shqipërisë po të them, nuk peshoni as gjë, as mall as ty as t' ime bijë!

BAJKUSHJA

Bravo! Shumë lezet të kanë këto fjalë; tamam fjalë me mënt që dalin nga goja e një burri plak ! Qënke familjar i mirë ! Kurrë s' e shkonja në për ment të mohosh fëmijën tënde përpara Shqiprisë, po duket se ta kanë mbushur mendjen ata bukuroshët shokët e tu, që ven' e vijnë për dit këtu e flisni fshehtazi.

SKËNDUA

Mendohu se ç' flet edhe rrudhe gojën ! Nuk do më msosh ti si të sillem se jam burrë plak sot e di se ç' them. Këto që po të flas më dalin nga thelbi i

[1] Stamna = shtambë (**στάμνα**)

zembrës. Grua, dije prej mejet se s' ka gjë më të shejtë e më të dashur se Atdheu! Atdheu dhe vetëm Atdheu ! Ajy na nderon, ajy na jep embrin Shqiptar, për të cilin mburremi. Po të mos jetë Atdheu i lirë ësht' e tepërt të rrojmë edhe ne. Ajy që i kupton thellë këto fjalë e merr vesh se ç' them. Atdheut duhet t' ja falim të gjitha, duhet ti bëhemi kurban ! Grua, grua mblidhe mendjen ! Nuk do duronjë më xverku jonë këtë zgjedhë të poshtër, këtë thundër të huaj të fëlliqur, ja se do rrojmë të lirë, ja se do vdesim me nder !

BAJKUSHJA

Mos u egërso kështu e mos prish gjakun !

SKËNDUA

Si të mos egërsohem me këto që po më thua ti ?

BAJKUSHJA

Po ne nuk na ke menduar aspak ?

SKËNDUA

Ju kam menduar, po të thashë, më parë kam menduar Atdhenë. Ti, në qoftë se më kundërshton edhe një herë kështu si sot, ta dish se do marr syt' e këmbët e do shkonj ku më thret nderi dhe do mos më shikoni më. Këto fjalë s'munt ti duroni prej teje !

BAJKUSHJA

Ahere bëj si të duash, unë s' të përzihem më në këto punë.

SKËNDUA

Do bësh mirë të mos përzihesh, mbassi s'kè haber nga këto punë. Shëko punët e shtëpisë, mjaft për ty të merresh me nikoqirllëkun. Unë po dal pak jashtë se mos mësonj ndo një të re. (*Del jashtë*).

Sqena 2

BAJKUSHJA

(*vetëm*)

BAJKUSHJA

Si u bë kështu ky burri im, që s' kuxon ti flaç dy fjalë ? Çudi ! Sado që ti flaç s'i mbushet koka; gjithënjë këngën e Mukës të këndon. Atdhe, Atdhe, ç' do me thënë kjo fjalë ? Për Zotin më duket se këta pleqtë, sa më tepër mplaken, aqe më shumë dalin nga kondaku ! Këta do ta bëjnë Shqiprinë ? Këta ? Nuk e besonj kurrë! Një gjë di vetëm, se këta do marrin më së fundi vehten më qafë dhe fëmijën do t' i lenë rrugavet. Mos, o Zot ! Shumë frikë kam. Këjo është një marrëzi, po veç Zotit i arthtë keq për ne !

Sqena 3

BAJKUSHJA, LULJA

BAJKUSHJA

(*Posa sheh Lulen*).

Ç' u bëre ti që po të kërkonjam ?

LULJA

Isha me ca shoqet e mija nga çajiret. Më deshe gjë ?

BAJKUSHJA

Të desha. Nuk ardhe pak më parë të dëgjonje hyneret[1] e t' yt ati !

[1] Hünere = mbrapshti, punëra të mbrapshta

LULJA

Ç’ farë hynere ? Mos u përfoltë prapë, si e kini zakon ?

BAJKUSHJA

Më ka folur shumë rëndë !

LULJA

Për se, nuk më thua edhe mua ?

BAJKUSHJA

Për shkak të Shqipërisë, për se tjetër ? Atij s'i mbushet koka kurrë që ka marrë një rrugë të shtrembër e po na merr më qafë !

LULJA

Pse do na marrë më qafë ?

BAJKUSHJA

Pse ? Nuk e merr vesh pse ? Po të vejë kështu si ka vajtur, të mjerat ne se ç’ na ka për të gjetur ! Ky e kërkon si breshka gozhdën !

LULJA

Ç’ flet ashtu, moj nënë ? Babai nuk di se ç’ bën edhe do ta mësojmë ne? Ajy e di detyrën e tija si patriot edhe bën ashtu si i ka hije një patrioti edhe bravo i qoftë për atë !

BAJKUSHJA

Ç’ kuvëndon, moj e marrë ? Edhe ti me mëntt' e atij po vete ? (*I jep*

munxët[1]). Na ! ... Për ato paç !... Më duket se do lidhur dhe ti, se të paskan rrojitur[2] menttë !

LULJA

Nëne e ke gabim, shumë gabim !

BAJKUSHJA

Un' e kam gabim, apo ti, që nuk di se ç'flet ? Juve ju kan hedhur hi syve; ju ka zënë mendja pezhishka !

LULJA

Mos fol' ashtu; ti s' munt ta mësosh babanë, se nuk munt ti edhe unë të gjykojmë kësij punësh. Po ty të dhimbet lëkura prandaj flet në këtë mënyrë, se të pëlqen kjo jetë që po rron, që për babanë dhe shokët e babajt s'ka as lezet, as shijë!

BAJKUSHJA

Le të përpiqen të tjerët për Shqiprinë, ajy le të shohë punët e tija.

LULJA

Ashtu ? Të përpiqen të tjerët edhe ne ta gjejmë sofrën shtruar? Tamam, bukur po flet ! Po je grua e s' e kupton !

BAJKUSHJA

E ti ç' je, që po e kupton më mirë se mua ?

---

[1] Munxë = Shenjë që bëhet me pëllëmbë të hapur drejt dikujt për t'i shprehur përçmimin a mospërfilljen, për ta përqeshur, për ta sharë a për ta mallkuar

[2] roitur mënt = të paska ikur mendja

LULJA

Edhe unë grua jam, po e kuptonj se babai ka të drejtë. Ajy sot kryen një detyrë të lartër, që ka për të folur një ditë historija !

BAJKUSHJA

Mua këtej më hynë, këtej më dalin ato që thua ti. Atë historin që po thua ta fal ty e t' yt eti ta zieni e ti pijni lëngun !

LULJA

Po të mendoheshin të gjithë kështu si ty, mjerë Shqiprija !

BAJKUSHJA

Do të rish urtë edhe ti, apo ç' thua ? E shoh se të paska zënë vapa edhe ty, e paske marrë fora[1] !

LULJA

Jam e bij' e babajt, po të them edhè në rast nevoje jam gati ti vete pas babajt e ti ndihmonj sa të mundem.

BAJKUSHJA

Të març edhe dyfegun në sup ! Ha, ha, ç' më bëre. të qesh !

LULJA

Pse qesh ? Edhe atë do ta bënj kur të jetë nevoja !

[1] Fora = guxim, trimëri

BAJKUSHJA

Më duket se të kanë lojtur menttë, e marrë !

LULJA

S' jam e marrë, po ti e ke gabim !

BAJKUSHJA

Edhe ti do më japësh ment mua ! Nuk ke turp, them unë ? Ato ment i paç për vehte.

LULJA

Duket se s' ke gjak Shqipëtari ! Shtërgjyshet e tua kanë luftuar krah për krah me burrat e tyre kundra armiqve ! Ty, si do mos, nuk të ve njeri në këto mundime.

BAJKUSHE

Ashtu të ka mësuar yt' atë ? Prandaj të ka nxjerrë çirak !

LULJA

Ju kështu e nistë jetën, kështu do ta ngrysni !

BAJKUSHJA

Ajo është puna ime, ty s' të ve qehaja, as avukat !

LULJA

Ke për të parë se kush ësht' i gabuar !

BAJKUSHE

Ç’ më çan kokën edhe ti ! Jam e marrë unë që po ri e dëgjoj këto pallavrat e tua, këto marrëzira ! (*Del jashtë me inat*).

Sqena 4

LULJA

(*vetëm*)

LULJA

Ku di kjo e gjorë se ç' do me thënë Atdhe e kombësi ! Kush ja msoj që ta dijë ? Mos pa shkollë, apo mos e msuan prindët e saj ? Po ne grat’ e reja të Shqiprisë kemi të tjera mendime. Më është mbushur mendja se Shqiptari duhet të rronjë i lirë e jo i përbuzur e i shkelur, se ashtu nuk ka nder. Ajy që s’ e ndjen këtë, ajy që s’ përpiqet ta shkundë nga qafa pluhurin e robrisë, ajy është një shtazë për mua që nuk meriton të rronjë në botë! Është një tradhëtor ! I huaji ësht’ i huaj, s’ ka vent këtu; kjo është toka jonë, toka e shenjtë Arbrore, vendi i trimave që kanë çuditur botën e tërë, që mbahen gjithmon në për gojë !... Ah, Shqipëri, Shqipëri, a do shkrepë ndo një herë ajo dit’ e lumur, ku ta shohsh lirinë e dëshëruar kaqe shekuj ? A do valonjë ndo një dit flamuri jot i shenjtë mbi kodrat e pullazet tona?... Po kij shpresë, se bijt' e tu u zgjuan sot; nuk e durojnë më zgjedhën shekullore! Ardhi dita që do ta shkundin qafet pluhurin e rëndë! Do të të zbardhin faqen e do të ta venë nderin në vent ! Shqipri ngjallu, madhnohu, se ja mbrini dita të rrosh edhe ti si shoqet e tua, e lirë !...

Sqena 5

LULJA, SKËNDUA.

SKËNDUA

Ç’ dashke këtu, bija ime ?

LULJA

Kot ardha. Po bisedonja me nënën.

SKËNDUA

He, ç’ po të thoshte ?

LULJA

Ajo s’ është me mendimet tona; ka frikë se mos na venë kot mundimet tona, se pas mendjes së saj Shqiprija nuk bëhet kurrë !

SKËNDUA

Lere atë më nj’ anë e mos e trazo. Ajo i ka menttë të ndryshkura; s’munt t’ja shkulësh dot atë që ka në trutë.

LULJA

Në vafshim me mendjen e saj pika nevet !

SKËNDUA

(*Qesh*)

Ashtu është vërtet; ato nuk rrojnë në këtë dynja dhe kot është ç’ do që t’u thuash. Po ti qëndro, ashtu si të kam thënë, se un’ e di ç’ bijë kam; ti për mua je një burrë, jo një grua ! Kur të vinjë sëra do na ndihmosh edhe ti !

LULJA

Mos kij dyshim. Ku të vesh ti edhe unë pas !

SKËNDUA

Bravo ! (*E puth në ballë*). Jam i bindur se ti ke karakter edhe nuk e rëzon poshtë; Atdheu ka nevojë sot prej nesh dhe duhet të mos kursehemi për atë me mish e me shpirt gjer në pikën e fundit ! Kjo jetë skllavërijë nuk ka vleftë për ne !

LULJA

Më mirë nën dhê se sa mbi dhê kështu !

SKËNDUA

Tamam ashtu është; po ti mos ri këtu, se sot na vijnë ata miqtë, ata shokët që di ti dhe duhet ti presim. Pregatitni gjësendi për drekë. Unë do vërtitem një herë rrotull dhe do kthehem prapë. Haj, bij' e babajt e mos harro se je bija ime! (*del*).

Sqena 6

LULJA vetëm, pastaj MUSAJ

LULJA

I gjori baba ! Më s' i zenë këmbët dhê ! Është shumë merak për këtë qëllim të shenjtë ! Ashtu duhet, është detyra e tyre; detyra e burravet ! (*Hyn Musaj*).

MUSAJ

Vetëm qënke, Lule ?

LULJA

Vetëm.

MUSAJ

Ç’ po bisedonje më parë me t’ ët ëmë ?

LULJA

Unë ? Asgjë ! .

MUSAJ

Si as gjë ? Po unë isha këtu prapa e ju dëgjonja e ti do të ma fshehësh? Pse je si e hidhëruar ?

LULJA

Jam e hidhëruar unë ? Jo, aspak. Nuk kam gjësendi.

MUSAJ

Më vjen keq të të heq vërejtjen që i kundrështonje aqe tepër s’ at’ ëme! Nuk të pëlqejnë këshillat e saja ? Ajo e ka tamam, po ju me t’ ët atë nuk mendohi mirë !

LULJA

(*Me zembrim*).

E shoh që po të intereson shumë kjo çështje, prandaj po i mban krahun nënës.

MUSAJ

Ta merr mendja; e kemi nënë e s’ bën t' ja prishim qejfin.

LULJA

Po si duhet të bëjmë ahere, ashtu si thot' ajo ?

MUSAJ

Ajo ka të drejtë !

LULJA

(*Me zembrim*).

Ka të drejtë ? I jep të drejtë ? A merr vesht se ç' po thua ?

MUSAJ

Unë s' e marr vesh ? Shumë më mirë se ty !

LULJA

Do me thënë, pas mendimit t' uaj duhet të flemë akoma dhe nuk kemi të drejtë të kërkojmë edhe ne lirinë tonë të dëshëruar ? Ashtu thua zotrote ?

MUSAJ

Moj Lule, ç' janë këto që po flet sot ? Edhe ti me mëntt' e Sdrallos po vete? Ashtu kujton se bëhet Shqiprija me një grusht njerës, si këta që po shoh unë ?

LULJA

Je i gabuar, në qoftë se kujton se janë vetëm një grusht patriotë. Janë shumë. Mjafton një shkëndi që të marrë zjarr një pyll i tërë !

MUSAJ

Edhe Dovleti kujton se do rijë me duart kryq ? Thua se i ka në hesap këta nacionalistët e tu ?

LULJA

Kush e pyet Dovletin ?

MUSAJ

Dovletin kush e pyet ? Po, a kujton ti se munt të qëndrojnë më këmbë këta patriotët e flaktë po të mos dojë Sulltani ?

LULJA

Të thashë, as Dovletin, as Sulltanin s' e peshon njeri !

MUSAJ

Fole një fjalë të rëndë, që nuk ta pranonj, po të kam grua e s' dua të të flas më tepër. Nuk e di ti, se, sa të fërkosh sytë, Sulltani ta bën hi e pluhur Vlorën e Vlonjatët bashkë ?

LULJA

(*Së cilës i bëjnë përshtypje fjalët e Musajt*).

Pa dale ta marrim pak shtruar. Po shoh se ti paske të tjera mendime e sot po më çfaqesh ndryshe ! Më duket se sot po flet me një gjuhë të ndryshme. Nuk më thua si e konsideron vehten zotrote ? A flet kështu, si një njeri i huaj, ose si një turk, që nuk ja do të mirën këtij vëndi ?

MUSAJ

(*Më vehte*).

E shoh se puna mori zjar dhe duhet ta zbutim. (*Lules*). Unë jam një i huaj vërtet, po, mbassi u martova me ty quhet se jam me ju, prandaj po ju flas për të mirën t' uaj e jo se kam ndo një interes tjetër. Më vjen keq për sa që shoh për hesapin t' uaj, se jam i sigurt se nuk do ta nxirni me kut, sa do që të mundohi !

LULJA

Ahere si na këshillon ?

MUSAJ

Unë nga ana ime them se duhet të hiqni dorë nga këto e ti shtrohi Dovletit, se ajy nuk ju do të keqen. Nuk më vjen mirë të venë gjith këta Shqiptarët si sqapi ne kasapi, të shkojnë si qeni në vreshtë ! A e merr vesht ç' do me thënë ta venë me një qeveri ?

LULJA

Nuk do më bindësh kurrë të heq dorë nga ideali i lartër. Ne, ja se do ta fitojmë këtë radhë lirinë, ja se do bijem një e një me nder !

MUSAJ

(*Më vehte*).

Duhet ta marr me të mirë, që ti shkëput ndo një të fshehtë. (*Lules*). Kur ësht' ashtu edhe unë jam ti e ju; do tjetër ?

LULJA

Të falemi nderit.

MUSAJ

A janë mirë armatosur këta të Vlorës ?

LULJA

Ashtu duket, po na mungojnë akoma armë, të cilat i presim së jashtmi. Ahere do jemi më mirë.

MUSAJ

Që nga i prisni armët ?

LULJA

I presim nga Korfuzi. Kanë shkuar njerëzit t' onë atje që ti marrim dhe po i presim dita-ditën.

MUSAJ

(*Më vehte*).

Kaqe desha të msonj (*Lules*) Nuk do vemi sot në Panaja, si e kemi bërë fjalë, që të dëfrejmë me miqtë tonë ?

LULJA

Do vemi.

MUSAJ

Kur ? Më duket se e kishim fjalën për sot.

LULJA

Sot do vemi pas dreke.

MUSAJ

Pse jo përpara drekës ?

LULJA

Se presim ca mysafirë të babajt e më tha të pregatit drekën.

MUSAJ

Cilët janë ata mysafirë ?

LULJA

Nuk e di, po si duket janë shokët e tij, nacionalista.

MUSAJ
(*Më vehte*)

Dal-nga dale po marr vesh shumë gjërra. (*Lules*). Ahere lajmëroji shoqet e tua, si edhe unë miqtë tonë që pas dreke të nisemi aty nga mbrëmja, të mos na djegë djelli.

LULJA

Mirë thua. Ahere po shkonj me vrap ti lajmëronj. (*Del*).

Sqena 7

MUSAJ
(*vetëm*)

MUSAJ

Shumë gjërra mora vesh sot edhe këto më hyjnë të gjitha në punë. Pa shih, pa shih, na duall edhe gratë nacionaliste, pale, pale. Kurrë s' e mbesonja një grua Shqiptare të çfaqet me kaqe enthusiasmë e të shprehet në këtë mënyrë, si Lulja! Duket se ja ka mbushur mendjen i ati, që nuk shëkon punën e tij dhe rrezikun që po i tirret[1], po kërkon të peshkonjë në ujra të turbulla ! Vallahi, nuk e marr vesh si u është mbushur mendja këtyre pleqve e nuk rijnë urtë ! Me ç'njerës do bëhet kjo Shqipëri ? Me ç' gjuhë ? Me ç' mjete ? Ashtu u ngrehka një Shtet me profka ? Po më duket se e kërkojnë si breshka gozhdën dhe kam frikë se do ta pësojnë si Ermenët ! Ja u kanë nxehur gjakun të huajt që të kriojnë një Shqipëri, si e si ta gllabërojnë. Vet' ata dhe shtyjnë këta fatkeqët në mes të zjarrit ! S' u ka faj njeri, vet' e kërkojnë, se s' rijnë urtë. Më qafë paçin vehten, se kështu i do mushka drutë! Sa për mua, unë jam i sigurt dhe një ditë marr edhe Lulen e i le shëndet këtij vendi; vete në Sivas, në vendin t' em. Sot kam një

[1] tirret = nga folja "me tjerrë

rrogë të mirë, pastaj paguhem edhe mirë prej Xhemijetit për të kallzuar këto të fshehta; këta, si kanë kokën le të venë festen ! *(Sheh rrotull*). Dikush vjen ....

Sqena 8
MUSAJ, SKËNDUA

SKËNDUA

Ti, Musa, ç' po bën këtu ?

MUSAJ

Isha me Lulen gjer tani e po llafoseshim.

SKËNDUA

Llafoseshit fjalët t' uaja si gjithnjë ? Se juve ju bije 8 sahati nga hera. Po kini të drejtë, se jini të rinj. Dikur kemi qënë edhe ne si ju. Koha juaj është.

MUSAJ

E kemi bërë me fjalë me disa miq e me ca shoqe të Lulës të vemi sot të dëfrejmë në Panaja.

SKËNDUA

Mirë do bëni, munt të vini kur të doni, që sot në daçi.

MUSAJ
(*Më vehte*)

Shumë ngutet. Kërkon të më çporrë qafet sa më parë, se s' më duron! (*Skëndos*). Ashtu e lamë fjalën të nisemi sot pas dreke.

SKËNDUA

Ç’ kini për të bërë bëjeni një or’ e më parë.

MUSAJ
(*Më vehte*).

U muar vesh! E di se s’ do të më shohë as të zografisur, po s’ ka ç’ bën, se i rashë në çanak.

SKËNDUA

Ç’ mendohesh ?

MUSAJ

As gjë, po shkonj të pregatitemi që tashti....

SKËNDUA

Shumë bukur, mos humbisni kohë.

MUSAJ
(*Më vehte*).

Tamam, atë që s’ do ky ! (*Skëndos*). Ahere tu mirë mbetshi. (*E ze për dore dhe largohet*).

Sqena 9

SKËNDUA
(*vetëm*)

SKËNDUA

Morè, ç’ na u bë bela edhe ky? S’ kuxon të vërtitesh e sheh përpara si fantin bastun ! Shumë po nuhat këtu ka ca kohë. Sado që e kam dhëndër, po s’munt ti ze besë, se më në funt ësht një i huaj, po taksirati që e bëra dhëndër!

... Po ç'u bënë xhanëm, këta njerës, që më s' duken ? As Lumua nuk u kthye!.... Ky kazan që po zjen do pëlcasë një ditë, se edhe kështu s' durohet! Lëvizjet kanë filluar më të katër anët e Toskërisë, po puna është që të na vijnë edhe armët e municjonet, që po presim, që të marrë flagë si duhet! (*Trokasin*). Dikush po vjen…. Më duket se do jetë Petriti ky. Pa të shohim ç' të reja na ka sjellë. (*Shkon e ja hap derën*).

Sqena 10

SKËNDUA, PETRITI.

SKËNDUA

(*Tuke parë Petritin*).

Ç' u bëre, jahu? Po të pres si ujin e ftohtë! Urdhro e sheshohu ... Ç'të reja kemi ?

PETRITI

Pëllëmb' e tym shkon ku do ! Mjaft përpjekje janë bërë në mes të nacionalistëve e të ushtris turke. Çerçiz Topulli me çetën e tij të vogël po bën çudira ! Një luftë gjaksore bëri në Mashkullore, ku ish tradhtuar e qarkuar nga turqit dhe vrau e plagosi mjaft ! Në Gjinokastër vrau një bimbash ...

SKËNDUA

Hallall i qoftë ! Po edhe këtej punët nuk shkojnë keq. Ne s'dëgjojmë më as urdhra, as kërpudhra. bëjmë si na do qejfi !

PETRITI

A e muart vesh ç' u bë në Korçë ?

SKËNDUA

Jo ! Pa na trego ...

PETRITI

Një tufë djelmoshash në fushën e Korçës u përpoq me një koxha ushtri dhe po thuaj e shkatroj, Prej tonët u vranë nja katër, por i dhanë të kuptonjë halldupit se Shqiptarët s' janë gorica Stanjolle, po janë prej atyre goricave mbytka që të zihen në grykë!

SKËNDUA

Bravo ! Cilin kishin kapitan ?

PETRITI

Kishin dy: Spiro Bellkamenin dhe Qamil Panaritin, që të dy djelm të rinj, trima që përpinin retë! Po atje u ngritnë edhe katundet më këmbë, si edhe gratë me shata e me kazma e i vunë përpara turqit si berrat, sa u bint edhe dreqi !

SKËNDUA

Ç' thua ? Edhe gratë ?

PETRITI

Po, po edhe gratë; një gjë e këtillë s' ka ngjarë kurrë !

SKËNDUA

Bravo Korçarë !

PETRITI

Edhe kolonjarëve thuaj, se ka qënë atje një farë Bajaziti, një kolonjar prej Psarit, që bëri kërdinë mbi turqit gjer sa ra edhe vetë i vrarë ! Kaqe ishin të zembruar turqit, sa edhe të vrarëve u thyen krerët me kondaqet e dyfegjevet !

SKËNDUA

Bishat e fëlliqura ! ... Të shkretët dëshmorë !

PETRITI

Deshnin ti hithnin në hendeqet ti hanin sorrat, po u ngrit Korça më këmbë e protestoj me aqe telegrafë te Sulltani gjer sa muar lejën ti varrosin dhe i varrosnë me një shkëlqim të math. Nuk mbet sy pa lotuar !

SKËNDUA

Ah, të mjerët ! ... U qoftë kujtimi i paharruar ! Po ata që shpëtuan ç'u bënë?

PETRITI

Ranë në mes të kënetave të liqenit Maliq e mezi kaluan përtej nga Starova e shpëtuan[1]!

Sqena 11

TË PARËT, LUMUA

SKËNDUA

(*Posa sheh Lumon*).

Ku je, mor Lumo që po të pres?

LUMUA

Tani posa zbrita nga kali. Të fala kini nga kapitanët e çetavet.

[1] Këtë ngjarje të luftës së Orman Çiflikut të korrikut 1911 në Korçë, Kristo Floqi e ka përshkruar në epopenë e shkruar prej tij të titulluar "Dëshmorët e Rilindjes ose Epopeja e Korçës"

SKËNDUA

Qofshin shëndoshë. Ç' të reja kemi ?

LUMUA

Mirë venë, po ju mungojnë armët të shumëvet. Si e dijni, delegatët që i dërgoj Gjirokastra në Korfus s' janë kthyer akoma. Po thonë akoma, se bashkë me armët e municjonet vijnë në Shqipri edhe nj' a dy qint Garibaldinë kuqalashër, që i sjellin armët.

SKËNDUA

Mir se të vijnë. Sihariq i math ky për nè !

PETRITI

Oh, sa na halladite zembrën ! Kur priten të vijnë ?

LUMUA

Dita-ditën. Tani jam i porositur t' ju them të jini gati për një kryengritje me karakter të përgjithshëm, se janë më këmbë Toskëri e Gegëri bashkë !

SKËNDUA

Shumë bukur ! Edhe nè gati jemi, le të vinj' ajo ditë. Ti Petrit, pasi të hamë bukë të nisesh shpejt atje ku të thret detyra, se shokët kanë nevojë prej teje. Këtu jemi nè, mos kini merak.

PETRITI

Unë shkonj të ble sa më kanë porositur dhe kthehem shpejt.

SKËNDUA

Ashtu bëj, vëlla. (*Petriti e Lumua dalin*).

Sqena 12

SKËNDUA

(*vetëm*)

SKËNDUA

S' ka lënë njeri Perëndija pa derman ! Duket se Fati s' e ka lënë doret Atdhenë tonë, se s' është gjë e vogël të të vijnë sot dy qint burra Gariballdinë, luftëtarë të provuar, të sakrifikohen për hatrin tonë ! Rasti që na paraqitet sot nuk vjen tjetër herë. Lipset të përfitojmë. Turqija nuk ësht' ajo e para, se sot i kanë rënë pendët. Lufta me Italinë e theu në mes. Tashti po i vërtiten edhe shtetet e Ballkanit, Greqija, Bullgarija, Sërbija edhe Karadaku[1]. Ata do t' ja hanë kokën sigurisht. Nè duhet të kemi mendjen sot. Kaloj ajo kohë që vijnim vehten në rrezik si të marrët për hesap të Osmanllisë ! Nè s' e kemi lënë të shkatërohet sa herë ka ardhur në buzën e varrit. Po tani shkoj ajo kohë. Turqisë po i tingëllon ora e fundit; nè do ti japim shkelmin e mbramë që ta dërgojmë nga ka ardhur! Mjaft i duruam ! (*Troket dera*). Kush të jetë vallë ? (*Shkon e çel derën*). Ç'urdhëroni ?

Sqena 13

SKËNDUA

një komiser Policije dhe dy gjindarë.

KOMISERI

Do të urdhërosh pak në Polici, se po të kërkojnë për një pyetje të vogël.

[1] Karadaku = Mali i Zi

SKËNDUA

(*Më vehte)*

Ja këtu s' më pëlqen puna ! (*Komiserit*). Cila ësht' ajo pyetje nuk ma thoni?

KOMISERI

Nuk e di, po kam urdhër nga superiori im t'ju marr atje.

SKËNDUA

Të më merni atje ? Pse, nuk vinj edhe vetë ? S' ish nevoja.

KOMISERI

Ashtu e kam urdhrin. Po të mos doni me të mirë do t'ju mar me zor.

SKËNDUA

Ashtu qënka puna ?

KOMISERI

Si urdhëron.

SKËNDUA

(*Me vehte*).

Kam dyshim se mos na ka tradhtuar njeri dhe po të vete atje mos bije si miu në kurthë!

KOMISERI

Ç' thoni do vijni, apo jo, se s' munt të pres më tepër.

SKËNDUA

Kaq'e madhe nevojë qënka për mua ? Po për se më duan nuk munt të ma thoni ju ?

KOMISERI

Nuk e di, as që është puna. ime ajo. Mjaft e zgjate. Do vish me të mirë, apo jo ?

SKËNDUA

Nga dale, jahu, mos bëj ashtu, unë nuk u bëra kaçak, këtu jam, nuku ikinj!

KOMISERI

Ahere mos më bëj të pres, se kam edhe punë të tjera.

SKËNDUA
(*Më vehte*).

E shoh se s' u bëkërka ndryshe ! Po fundi i fundit ç' ka për të më gjetur le të më gjenjë sa më parë. Ky stan këtë bulmet ka !

KOMISERI

Mos u silli. vjen, apo jo ? Një e një bëjnë dy !

SKËNDUA
(*Të cilit i pëlcet shpirti*).

Edhe dy e dy bëjnë katër, ç' kërkon të thuash me këtë ? Shkoni se po vinj vetë atje. Nuku dua të më shohin se më shpini ju ....

KOMISERI
(*Gjendarëvet)*

Kapeni ! (*Gjendarët sulmojnë mbi Skëndon, ndër sa që ky kundërshton e i shtyn*). Vinjani hallkat ! .... (*Gjendarët mundohen t' i hedhin hallkat duarve,*

por Skëndua mbrohet tuke bërditur. Në këtë kohë dalin në sqenë Bajkushja, Lulja dhe Lumua dhe sulen të dy të fundit ti ndihmojnë Skëndos).

Sqena 14

TË PARËT, BAJKUSHJA, LULJA, LUMUA

BAJKUSHJA

Ç' ngjet kështu ?

LUMUA

Ç' pate, dajko ?

SKËNDUA

Nuk e shëkoni që po më marrin me përdhuni ?

KOMISERI

Mbrapsuni ! (*Gjendarëvet*). Lidheni shpejti (*Gjendarët mundohen ta lidhin, po Lumua u hyn në mes e i ndalon)*

LUMUA

(*Tuke nxjerë revolverin*).

Nuk lidhen, or jo, kështu burrat ! (*Fillon të shtjerë mbi gjendarët të cilët nxjerin kasaturat*).

KOMISERI

(*Lumos*).

Hallt, jezit ! (*Nxjer dhe ky revolverin dhe e qëllon Lumon, të cilin e plagos rëndë. Lumua rëzohet*).

LUMUA

Ah, më vranë të pabesët !

SKËNDUA

Lumo, djali im, ah, të mora më qafë !

LULJA

(*Tuke ju afruar përsipër Lumos, kujton se u vra. Komiserit*).

Ah, gjakpirës të poshtër ! Do ta shpaguani këtë gjak !

KOMISERI

Mbrapsu edhe ti dosë ! (*Gjendarëvet*) Merreni këtë të vrarin dhe hiqeni që këtej jashtë! (*Tuke treguar Skëndon, që ësht' i lidhur*). Nxireni edhe këtë firaun ta shpiem në Polici ! (*Gjendarmët venë në vepërim urdhrin e komiserit, po Lulja hyn në mes*).

LULJA

(*Si e prishur mentsh*).

Ku e çoni këtë? Lereni…. unë s' e le e gjalla ta merrni ju ! (*Pushton t'atin*). Më vrisni mua më parë pastaj më merni babanë ! (*Gjendarët ja çliroinë duart*).

KOMISERI

Merreni shpejt e çojeni ku e ka vendin të na lerë rehat ! Marrsh, përpara!

SKËNDUA

(*Tuke dalë jashtë*).

Ah, katila, xhelatë! ... Do të na e paguani shtrenjt këtë gjak ! .... Ah, Lumo, Lumo, nuk ta lemë pa marrë gjakun ! (*Lulja përplaset poshtë nga dëshpërimi, ndër sa që Bajkushja i ri përsipër Lumos, tuke i fshirë gjakun, Komiseri e gjendarët me Skëndon dalin*).

LULJA

(*Çohet përgjysmë më gjunjë dhe mbërthen duart, tuke ngrit sytë përpjetë*).

Ah, ç' na gjet !. ...

BAJKUSHJA

Mirë ti bëhet, e kërkoj dhe e gjet !

LULJA

T' u thaftë goja, t' u thaftë !

Bije napa.

Fund i Aktit të II .

A K T i III

(Theatri çfaq një shesh pranë katundit Cakrani të Mallakastrës. Nga an'e djathtë një rrap i math me hije të dendur pranë të cilit një mburrim (krua). Rrotull shelgje. Petriti, Gjençua, Lumua dhe Lulja, mveshur të gjithë me roba komitash, të armatosur me vezme e fyshekë e me revolver me kryet lidhur me shami të zeza, janë sheshuar këmbëkryq me dyfegjet mbi prehërit e tyre. Është natë).

Sqena 1

PETRITI, GJENÇUA, LUMUA dhe LULJA.

PETRITI

Sa lezet që të paskan këto roba komitaxhiu, moj Lule ! Dukesh tamam si një kapitan !... Po, nga babaj a kini ndo një lajmë ?

LULJA

Që kur se muarm vesht që e bënë syrgjyn në Konjë, tjetër gjë s' dijmë edhe jemi shumë merak !

PETRITI

Do kalonjë edhe këjo, mos u sëkëlldisi.

GJENÇI

Një taksirat ishte edhe ky; veç të jetë mirë, pa të gjitha harrohen.

LUMUA

Jemi si pa krye e nuk ngushëllohemi dot !

PETRITI

Kini të drejtë, po durim !

GJENÇI

Ja ku kemi këtë kapedaneshë në vent të tij ! (*tregon Lulen*).

LULJA

Sa pare bën kur s' e kam babanë këtu? (*fshin sytë*).

PETRITI

Durim, durim !... (*Të tjerëvet*). A e muart vesh se ja muarm hakkun Ismail beut?

LUMUA

Qysh? Pa na thuaj ....

PETRITI

Dervish bejnë, atë deputetin e Serezit që pat rahur me pëllëmbë Ismail Qemalin a e mbani mënt ?

LUMUA

Po, po, s' na harrohet kurrë ajy i poshtër !

PETRITI

E vranë dy Labër !

LULJA

Folë mirë !

PETRITI

Po, po, kjo është e vërtetë si më shihni e ju shoh. Njëri prej atyre u kthye në Vlorë e e poqa pardje e më tregoj. E vranë në Pire të Greqisë, tek po bëhesh gati për të shkuar në Skënderi.

LUMUA

Mirë ja bënë !

LULJA

U lumçin krahët !

Sqena 2

TË PARËT, THEMISTOKLI GËRMËNJI

THEMISTOKLIU

Mir' se ju gjejmë !....

TË GJITHË

O, urdhroni, urdhroni !... (*Përshëndoshen*).

THEMISTOKLIU

Ku i kini shokët e tjerë ?

PETRITI

Këtu rrotull janë; do vijnë tani, po urdhroni e mbani një raki, se jini të lodhur, (*i jep një pagur me raki*), se kjo uj' e këtij rrapi e heq fort.

THEMISTOKLIU

(*Tuke marrë pagurin*).

Mir' se ju gjejmë dhe ç' do punë për hair ! (*Pi*).

TË GJITHË

Mir' se na ardhe ! Amin !....

GJENÇI

Si vijni andej nga Korça ?

THEMISTOKLIU

Nuk shkojmë edhe aqe keq si më parë, se tashti turqit kanë zënë hallin e tyre dhe nuk na bijen edhe kaqe më qafë ! Po unë ardha këtu t' ju kallzonj një pllan të ri që kemi bërë gjithë krerët e Korçës, Devollit, Starovës, Kolonjës e Dangllisë.

PETRITI

Urdhroni, se po dëgjojmë.

THEMISTOKLIU

Duhet ta dijni se turqit zunë të kenë frikë nga nè ...

LULJA

Si kështu ?

THEMISTOKLIU

Si e dijni, është gati të pëlcasë lufta e Ballkanit dhë turqit janë trembur mjaft, se e shohin se nuk do t' ju bëjnë ballë aleatëve të bashkuar. Prandaj fuqitë më të mbëdha të tyre i kanë tërhequr në për kufit e Bullgarisë, të Greqisë, të Sërbisë e të Karadakut ! Andej nga viset tona ka mbetur një fuqi e vogël.

PETRITI

Ashtu ? Ahere puna qënka mirë.

THEMISTOKLIU

Pra, tani është një rast i mirë për nè dhe duhet të mos na shkonjë kot, edhe për këtë qëllim kam ardhur këtu që ta bisedojmë çështjen e të shohim se si na del.

GJENÇI

Shumë mirë paski bërë.

THEMISTOKLIU

E kuptoni të gjithë se, në qoftë se kërcet lufta Turqija nuk do jet' e zonja të qendronjë më këmbë, se sot është, pothuaj, e shkatëruar krejt ! Ahere vendi jon' i mjerë do të bëhet sheshi i kësaj lufte të përgjakëshme dhe kafshata e lakmis së beligjerantëve[1] Ballkanas, në qoftë se ne nuk i dalim zot vendit tonë!

PETRITI

Tamam ashtu është !

THEMISTOKLIU

Ballkanasit do na ndajnë e do na përçajnë, a më mirë të them e kanë ndarë që me kohë në mes të tyre Shqipërinë, ashtu si ja u do qefi e interesa e tyre.

LUMUA

Ta merr mendja !

THEMISTOKLIU

Gjer tani kishim frikën e Turqisë, po nuk rrezikonim të shpërndaheshim ca andej e ca këtej, si zoqt' e korbit, kur se tani, jo vetëm do na shpërndajnë, po do humbasim edhe gjuhë edhe kombësi e ç' do gjë tjetër që kemi, edhe pastaj ... Lamtumirë Liri për gjithmonë! Do vdiste ç'do shpresë për nè. Apo s'ësht'ashtu?

PETRITI

Mjerisht ashtu është !

THEMISTOKLIU

Nè andej jemi menduar kështu: Tuke. qënë se edhe për pak kohë largohen nga Shqipërija gati të gjitha fuqit ushtarake turke, nè, tue u bashkue edhe me

[1] Beligjerant = ndërluftues,shtete që luftojnë midis tyre

disa oficera e ushtarë Shqiptarë që janë n' ushtërinë turke e që do dezertojnë për dita e do vijnë me nè, se më së fundi janë Shqiptarë edhe ata, ne do bëjmë një fuqi të fortë dhe do mundim t' u presim hovin turqve kur të kthehen të shkatruar nga lufta, kështu që do ti vemë në mes të dy zjareve, gjë që do t' u interesonjë aleatëve Ballkanas, po nuk do t' ju dalë edhe mirë ...

GJENÇI

Pse ashtu ?

THEMISTOKLIU

Se, si do qoftë, ne do ngrehim flamurin tonë dhe do ta deklarojmë independent vëndin tonë dhe, kur ta shohë kështu Evropa, që nè i duallm zot vetë vendit, s' ka dyshim se do na e njohë edhe ajo vetëqeverimin tonë !

PETRITI

Shum' e mirë ide … po, në realitet nuk dijmë si del !

THEMISTOKLIU

Edhe në realitet mirë do dalë, mjafton të kuxojmë !

GJENÇI

Më duket si tepër e vështirë kjo punë !

LUMUA

Mua më duket ëndër !

THEMISTOKLIU

Ç' do punë ësht' e vështirë në krye, po ta dijni se, fillimi i punës është gjysma e fundit !

LULJA

Të gjitha të bukura këto, po kam frikë mos mbeten vetëm në theori e mos mbetemi edhe nè me gisht në gojë e në turp !

THEMISTOKLIU

Pse do mbetemi në turp ? Mos kujtoni se nuk do ta nxjerim mb' anë ? Po edhe si kur të mos bëhet gjë mjafton që ta turbullojmë një herë pa le të dalë ku të dalë, të paktën do ta tundim!

PETRITI

Ashtu po, se që ta vemë nè me kaqe taborë është një gjë e pamundur, sado të shkatëruar qofshin !

THEMISTOKLIU

Një ushtri kur humbet moralin s' bën as pesë pare ! Me një herë i heth armët e të dorëzohet !

LUMUA

Kështu do mbushemi edhe me armë !

GJENÇI

Qysh e kini ngrehur pllanin ?

THEMISTOKLIU

Nè do zemë qafat e grykat strategjike, se jemi marrë vesh edhe me Kosovën e me Shkodrën. Ju këtej do vini në marrëveshje edhe me Durrësin e do të mbroni bregjet e detit. Ja dhe pllani. (*Ja u tregon*).

TË GJITHË

(*E kqyrin me vërejtje*).

Shumë bukur !

THEMISTOKLIU

Po ju jap një kopje dhe studijojeni edhe ju mirë e me kujdes ! Këto desha t'ju them edhe merni edhe ju masat këtej. Unë po nisem. Mbetçi me shëndet. (*I përshëndet të gjithë*)

TË TJERËT

Ju qoftë udha e mbarë ! (*Themistokliu del*).

Sqena 3

TË PARËT përveç THEMISTOKLIUT

PETRITI

Nuk ësht' i keq pllani që na tregoj Themistokliu.

GJENÇI

Ajy është shum' i zoti për kësij punësh se ja pret mëndja.

LUMUA

Me fjalë mbarohen të gjitha, po fundi për hair !

LULJA

Nè le të përpiqemi, pa edhe në mos u bëftë gjë fundi i fundit një vdekje kemi borç !

PETRITI

Ashtu është. Nè duhet të përpiqemi një herë, pastaj fjalën le ta ketë historija !

GJENÇI

Se mos jemi nè të parët e të fundit ? Historija kështu bëhet !

LUMUA

Ahere le ti përvishemi punës.

PETRITI

Ju qëndroni këtu; ne me Gjençon po shkojmë të lajmërojmë edhe shokët për këtë pllanin e ri.

LUMUA

Ç' ka, shkoni ju. (*Petriti e Gjençua dalin*).

Sqena 4

LUMUA, LULJA

LUMUA

Si të duket ky pllan, Lule ? Kupton nga këto gjërra ti ?

LULJA

Si do qoftë, ata që e kanë e menduar s' kanë bërë keq. Ja u pret mendja më mirë se nè. Mua më vjen keq vetëm se nuk ndodhet edhe babaj këtu të na jepte edhe ajy një mendje.

LUMUA

Edhe mua më këputet shpirti kur e kujtonj !

LULJA

Akoma s'munt ta kuptoni kush ishte ajy që e tradhtovi ! Ah, si kur ta dinja!

LUMUA

Ajy do të ketë qënë ndo një çanak-lëpirës, ndo një faqe-zi, po si do mos është një njeri që e njohim edhe nè, se s' mund të dinte aqe hollësira qeverija për mbi kompllotin tonë !

LULJA

Të betohem, Lumo, për kryet e babait, që po e dëshëronj, se kush do qoftë ajy, unë vetë kam për t' ja marrë hakkun me këtë dorë.

LUMUA

Edhe unë po ta dinja nuk do ta linja pa spastruar !

LULJA

Na shkaktoj një të keqe të madhe !

LUMUA

Na shkurtoj krahët !

Sqena 5

TË PARËT, ÇERÇIZ TOPULLI, MIHAL GRAMENUA

ÇERÇIZI
(*Tuke hyrë*)

Ç' bën, more Lumo, lum' e përrua ?

LUMUA

O, mir' se ardhe, kapitan, urdhroni ! (*Përshëndoshen*)

MIHALI

Po ky komit i ri kush është ?

LUMUA

Nuk e njeh ?

MIHALI

Më vraftë mushka e papa-Sofronit se në e njoh !

LUMUA

Është komitaxhesë e jo komit !

MIHALI

Folë mirë, pash Zotin !

LUMUA

Nuk e njeh të bijën e Skëndo Gjatës ? Është Lulja !

MIHALI

Lulja këjo ? Folë mirë ! (*E ze përdore*) Bravo Lule !

ÇERÇIZI

Si moj ? Ti Lule qënke ? Piqe një here ! (*E përshëndosh*). Sa mirë të vajtkan këto roba andarte[1] !

[1] Andart = komit

LUMUA

E kemi në vent të daj-Skëndos !

MIHALI

Vërtet nuk të pyeta, Lumo, ç' bëhet Skëndua ?

LULJA

Zoti e di, nè s' po dijmë gjë prej gjëje ! S' dijmë në ësht gjall, apo jo !

ÇERÇIZI

Mos e fol' atë fjalë; nuk vdesin burrat si Skëndua.

MIHALI

A më sheh mua ? Kjo lëkurë ësht' argasur[1] prej burgut, po prapë si më shëkoni, jam i gjallë !

ÇERÇIZI

Ku janë shokët t' uaj?

LUMUA

Këtu janë të gjithë ! Ju si shkoni andej ?

ÇERÇIZI

Si të shkojmë ? Nuk i msuat të rejat ?

LUMUA

Jo !

[1] Argasur = regjur

ÇERÇIZI

Nuk e muart vesh se delegatët që dërguam në Korfuz për armë e municjone na i zunë në Sarandë dhe i dërguan lidhur në Janinë ?

LULJA

Ç' më thua ? U tradhëtuan ? Oh, sa keq !

ÇERÇIZI

Mjerisht u tradhëtuan dhe jo vetëm ata, pa na konfiskuan edhe tre qint e ca dyfegje dhe kush e di sa kasa fyshekë që kishin nxjerë në Konispol !

LUMUA

Medet, qënkemi për të vrarë !

MIHALI

Ajo e armëvet edhe e fysheqevet është çështja më e keqe për nè, se ato na mungojnë sot !

ÇERÇIZI

Mynafiku[1] të prish kalanë !

MIHALI

Nè akoma s' munt ta kuptojmë si u bë kjo tradhëti ! Po duket se tradhëtori është njeri i brendëshëm që na i ka marrë vesh të gjitha dhe e marrim me mëndje se ky do jetë jase një Vlonjat, ja se një Gjirokastrit !

[1] Münafik = hipokrit

LUMUA

Kush të jetë, vallë, ky i dobët ?

MIHALI

Do ta gjejmë, mos kij dyshim !

LULJA

I mallkuar qoftë kush do qoftë !

ÇERÇIZI

Tani mos i zgjatim fjalët, a ju ndodhen juve fyshekë ?

LULJA

Fyshekë kemi, kapitan, mos u bëni merak.

ÇERÇIZI

Të lumtë e bardha gojë, moj Lule ! Edhe nè tjetër s' duam. Po ku i kini? A munt të na i jepni që tani ç' na kini për të dhënë ?

LULJA

Kur që të doni, po mos u ngutni se ju kemi për darkë sonte.

ÇERÇIZI

Ç' darkë flet, moj e uruar? Ku kemi kohë për dark' e për drekë ? Ne e kemi kokën në torbë sot ! Darkën e hamë edhe udhës, po për fyshekë është nevoja sa më parë, ajo punë s' na pret !

LULJA

Ç' ka, si të doni. (*Lumos*). Ti Lumo i di se ku i kemi nj' a 3-4 kasa fyshekë. Sulu që tani dhe dërgoji këta miq gjer në vënt, jepjuni sa fyshekë të kenë nevojë, dhe të tjerat i ruani për nè.

MIHALI

Na kini bërë një shërbim të math, zojushe, që nuk do t' ju a harrojmë !

LULJA

E kemi detyrë këtë përpara Atdheut !

MIHALI
(*Çerçizit*)

Ja, këto janë ato Spartiatet që të kam thënë ! Ka edhe Shqipërija Spartiate, Çeço ! Hyre brenda ?

ÇERÇIZI

Po, more, po l Këto janë xhevahiret e Shqipërisë ! (*Lules*) Zoti më të faltë, moj burrneshë; qofsh shëmbëlla e shoqeve të tua !

MIHALI

Dardha nënë dardhën do bjerë ! Bravo, moj fisnike !

ÇERÇIZI

Hajde, Mihal, mjaft fole. U pjekshim shëndoshë o Lule!

MIHALI

Lamtumirë e falemi nderit shumë !

LULJA

Paçi udhën e. mbarë dhe Zoti me ju; ju nxjertë faqe-bardhë ! (*Çerçizi, Mihali dhe Lumua dalin jashtë*).

Sqena 6

LULJA

(*vetëm*)

LULJA

Kush të jetë, o Perëndi, ky tradhëtor i poshtër që na tradhëtoj kështu? Nuk ishte mjaft ç' na ngjau me babanë, po na dhe një tjetër tradhëti më e keqe se e para! Kjo na shkurtoj krahët! Në ato armë e municjone i kishim mvarur të gjitha shpresat. Kam frikë se mos na venë kot të gjitha. Ah, ta dinja tradhëtorin, do t'ja mernja hakkun me këto duar, do ta coptonja me thonj! O Atdhe i dashur, Shqipëri ! Ty veç të të shohim të lirë e të lumur pa do ti gëlltitim këto të gjitha!

Sqena 7

LULJA, BAJKUSHJA, MUSAJ.

BAJKUSHJA

Moj e marrë, këtu je akoma ? Nuk të kanë ardhur mentë ? Ike e le burrë e shtëpi e ardhe këtu të bashkohesh me këta të prishurit nga kondaku? Ti do t'a shpëtosh Shqipërinë, ti, që u bëre qepaze në gjithë mëhallën ?

MUSAJ

Mirë të thotë ! Unë çuditem me ç' lejë ike nga shtëpija e me ç' sy e. faqe do kthehesh prapë !

LULJA
(*Me inat*)

Kush ju tha të vijni këtu ?

BAJKUSHJA

Kush na tha ? Ishte nevoja të na thotë njeri, që s' kuxojmë të dalin ne pragu i derës nga shkaku yt ? Arthmë nga halli !

MUSAJ

Ka të drejtë Bajkushja, ashtu është !

LULJA

Ç' do njeri ësht' i lirë dhe e urdhron vehten e tija; edhe unë urdhronj vehten e s'kam nevojë të pyes njeri !

BAJKUSHJA

Mblith mëntë, po të thom, se më duket se të kanë rrojitur !

LULJA

Mëmë të kam, po për këtë qëllim që mora malet, nuk pres këshilla prej tejet, as prej kurkujt ! E di detyrën t' ime !

MUSAJ

Kush ta dha lejën që ardhe këtu ?

LULJA

E mora vetë, s' kam nevojë të pyes njeri !

MUSAJ

As burrin ? Mua s' më ke burrë ?

LULJA

Nuk të njoh, po të duash ndamë, s' bëhem shumë merak !

BAJKUSHJA

Përpara t' yt shoqi flet kështu ?

LULJA

Përpara t' im shoqi e përpara teje akoma kam Atdhenë ! Për nderin e atij Atdheu rronj edhe për atë do të jap edhe jetën !

BAJKUSHJA

Ti ke lojtur mentsh, më duket, s' je tamam !

LULJA

Është puna ime !

MUSAJ

Mjaft, se nuk të ka lezet më, e tepërove !

LULJA

Shëkoni punën që të dy e më lijni rehat ! Nuk do më shmangni kurrë nga kjo detyrë!

BAJKUSHJA

Ktheu në shtëpi, po të them se do bëhesh pishman !

LULJA

Mos hump fjalët kot; është punë që s' bëhet !

MUSAJ

Do të të marrim me zor, në mos arthç me të mirë !

LULJA

Provoni, po të jini të zotët !

BAJKUSHJA

Mos bëj kokë të fortë përpara burrit; burri të urdhron !

LULJA

S' kam burrë përpara Atdheut !

MUSAJ

Po të jap një kohë të shkurtër të mendohesh !

LULJA

Jam menduar me kohë; s' kini si më bindni; do bëni mirë të shkoni nga kini ardhur, s' ka kush më pengon !

BAJKUSHJA

Kaqe kokë-fortë qënke, moj teknefeze ?

LULJA

E kam vendosur të vdes për Atdhenë, e s' më ndalon as njeri !

MUSAJ
(*Bajkushes*).

Hajde dalim tashi e në mos u bintë më von marrim masa të tjera. (*Lules*). Një orë ke kohë, mendohu thellë !

BAJKUSHJA

Mendohu, vere gishtin në kokë ! ... (*Dalin që të dy*).

Sqena 8

LULJA
(*vetëm*)

LULJA

E prisnja edhe këtë ! Edhe në mos u kthefsha me të mirë do marrin të tjera masa, thotë; do më tërheqin me zor ! Aqe kollaj u duket; pa le të shohin një herë, se me cilën kanë të bëjnë! Unë e vdekur ikinj që këtej ! E vendosa të vdes, fjalën s'munt ta mar prapë !.... O Atdhe; Atdhe i dashur, u betova për ty mbi Flamurin tonë dhe do të të mbroni gjer në pikën e fundit të gjakut t' em !... Atdhe, s' dëgjonj tjetër përveç se zëthin tënt, atë zë të vajtushëm që më ngjeth eshtrat e mija, që më prek shpirt e zemër !... Atdhe, s' të ndahem kurrë !

Sqena 9

LULJA, LUMUA

LULJA

He, mbaruat punë ?

LUMUA

Mbaruam. U dorëzova dy kasa, si më the, të. tjerat i mbajtmë për nè, dhe përcolla me bekime që të dy (*Tuke e parë Lulen me verejtje*). Pse më dukesh si e sëkëlldisur? Mos të ngjavi gjë sa nuk isha unë këtu ? Të shoh mjaft të zbetë në fytyrë, si kur të është prishur gjaku !....

LULJA

Nuk kam gjë !

LUMUA

Kujt do t' ja sheshish ato mua ? Lumos ? Thuajm ç' të ngjau, se unë e shoh mirë që je e turbulluar shumë ....

LULJA

Nënëja me Musanë ishin këtu dhe u munduan të më bindin të kthehem prapë në Vlorë ....

LUMUA

E ti ç' u the ?

LULJA

U thashë se mundohen kot, se unë nuk kthehem kurrë !

LUMUA

Mir' u paske thënë ... Pastaj a e këputnë qafën që të dy ?

LULJA

Do kthehen përsëri. Më dhanë një orë afat të mendohem ...

LUMUA

Ndryshe ?

LULJA

Ndryshe do marrin masa të tjera. Do më marrin përdhunisht !

LUMUA

Përdhunisht, hë? Ha, ha, ha !... Gjetnë kishë ku të falen ! Po ... si kur të të mernin ç'do theshe ? (*qesh*).

LULJA

Ç' kuvendon, mor buf' i kënetës ? Nuk ma di kokën ti ?

LUMUA

E mora vesh, e mora !.... Po ... si do harro se këtu jam edhe unë ...

LULJA

Copën më të vogël kaqe të ma çajnë, unë e gjallë s' kthehem !

Sqena 10

TË PARËT, PETRITI, GJENÇUA, SHPENDI

PETRITI

He, vetëm qënki ?

LUMUA

Vetëm jo, se kishim edhe mysafirë.

GJENÇI

Cil' e cilë ?

LUMUA

Ishin Çerçiz Topulli me Mihal Gramenon.

SHPENDI

Kur kështu ? Si s' i pamë ne ?

LUMUA

I përcuallm shpejt, se ashtu e kishin punën.

PETRITI

Për se kishin ardhur ?

LULJA

Kishin nevojë për fyshekë e ju dhamë dy kasa.

PETRITI

Mirë bëtë.

GJENÇI

Qysh, nuk kishin ata fyshekë? Po nè prisnim të na jepnin ata e jo t' ju japim ne.

LUMUA

U ngjau një taksirat i math, që është edhe taksirati tonë !

SHPENDI

Ç' u ngjau ?

LUMUA

Ata të dy delegatët që ishin dërguar në Korfuz për armë e municione, u tradhtuan e u zunë në Sarandë e u dërguan lidhur në Janinë. Po e keqja ishte që bashkë me ata u zunë edhe armët e fyshekët !

PETRITI

Oh, medet ! Ne qënkerni për të vrarë !

LULJA

Mos e pyet sa jemi sëkëlldisur !

GJENÇI

Qënkemi për të qarë e për të vajtuar !

SHPENDI

Kush, vallë, do na ketë tradhtuar ?

LULJA

Ndo një faqezi, kush tjetër! Atë mundohem ta gjenj edhe unë e po vras mendjen kot !

LUMUA

S' kemi ç' bëjmë; do cigarisemi me vajin t' onë; do luftojmë si burrat me ato të pakta fyshekë që kemi !

PETRITI

Zoti mos na turpëroftë !

Sqena 11

TË PARËT, HAJDAR KALOSHI

HAJDARI

(*Hyn tuke u drojtur e flet me zë të ulët*).

Mos u trempni, jam unë !

TË GJITHË

O ! Kajmekam beu !

HAJDARI

Ju vjen çudi pse më shëkoni këtu pa pandehur edhe si do mos në këtë orë të shkuar, po, ju them se më ka shtyrë një detyrë e naltë e e shenjtë !

PETRITI

Ju lumtë këmba !

HAJDARI

Mos më shëkoni me sy armiku, sepse jam miku e vëllaj juaj !

GJENÇI

S' kemi dyshim për atë; edhe ne ju konsiderojmë si një Shqiptar të ndershëm e fisnik ! Urdhroni...

HAJDARI

Me hidhërim të math, ju them, se delegatët t' uaj që ishin dërguar në Korfuz për armë u zunë në Sarandë me gjithë armët e municjonet e u dërguan në Janinë, ku janë edhe tash në burg!

PETRITI

Mjerisht e muarm vesh !

HAJDARI
(*Me habitje*).

Nga e muart vesht ?

GJENÇI

U lajmëruam nga Gjirokastra !

HAJDARI

Tradhëtori duket se e ka qendrën në Vlorë ! ...

TË GJITHË

A ! ...

HAJDARI

Si duket, ajy i ka ditur të gjitha të fshehtat t' uaja e ja ka kallzuar me shifra Valiut të Janinës !

PETRITI

O, tradhëti e poshtër !

LUMUA

Zjari e djektë e e shkrumboftë tradhëtorin !

HAJDARI

Po nuk më besohet të jetë Vlonjat ky, se Vlonjati, Shqiptari, nuk munt ta bënjë këtë tradhëti kaqe të fëlliqur !

SHPENDI

Ahere lipset të jetë ndo një i huaj !

HAJDARI

Sigurisht ashtu duket !

LULJA

Kush të jetë vallë ?

HAJDARI

Do të gjendet, mos u mundoni, as mos bëhi merak ! Po tani le të mos humbasim kohë; duhet t' ju kallzonj pse ardha këtu ...

PETRITI

Urdhroni, po dëgjojmë.

HAJDARI

Këtu ku gjendi jini tradhtuar të gjithë ! Lëvizjet t' uaja, fuqinë, e ç'do tjetër u a di hyqmeti[1] të gjitha që më pe e më gjylpërë pra, merni masat !

GJENÇI

Kush na ka tradhtuar edhe tani ?

HAJDARI

Pa dyshim, ajy që tradhtoj Skëndon e e zunë, ajy që tradhëtoj delegatët e Korfuzit, ajy ju ka tradhtuar edhe ju tanithi ! Duket se ajy është në korrent të plottë me mendimet e me lëvizjet t' uaja edhe ju duhet të hapni sytë e të mos flijni mbi trëndafilet !

PETRITI

Falemi nderit shumë që na lajmuat !

GJENÇI
(*Petritit*)

Kam frikë se mos është ndo një nga shokët tonë ! ....

HAJDARI

Atë dyshim mos e kini kurrë; ju siguroni unë, se Shqiptari s' e bën atë myxyrë të mallkuar ! Ju thashë se ësht' i huaj tradhtori. Sot s' munt t' ju a them, po do t' ju a them kur të vinjë sëra ! ...

[1] Hükmet = qeverija

LULJA

A ! ... E ditki zotrija juaj e s' na e kallzoni ?

HAJDARI

Mos u ngutni; ashtu është puna; duhet të sigurohem mirë dhe për këtë dhe duhet të mos dijë ajy që unë e njoh, gjer sa ti shtije shumë prova të gjalla në dorë, dhe pastaj ja japim dënimin që i meriton një tradhtori ! Tani, ju, lutem mos më shtrëngoni t' ju a them.

PETRITI

Si të dëshëroni.

HAJDARI

Unë këtë ardha t' ju them se, tre taborë po nisen sonte nga Berati me drejtim Cakranin dhe Vlorën dhe do t' ju bijen befas e pa pandehur ! Këtë s' e di tjetër kush veç meje. A i ruani mirë qafat e Sinjës dhe këto grykat e Mallakastrës ?

GJENÇI

Po i ruajm sa mundemi; kemi një fuqi të mjafnë të dy anët.

HAJDARI

Hapni sytë mirë mos t' ju marrin krahët ! Dua t' ju këshillonj të mos trembi, se fuqija që do t' ju bjerë është krejt e demoralizuar dhe mjafton të thyet rema e parë që të hedhin të .gjithë armët !

SHPENDI

Falemi nderit shumë për këto shpjegime që na jepni.

LUMUA

Këtë të mirë nuk do ta harrojmë kurrë !

HAJDARI

Un' e di fort bukur se këjo që bënj sonte është një vepër e dobët për mua, një shkelje detyre, një tradhëti, po e di mirë se, nuk jam tradhtor kur vinj të shpëtonj Atdhenë ! Përpara rrezikut ku ndodhet sot Atdheu, unë këtë e quanj një detyrë të shenjtë !

PETRITI

Të lumtë !

TË TJERËT

Na rrofsh sa malet !

HAJDARI

Nga ana e Vlorës mos kini merak se jam vetë dhe i mbanj në vezhgim gjith ata burrat patriotë që kemi andej e që po përpiqen si edhe ju këtej. Fundi i fundit unë jam me ju dhe posa që ta shoh hollë do kërcas me një herë e do vinj të bashkohem me ju !

LUMUA

Nder i math ky për ne Hajdar bej !

HAJDARI

Po ikinj dhe u pafshim për hair!

PETRITI

Zoti na mbaroftë qëllimet !

HAJDARI

Tu mirë mbeçi; ... kini mëndjen !... (*të gjithë e zenë për dore me mallëngjim*).

TË GJITHË

Vafshi shëndoshë! (*Hajdari del*).

Sqena 12

TË PARËT përveç HAJDAR BEUT

SHPENDI

A na e ka me të drejtë ky kajmekam beu ? Si thoni ju ?

PETRITI

Ç' kuvëndon, jahu ? Po të mos e kishte me të drejtë do vinte këtu këtë orë e do na tregonte sa na tregoj ? Mendohu ç' flet !

SHPENDI

S' di, s' di, po unë s' ju ze besë edhe aqe fort këtyre memurëve[1] !

LUMUA

E ke gabim; ti duket se s' e di se dajko Skëndua e ka bërë nacionalist këtë kajmekamin dhe sot është patriot i flaktë aqe sa nè ! Un' e di mirë sa pishman

[1] Memur = nëpunës shteti në Perandorinë Ottomane

është bërë ky për ato veprimet e para që ka bërë kundra nevet dhe sa na ka ndihmuar qysh atëhere.

SHPENDI

Makar, ashtu qoftë !

PETRITI

Le të pregatitemi shpejt. Ti Lumo me Shpendin lajmëroni të gjitha postat tona sa më parë .... *(Dalin gjithë jashtë veç Lules*).

Sqena 13

LULJA

(*vetëm*)

LULJA

Më bënë përshtypje të madhe fjalët e Hajdar beut! Duket se tradhëtori i ndyrë do të jetë ndo një njeri i njohur shumë me ne që po na e bën varrë pa kuptuar!...Po kush munt të jetë ky ? Hajdar beu e di po s' desh të na kallzonjë! Për se vallë s' na e tregoj tradhëtorin ? Ah, ta dinja kush është, mjaftonte ta dinja! Nuk do ti ndahesha këmba-këmbës ! Do ta grinja me këto thonjt' e mija; do t' ja mernja hakkun vetë ! ... Ah, ta dinja !...

Sqena 14

LULJA, MUSAJ

MUSAJ

(*Tuke hyrë*)

He, tu mbush mendja? Eja tani të nisemi të shkojmë për në Vlorë se kam gati edhe kafshët.

LULJA
(*Me inat*)

Të thashë, hiqu prej mejet; nuk munt të më bindësh kurrë të kthehem prapë!

MUSAJ

Nuk do vesh mënt më së fundi ?

LULJA

Trut' i kam në vent; e kam menduar thellë dhe mos u mundo kot ! Për mua s' mbet më as burrë, as nënë, as shtëpi, as gjë !

MUSAJ
(*Më vehte*)

Pa le ta marrim një herë me të mirë, se e shoh se me të egër nuk bindet kurrë ! (*Lules*). Moj Lule, ti nuk e merr vesh se të dua të mirën tënde ? Nuk e kupton se ardha të të shkëput që këtej, se s' të ka lezet ty, një grua e re të jetosh në mes të kaqe burrave të huaj ? Dëgjomë mua, se do shkojmë të lumur sa do na kenë zili bota !

LULJA

More Musa, mblidhe mendjen, se unë nuk kthehem e gjallë !

MUSAJ

Ti s' e di se kam qellim të largohem nga Vlora dhe prandaj kam marrë një muaj lejë të shkojmë më parë në Stamboll dhe atje do pres transferimin për në Izmir, ku do jetojmë një jetë fatbardhë e plot dëfrime !

LULJA
(*Me habitje*)

Qysh ? Paske marrë lejë për në Stamboll e po pret të transferohesh në Izmir? S'të pëlqen Vlora?

MUSAJ

Barabar e ke Vlorën me Izmirin ? Ku Vlora, ku lzmiri !

LULJA

Po ç' ishte shkaku i këtij transferimi kaqe të shpejtë ?

MUSAJ
(*Më vehte*)

Duhet t' ja them; më së fundi grua e kam le ta dijë. (*Lules*). Si të të them? Shkaku është se, ka disa kohë që po më shohin me sy të dyshimtë këtu në Vlorë.

LULJA
(*E kureshtuar*)

Pse ashtu ?

MUSAJ

Nacionalistët e Vlorës kujtojnë se mos jam ndo një spiun i Dovletit dhe i tradhëtonj !

LULJA
(*Gjithashtu*)

Spiun ti ? E pse ?

MUSAJ

Kujtojnë se merrem vesh me autoritetet e vëndit e u kallzonj të fshehtat e kryengritësve!

LULJA
(*I afrohet*).

I ke thënë ndo një gjë kajmekamit, ose .komandantit ?

MUSAJ

Unë ? Kurrë !

LULJA
(*Më vehte*)

Duhet gërmuar mirë të më kallzonjë. (*Musajt*). Në më ke grua edhe në do të të vinj pas ku do që të vesh duhet të më tregosh të vërtetën.

MUSAJ

Ç' të intereson ? Pse më shtrëngon kaqe fort ?

LULJA

Nuk e kupton ? Dua, si patriote, të shpëtonj këta të mjerët, që i kam më qaf' e sipër, pastaj ne vemi ku të dëshirosh !

MUSAJ
(*Me një bindje e decizjon*).

Ashtu ? Ahere do t' i them të gjitha, veç të qendrojnë midis nesh, mos na dalë ndo një fjalë jashtë.

LULJA

Dyshon prej mejet ? Ahere mos mi thuaj ...

MUSAJ

Unë të dyshoni nga ty ? Jo, kurrë; ty të kam grua dhe për ty e bënj këtë therori, se s' dua të të lè këtu në mes të zjareve prandaj edhe ngutem të shkojmë një or' e më parë që këtej ....

LULJA

Ahere folmë çgjeshur.

MUSAJ

Ç' kërkon të marrësh vesh prej meje ?

LULJA

Dua për shëmbëll, të di në vjen këtej ndo një fuqi ushtarake nga Berati, ose nga Janina t' u bjerrë befas nacionalistëve.

MUSAJ

(*Më vehte*)

Dreq, o punë, nga i ditka këjo këto hollësi që kërkon të vërtetohet prej meje? (*Lules*). Mbassi ma dhe fjalën se do vish me mua, po të them se nj' a dy tre taborë po drejtohen këtej nga Berati që t' i bijen Vlorës dhe Mallakastrës.

LULJA

Janë nisur, apo do të nisen ?

MUSAJ

Thuaj se janë nisur e po vijnë.

LULJA
(*Më vehte*)

Qënkan të drejta fjalët e Hajdar beut ! (*Musajt*) Ke marrë vesh se ç'u bënë ata delegatët që kishin shkuar në Korfuz për armë e municjone për komitat Shqiptarë ? E di ti se kemi folur për këta. tjetër herë bashkë.

MUSAJ

Po e di. Por, mbassi ma ke dhënë fjalën se do të jesh imja për gjithmonë do të të them edhe për ata. Pra, ata delegatë u zunë në Sarandë e u dërguan në Janinë ku janë edhe sot në burg.

LULJA
(*Kafshon buzët, po e mban*
akoma në zemër pikëllimin).

Po kush ja kallzoj qeverisë që mundi e i zuri ? Aman, mi thuaj të gjitha që t' u them edhe unë këtyre shokëve të mbledhin mëndjen e të mos vriten kot, se më vjen keq për këta. Kush i tradhtoj ?

MUSAJ

Shumë gjëra po më pyet ! Ç' të duhen ty kaqe hollësira ?

LULJA

Mbassi mi the të gjitha s' besonj të të pengonjë dhe këjo. Thuajm, pra kush i tradhtoj ?

MUSAJ

Një telegrafçi, miku im.

LULJA

Një telegrafçi miku jyt? Po, kush ja tha atij? Thuajma, të lutem, ta di; unë nuk i them njeriut, mbassi nè do shkojmë që këtej po vetëm se dua ta di. Thuajma ....

MUSAJ

(*Me një decizion*)

He, ... ja ... un' i thashë !

LULJA

(*Çohet përpjetë e egërsuar*)

Ti i the, ti? Ti i tradhtove ? Ti tradhtove edhe babanë? O, xhelat i mallkuar!... O faqe-zi ! ...

MUSAJ

(*I trembur*)

Lule, ç' bën kështu ? Ç' pate që u egërsove ?

LULJA

Edhe më të kem ? Edhe më ? Ç' bëre ashtu tu thaftë ajo gojë ! Nuk pate gjynah nga Perëndija ? Nuk u hap dheu të të pijë ?

MUSAJ

(*Tepër i çqetësuar i afrohet Lules ta zbutë*)

Lule, të lutem, mos folë kështu ...

LULJA

(*Tuke e shtyrë me indinjasjon*)

Largohu prej meje, katil i fëlliqur, mos më prek me ato duar të lyera në gjak ! ... Ti qënke, ti, qënke, ti, që po të kërkonja me qiri ?

MUSAJ

Lule, mos prish gjakun, mbahu, ç' janë këto që po thua ?

LULJA

Çporru, tradhtor i poshtër, gjakpirës i mallkuar ! Ke edhe sy e faqe të dalç para meje ! (*Ngreh duart përpjetë*). O Perëndi, si i duron këto shtaza me fytyrë njeriu ! O, i mjerë, qoft' e mallkuar ajo dit' e zezë që u bashkova me ty ! (*Më vehte*). Jam betuar ta vras vetë tradhtorin!.... (*Nxjer fshehtazi një kamë*).

MUSAJ

Lule, jakë ndër ment; leri këto tani dhe mbaj fjalën ...

LULJA

Fjalën ? Fjalën ? Ah !.. Na, pra ... vdis, faqezi tradhtor i poshtër! Kjo është fjala që kërkon ti !. .. (*E godit*).

MUSAJ
(*Rëzohet i plagosur për vdekje*)

Ah !... më .. vrave !...

LULJA

Ky shpërblim u meriton tradhtorëvet ! (*Musaj vdes*).

Bije napa.

Fund i Aktit të III.

A K T i IV.

(Theatri çfaq një odë të madhe të shtëpisë së Petrit Sulovës
në katundin Cakranj. Shtresa e mobilje alla shqiptare.
Një tryezë e gjatë midis odës dhe frona rrotull)

SKËNDUA e LULJA

LULJA

Oh, sa e gëzuar që jam i dashur baba, që të pashë dhe nj' herë në Shqipri! (*E përqafon*). Isha si peshku pa ujë lark teje !... Unë e di ç' kam hequr, po ta dish se të kam qëndruar besnike!

SKËNDUA

Të falem nderit fort, bija ime; po edhe unë në mes të andrallave që kisha gjith ty të kujtonja; ti e di sa të kam dashur ! (*Tuke e parë mirë në sy*). Po, ç'mora vesh pa ardhur mire ? Qysh ? E vrave ti vetë Musanë, burrin tent? Si e bëre këtë punë ?

LULJA

E vrava si një tradhtor ! ... Isha betuar për atë që na tradhtoj të gjithëve, se po ta mernja vesh do ta vrisnja vetë më dorën t' ime. Edhe kur u sigurova për këtë, e vrava !

SKËNDUA

Ishe e sigurtë se ajy ishte tradhtori jonë ?

LULJA

S' më mbet as një dyshim për atë; ma tha vetë. goja e tija !

SKËNDUA

Si takoj që ja zbulove të mfshehtat ?

LULJA

E mora me të mirë edhe mi kallzoj që të gjitha !... Ajy të tradhtoj ty, ajy tradhtoj delegatët që kishin shkuar për armë e u kthyen me ato nga Korfuzi, ajy tradhtoj gjithë lëvizjet tona, me një fjalë ajy ishte njeri i keq, një spiun i poshtër që paguhej prej Xhemijetit e na tradhtonte për dita, po ashtu si punoj e gjeti !

SKËNDUA

Ahere mirë bëre; qërove një plehë të fëlliqur ! Aferim !

LULJA

Nuk u ktheve nga Vlora kur ardhe ?

SKËNDUA

Ç' të bënja në Vlorë, apo të binja prapë ne duart e Xhonturqve, që mezi shpëtova prej syresh ?

LULJA

Kishe Hajdar benë aty që do të të delte zot, se edhe nevej na bëri shumë shërbime ky njeri i mirë !

SKËNDUA

Nuk ke marrë vesh gjë për Hajdar benë ?

LULJA

Jo, nuk di gjë !

SKËNDUA

E thirrë në Selanik dhe kur vajti atje me një herë e burgosnë, dhe e pushuan nga puna të shkretin !

LULJA

Si ? U burgos kajmekami jonë ?

SKËNDUA

Mjerisht, po, edhe së shpejti do të shkonjë nga gjyqi ushtarak e do gjykohet si tradhtor!

LULJA

Hajdar beu si tradhtor ? Ruajna, o Zot !

SKËNDUA

Si tradhtor, sepse na ndihmonte neve Shqiptarëve fukaraj !

LULJA

Oh, sa më vjen keq për të mjerin ! Dhëntë Perëndija e mos pësoftë gjë !

SKËNDUA

Dhëntë Zoti, po ta dish se më ka ardhur shumë keq kur e mësova, se ishte burrë i mirë e me ndërgjegje, një patriot i rallë. Ne i falemi nderit fort e fort se s' la kusur pa bërë për hatrin tonë, ose më mirë të themi, për Atdhenë, që e dëshironte ta shihte të lirë edhe ajy, si kur se nè. Neve na shërbeu shumë ajy njeri !

Sqena 2

TË PARËT, PETRITI, GJENÇI, SHPENDI

SKËNDUA

(*Tuke parë të tjerët*)

Ejeni, ejani ! (*Përqafohen*)

PETRITI

Qoft' e shkuar, zoti Skëndo !

GJENÇI

U bëmë shumë merak për ty !

SHPENDI

Kur paske ardhur ?

SKËNDUA

Ja, tani kam ca që arrita.

PETRITI

Ardhja jote ngushëlloj mjaft t' ët bijë, se s' kish derman !

SKËNDUA

Ja u kisha lënë amanet juve.

GJENÇI

E paç sa malet, zoti Skëndo, se Lulja na sbardhi faqen ! Ka luftuar krah për krah me ne, si një luaneshë !

SHPENDI

Ajo na e mori hakkun të gjithve me dorën e saj, se qeroj një tradhtor të poshtër !

SKËNDUA

Bëri detyrën e saja, hallall i qoftë ! Un' e di se ç' bijë kam ! (*E sheh në sy edhe qesh*).

PETRITI

Si shkove andej nga syrgjyni i Konjës ?

SKËNDUA

Nuk shkova edhe aqe keq. Për fatin tonë qëlloj që Valiu i Konjës ishte një Shqiptar i njohtur nga Leskoviku dhe na kishte lënë të lirë po thua, mua edhe disa Shqiptarë të tjerë që ishim bashkë. Atje buçiste kënga e vallja lapçe natë për natë !

GJENÇI

Prapë mirë!

SKËNDUA

Ç' e do, se kur u ktheva më ardhi shumë keq për kajmekamin e mikun tonë Hajdar benë, kur mora vesh se e kishin pushuar e burgosur në Selanik dhe se do ta shkojnë në gjyq ushtarak së shpejti !

PETRITI

Edhe ne tani e msuam e na ka ardhur shumë liksht për atë !

SHPENDI

Ajy i shkreti ra viktim për nè !

GJENÇI

Duhet të mundohemi me mish e me shpirt ta shpëtojmë !

SKËNDUA

E meriton, se ne jemi shkaktarët që u muar më qafë njeriu !

Sqena 3

TË PARËT, LUMUA

LUMUA

(*Skëndos*)

Dajko, ka ardhur një bajraktar prei Malësis së Shkodrës dhe kërkon të flasë me ju.

SKËNDUA

Si quhet ?

LUMUA

S' e mbanj ment mirë, se kishte një emër të ngatruar. Prit pak se e kam shkrojtur... (*Nxjer një copë letër e e këndon*). Prenk. ... Gjo .... Luci. ..

SKËNDUA

Po, po e njoh mirë, thuaji të urdhronjë brenda. (*Lumua del dhe për pak hyn së bashku me Prenk Gjo Lucin*).

Sqena 4

TË PARËT, PRENK GJO-LUCI

PRENK GJO-LUCI

(*Veshur malësorçe hyn brenda e saluton*)

Ju ngjatët jeta juj; si po jeni, o burrat e dheut ? (*I përshëndosh*)

SKËNDUA

Mirë, mirë, falena nderit që na begendistë ! (*Ulen*).

PRENKA

A keni mujtë ?

SKËNDUA

Ashtu, ashtu, e ju andej ?

PRENKA

Asha të madhin Zot, nè jena tue u gri andej me turkun ! As Turgut Pasha, as Xhavid Pasha kanë mujtë me na ba terbijet ! Na kan djegë e pjekë, por edhe na kena shkri e i kena shkatrue. Pasha të lumin Zot, Shqypnin s' kanë mujtë me shtrue aqe pashallarë, jo këta kopila, as që i kena shkue në hesap, po ç' ka se na kanë djegë troja e plangje sa u ka ardhë ndorje e kanë mytë gra e pleq ! …. Por ju knej shka po bani ?

PETRITI

Edhe nè po mundohemi sa na mundet !

PRENKA

Hallall u kjoftë buka, brè burra; bijni turkut sa të mufti ! Na kanë pi gjakun, horrat e horrave edhe mâ do ti durojmë ? Mâ mirë me dekë, se sa me ndejë nënë thundrën e tyne !

GJENÇI

Edhe ne ashtu po themi.

PRENKA

Na kena ardhë këtu për nji hall të math !

SKËNDUA

Urdhëroni !

PRENKA

Ju e dijni se Shqau na ka rrethue keq në Shkodër; po them për Shkodrën, se andej kah malcit tona ne s' kemi kambë turku, jena rahat tash për tash. Turqit kanë zanë vedin e s' po na kqyrin nè. Përkundrazi duen me na marrë me të mirë me u ndihmue kundra Karadakut e Serbit! Por nè s' jena mâ budalla ! Na do mendohena edhè për vedi tash, se mjaft jena shkatrue për Dauvletin !

SKËNDUA

Keni të drejtë !

PRENKA

Komandanti i ushtris turke në Shkodër, gjenerall Ali Riza Pasha nuk po mbahet më kambë ! Herët a von ka mu dorzue!.. Aj, thuj kah e mira, thuj kah e keqja, ka disa javë qi po na shtyn me i dalë zot vendit tonë e më ngrehë flamurin të kuq e t' zi mbi kalân' e Shkodrës. Na i thamë se kena me u mendue. Prandaj jam i çuem prej krenëve tanë për me u marrë vesh edhe me ju, me Toskallëkun,

qi, si Shqyptarë që jena, si ne, si ju, ta ngrehim së bashkut flamurin e shêjtë ! Hè, pra, si mendoni ju kndej ?

SKËNDUA

Bukur e kini mendue. Edhe ne me ju jena !

PRENKA

Atbotë duhet me caktue ditën, qi, njikohsisht ta ngrehim flamurin edhe ju edhe ne ! Na kena me dhanë kushtrimin gjith Malcive tona si dhe Hotit e Grudës, qi nji ditë me e shkundë pluhnin e randë e me u bâ m' vedi !

SKËNDUA

Bukuri !

PETRITI

A i zini besë Ali Riza Pashës ?

PRENKA

Në daç mos i xenë besë; keq ashtu, keq kështu; por ta dijni, brè burra, se Ali Rizaja asht nji burr' i ndershëm, e atjè ku t' ja dorzojë vendin Shqaut mâ mirë na e dorzon nevet. Nuku na rren burr' i botës, na e njofim tash kohet, bilè ka me na njoftë edhe Sulltani vetë, nè ashtu kujtojmë !

GJENÇI

Edhe llogjika ashtu e thotë !

SKËNDUA

Caktojeni ju ditën e ngrehjes së flamurit, nè jemi gati.

PRENKA

Mirë boll. Atëhera kena me ju lajmrue nè.

SKENDUA

Keni nevojë për të holla ?

PRENKA

Tash për tash s' kena nevojë, por si do kjoftë ju falena nderit fort. Pra, ma bani hallall se po ikij.

PETRITI

Urdhroni me shëndet.

SHPENDI

Ju qoftë rruga e mbarrë.

PRENKA

U pjekshim për hair, inshallah ! (*I përshëndet të gjithë*).

SKËNDUA

Shëndete të gjith vëllazënve tonë andej.

PRENKA

Me gjith qejf ! Lam tu mire ! (*del jashtë*).

Sqena 5

TË PARËT përveç PRENK GJO LUCIT

SKËNDUA

Si duket punët po shkojnë mbarë !

PETRITI

Ata janë burra një e një dhe do ta nxjerin mb' anë, po ne këtej si do bëjmë, që do na mbshtjellin armiqtë rrotull !

SKËNDUA

Mos e hump torruan se ka Perëndija edhè për nè !

LUMUA

Duhet tu falemi nderit Gegëve, se ata ja dhanë shuplakun e parë Osmanllisë! Grykat e Kaçanikiut e të Ferizoviqit, si dhe Malësit e tjera të Shkodrës janë dëshmorë të vërtetë të gjakut që është derdhur !

GJENÇI

Bravo u qoftë burravet !

LULJA

Rast i mirë për Gegët të ndodhet një Ali Riza Pashë që ti ngutë për çpalljen e lirisë ! Nuk është gjë e pakët !

SKËNDUA

Ç' i doni fjalët ? Puna vete mirë, po edhe nè duhet të hapim sytë, se rasti është shumë kritik !

Sqena 6

TË PARËT, THEMISTOKLIU, ÇERÇIZI, GRAMENUA

(*Të tre të fundit hyjnë tuke përshëndetur*).

THEMISTOKLIU

Të qoft' e shkuar, zoti Skëndo !

ÇERÇIZI dhe **GRAMENUA**

Shyqyr që shpëtove !

SKËNDUA

Ju falem nderit shumë, bujrum !

ÇERÇIZI

Tu ngjat' jeta, o Lule trime !

LULJA

Tu ngjat' jeta, kapitan ! (*Përshëndoshen*).

THEMISTOKLIU

(*Lules*)

Po qysh ja punove ashtu Musajt të shkretë ?

LULJA

Ishte një mësim për tradhtorët !

GRAMENUA

Më të lumtë krahu ! ... Ja bëre paq ! E kam thënë kjo ësht nga ato lllyrianet e vjetra, që ta marrin gjakun në vetull !

THEMISTOKLIU

Tani ti lemë këto fjalë, se puna s' pret. E mbani mënt kur ardha këtu e ju tregova planin që kishim bërë që t' i bijem asqerit të Turqisë kur të ktheheshe i mundur e të çpallnim vetëqeverimin tonë. Ajo ditë ardhi sot Turqija e ka shumë pisk, se Bullgarët i vajtnë në pragun e Stambollit, në Çatallxhë, Serbët kanë zaptuar Manastirin e po vijnë në Ohri, Grekët muar Janinën e Selanikun e tani po marshojnë për në Korçë dhe Malazijasit gati po hyjnë në Shkodër. Nè duhet të mos humbasim kohë, t' u bijem që tani, pa arritur armiqtë në tokën tonë. Tuke qënë marrë vesh edhe me Gegërinë, nè do fillojmë pushkën e do ngrehim flamurin, si nè si ata. Prandaj atë duhet të bëni edhè ju këtej. Qellimi "ÇPALLJA E VETQEVERIMIT TONË" !

SKËNDUA

Të gjithë me një mendje jemi, edhe nè këtej jemi gati.

ÇERÇIZI

Edhè nè nga Gjirokastra gati jemi; për atë qellim arthmë këtu.

GRAMENUA

Atë që do bëni ju andej, do bëjmë edhè nè.

THEMISTOKLIU

Kini marrë vesh gjë për Ismail Qemalin ?

PETRITI

Kemi dëgjuar se shkoj në Rumani të merret vesh me Shqiptarët e atjeshmë, po për këtë qëllim. Ajo lëvizje po bëhet edhe në Bullgari, në Misir e në Amerikë.

GJENÇI

Shqiptarët e Amerikës me anën e Federatës VATRA po i ndihmojnë mjaft çështjes tonë me të holla e me ç' tjetër munden.

ÇERÇIZI

U lumçin Shqiptarëvet të jashtmë ku do që janë !

THEMISTOKLIU

Tani s'kemi fjalë tjetër, o burra përpara edhe Zoti na qittë faqebardhë ! ... U pjekshim në një Shqipëri të lirë e veturdhronjëse !

TË GJITHË

Të lumtë goja ! (*Përqafohen të giithë*). (*Themistokliu del bashkë me Çerçizin e me Mihal Gramenon*).

Sqena 7

TË PARËT, përveç THEMISTOKLIUT, ÇERÇIZIT e GRAMENOS

LUMUA

Morè tamam, si e kishte parashëkuar Themistokliu ashtu ngjau !

PETRITI

Themistokliu ka ment gjenerali !

GJENÇI

Ësht' i vetëmi për kësish punësh !

SHPENDI

Ja pret mendja hollë edhe e nxjer më kut atë që thotë !

SKËNDUA

Ti Lumo shko e ju jep haber shokëve të mblidhemi sonte te rrapi e të marrim masat që duhen. Shëko pastaj na pregatitni edhe darkën. Shko edhe ti Lule me Lumon, se po të vjen doresh më mirë. (*Lulja me Lumon dalin jashtë*).

Sqena 8

TË PARËT, përveç LULES e LUMOS

SKËNDUA

A munt ta dijni, Petrit, se ç'fuqi ushtarake ka Turku në Berat e rrotull?

GJENÇI

Ju a jap unë atë përgjegje. Brenda në qytetin e Beratit nuk ka as 50 ushtarë dhe ata të hallakosur, kështu që Beratin e marrim shpejt në dorë. Nga an'e

Fijerit, të Lushnjës e të Roskovecit ësht' një fuqi fort e pakët, po për fat tonë ata janë Shqiptarë dhe bashkohen me nè.

SKËNDUA

Me fjalë të tjera ne këtej qënkemi mirë.

GJENÇI

Jemi ashtu si e duam nè e e dëshërojmë.

PETRITI

Nga an' e Gjirokastrës më duket se ka shumë fuqi, se po kthehet edhe ajo e Janinës, me gjith që është e shkatruar e po dezerton për dita, po kemi besim të plottë në Kurveleshasit e Delvinjotët, pastaj janë edhe Çamët e Konispolit me ata.

SKËNDUA

Atëherë qënka mirë edhe andej.

SHPENDI

Duket se është fati i Shqipërisë të na venë punët aqe mbarrë sa nuk e pandehnim !

SKËNDUA

Ashtu duket, veç Zoti përpara !

GJENÇI

Besa, po, si këtë herë kurrë s' kemi qënë, Sot, si duket, i ardhi fundi Turqisë dhe do ti lanjë duart nga Shqipëria !

PETRITI

Insaf!... Ardhi thika në koskë. U mbush kupa!...

Sqena 9

TË PARËT, LUMUA, LULJA

LUMUA

(*Skëndos*)

Për një orë janë gati të gjitha. Sonte do hani darkë të hani poshtë për mê siguri.

SKËNDUA

Ç' ka.

LUMUA

(*Nga dale Skëndos*)

Ka ardhur një komit i armatosur me një mjekër të zezë, me një mveshje tamam si tonat, po e mban suratin e mbuluar e nuk desh të më kallzonte kush është. Si duket është Shqiptar. Kërkon t' ju shohë e të flasë me ju.

SKËNDUA

Kush të jetë ky? Mos është prapë ndo një spiun ? A e pyete si mundi e kaloj këtej e pse u mundua gjer këtu ?

LUMUA

E pyeta, po nuk desh të më tregonte.

SKËNDUA

Cili të jetë vallë ? (*Lumos*) Po a më njeh mua ky ?

LUMUA

Si po duket ju njeh, se vetëm juve kërkon t' ju flasë.

SKËNDUA

Myster ! ... Neise, thuaji të vinjë brenda. (*Lumua del e m' andej kthehet në sqenë me të panjohturin).*

Sqena 10

TË PARËT, I PANJOHTURI

I PA NJOHTURI

(*Hyn tuke përshëndetur shqiptarisht me dorën në zemër*)

SKËNDUA

Urdhroni, urdhroni.... Mos kij të drojtur, po folë haptas kush je zotrote e pse je munduar gjer këtu ?

I PANJOHTURI

Ma falni besdinë, po ishte nevoja të vinj këtu ...

PETRITI

(*Veçanërisht*)

Or, më duket se e njoh këtë zë !

GJENÇI

Edhe mua ashtu më vjen; zër' i njohtur ky !

SHPENDI
(*Gjençit e Petritit*)

Kush të jetë ky ?

SKËNDUA

Shtektar i mirëpritur, ju lutem, përpara se të hapim bisedim së bashku është nevoja të dijmë se kush jè; pra, ju lutem nxireni ca më parë atë maskë nga fytyra juaj, që t' ju njohim. Zotrote, si më ngjan mua, nuk je njeri i huaj për nè, prandaj mos na mbaj në dyshime akoma !

I PANJOHTURI

Kini të drejtë; do më njohini tani ! .... (*E nxjer maskën nga fytyra*).

TË GJITHË
(*Posa e shohin*)

O ! ... Kajmekam beu ! (*habiten*).

SKËNDUA

Si kështu ? Hajdar beu këtu me ne ?

HAJDARI

Unë jam i tëri e mos u çuditni ! (*Të gjithë një nga një sulen e e përqafojnë*). Mir se ju gjeta ! ...

TË GJITHË

Të lumçin këmbët që ardhe !

HAJDARI

Ndofta ju vjen çudi qysh e pse më shëkoni këtu dhe si kam shpëtuar e kam ardhur i gjalli, po prisni se do ti dëgjoni të gjitha.

PETRITI

S' na durohet gjer sa ti msojmë !

GJENÇI

Urdhroni, se po dëgjojmë. E para ju urojmë që shpëtuat mirë.

HAJDARI

Falemi nderit shumë !.... E muart vesh se isha pushuar nga puna e se isha hequr në gjyqin ushtarak të Selanikut të gjykohem si tradhtor i Dovletit...

SKËNDUA

Si urdhron, e kemi marrë vesh edhe na ka ardhur shumë keq !

HAJDARI

Gjyqi ushtarak i Selanikut më dënoj për vdekje, se pata tradhtuar Vatanin dhe Sulltanin!

SHPENDI

Për vdekje ?

HAJDARI

Po, në litar ! Dhe do të isha eksekutuar dhe sot do mos kisha fatin të vinj këtu t' ju shoh e të më shihni !

SKËNDUA

Taksirat-madhi !

PETRITI

Si të shpëtoj Perëndija ?

HAJDARI

Pata fatin e math që ra Selaniku dhe hyri brenda ushtrija greke ! Kështu Turqit u çakërdisnë dhe s' kishin kohë të më vijnin në litar ! Disa njerës të mirë vrapuan e na hapnë burgun dhe duallm të gjithë jashtë. Si kur të paskeshin vonuar edhe nj' a dy orë, ne s' ishim sot në jetë !

LUMUA

Ju shpëtoj Perëndija

SKËNDUA

Kur paska ditët e gjata njeriu kot janë të gjitha ! Hè pastaj ?

HAJDARI

Kështu shpëtova me kulaç për brezi !

LULJA

Po si munttë e kaluat gjer këtu ?

HAJDARI

Ajo është një histori e tërë; munda të mar një pashaportë greke e të hipinj në vapor, tuke ardhur në Pire; prej andej ardha në Korfuz dhe prej Korfuzit u hodha me një lundër në Himarë; fshehtas nga Himara kalova Llogoranë i panjohtur, u bashkova me disa komita tanët prej Labërije dhe u mvesha kështu si më shëkoni e ardha këtu !

SKËNDUA

Shyqyr që arrive shëndoshë dhe qofshin të shkuara të gjitha.

HAJDARI

Ju falem nderit të gjithëvet ! Tani jam me ju, ashtu si e kam dëshëruar, gati të vdes me ju bashkë, tuke luftuar krah për krah me ju tiranët shekullorë! Pra, më quhani vëllanë t' uaj, si edhe unë ju quanj e ju kam vëllezër !

SKËNDUA

E di vetë Perëndija ! Zotrote e tregove gjakun e fisin tënt me gjithë fisnikërin' e duhur, se na ndihmove kaqe shumë, sa edhe veten vure në rrezik për nè, po të shpëtoj Zoti !

PETRITI

Ne ju jemi mirënjohtës për jetë për shërbimet t’ uaja !

HAJDARI

Bëra vetëm detyrën t’ ime faqe Atdheut të dashur ! Tani duhet t’ ju them se, me gjithë shkatrimin e plottë që pësoj Turqija, ne s’ duhet të flemë më atë krah, sepse duhet të mentojmë se ushtrija që po kthehet, sa do që e ka humbur moralin, po ësht’ e urët e do të derdhen mbi nè si sorrat e Qiellit. Hapni sytë

mos i lemë të marrin frymë. Të ruhemi se mos na plaçkitin e mos na djegin në deshprim e sipër që kanë, Xhavid Pasha po kthehet këtej bashkë me Kara-Seid Pashën me 70,000 e sa ushtarë të ngordhur nga urija, se s' kanë as bukë të hanë. Gjendja e tyre është për të vajtuar, prandaj të ruhemi më fort ! Janë të grisur e të reckosur të gjithë, prandaj tani është koha të hanë shukretën e fundit prej nevet ! Ta dijni se po ju ramë edhe nè përsipër me gjith fuqinë tonë, ata do të hedhin poshtë armët e kështu do mbushemi edhe me armë !

SKËNDUA

Nuk do lemë kusur pa bërë !

HAJDARI

Harrova t' ju them se, kur dolla në Korfuz pashë një koxha flotë greke që po pregatiteshe të vinte në ujrat e Vlorës, pra, kini mendjen edhe për këtë.

PETRITI

Do përpiqemi sa të mundim !

HAJDARI

Edhe një tjetër më dolli mentsh ... Të ruhi shumë nga dhëndri juaj Musaj, se është një tradhtor i qelbur e ju ka tradhtuar gjithë !

SKËNDUA

Ajy na e mori të keqen !

HAJDARI

Si ? Pa më thoni !

SKËNDUA

E vrau me dorën e saj këjo bija ime Lulja asllanja

HAJDARI

Ashtu ? (*E ze për dore*). Bravo të qoftë ! Ja bëre mire ! Prandaj po e shoh edhe këtë komitaxheshë !..... Unë i shkrova Valiut në Konjë që t' ju ketë kujdes, se është Shqiptar.

SKËNDUA

Falem nderit shumë edhe atij edhe juve, Me të vërtet shkova mirë unë edhe Shqiptarët e tjerë që ishin në syrgjyn !

HAJDARI

Tani të vijmë prapë në çështjen tonë; Do ta kini marrë vesht se në Shkodër Ali Riza Pasha, komandanti përgjithshmë i ushtrive atje, i ka ngutur Shqiptarët të grehin flamurin ! ...

PETRITI

Si urdhron, e dijmë.

HAJDARI

Po, mjerisht, Ali Riza Pasha u vra me të pabesë në Shkodër !

SKËNDUA

Folë mirë ! Kush e vrau ?

HAJDARI

Essad Pashë Toptani !

TË GJITHË

Qoftë i mallkuar tradhtori

HAJDARI

E vrau se ishte paguar nga Serbo-Malëzijasit t' u dorëzonte kalan'e Shkodrës ! Me qënë se Ali Rizaj kundrështonte, Essadi e vrau, se nuk desh të ngriheshe flamuri kombëtar !

TË GJITHË

Tradhtor i fëlliqur !

HAJDARI

E ftoj një natë për darkë, dhe kur po delte nga Fush' e Çelës e vrau tradhtisht ! Pra, Essadi na tradhtoj edhe kështu vdiq edhè ajo shpresë që kishim në Shkodër !

SKËNDUA

Ah, sa na pikllove zembrat ! Durim !....

HAJDARI

Tani duhet të bazohemi mbi krahët tona; kurajo e durim ! Lumërisht ndo një frikë që për brenda nuk kemi aqe të madhe, se ushtrit turke nuk do na bëjnë gjë, se kanë zënë hallin e tyre, veç të ruhemi ashtu si ju thashë. Pa shkelur vendin tonë beligjerantët Ballkanas nè duhet ta kemi ngrehur flamurin. Ashtu do bëjnë dhe viset e tjera të Shqiprisë. Do ta ngrehim flamurin me një kurajo e pa frikë dhe do betohemi të gjithë VDEKJE a LIRI!

SKËNDUA

Do ta bëjmë edhe këtë dhe Zoti përpara !

HAJDARI

Mos u trembni, se shpresonj se do ta fitojmë qëllimin !

TË GJITHË

Dhëntë Zoti !

HAJDARI

Nga ana tjetër duhet ta dijni se kemi edhe miq përjashta që na ndihmojnë, si do mos dy nga më të mbëdhatë fuqi të Evropës, Italinë dhe Austro-Hungarinë!

TË GJITHË

Rrofshin shpëtimtarët tonë !

HAJDARI

Për këtë qellim ka shkuar edhe Ismail Qemal beu në Vjenë e si kam marrë vesh, me pëlqimin e graf Bertholldit dhe të marqezit San Giuliano ajy këto ditt vjen në Durrës të ngrehë flamurin kombëtar dhe të çpallë vetëqeverimin e Shqipërisë! O burra, pra, mos humbasim kohën, se kjo kohë është flori për nè ! ... Poshtë Tiranët ! Poshtë robërija shekullore, rroftë Shqipriia e lirë, rroftë Flamuri !

TË GJITHË

Rroooooooooftë !...

Bije napa

Fund i Aktit të IV

T A B L L O

(Theatri çfaq një shesh në të hyrën e Vlorës, ku sot është Sheshi i Flamurit. Nga an'e mëngjër duket rruga publike e Skelës së Vlorës. Në funt te sqenës figuron shtëpija e Xhemil bej Vlorës me një ballkon përpara. Nga an' e djathtë një tjetër rrugë e disa shtëpi. Në ngrehjen e perdhes çfaqen në sqenë, Skëndua, Petriti, Gjençi, Shpendi, Lulja, Lumua dhe Hajdar Kaloshi)

Sqena 1

SKËNDUA

Shokë ! Ndodhemi në ditën e fundit të tiranisë turke ! Turqija po lan duart nga gadishulli i Ballkanit dhe nga vendi jonë dhe për ne po shkrep sot Dielli i Lirisë!...

TË GJITHË

Rroftë Lirija !... (*Duartrokitje*)

SKËNDUA

Me gëzim të math po ju lajmëronj se Ismail Qemali jynë ardhi pardje në Durrës me disa delegatë Shqiptarë prej Rumanije e prej viseve të tjera të Shqiprisë me qellim të ngrehë Flamurin e shenjtë kombëtar në atë qytet !

TE TJERËT
(*Brohorisin tuke duartrokitur*)

Rroftë Flamuri !

LULJA

Rroftë plaku i Vlorës

SKËNDUA
(*Vazhdon*)

Nuk dihet se për ç' shkak komandanti i Durrësit Hamid bej Toptani nuk e la Ismail bejnë ta ngrehë Flamurin atje, po, si duket, janë arësye të tjera që do ti msojmë më von. Nè, kur muarm telegrafin e Ismail Qemalit që na pyeste "a do mundë të vijë në Vlorë e të ngrehë këtu atë Flamur" ju përgjiqmë me enthusiazmë që të niset ca më shpejt, se po e presim si ujin e ftohtë, gati për ç'do therori !

TË GJITHË

Mirë se të vinjë !

SKËNDUA

Dhe muarm me një herë përgjigje se u nis q' atë ças nga ana e Lushnjës dhe tash që po flas me ju Ismail Qemali me shokët janë tuke ardhur!....

TË GJITHË

Rrofshin patriotët e vërtetë ! (*Duartrokitje*).

SKËNDUA

Nè do ti presim me krahë hapur me gjithë zembër ... (*fshin sytë prej mallëngjimit*) dhe ... me gjith shpirt !

TË GJITHË

Mir se të na vijnë ! (*Brohorisin. me enthusiazmë*).

PETRITI

Pse nuk vijnë nga an' e detit ?

SKËNDUA

Se, përveç që s' ka vapor për dita, po janë edhe arësyje të tjera politike, për të cilat nuk është nevoja të këshillojmë plakun e Vlorës ! (*Lumos*). Ti Lumo, shko e jep kushtrimin të mblidhet i math e i vogël këtu, burra e gra, se po presim shpëtimin t' onë. (*Lumua del jashtë*).

GJENÇI

Duhet t' u gjejmë vent këtyre mysafirëve ....

SHPENDI

Sa për vent kemi sa të duash, mjafton të vijnë ...

SKËNDUA

Kemi oxhakun e Sharrajvet…. Jemi marrë vesht me mikun t'onë Hasan Sharrën, i cili me gëzim të patreguar do ti çelë dyert e shtëpis së tij për këtë qellim!

PETRITI

Ahere qënka mirë ! ...

LULJA

Do ti presim me krahët hapur; mir se të na vijnë !....

Sqena 2

TË PARËT, THEMISTOKLIU, ÇERÇIZI

TË DY TË FUNDIT

(*Hyjnë me një ngutsi të madhe*)

Hapuni, hapuni.

TË PARËT

Ç' është, ç' është ?

THEMISTOKLIU

Po vijnë, po vijnë …. (*Një brohori e një enthuiasmë e pa treguar*) ...

SKËNDUA

Rrjeshtohi të gjithë përsë-gjati ! (*Populli rrjeshtohet*). Sot nuk është as Pashkë, as Bajram ... është një kremte tjetër, m'e madhe e m' e shenjtë nga gjithë kremtet e tjera! Hapuni… (*Dëgjohet për së largu kënga me anë korit*)

Për Mëmëdhenë, për Mëmëdhenë
Vraponi, burra, se s' ka me prit,
Të vdesim sonte, nè dhamë benë,
Pranë Flamurit të·kuq, q' u ngrit !

(*Në mbarim të këngës hyn në sqenë kori dhe pasojnë Ismail Qemali me delegatët e tjerë e me popull. Ismail Qemali, i baltosur prej udhe përshëndet,me buzëqeshje popullin, i cili brohorit me enthusiazmë të madhe, tuke fshirë sytë prej lotësh, ndër sa plaku i Vlorës hyn në shtëpi të Xhemi beut e merr vent në ballkon. Aty nxjer e zhvillon Flamurin kombëtar*

dhe në. mes një një freniti të patreguar të brohorive e duartrokitjeve, ngul Flamurin mbi ballkon)…

TË GJITHË

Rroftë Flamuri ! Rroftë Shqiprija !... Rroftë Ismail Qemali! (*Brohoritje të parreshtura*)

ISMAIL QEMALI
(*Në mes të një pushimi të thellë fillon të flasë me një zê të mallënjgjyer*):

P o p u 11 S h q i p tar ! "Agoj dita e shenjtëruar ! Me vullnetin tonë të pa-epur dhe me gjithë deshirën e shpirtit, sot po ngrehim edhe një herë FLAMURIN tonë të shenjtë, FLAMUR1N e famshëm të Kastrjotëve dhe, po çpallim vetëqeverimin tonë ! (*Populli brohorit sa munt*) …. Vargonjt' e robrisë së mallkuar shekullore u zhduknë sot !Sot fryn erë lirije në vendin tonë, në vendin e fatosave të përmendur në botë. Në këtë Flamur kryenaltë të Skënderbeut përshëndetni të gjithë shpëtimin tonë, lirinë, vetësundimin e Atdheut ! (*Brohoritje e lote*). Betohemi të gjithë përpara këtij, se do ta mbrojmë me mish e me shpirt gjer në pikën e gjakut të fundit ! (*Brohoritje e betime. të gjithë ungjen më gjû e tuke ngrehur duart përpjetë betohen*). Ky është Flamuri jonë, shenja e emblema e Lirjsë e e vetësundimit

TË GJITHË

Rroftë Flamuri !. Rroftë Vetësundimi për jetë!.... Rroftë Kombi e Atdheut (*Në mes te këtij enthusiazmi Skëndua del përpara Flamurit dhe me zê të fortë, sa edhe të ngashruar ligjëron*):

Valo, Valo, si të ka hije,
Shkrep, po si Dielli vetëti,
Flamur, emblemë trimërije,

Valona sot në Shqipëri !....
Po unjim gjunj e t' adhurojmë,
Dhe po të shofim sy ndë sy,
Dhe BESA-BESËN të betojmë,
FLAMUR, të vdesim nè për ty !...

SKËNDUA

Rroftë FLAMURI KOMBËTAR !

TË GJITHË TË TJERËT

Rroftë Shqiprija e lirë !

SKËNDUA
(*Me mallëngjim fshin sytë*)

Tani... le ... të vdes !!!

(*Midis duartrokitjeve e brohorive*
muzika exekuton hymnin e Flamurit,
tuke qënë më këmbë gjithë populli.
Pas hymnit të Flamurit dëgjohet
hymni Mbretnorë).

Bije napa.

Fundi i tabllosë e i gjithë dramës.

SHËNIM I HENRIK KAÇULINIT :

Ngjarjet e kësaj drame janë treguar më hollësisht nga Kristo Floqi tek "AUTOBIOGRAFIA IME". Janë ngjarje të ndodhura realisht dhe jo "fiction". Ngjarjet në telegraf-hanen e Vlorës më 1909 K. Floqi i ka treguar me hollësi në autobiografinë e tij, ku ai ka qenë pjesmarrës aktiv. Ai ka qenë një nga të përndjekurit e Xhon-turqve, dhe për këtë arsye ai u detyrua të emigrojë për të parën herë në Amerikë.